

Sabri Godo



Kohët
që shkijnë,
kohët
që vijnë

PËRSHKRIME DHE REPORTAZHE

8-413
863

Sopu Gao

REDAKTOR
ARDIAN KLOSI

KOHE^T

QE SHKONE

KOHE^T

QE VINE

berspurme die telefonaxpe

SHETTA BOTUKE MAM TASHIRI

KALËRIMI I GJATË MBI DRIN

Kurora e dytë

Ruga e asfaltuar në pyjet me ah. Më tej fillon pisha. Në qafat dhe majat shfaqen skele me përkrenare, dyzet metra të larta. Telat e trashë prej alumini shndritin në qiell. Është «qarku i dytë» i Fierzës». Njeriu ndien se po ecën drejt një burimi të fuqishëm energjie, që përhapet mbi shpatet e maleve.

Ruga malore është plot me befasi. Drini i shndërruar në liqen të gjatë, të blertë, si pyjet që përshkon. Pastaj diga, masivi kolosal që ka zënë rrjedhën e lumit. Në mes të digës kalon një «qilim» ngjyrë tulle, në të dyja anët e «qilimit» shtresa me zhavorrin e hirtë, në anët e jashtme, shtresa me gurë të bardhë. Në shpinën e digës lëvizin mjetet e rënda, që duken nga lart si ca buburrecë metalikë të gjëzuar, ndërsa njerëzit mezi shquhen.

Ngjyrat e digës, gjallëria e saj, krijojnë një kontrast të fortë me luginën e ashpër. Përtej digës, që ka filluar të mbajë liqenin e blertë me dy miliardë m^3 ujë, vazhdon rrjedhën Drini i holluar, si një vijë mellani, për t'u takuar pak më poshtë me Valbonën e lirë e të kal-tër.

Këtu duhet të përbash thirrjet e habisë. Fotoreporteri, që është edhe shofer, ngutet të fotografojë, me lëvizjet e njeriut që ka rënë në një pre të madhe. Më duket se mundohet më kot. Diga dhe liqeni kanë përmasa që nuk i nxë fokusi i aparatit.

1

Fierzën duhet ta shohësh pjesë-pjesë.

Në të djathtë janë tunelet e shkarkimit. Një i porsaardhur nuk e gjen lehtë hyrjen e tyre, sepse në mal janë hapur edhe galeri anësore, pa të cilat heqja e dheut dhe e gurrevë do të kishte zgjatur pesëdhjetë vjet.

Tunelet e vërteta të kësaj ane janë katër. I pari, ai që devijoi Drinin gjatë punimeve, është mbyllur përjetë me një tapë betoni. I dyti është taposur gjithashtu me një konstruk-sion metalik për t'u hapur në raste të veçanta. I treti shkarkon një pjesë të ujërave të tepërtë, menj shpejtësi të rrallë në lëmin e hidroteknikës botërorë.

Poshtë, në shtatin e lumit, ku janë vendosur në trajtë amfiteatri bloqet e mëdha të betonit, është pika e «shuarjes së energjisë». Tani aty sundon qetësia. Grykat e tuneleve rrinë në përgjim. Lëviz vetëm uji i paktë, që kalon nga tuneli i tretë sa për të sajuar Drinë.

nin. Sikur tē lëshohej plot gojēn ky tunel, një katarakt i madh do tē kërcente qindra metra nē ajér, do tē gjëmonte me shkumë e tym tē bardhë lugina, një shi i vërtetë do tē binte nga lart, i sajuar nga pikat e ujit tē hedhura me një rreze 2 km. Kjo është bërë vetëm një herë, kur u desh tē ulej fare pak liqeni. Jo çdo gazetar ka fatin ta shohë me sytë e tij «shuarjen e energjisë».

Më lart ndodhet tuneli 4, që është nē përfundim. Kur vizatoheshin nē letër këto tunele, shkencëtarët thanë se prurja më e madhe e Drinit ngjan një herë nē dhjetë mijë vjet. Projektuesit thanë se do tē llogaritnin që tunellet tē shkarkojnë lirisht ujin që mund tē sje llë Drini qoftë edhe një herë nē dhjetë mijë vjet.

Pyes një minator nëse ka dëgjuar për ujin që sjell Drini një herë nē dhjetë mijë vjet. Ai s'ka dëgjuar një gjë tē tillë. Thotë se këtë duhet ta dinë inxhinierët dhe Xhemë, brigadieri i vjetër.

* * *

Po Fierzën s'mund ta shohësh pjesë-pjesë. Për tē kuptuar mekanizmin e madh që lëviz nën beton, duhet tē kthehesë nē kantier, nē zyrën e skemave, aty ku vepra zvogëlohet mijëra herë.

Skemat e ngatërruara varur nē mure zënë e qartësohen për mrekulli, marrin shpirt. Të duket se edhe vetë mund ta kishte projektuar një gjë tē tillë kaq tē thjeshtë. Thjeshtësia është veti e gjenialitet tē vërtetë. Megjithatë duhet një bisedë prej dy orësh që tē

shpjegohen këto gjëra të thjeshta. Sa më thellë hyn në të, aq më tepër bindesh se thjeshtësia ka shpirtin e vet, ajo nuk është një ekivalënt i lehtësisë.

I kthehem digës, kësaj here i pajisur me «të dhënë teknike», me njohuritë e duhura përtë kuptuar. Prapë shikon se në çdo hap ke ende përtë mësuar.

Fillon ngjitja e digës, një llogara në miniaturre, me shtatë kthesa. Në rrugën e saj të gjerë ecin kamionët 32-tonësh. Shoferët, që nga kabinat e vogla me xham, përshëndetin këmbësorët. Gurët kthejnë mbrapsht rrezet e pingultat të diellit. Shtohet nxehësia.

Sipër, në kurrizin e digës, ajri është më i lehtë. Masivi që ke nën këmbë të komunikon një ndjenjë fuqie. Duhen përtypur fjalët që të tregosh përdimensionet e vërteta të digës. Mbështetje mund të bëhet më mirë me anë të krahasimit. Krahasimi më i goditur më duket ai që thotë: Me lëndën e derdhur në këtë digë mund të ndërtohej një mur që të rrethonte tërë vijën e kufirit të Republikës.

Në të majtë del mbi liqen vepra e marrjes, me dy konstruksionet masive prej betonarmeje. Të dyja kullat qëndrojnë mbi liqen të vetmuara, autoritare. Rreth tyre pluskojnë qeninë të gjalla. Notojnë njérëzit. Kulla e parë pengon kalimin e drurëve. Kulla e dytë, 84 metra e lartë, është porta e katër tuneleve, në dy të tretat e gjatësisë së blinduar, që çojnë ujin në turbinat. Blindazhet e rënda ecin nën tokë. Prapë jehojnë në ajër ato fjalët «vepër e rrallë në lëmin e hidroteknikës». Qenkan një varg me objekte «të rralla», që sajnjë tërësinë e veprës. Në grykat e tuneleve me blindazh të rë-

ndë të duket se ndodhesh para disa gypave me shkëlqim të errët që synojnë thellësitë e mëdha të tokës. Në këtë anë të veprës nuk sheh gjë tjetër në sipërsaqe. Në sy të mbeten vetëm të dy kullat, të cilat janë në marrëdhënie të nënüşhme me liqenin. Më e vogla prej tyre është sa hoteli i ri i Tiranës.

Ecim në digë, që është më e madhja e llojit të vet në Evropë. Përmes kurrizit të saj të sheshjtë kalon vija ngjyrë tulle e argjilit. Kësaj i thonë «bërthama argjilore», e mbështetur në një «jastëk» betoni të trashë. Brenda këtij jastëku janë ndërtuar galeritë, «për të krijuar, me anë të injektimit të solucionit të çimentos, perdet kundër filtrimit». Veprat e thjeshta nuk janë më të lehtat. Këtu kanë punuar për dy vjet e gjysmë 250 punëtorë, me tri ndërresa, me porosi të prerë që të mos ketë asnje lëshim në cilësinë.

Pesë vjet më parë, kur zgjidhej vendi për themelit e kësaj dige, u gërmuan tridhjetë metra thelli si shtratin e lumit për të gjetur bazën shkëmbore. Pastaj u la e u pastrua guri, derisa shkëlqeu si dhomë pritjeje, dhe nisi bëtonimi i themelit të bërthamës prej argjili. Kjo digë masive, mbi të cilën u hodhën tetë milionë m^3 materiale, është e lidhur me shkëmbin e dheut, e llogaritur për t'u qëndruar fenomeneve sizmike e hidroteknike. Kjo digë e lartë dhe e fortë do t'i qëndrojë yetë kohës.

2

Brigadier Xhemë ka shkuar për furnizim. Sabriu, minatori i ri prej Lure, tregohet i gatshëm të vijë me ne për të gjetur brigadierin.

Një orë më pas që të tre pimë në klub birrë të freskët me vezë të ziera.

— Ke bërë mirë që shoqërove mikun... për hir të punës e të sjelljes, — i thotë Xhemë Sabriut.

Fytyra e pashme e djaloshit skuqet prej kë-naqësisë. Ai ka një trup prej atleti. Është aq «i shkathët», sa ta kapë në ajër atë që i thua. Por veçanërisht «i shkathët» ndaj atyre që thotë e bën brigadieri, dhe të kujton një pinjoll të lumtur që del në botë duke ecur në gjurmët e të atit.

— Njeriu nevrik has pengesa, — thotë prapë Xhemë. Nuk kuptohet nëse kjo ka lidhje me dikë aty, në furnizim, apo është një këshillë përdjalin.

Xhemë, prej Armit të Kukësit, është 46 vjeç, me lëvizjet e ngadalta të një punëtori të vjetër me kasketën shrembër. Ka qenë në Bitricë, në Vaun e Dejës, dhe prej nëntë vjetësh në Fierzë.

— A do të shkoni në Koman?

— Nuk i dihet se ku na çon ndërmarrja. Dëshirën e kemi.

I them se ndofta ka punë dhe e pengoj.

— Do të rrojmë sa kemi rrojtur, jo më shumë. Kemi mall të rrimë pesë minuta me një shok, s'po na del koha, — thotë ai.

— Xhemë është komunist, — thotë Sabriu i skuqur flakë.

Xhemë hesht. E kupton djalin. Djali gjëzohet, krenohet për Xhemën si për babën e vet.

I recitoj Xhemës një strofë për të qeshur.

— Si, si?

Ai zgjat kokën. Kur ia përsërit, fytyra i merr dritë.

Ky burrë është i lidhur me tokën si diga

me shkëmbin. Ai përhap rrreth vetes qetësi. Unë përpinqem të eci me ritmet e tij, të flas ngadalë, pa fjalë të urta. Xhemë nuk është maledor i fjalëve të urta, të zgjedhura. Ato që thonë vijnë nga brenda, të vërbeta e të thjeshta.

* * *

Kur brigada e tij u shpall heroinë, Xhemë u thirr në Tiranë. Ishin Festat e Nënëtorit. Qëndroi aty pesë ditë. Zëri i tij i butë bëhet edhe më i ulët. Ai habitet edhe sot. «Kush isha unë, që më çuan para gjithë udhëheqjes!» Pastaj e çuan në pritjen e Pallatit të Brigadave dhe aty ishte shoku Enver.

— Nuk i lahemi kurrë Partisë.

Xhemë dredh cigare. Për miqtë mban paketë.

— Sabriu punon këtu prej viti 1972. Shkoi ushtar dhe u kthyesh përapë. Tani mëson natën për elektricist, — thotë Xhemë, duke ngritur mbi djalin një gisht paralajmëruesh.

Djali, i rritur nën hijen e Xhemës, u kap në befasi, lëviz i shqetësuar, kërkon me ngut në mendje ndonjë gjë që mund të mos e ketë bërë mirë. Sytë e Xhemës i thonë se gjërat ecën si duhet, veçse ai, si djalosh, gjithnjë të ketë kujdes. Djaloshi ka dëshirë të porositë tri birra nga ana e tij.

— Jo, — thotë Xhemë. Kur thotë ai jo, kuptohet se s'mund të jetë ndryshe. S'kam parë njeri tjetër, që ta ketë pohimin ose mohimin aq përfundimtar. Ndofta kjo anë e karakterit të tij lidhet me punën, ndofta i tilljë është ai vetë. Atij nuk i rronin fëmijët. I kishin vdekur pesë njëri pas tjetrit, pa mbushur vitin. Po në Tiranë e gjetën shkakun dhe jeton fëmija

i gjashtë, vajza që po hedh shtat plot shëndet.

— Në dasmë të vajzës, Xhemë!

Një mallëngjim ndizet në sytë e tij, të duket se sheh sytë e një fëmije në vijgiljen e një festë. Pastaj ai ngre gotën, bëhet prapë Xhemë i disa çasteve më parë, me fytyrën e mirë të rrudhur, njeriu që s'ka kohë të merret me veten, se është tepër i zënë me gjëzimet, sukseset dhe hidhërimet e të tjerëve.

— Prej dy javësh nuk i ke shkruar shtëpisë, — i thotë Sabriut. — Plaku është ankuar.

Djaloshi skuqet, lëviz duart, shikon andej-këndej.

— Kam shkruar sot, — përgjigjet.

Nga jashtë vjen gjëmimi i vazhduar i kamionëve të rëndë, duke sjellë një dridhje të lehtë të tokës. Xhemë dhe djaloshi janë mësuar me këtë zhurmë. Po të ndalej ajo, ata do të 'ngrinin' kokën me shqetësim. Që nga dritarja duke lumi, më i fryrë e më i qetë, sikur tërheq një barrë. Sot kanë lëshuar për eksport turbinën e dytë. Si do të dukej lumi, po të lëshoheshin të katër turbinat?

Kur nisi Fierza, ndonjë gazetar apo poet i ri e quajti Drinin përbindësh që po mposhtej, i thirri gjithfarë emrash që ndjellin tmerr. Ndësa Drini është një pasuri e madhe e natyrës. Ai ka rrjedhur në punën e vet për mijëra vjet, duke u fryrë në dimër, e holluar në verë, duke pritur ditën. Tani që erdhi dita të shtjellojë fuqitë e tij, ai do të japë 1.8 miliard kilovatorë energji elektrike në vit. Përsë i kemi thirrur Drinit më kot gjithfarë emrash?

Ia them këtë Xhemës. Ai pëlqen mendimin, — Drini është pasuri e madhe e popullit,

—thotë. — Çdo pëllëmbë tokë dhe çdo metër ujë është i Republikës. —

Nënqesh. — Ndërsa disa njerëz besojnë se pasuri e popullit është vetëm malli i mbyllur në magazina.

* * *

Shkojmë te tuneli 4.

Rrugës mendoj përfjalët e Xhemës. A mund ta shohësh çdo pëllëmbë tokë e çdo metër kub ujë si një pronë të përbashkët përf'tu vënë në inventar?

Përf një pëllëmbë tokë e një vijë uji është derdhur gjak. Ky miendim i Xhemës, përf pasurinë e popullit, vjen edhe nga ndjenja e tij prej fshatari, buron nga shpirti i tij i pastër.

Ai ecën me hap të qetë e të sigurt, me kasketen shtrembër, me mendjen gjetiu, duke përshëndetur njerëzit. Pastaj kujtohet përf ne, ka merak se na djeg dielli e po bëhem me pluhur.

Në tunel punojnë dy brigada heroina.

Brenda këtij tuneli ecin kamionë të mëdhenj. Këtu mund të lëvizë edhe një ndërtesë pesëkatëshe, sikur të vihej në rrota. Në tunele kanë qejf të bëjnë krahasime të tilla. Në armaturat me çelik të trashë janë qepur saldatoret. Duket sikur shkëmbi i madh prodhon një dritë të bardhë të vazhduar. Fërshëllen kompresori. Dëgjohen goditje mbi metalin. Këto goditje, që i dëgjon me veshë, i ndien edhe në poret e trupit, bashkë me dritën e saldimit. Më tej, nën vargun e dritave elektrike, lëvizin hi je të papercaktuara. Njerëzit kanë ngut, po dy fjalë me kalimtarin i këmbejnë me dëshi-

rë. Më tej pamja qartësohet. Në dysheme, në muret në tavanin kube, ka përfunduar betonimi dhe lëmimi i përsosur, si prej mermeri gri, ku pasqyrohen e lodrojnë dritat. Ky lëmim do ta mbrojë tunelin nga qdo gjerryerje, kur të vërshojnë në të me forcë mijëra m^3 ujë njëherësh. Punëtorët tanë e ndërtuan me duart e tyre mekanizmin e madh të kallëpëve metalikë të lëmimit, që zhvendoset mbi shina metër për metër. Tuneli katër qenka gjithashtu vepër e rrallë në fushën e hidroteknikës.

Xhemë do të dalë në fotografi i përqafuar me shokët e Tiranës. Edhe kjo më habit, se gjëra të tillë nuk janë në natyrën e tij. Ndofta përqafimi nuk lështë për ne. Ndiej prehje e gëzim në tërë trupin, një peshë mirëbërëse mbi supe.

— Po të jeni burra, na i çoni fotografitë,
— thotë Xhemë.

I dashur Xhemë, fotografitë po se po. Do të më bëhej një nder i madh sikur ti t'i lexoje e t'i pëlqejë këto radhë. Xhemë është ulur e pi duhan, me bërrylat në gjunjë, me grykën e tunelit prapa, nga ku buron freski. Disa minatorë po këshillohen me të për diçka.

Këta të gjithë do të rrinë këtu për një kohë të caktuar. Do të vijë dita që të ikin, ashtu si erdhën, duke mbartur pajisjet. Këta janë udhëtarë të ndalesave të gjata, ndryshe nga çdo udhëtar. Ndërsa punojnë këtu, me ngulm e me talent, mbledhin fuqitë për hidrocentralin tjetër. Një inxhinier i moshuar ka qenë në Selitë, në Bistricë, në Mat, në Vaun e Dejës, në Fierzë dhe tani ka shkuar në Koman. Ky është udhëtar më i vjetër. Po të vësh re mirë, ka njëfarë hierarkie të heshtur. Ai që ka kaluar dy hidrocentrale është i vemendshëm ndaj atij

që ka ndërtuar katër hidrocentrale. Çohet e i liron karrigen. Kjo shoqëri ka ligjet e saj të brendshme. Tani ndërsa flasin për punët që mbeten të bëhen, hera-herës shikojnë poshtë lumit, në grykat e thella, aty ku do të nisin ndalesën tjetër katërvjeçare. Udhëtarë si këta dhe që të lënë të tilla gjurmë në shtegtimet e tyre s'ka pasur më parë. Këta i nxori koha dhe janë me mijëra. As fotografitë, as shkrimet nuk arrijnë ta kapin shpirtin e tyre. Por kjo duhet bërë, sepse këta, ndërtuesit e hidrocentraleve, po ndryshojnë vetë gjeografinë e tokës dhe klimën e saj, po krijojnë qendra të tilla energjje që e shtrijnë ndikimin mbi tërë vendin. Dhe ka për të ardhur një ditë kur këta do të ndalen, nuk do të jenë më. Prandaj duhet shpejtuar, të kapet ky «moment», të përjetësohet në art, sa kohë «materiali» është në sytë tanë.

3

Hija mëngjesore e malit shtrihet mbi digë e mbi liqen. Një pulëbardhë sulet pingul mbi peshkun. Lëviz pasqyra e ujit. Rrathët e valëve përhapen larg.

Edhe pak dhe «kupa» e këtij liqeni të gjatë do të mbajë 2,7 milardë m^3 ujë. Ai ka një sipërfaqe prej 82 km^2 dhe do të arrijë deri në Kukës. Tani po presin shkurret e drurët që të mbahet pastër «kupa» dhe të rriten peshqit. Barqet e kodrave dalin mbi lumë si të rruara me brisk. Deri në kufirin e shkurreve do të rritet liqeni i gjelbër. Si do të duket liqeni i Skavicës, 2,5 herë më i madh se ky i Fierzës?

Ai, «rregulatori i madh», do të jetë një det i vogël i brendshëm.

Këto janë investime të mëdha të një ekonomie të fuqishme. Por janë edhe me leverdi. Fierza e lan veten në pak vjet. Vështirësitet e ndërtimit, dhe investimet e mëdha do t'i kthehen brezit tonë me fitim, por fitimi neto, shekullor, do t'u takojë brezave që vijnë. Llogari të tillë as ka dashur dhe as ka ditur t'i bëjë njeri më parë. Në ditën e Çlirimt trashëguam vetëm hidrocentralin e Vithkuqit, me 420 kw. Për të barazuar fuqinë e hidrocentralit «Drita e Partisë» do të duheshin 1190 hidrocentrale të ish-shoqërisë aksionare të Vithkuqit.

Në mbrëmje, kur lugina e lumi kridhet në errësirë, sipër digës ndizet kordoni i gjatë i dritave. Shirita të tjerë dritash varen në «shpatullat» e digës, aty ku betonohet mali me galeri 200 m të thella, që asnjë pikë ujë të mos depërtojë në asnjë anë. Në të shtatë kthesat ngjiten dhe zbresin ngadalë dritat e makinave të rënda. Në tërë hapësirën nga e majta vezullojnë dritat e fshatrave.

E parë që nga bregu i lumi, kjo duket si një festë dritash në qiell, e përcjellë nga kënga e pukjanëve të tunelit 4 dhe nga tinguj vibrues të zërit të Vage Zelës, që lëshojnë altoparlantet e qytezës. Në një çast të tillë njeriu mund të murmuritë vargje, në një moshë kur është mësuar të mendojë në prozë. Por duhet treguar thjesht. Kaskada e Drinit nuk i duron zbulurimet, artificet, gjetjet e fortaletrare

Edhe 400.000 metra kub materiale, një e njëzeta pjesë e materialit të hedhur deri tanë, dhe arrihet kuqja e digës. Kamionët e mëdhenj shpejtojnë në rrugë, gjëmojnë te kthesat. Këtu natë e ditë ke përshtypjen se ndodhesh buzë një fushe aviacioni që s'gjen prehje.

Tani në qytezë dhe në vetë digën ndihet «térheqja». Në Fierzë ka mbetur «bërtħama», pothuaj ajo e fillimit. Vështirësitë, përpjekjet e pashembullta, kanë mbetur pas. Rēnia e valës njerëzore tregon se po «shfuqizohet» Fierza. Po kushèdi si do të jetë dredhur nata këtu në kohën e sulmit të madh, kur kantieri mezi nxinte dhjetë mijë vetat. Kushedi si ka qenë në dimër, kur në lugine fgrinte gjithçka, përveç lumit!

Sot kam ditëlindjen. Më kishte dalë nga menjja krejt. Darkën do ta hamë me Xhemën, lart, në mensën e Gropajt. Aty bëjnë biftekë të mirë, birra eshtë e freskët dhe uji më i ftohtë se ai i Selitës.

4

Një shofer i ri, i pashëm, më buzëqesh me druajtje që lart nga kabina e vogël prej xhami, sa herë e takoj në rrugë. Duhet të jetë ndonjë i njobur. Për shkak të tij ndjek me sy kabinat e téré kamionëve 32-tonësh që kalojnë me vrull në rrugë.

Këta nuk ngjajnë dhe aq me shoferë. Janë pothuaj të gjithë nën tridhjetë vjeç, me shikim depertues, me lëvizje të lehta, të sakta. Ndjenja e përgjegjësisë rrit personalitetin e njeriut. Secili çon në digë për qdo rrugë 320 kw

materiale. Shumë prej tyre paskan dëshirë të përshtëndesin udhëtarët.

Ai shoferi i pashëm, që më ka buzëqeshur disa herë, nuk qenka ndonjë i njohur. Ky lexoka çdo libër. Dhe ja tek ka qëndruar me kamionin para ndërtesës së «centralit». Bisedon me brigadier Selimin, Hero i Punës Socialiste.

Shoferi i ri i thotë Selimit se llogaria e tij është e saktë. Sikur materiali i digës të mbar-tej me krahë e jo me makina, do të duhej puna rraskapitëse e dhjetë mijë njerëzve përvjet. Këtë ai do ta shkruajë në gazetë.

— E pse ta shkruash? — thotë Selimi. Ai po shikonte dicka poshtë makinës, fshiu duart dhe ngriti kokën i menduar. Partia u ka dhënë një teknikë të fuqishme, e ka çliruar njeriun. Koha e skillavit ka kaluar.

Ky Selimi, edhe 20 ditë dhe plotëson planin vjetor katër muaj para mbarimit. Është i gjatë e i thatë, me shkëndija drite në sytë e kallëzur. Ka pesë fëmijë, që i merr pas në kantieri. Kanë nota të mira në shkollë. Buzëqeshi dha tha:

— Edhe mund ta shkruash. Për punën e parkut në digë le të dinë njerëzit. Shkruaje, bre burrë. Veç shkruaje mirë.

Ndërtesa e centralit ngjan nga jashtë si një depo betonarmeje, e ndërtuar me shije, që mban brenda vetes dicka të qmuar.

Një inxhinier 23 vjeç bën ndërresën e dispeçerit rajonal në sallën e komandës. Ky djalosh, i sjellshëm, i heshtur, mund të lëvizë me disa butona tri të katërtat e fuqisë së Fierzës.

Ai rri i qetë para skemave dhe vargut të telefonave. S'ka asnje thirrje, asnje sinjal. Çdo gjë ecën mirë. Është tregojnë llambushkat e ndezura.

Salla e turbinave, njëqind metra e gjatë. Këtu është përqendruar e tërë energjia e veprës, kjo është zemra, për këtë u ngrit ajo diga nga më të lartat në Evropë. Për këto turbina vërsyon në tunelet e blinduara uji i ligjenit, me trusninë që krijon ajo pesha prej miliarda mettrash kub. Po nuk dëgjohet asgjë, veç fërrshëllimës së turbinave, që i kalojnë sallës një dridhje të lehtë.

Inxhinierët e rinj po bëjnë remontin kapital të turbinës së parë, që i mbushi të dy vjetët. Këtu ngrihen e lëvizin pesha 370-tonëshe, më të rëndat që kanë lëvizur në Shqipëri. Nga pesha të tillë përkulen 13 milimetra shtyllat e mëdha betonarmeje të vinçit. Inxhinierët e rinj mbajnë frymën. Po shtyllat dhe mekanizmat kanë rezervë për pesha edhe më të mëdha. Të huajt, që ishin këtu më parë, s'kë si të mos i përmendësh, n'e zgjatën gjashtë muaj montimin e kësaj turbinë. Pastaj bënë marifete të tjera me «kushinetën-pasqyrë». Kur kthyen krahët ata; djemtë tanë e montuan, në dy muaj e giysmë.

Edhe pak e do të montohet turbina e katërt. Edhe disa muaj dhe diga do të arrijë lartësinë e piketuar

Interval

Është e habitshme që të bëjë kaq vapë këtu në malësi. Dielli i bardhë qëndron si saç mbi qytetin e vogël të Bajram Currit. Gjinkallat si-



kur brejnë ajrin me këngën e shtruar, që ndjell gjumë. Këto vise i përfytyrojmë si të mbuluara me dëborë, ndërsa tani duket sikur dielli do t'i kallë flakën tokës.

Po toka i qëndron të nxehtit mirë. Poshtë në fusha ujtin me spërkatje, Valbona sjell ujë më shumë se çdo vit, trofta lëviz si shigjetë dhe në malin e Radeshës varen ende rrëketë e dëborës.

Në qendër të qytetit bëhen punime, hapet tokë në pjerrësi. Më duket se ndërtohet diska monumentale. Te turizmi po zurret nga makinanat një ekip i bujqësisë. Kanë në fytyra atë shprehjen e mjekut të thirrur për një rast me rendësi. Porsa, zënë vend në hotel, ata bëjnë vizitën e parë në pyllin e madh të gështenjave, sipër qytetit. Janë «sëmurur» nja dhjetë drurë. Kjo sëmundje ka një emër latin të ngatërruar. Të vjen çudi që të krijojë kaq shqetësim sëmundja e dhjetë drurëve në një pyll shekullor me mijëra rrënje. Por ama, kur sheh ndonjë nga këta drurë të zbehet, të zvërdhet e më në fund, të thahet, në mes të një gjelbërimi aq të plotë, të bëhet sikur shikon vdekjen.

«Mjekët» u sillen rrötull drurëve të sëmurë, vendosin prerjen dhe djegien e tyre. Pastaj marrin gjethë për analiza. Kthehen të nesërmen, e i bëjnë pyllit një kontroll të thellë. Pylli është i paprekur, i shëndetshëm, nuk vuani nga asgjë dhe do të qëndrojë përjetë, sepse nën hijen e drurëve të vjetër rriten filizat e rind, duke synuar diellin.

Ky është një pyll madhështor, një pasuri në inventarin e popullit. Kushedi se ç'do të thoshte Xhemë për këtë pyll. Dhe pse vallë në televizor tregojnë gjithnjë punën e sharrë-

xhinjve duke përbysur pishat dyzetmetër-she? Nuk 'më ka qëlluar asnjëherë të shoh, krahas kësaj, edhe ndonjë emision për njerëz që mbjellin pyje.

Në nëntor mbi qytetin e bukur e mbi pyjet ka për të rënë dëbora e parë. Atëherë do të pushojë edhe lëvizja e qindra makinerive në rrugën buzë lumit, do të tërhoqet nga Fierza edhe «praparoja», për të emigruar poshtë Drenit, në vënde më të buta. Në Fierzën e afërt do të mbeten për ca kohë vetëm skuadrat e «zbukurimit» dhe inxhinierët e centralit.

Kurora e tretë

5

Rruga turistike me asfalt-beton e Komanit shikon buzë ligjenit të Vaut të Dejës për 36 km. Në anën e tejme zbardhojnë kodrat shkëmbore, duke sajuar qytete nën ujë. Sipërfaqja e qetë e ligjenit ndryshon ngjyrë nga e kaltra në të blertë.

— Aty shkodranët do të hapin një lokal vallëzimi, — thotë një mjek babaxhan që udhëton me ne, duke treguar ishullin rrëzë ligjenit. Mjekut i pëlgën ideja fort, e përsërit frazën dhe shton:

— Kanë për të ardhur me motoskafë nga Bushati, çdo pasdite Qindra shkodranë!

Inxhinieri i drejtorisë së centraleve elektrike thotë se njerëzit mund të nisen në të ardhmen nga Vau i Dejës, të ndërrojnë tri herë mo-

tobarkë në digat dhe të arrijnë me lundrim në kufijtë verilindore të Shqipërisë.

Mjeku thotë se katër liqenet do të kenë ndikim të fortë mbi klimën e ashpër të maleve e në bimësinë.

Pas edhjetë vjetve, ndofta më shpejt, me të vërtetë do të mund të kalohet e tërë kaskada e Drinit, duke ndërruar tri herë motobarkë, siç bëhej më kuajt qëmoti në hane. A mund të prenotohet që sot një biletë për një kavalkatë të tillë mbi liqenet?

— Këtu do të zhvillohet peshkimi... edhe transporti ujor me anije të vogla do të zhvillohet... Me stacione pranë digave, — thotë ngadalë inxhinieri.

Mbi liqenin e qetë, aq sa të duket si i ngrirë, bëjnë rrathë pulëbardhat. Edhe zoologja do të ndryshojë. Do të vijnë shpendët shtegtarë. Lugina po mësohet të marrë frymë ndryshe.

Veprat mbi Drin nxitin fantazinë e udhëtarit. Veçse nuk bëhet fjalë për èndrra. Ky është realitet i afërt, që preket me dorë. Një burrë, edhe po t'i ketë kaluar të shtatëdhjetat, mund të bëjë zemër e ta porositë biletën për udhëtimin e ardhshëm në liqenet e Veriut.

Varrezat e stërlashta të Komanit janë diku lart në majat.

Mjeku thotë se kantieri deshi të hapte gurorre në shpatet e maleve, por erdhi porosia nga Tirana të mos preken varrezat dhe muret; gurët për digën të merren gjetiu.

Në Drin, tani është e vështirë të kontrollosh nëse janë të vërteta disa nga gjërat që thuhen ndër klube. Këtu gjithnjë do të dalë diçka e re për të ushqyer bisedën. Sidoqoftë, varrezat dhe muret e vjetra aty lart e kanë të sigurt se

nuk do të preken, se do të mëkëmben porsa të jetë e mundur dhe do të ruhen përjetë.

Po sa herë, vallë, i ndërronin komanitët ku-ajt ndër hane për të zbritur në Shkodër e Lezhë, ku gjendej kripa e lulëzonte tregtia?

Do të bëhen zbulime të tjera e do të dalë në shesh se Drini ka pasur qytetërimin dhe dramat e veta. Dikur, brinjë tij kalonte kufiri që ndante Perandorinë e Bizantit me barbarrët. Ndofta që atëherë ky qytetërim filloi të shuhej, të mbulohej nga shkurret, prej nga dillnin egërsirat për të shuar etjen në lumë. Aty s'ka çarë dot as ushtari i türkut, as xhandari i Zogut.

6

Barakat e bardhë të kantierit në Koman ngjajnë me kampe verimi. Rrugët janë të sheشتë, pastërtia e mirë. Tani këtu janë 1500 punëtorë. Po përfundon lagjja për të pritur dy mijë të tjerë.

Në shpatin e malit, nga e majta, hapet një rrugë. Ngjitemi deri aty dhe takojmë një skuadër me tetë dukagjinës, të djersit, të përzemërt e të qeshur. Janë edhe këta zogj nga Fierza. «Nuk kalohet këtej, o shokë! Veç po të zbritni me litar.»

Kthehemë duke bërë një rrith të gjatë për të hyrë në grykën e Melgunit dhe të duket se je në grykën e Këlcyrës.

Në faqen nga e majta, në katërqind metra lartësi, lëvizin si në ajër punëtorët që hapin rrugën. Janë të lidhur me litarë njëri pas tjetrit.

Alpinizmi më është dukur si një mani e

disa njerëzve për të thithur një copë herë ajër të lehtë e për t'u ngritur në lartësi, ku s'shkelin të tjerët, një sport i rrezikshëm, që mund të zëvendësohej me një shëtitje në rrafsh. Tani mendoj se, në një vend të zënë në tri të katërtat është sipërfaqes me male, është turp të mos kesh bërë pak alpinizëm.

Në grykën e Melgunit ka lëvizje të paprerë. Hyjnë e dalin kamionë të rëndë, buldozerë, makina vetëshkarkuese, me një ritëm të rregulluar, gati mekanik. Sundon fryma e vigjiljes. Këtu thonë se devijimi i Drinit do të bëhet në mesin e korrikut, në zyrat e sektorit e shtyjnë këtë datë edhe një javë, në drejtorinë e ndërmarrjes dy javë. Secili mban një rezervë. Por ama devijimi do të bëhet brenda korrikut. Ky është muaji: më 19 korrik 1969 — në Vaun e Dejës, më 21 korrik 1974 në Fierzë, më korrik 1981 në Koman.

Lumi është i holluar, i kaltër. Në këtë orë të mëngjesit lëshojnë turbinat në Fierzë. Pas katër orëve uji i lëshuar do të arrijë këtu në Koman, lumi do të bëhet i blertë e i madh, me ushtimë rrëmbyese, me kreshtën të shkumbëzuar. Ky lumë tanj i nënshtronhet me bindje të plotë dorës së njeriut. Tej, te shkëmbi, thërret me gjësim një teknik shkodran. Ka kapur rrëzë gurëve një peshku sa një qengj. Po peshku i ikën nga duart, kërcen prapë në lumë, duke e lënë teknikun me duart ngritur. Ai përkulet dhe shikon vorbullat e ujit, lëpihet i hutuar. Njerëzit qeshin:

Në të majtë është portal i masiv me tri kolona, të grënda e dy hyrje. Aty poshtë punojnë njerëz me helmeta të kuqe. Nuk kuptohet se ç'bën secili prej tyre, po të gjithë bashkë duket se bëjnë diçka të ndërlikuar, që kër-

kon forcë, shpejtësi e vëmëndje. Vërvhellejnë pompat që nxjerrin ujin. Ky portal, që hedh dritë mbi tunelin, ka për ta thithur lumin kur të vijë ora. «Bërthama» e hidrocentralit nuk iu nda këtij tuneli asnje orë, as në acarin e dimrit. Çdo brigadë dhjetëra metra, kundër shkëmbit, ujit dhe akullit, gjithnjë përpara. Në tunel vezullojnë llambat elektrike, duke e bërë shkëmbin e errët të përhapë një dritë si prej metali. Këtu do të devijojë Dri-ni, për të tretën herë në njëmbëdhjetë vjet.

* * *

Në pikën ku po hidhen themelët e «pritës provizore» lumi është ngushtuar në 10 metra, nga 99 metra që ishte shtrati i tij më parë. Rreth pritës punojnë bateria e sondave dhe makina e shpuarjes së shkëmbit. Ka tym e zhurmë të vazhduar. Lumi krijon vorbulla, sillet rreth vetes me shenja egërsimi. «I është mbledhur», thotë një minator trupmadh, duke bërë dorën grusht. Kjo pritë provizore do të lidhet më vonë me digën dhe do të qëndrojë para saj si një kokë dashi.

Në rrugën me pluhur kalon me duart prapa inspektori i sigurimit teknik. Ora 11.50. Pas dhjetë minutash shpérthejnë minat. Vargjet e punëtorëve në shpatet e maleve tërhiqen drejt vendeve të mbrojtura. Na duket një gjë komike të zëmë vrapin në rrugën e gjerë të kantierit, por e kemi lënë makinën në vend të hapët:

«Hej, prisni dy minuta. Do shokë të Tiranës kanë lanë makinën në rrugë!»

Tani zëmë vrapin me gjithë mend. Po pen-

gojmë punën e kantierit. Dielli vërtitet në kuppën qiellore si disk përvëlues. Dikush tha aty më parë se në tetor në Koman vendoset drejtoria e ererave për gjashtë muaj. Ku ma gjen të fryjë pak. Në verë, në kantiere të tilla bën gjithnjë më tepër vapë, për shkak të gurëve, pluhurit, punës së pareshtur të makinave. Por duhet vrapiuar.

Shpatet e Melgunit mbushen në të dyja anët me pufka tymi të bardha e të gëzueshme. Gjëmimi vazhdon disa caste, rrokullisen gurë, duket sikur lëviz faqja e malit. Pastaj riven-doset heshtja. Që nga vrimat e malit dalin dukagjinat e dibranët që shkojnë afër majave si në ajër, në lartësi që të merren mendtë. Në fillim një vizitori këtu i duket sikur të gjithë jetojnë buzë, rrezikut, lart në shpate e poshtë në, grykë, po nuk sheh gjurmë frike në fytyrat. Minatorët shpejtojnë. Po të ndërpritet puna, zënë e marrin ujë tunelet. Në grykën e Melgunit nis e vizatohet më qartë hidrocentrali, i téri në shkëmb dhe brenda shkëmbit.

7

Njëri hidrocentral ndryshon prej tjetrit me natyrën, me sfondin, por edhe me llojin e ndërtimit.

Ata që nuk ndryshojnë janë minatorët, montatorët, makinistët. Ose më mirë, nuk ndryshon sjellja e tyre, mënyra e të shikuarit. Ndërsa flet me ty, montatori duket sikur shikon diçka në lartësi dhe nga mënyra si lëviz duket sikur gjithnjë ka boshllék rrreth vetes.

Brigadier Shabani, emrin e të cilit e dëgjon shpesh në zyra, të kujton Xhemën. Veçse ky

Shabani s'ka atë të folurën e qartë e të ngadalta të Xhemës. Është 54 vjeç, i thatë dhe, kur flet, duket sikur grindet me veten, atykëtu duhet ta pyesësh dy herë për të kuptuar atë që thotë. Por ai vetë kuptuar se duhet të thotë ato që di, meqë këto mund t'i hyjnë në punë dikujt. Edhe fotografinë po me këtë ndjenjë e bën. «Dakord shumë». Ai zë e tregon pér brigadën që plotëson planin 170 pér qind.

Është prej Ujmisihit të Kukësit, buzë Drinat e ka shtëpinë, pak hapa më poshtë do të fillojë Skavica. Ujmishi është një rastësi, apo çfarë? Në mendjen e Shabanit, bëhet një lidhje ndërmjet Kastriotëve dhe ligenit të ardhshëm, me shtatë miliardë metra kub ujë. Por ai nuk guxon të flasë pér këtë. Gjëra të tilla i ruan në shpirt, sepse janë tepër të mëdha pér një njeri si ai, dhe krenohet me vendin e lindjes fshehtas. Këtu hapet një perde dhe ti fillon të kuptosh diçka nga ky njeri, t'u japoesh, të drejtë atyre në zyra.

Ai thotë se, që të punojë brigada, duhet të ecin zinxhir ajri, uji, energjia elektrike, shpimi, betoni, transporti. Ai, brigadieri, rri me systë hapur, që të ecë ky zinxhir. Po të ndërpitet, thërrret aty njerëzit, mund të kthejë kundër defektet edhe tërë brigadën. Vetëm kaq bën ai.

Të duket se edhe ti mund të bëhesh një brigadier po aq i lavdishëm. Por, kur hyn në tunel, zhdukjet ky përfytyrim, zë e sheh se një dëftesë të tillë mund ta marrësh si të kesh bërrë një shkollë tridhjetvjeçare në tunele. E duhet edhe një kusht tjetër: Ta kesh zemrën të madhe.

Se Shabani lë pa thënë ca gjëra të tjera,

që janë po aq vendimtare në tunel. Nuk thotë se si vëzhgon ushqimin e brigadës në mensë. Duhet të hajë më tepër ai që e ka pasur ditën më të vështirë, të bëjnë shëtitje çunat, të lexojnë gazeten, të shkruajnë letra e të çojnë lekët në rregull në shtëpi, të flenë mirë, Të gjitha këto i vëzhgon ai, se më parë është babë pastaj brigadier, dhe ata 80 vetët nuk i shqiten punës kurri.

* * *

Më 16 qershor, në orën pesë pasdite, në fushën e zbuluar me flamurë e banderola u hap spartakiada e dytë e Komanit. Tetë ekipet paraqitën forcën, nisi parakalimi në mes të duartrokitjeve, ndërsa kamionët e rëndë anës lumit u binin borive. Programi u hap me tërheqjen e litarit, pastaj nisën ndeshjet e futbollit, volejbollit, basketbollit.

Kjo spartakiadë, që po vazhdon çdo pasdite, erdhi pas festivalit folklorik, me shfaqje, valle e këngë, ku zotëronte çiftelia. Ka energji të pashpenzuara rinia, që vjen në fushën sportive me librat e shkollave të mesme profesionale nën sqetull. Në mbrëmje hapen televizorët në kantiere dhe nis kinemaja. Rinia ka krijuar këtu jetën e saj, nuk i lë ditët të shkojnë kot e tërheq me vete edhe brigadierët 50-vjeçarë. Nga kjo rini e shëndetshme e merr gjakun dhe përtërihet bërtama e vjetër.

Shabani po shkon të pijë një kafe me Kamberin, brigadierin e plasjeve masive. Shabani i ka dy djem minatorë, njërin në Fierzë, tjetrin në Koman. Kur të dalë në pension, prapë do të mbetet i lidhur me ndërmarrjen. Ai

kthehet te çezma dhe lan ngadalë duart e zverkun në ujin e ftohtë që vjen prej Bendës.

Ata hyjnë në klub. Banakieri u buzëqesh me përzemërsi. Këta banakierë duken gjithandej njëloj, sikur të ishin shpërndarë përgjatë Drinit nga e njëjta dorë. Janë tepër të zënë me punë, përgjigjen sa më shkurt, me sytë mbërthyer në atë që japid e marrin. Kurse ky këtu ndryshoka. U buzëqesh të gjithëve. Prej pesëmbëdhjetë vjetësh ecën pas kantiereve. Në njëfarë mënyre edhe ky bën pjesë në bërthamën. Që prapa avullit të ekspresit, fytyra e tij rrumbullake, e bardhë, për një çast i ngjan hënës.

Që nga «stadiumi» ngrihet një thirrje e fortë. Dikush duhet të ketë thyer një rekord.

8

Drejtori i ndërmarrjes u kthye nga një udhëtim 24-orësh. Shkoi në zyrë për të pyetur dhe u nis menjëherë në tunelin nr. 1. Qëndroi aty dy orë, shkoi në komitetin e Partisë dhe në mbrëmje hyri në zyrë. Lëvizjet e tij i ndiqte me shqetësim Dokoja, specialist në degën e planit, sepse kishte disa çështje të ngutshme për të zgjidhur dhe tërë kohën ecte nga zyra në oborr, sikur ta kishin lidhur me një litar të padukshëm prej 20 metrash. Nëpunës të tillë, gjithnjë të shqetësuar e të dobishëm, ndeshen në ndërmarrje. Ky jeton kështu që nga viti 1946, duke nisur me hidrocentralin e Selitës.

Drejtorin e kërkuan në telefon nga shtëpia në Shkodër. Ishte djali. «Babi! Të tana dheta.» Drejtorit iu zbut fytyra, pyeti për gjyshen e për mamin dhe e mbylli telefonin.

Aj është 39 vjeç, i gjatë, më ballin pak të kërcyer, me tiparet e njeriut zemërmirë, por edhe këmbëngulës. Kur ecën, tund ngadalë krahun e djathtë, si për të mbajtur kohën. Edhe ky e ka nisur me Vaun e Dejës, si gjithë dyzet-vjeçarët e hidrocentraleve. E dëgjoi specialistin e planit me durim, me sytë të ngulur në një pikë të skemës së Komanit. Kjo skemë me ngjyra paraqit lumin, digën, tunelin, veprën e marrjes. Një skemë të tillë mund ta bënte edhe një çupë e druajtur e teknikumit, veçse ky është i téri i gdhendur në shkëmb, pëllëmbë për pëllëmbë, llogaritjet i kërkón të sakta dhe mendimin të thellë. Vetëm për të hapur 400 m rrugë në një skarpat vertikal u desh të hidhen poshtë 90 mijë metra kub shkëmb i fortë.

Drejtori e përçolli specialistin dhe tha:

— Puna ecën, kemi qartësi, kemi shkollën e madhe të Fierzës, njerëzit e zotërojnë teknikën. Ne do të trokasim sa më pak në dyert lart... por ama Komani është Koman. Ende na mungojnë 15 inxhinierë. Ne nuk po ndihemi, po ministritë duhet të na kujtojnë.

«Komani është Koman.»

Vau i Dejës ndryshon prej Fierzës dhe Fierzë prej Komanit. Kjo jo dhe aq për shkak të vendit, po të kohës. Se me kohë projektuesit tanë mësuan të mos përsëritin veten. Si Paganini. Projektimi i hidrocentraleve mbi Drin, ka brenda poezinë dhe muzikën e vet, sigurisht për atë që di ta dëgjojë.

Në Fierzë shtylla e digës është bërthama e saj prej argjili. Në Koman kjo do të zëvendësohet me ekranin betonarme, që do të veshë fagen e digës në anën e liqenit. Në Koman nuk do të bëhen brenda tuneleve të shkarkimit kullat e larta në trajtë tulipani, po do të hapet

në vend të tyre një tunel i ri. Vepra e marrjes nuk do të ketë katër tunele kundrejt katër turbinave, sipas skemës klasike, po dy tunele dhe katër turbina. Më në fund, nuk do të ndërtohet portali i madh në tunelin nr.2 të devijimit, për arsyen e thjeshtë se ky tunel do të mbyllët përfjetë me një tapë betoni.

Këtu nuk është fjala për poezi, po për thjeshtime që i dikton përvoja e bazuar në shkençë. Këtu askush nuk guxon të ndryshojë diçka, sado të vogël, pa marrë nga shkenca pëlgim të trefishtë. Një thjeshtim shkurton kohën tre muaj, një kursim ka të bëjë me dhjetëra miliona.

Ka një veçori këtu në Koman, që e bën të lehtë punën e thjeshtimeve. Projektfuesit janë anëtarë të kolektivit. Ato që propozon bërthama e vjetër, ato që bën instituti, vijnë e shkrihen të gjitha në një.

* * *

Drejtori çohet dhe rri te dritarja. Ia ka dashur puna të ndjekë veprat hidroenergjetike në vendet e tjera. Hidrocentralet mbi Drin i kanë shokët të rrallë. Ai shikon, përmes errësirës, grykën e Melgunit që vezullon në dritë. Ai ka ndërt sy atë datën e pacaktuar të devijimit, që do të jetë në 15-ditëshin e parë të korrikut. Herët në mëngjes do t'i jepet urdhër Fierzës të hollojë lumin. Katër orë më pas do të nisë bllokimi, në prani të mijëra njérëzve, të delegatëve nga Tirana e rrëthet fqinje. Ka për të filluar njëherësh gumëzhitja e buldozerëve, makinave të rënda, që do të hedhin te prita provizore qindra blloqe betoni pësetonëshe dhe

materiale të tjera. Duke kërkuar daljen drejt detit, lumi do të zërë të fryhet para pritës, duke u çuar dy metra më lart. Kjo e gjitha do të zgjatë tri orë. Pastaj do të shtypet një buton përmëtë shpërthyer murin te portali i tunelit. Do të jehojë krisma në grykë. Në ajër ka për tu përhapur një erë e lehtë dhe e athët e barutit, pëllumbat do të fluturojnë më lart se kurrë. Dri-ni do të vërshojë me forcë në tunel. Atëherë ka për të shpërthyer brohoria e zgjatur e njerëzve. Forca e tyre e bashkuar ia ka ndërruar edhe një herë rrugën lumit, i ka hapur sheshin ndërtimit të hidrocentralit. Ky ka për të qenë çasti i pritur i përvurimit, gjëzimi i lartë i punës dhe i fitores, më i fuqishëm se çdo ndjenjë tjetër që mund të provojë njeriu.

9

Në agim, kur shkrep dielli, duket sikurngrihen lart muret e kalasë së Komanit, zënë e dalin nga hijet varret e lashta, me pllakat e rënda prej guri. Këtu sundon kultura e pastër arbërore, si një lis që nuk e nxë vendi, sepse qyteza e Komanit është tepër e vogël për ta përfiqësuar.

Përpara qytëzës ngrihen si parzmore një varg me pirgje shkëmbinjsh. Majat e tyre të mprehta sajognë gjithfarë figurash metalike në qiellin e mëngjesit, që ka ende ngjyrën e tymit.

Që nga «kulla» e kalasë së Komanit shihet një rrip i gjatë i liqenit të Vaut të Dejës. Aty ku fillon ky liqen, sillen kamionë. Mbartin zhavort për veprën, por edhe thellojnë shtratin e lumit, që lijeni të ngjitet më lart, të lidhet me

hidrocentralin e Komanit, ashtu si lijeni i Komani do të lidhet me atë të Fierzës dhe ky me Skavicën. «Pedagogët» e Drinit, që e mësojnë lumin të ecë, kërkojnë prej tij të jetë i dobi-shëm në çdo pëllëmbë.

Një i huaj, që përshkoi kaskadën e Drinit në vitin 1912, shkroi një libër për «Shqipëri-në e panjohur», duke thënë, ndër të tjera, se në këtë lumë mund të ndërtohej një lijen kolossal, po për këtë duheshin koncernet e Evropës. Por u dashka vetëm ajo ndërmarrja e ndërtimit të hidrocentraleve, për ta kthyer Drinin, pas disa vjetësh, në gjatësinë prej 240 km, në një lijen të vetëm, të lidhur me pesë akse, digat e hidrocentraleve. Koncernet e Evropës letë rrinë atje tek janë.

Bregu i djathjtë i lijenit të Vaut të Dejës pasqyrohet në ujë nga kreu në fund dhe vija që ndan ujin nga toka zhdukët. Një motobarkë e bardhë peshkimi ka qëndruar poshtë çadra-ve të gjeologëve. Dy barka të vogla në trajtë këpuce lundrojnë ngadalë drejt bregut tjetër. Këto po hapin lundrimin mbi Drin. Më tej, aty ku zgjerohet liqeni, mezi shquhet ishulli i Shurdhahut, qytezë e shekullit VI, me kapelat e shumta. Dikush thotë se kishte aq shumë kapela, sa priftërinjtë të falnin çdo shenjtor në një kapelë të vegantë. Kjo duket e pabesueshme, duke ditur numrin e madh të shenjtorëve! Ndof- ta që andej erdhën komanitët, në kohën e dy-ndjeve barbare e sllave, dhe u ngjitën lart, që të mbështetnin shpatullat në male dhe ta vinin Drinin përpëra armikut. Këtë mund ta thonë më saktë varret arbërore me pllakat e rënda, kur të bëhen më tepër gjermime.

Tani Drini po përqendron fuqitë. Sikur, në të ardhmen, ndokush ta kërcënojë e zemërojë

Drinin, ai mund t'i lirojë fuqitë e tij njëherësh dhe të zhvendoset përpara me peshën e 12 miliardëve metra kub ujë, me një furi e gjëmim prej kataklizmi, duke shkumëzuar në thellësi Adriatikun.

Drini jep dritë. Në vitin 1981, në vigjiljen e devijimit të tretë në Koman, Drini jep 300 herë më tepër energji elektrike nga sa prodhonte i gjithë vendi në vitin 1938.

* 10 *

Ndofta «pedagogët» e Drinit, që e mësojnë lumin të ecë e të jetë i dobishëm, tanë merren me projektidenë e hidrocentralit të Bushatit, që do të ndërtohet në plan të rrafshët, diçka si Biçtrica 2, po njëzet herë më i fuqishëm. Ky hidrocentral, që mbyll kaskadën e Drinit, krijon probleme teknike të reja, por ai do të bëhet. Pastaj lumi do të lihet i lirë të ujite fuhat e të lëshohet në det, për t'u shkrirë me gjithësinë.

Ndofta «pedagogët» po studiojnë në terren, në letër e në laborator Skavicën, «rregulatorin e madh», që do të shtojë edhe fuqinë e katër hidrocentraleve të tjera dhe do ta ruajë këtë fuqi të njëllojtë në vite. Harku i madh energjetik me pesë kurora dotë mbetet në shekuj si në veprat më të ndritura e më guximtare të epokës së ndërtimit të socializmit dhe sidomos të viteve të rrëthimit dhe çarjes së blokadës.

• * * *

Ndërkohë erërat sjellin lajme të tjera në vendën e hotelit në Tepelenë.

«Jemi vendi që ka më shumë ujëra në botë

për frymë», thotë një minator i Memaliajt. Asgjë nuk e luan bindjen e tij në këtë pikë. Ai pi një gotë birrë dhe shikon Vjosën.

Janë hapur fjalë se grupe gjeologësh dhe disa shkencëtarë i kanë rënë Vjosës poshtë e lart.

«Të jetë përmua, diga e parë e ka vendin atje», thotë minatori, duke ngritur gishtin mbi grykën e Këlcyrës.

«Mirë thua ti, po jmbytet Përmeti», përgjigjet shoku i tij i tryezës.

Një nepunës i postë-telegrafit, që mban me vete gjëra të fshehta, ua beson këtë «sekret» qytetarëve në tryezën tjetër: «Diga e madhe nuk bëhet te shkëmbi i Kalivaçit, se vjen liqeni në minierë, po tutje në Poçem».

«Vjosa do të kompensojë hidrocentralet e Veriut në sistemin energjetik unik», thotë një mekanik i parkut.

Qytetarët e Tepelenës, të qetë në pamje, kanë merakun e fshehtë, nëse Vjosa mund të vijë baras me Drinin dhe matin me sy lumin e tyre.

Në verandën e hotelit asnjëri nuk di gjë të saktë përmirësuar atë që do të zhvillohet në Vjosë. Se cili mbron hamendjet dhe bindjet e veta. Por bindja e thellë e përbashkët, se së shpejti Vjosa do të bëjë përpëra, po përhapet më tej. Dhe do të vijë dita që në pellgun e kodrave të Tepelenës të shfaqen «ushtarët» prej çeliku, me përkrenaret e mëdha, dyzet metra të lartë, «qarku i dytë i Vjosës». Nëpërmjet kabllove të trasha ngjyrë argjendi do të bëhet lidhja e përhershme e lumenjve.

Por ka të ngjarë të dalë në mes lumi i Devollit, me hidrocentralet në grykën shkëmbore...

gusht 1980 — korrik 1981

QYTETI I BARDHË

Për shkak të kodrave që e rrethojnë, dielli lëviz rreth qytetit sikur ta rrötullonte njeri me dorë. Është ngricë, rrugët e ndërtësat janë të bardha, lumi rrjedh i kulluar. Kupa e qiellit është krejt e pastër, mot i gëzueshëm për avionët në stërvitje, që vijnë nga larg dhe u turren majave të Tomorrit duke ndritur mbi retë si shpendë argjendi krahëmbledhur.

Bérati me shtatë kodra ndahet në katër pjesë që nuk takohen, e megjithatë ruan unitetin e tij të plotë. Pjesa muzeale e qytetit ka qenë zhvilluar me prirje vertikale. Lagjet e vjetra, të bardha, janë ngritur deri ku kanë mundur rrëzë kështjellës dhe aty janë ndalur. Sipër tyre rri lagjja «Kala», 180 m. mbi nivelin e qyte-

tit. Tani qyteti zhvillohet në rrafsh, me institucionet, fabrikat dhe apartamentet e reja.

Ky qytet kaloi nga ndërtuesat e stilit të vjetër me gurë e lëndë druri në blloqet prej tulle e betonarmeje, pa vilat e borgjezisë së viteve '30. E vjetra dhe e reja bëjnë këtu një kontrast të fortë. Sikur të mbuloheshin disa ndërtime pa vend të viteve të para të Çlirimt, kontrasti do të ishte jo vetëm i fortë, por edhe tepër i bukur.

* * *

Në pushtimin romak qyteti u quajt Antipatrea, sipas emirit të një sundimtarë; nën Bizantin u quajt Pulkeriopolis, «qytet i bukur», nga Pulkeria, motra e perandorit. Duket se kjo grua e humbi rëndësinë dhe më pas qyteti u thirr Albanorum Oppidum, «fortesa e shqiptarëve». Në fillimin e mesjetës qyteti na shfaqet me emrin sllav, Belgradun, «qytet i bardhë»; turqit e thirrën «Arnaut Belograd», për ta shquar nga dy beligradët e tjerë të perandorisë; duke ia thjeshtuar emrin, shqiptarët e thirrën Berat.

Këta janë gjashtë emrat e njohur të qytetit. A ka emër të shtatë të kohës së dasaretëve ilirë?

Në vitin 1972 u zbuluan në Kalanë e Beratit dy kodikët e mesjetës «memece», të cilët i gjurmonin prej kohe. Tregojnë se në vitin 1944 komandanti gjerman i vuri në betim pleqtë që mund të dinin për kodikët. Pleqtë u betuan se s'dinin gjë, meqë ishin marrë vesh më parë të bënин një betim të rremë, dhe shpëtuan pa u grabitur kodikët, që ruheshin në pilë guri e në thellësi të dheut. Aty në kala gjendet edhe epi-

tafi i vitit 1373, me fjalë të qëndisura anash. Do të gjenden shkrime në pergamenë a në lëndë tjeter, që të na thonë emrat e shtatë e të tetë të qytetit.

2

Berati është qyteti i monumenteve.

Xhamia e Plumbit, e vitit 1553. Një kub, një sferë, një cilindër. E bardhë, me një harmoni që të gëzon syrin, ajo i ngjet një lodre të madhe të Vtit të Ri.

Dora e mjeshtrit shfaqet sidomos brenda xhamisë.

Që nga mirami i tij hoxha mund të murmuriste mbi kurin dhe murmuritja të merrte forcë, të kumbonte e të thithet lart, të kalonte në qzell përmes disa vrimave të kubesë. Loja është sa e thjeshtë, aq dhe djallëzore: një gyp qeramike i fshehur në qdo njérën nga vrimat e kubesë, që ngjeshin dhe thithin, duke i dhënë zërit të hoxhës fuqi të mistershme. Mjeshtri, veç gjeometrisë e statikës, njihte edhe disa ligje të fizikës, të modulimit të zërit.

Xhamia e Plumbit, Xhamia Mbret, Xhamia e Beqarëve, Xhamia e Bardhë, Xhamia e Kuqe... Sensi i dyfishtë i tyre nuk të hiqet nga mendja. Ato ishin si ushtarë kubikë të ngulur në tokë, me helmetat e rënda dhe heshtat e gjata, roja të islamizmit luftarak, e në të njëjtën kohë ishin stacionet ku duhej të pastronte trupin e të prehte shpirtin mysliman i mirë. Këtu qëndron ideja, synimi i dyfishtë, forca tërheqëse e artit, që vepron fshehtazi. Këto ngrehina dinake duhej të ishin si pusira që nuk u shpëton gjahu lehtë.

Janë ndërtuar ato nga mjeshtër të sjellë prej Perandorisë së madhe Osmane apo janë bërë nga mjeshtër vendas?

Ndërtimet paraturke të japid bindjen se kemi të bëjmë me mjeshtër vendas të dalë nga e njëjta shkollë. Kanë qenë mjeshtër të zotë e të urtë, të dalë nga gjiri i popullit, nga i njëjtë popull, që i shihte këto ngrehina të pushtuesit gjysmë me habi, gjysmë me humor. Treqind vjet më parë në Berat numëroheshin tridhjetë xhami. Pastaj fuqia turke filloi të kalonte në anën tjetër të zenitit e bashkë me të edhe xhamitë. Thoshte i shtangur udhëtarë turk: «Na ndje, o zot! Këta arnautë guxojnë ta quajnë veten myslimanë!». Para Çlirimtës në Berat kishin mbetur nja shtatë xhami pothuaj të rrënuara. Tani ato janë restauruar, kanë marrë shkëlqim të ri, po të ftohtë, se shpirti u ka vdekur. Me bukurinë e tyre ato prekin vetëm syrin dhe ti kalon më tej duke menduar për shekujt, gjatë të cilëve në këto xhami janë vënë brezat në gjunjë, me synimin t'u thyejnë jo vetëm shpirtin, por edhe trupin.

* * *

Prej tri ditësh po i vërtitem kalasë, duke prioritur kohën, duke u përgatitur si për një ngjitje në një mur të lartë. Kam qenë aty edhe më parë, po tani duhet të shkruaj për të. Ditën ajo qëndron e tërhequr në vetmi, e largët dhe e pakapshme. Natën dritat e tregojnë si një qytet në qiell.

Ecim në kalldrëmin e bukur e të gjatë, që e pret kodrën në vijë tërthore, me kryetarin e degës së monumenteve në Berat dhe me një

oficer, shok imi i vjetër. Zhurma e qytetit fillon të shuhet. Ajri bëhet më i lehtë.

Kjo kala, me 24 kulla e shtatë porta, më shumë ka qëndruar kundër vendit të vet, duke mbajtur brenda garnizonet e pushtuesve. Këtu e pësoi Skënderbeu disfatën e rëndë, që nuk i erdhi nga kalaja, po për shkak të saj. Goditja i erdhi si gjëmim e si rrufe e qiellit që prapa krahëve, në orët e gjumit të vapës.

Ja porta e madhe, me perden mbrojtëse dhe me inicialet e Angelon Komnenit sipër, që e sunderoi dhe e rindërtoi kalanë në vitet 1204-1216. Mur pas muri, në dhjetë hektarë tokë, gjithnjë duke u ngjitur shtjellohet mbrojta e fuqishme e trefishtë. Rrethi i fundit i mbrojtjes është banesa e dizdarit, komandantit të kalasë. Oficeri thotë se me armatimet e shekuive të shkuar kjo kala s'mund të pushtohej. Mirëpo Ali Pasha e pushtoi në dy javë e sipër, me bombardime që bënë vetëm zhurmë e tym. Ai e kishte rrënuar nga brenda që më parë kalanë dhe pashallëkun e madh të Beratit. Fuqia e vërtetë e një kalaje qëndron në zemrën e ushtarit që rri prapa bedenave të lartë.

Disa punëtorë po grumbullojnë pircje dheu në një shesh të hapët. Këtu mendohet të ngrihet një teatër veror, për dhjetë mijë veta. Por këtu teatër nuk duhet të ketë pasur ndonjëherë. Kam dyshimin se kështu nuk bëhet ndonjë «zbulim». Ka rrezik që me një shtresë tjetër të «mbulosh» diçka.

Kryetari i degës së monumenteve po flet për «dhembjen e hershme të gurit». Me pasionin e përmbajtur të njeriut që i kushtohet punës së vet, ai shpjegon teknikat e ndërtimit, shtresat, shtojcat. Nuk besoja se njeriu mund të lexojë kaq tepër gjëra mbi një mur. Pastaj rru-

gët dhe rrugicat na têrheqin të gjitha në një pikë, në akropol.

Prej këtu sundimtari mbante në sy territorin e kalasë. Prapa krahëve kishte humnerën dhe rrugën e çuditshme të «ujit», që zurret thikë mbi lumë. Përtej lumi ishte «lagjja që nuk sheh diell» dhe sipër saj «pylli i thatë», vendi ku bëhej i paprekshëm i arratisuri. Më vonë ky pyll u pre, për të nxjerrë lëndën e pishës dhe u dogj që të zhdukej si «limer». Tani po përtërihet me forcë.

Akropoli ende nuk është formuar. Stera e madhe e ujit s'ka dalë e tëra në shesh. Aty poshtë, nën ujin e zi të ndenjur, ka bomba e mina italo-gjermane. Vërtitet shpirti i errët i pushtuesve më të vonë. Por xhenierët së shpejti do ta lirojnë sterën. Pak më poshtë, buzë humnerës, po ndërtohet një lokal i madh i ushqimit social, përshtatur arkitekturës së vendit. Prej këtu zotërohet panorama e plotë e qytetit, e luginës së gjatë të Osumit dhe e maleve që e rrrethojnë. Ka për të qenë pikë turistike e rrallë.

* * *

Kjo kala mban në gjirin e vet vepra arti që të habitin dhe këto vepra gjenden brenda kishave. Nga ndërtimi i jashtëm ato ngjajnë me kishat e Bizantit, që u përhapën në Ballkan rrëth shekullit X.

Afresket e Onufrit gjenden në kishën e shën Todrit. Së pari, një grua me fëmijë në duar. Gruaja ka rrathë poshtë syve dhe nuk ngjan as me Shën Mërinë e shkollës bizantine, as me

atë të Rafaelit. Më tej figurat e tjera, me të kuqen e famshme të mjeshtrit. Po mrekullia qëndron në katafalkun prej qelqi. Është epitafi i viti 1373, dy metra i gjatë, i qëndisur me fije ari, dhuruar nga Gjergj Golemi. Figura e njeriut lakuriq të qëndisur në epitaf, në ngjyrë kafe të çelur, diçka ndërmjet jetës dhe vdekjes, është një punë që s'mund të përsëritet. Për këtë epitaf dhanë në Paris një çmim që të prish mendjen. Nga Tirana erdhë përgjigja se veprat e artit të popullit shqiptar nuk janë në shitje.

Kjo kishëz sa një «dhomë», e ndërtuar mbi themellet e një kishe tjetër, është tepër e vogël për pasuritë e mëdha që përban. Pranë saj është Vllaherna, ku punoi djali i Onufrit. Ky u përpoq me sa mundi të ndiqte të atin, t'i bënte shenjtörët si njerëzit e gjallë që shihet rreth Beratit. Në Shëntriadhë, tamam si në një shkollë të Bizantit, shenjtörët rrinë në mure palë-palë, gati në madhësi natyrore, me ftyrat ngjyrë dylli. Duket sikur brenda tyre përhapet një sëmundje dhe ata do të lëviznin buzët për të thënë fjalë gjuhëprera me dy kuptime, me një murmuritje si shushurimë uji. Kjo kishë me kubenë e ngushtë vertikale të merr frymën e të shtyp dhe të lë një drejtim të vetëm; të ngresh kokën në qiell. Besintari do të ndihej shumë keq kur në atë kube të lartë e të ngushtë thërriste prifti dhe sipër kokës i gjëmonin këmbanat.

Dalim në sheshin e hyrjes së kalasë. Në këto platforma me gurë të ndritur historia ka ndërruar veshje si në një teatër. Por tani ha-

pësira e gjithë është dritë dhe ajér. Hijet e shkuara kanë flutuar nga muret. Duar të gëzuara punëtore po e bëjnë kalanë mikpritëse, një vend ku të mësojë e të çlodhet njeriu.

Duke zbritur e pyes kryetarin e degës së monumenteve për legjendat. Legjenda s'ka! Tregohet rëndom ajo legjenda fëmijnore për luttën e Tomorit me Shpiragun.

Në qafë ngrihet një lapidar, në kujtim të partizanëve që ranë aty për qirimin e qytetit. Kryetari shikon lapidarin dhe zë e tregon se zaptijet sollën gjere aty dy kryengritës të rilindjes. Kryengritësit thanë se nuk do të ecnin më tej në këmbë. Po të donin, le t'i çonin në krahë te pashai. Pashai u mendua dhe tha: «Pësh-tillini me rrogoza dhe i sillni këtu.» Pastaj ndërroi mendje dhe tha: «Jo. I lyeni me vajguri dhe i digjni, aty te qafa!» Gjatë 24 shekujve, sa ndodhi të tjera kanë parë muret e kalasë?

* * *

Berati është qytet-muze, qytet i monumenteve të shumta.

Të tria lagjet-muze dhe kalaja janë vërië «jashtë rrezikut». Janë restauruár treqind banesa e objekte. Banesat që të gjitha mbajnë datat nga viti 1851 e këtej, viti i tërmetit, kur «shfrynte tym nga toka». Çdo muaj e çdo vit dalin në shesh vlera të reja. Restaurimi vazhdon me durim, me shije, me kujdes, duke i kthyer kishat e xhamitë në muze të arkitekturës, të folklorit, të artit mesjetar.

Çdo mëngjes, duke shkuar për në zyrë, kryetari i komitetit do të këmbejë ndonjë fjalë

me i punëtorët dhe specialistët e degës së monumenteve. Këtu çdo qytetar është i gatshëm të flasë me dashuri për monumentet. Po Berati, mbi të gjitha, është qyteti i luftës dhe i punës.

3

Valëzojnë çatitë e kombinatit të tekstileve, që është balli i industrisë së rrëthit. Valëzojnë xhamat e serrave të perimeve ndanë rrugës. Kur, bie dielli mbi serra, ato shndërrohen në burime drite që të merr sytë. Valëzojnë kordat e gjelbra të veshura me ullinj tejandanë. Nga xhami i autobusit mund të soditësh këtë pamje që ndërron parreshtur dhe të hyn gëzimi në trup. Në të majtë shtrihet fusha, që pushton horizontin me ngjyrën e saj metalike. Toka pret shiun, që të shkrifet korja dhe të mbijë gruri.

Zbrita nga autobusi te stacioni i Lapardhës, me bindjen se do të bridhja në të ftohtë sa të gjeja kryetarin e kooperativës. Një traktor bënte në fushë vija ngjyrëkafe. Në një kodër nga e majta punonte një skuadër me çupa, me shamitë e bardha rrëth kokës, me fytyrat rru-mbullake të skuqura. Për qeshnin. Pak më tei, nën plepat, kishte ndalur një makinë. Ishin një ekip nga Tirana. Ndër ta një burrë i giatë, një profesor i ri në bujqësi. Jemi të njojur prej kohë dhe ecim pak më tej buzë arës. Toka e lëruar shndriste prej ngricës.

— Tokë e shëndetshme, — them ûnë. — Gjashtëdhjetë kuinalë grurë për hektar.

Profesori zuri të më shpjegonte, duke treguar mëshirë për një njeri që s'di nga këto pu-

në, se u dashkan miliarda mikroorganizma për ta bërë tokën pjellore. Do të duheshin 7 kv krijesa të tilla që nuk i sheh syri për një ha (sikur të mund të vihesin ato në peshore).

Kjo është diçka e habitshme, që mund ta dijë çdo student në agronomi, por që nuk e di një gazetar. U ndava nga profesori duke menduar për çupat e gjëzuara dhe për mikroorganizmat.

* * *

Po shkojmë me kryetarin e kooperativës së Lapardhasë në Lagjen Stan të fshatit Moravë. Aty do të hamë edhe drekë.

Kryetari shikon qiellin e tokën dhe ecën me hapin e rëndë. Një ditë më parë, në zyrë, më foli me sytë të skuqur nga pagjumësia, duke lexuar shifrat në bllok. Kjo kooperativë e tipit të lartë ka plotësuar drithërat, pambukun, ullinjtë, frutat, si pesëvjeçar. Kooperativa eci mirë edhe vitin e kaluar, që ishte më pranverë të vonë, me vjeshtë me shira. Dhe ka plotësuar të ardhurat e ka ulur koston... Këto i dija dhe më parë dhe i thashë kryetarit se më duhej ndonjë gjë më tepër. Ai ecën duke u menduar thellë për tufëzimin. Llogarit të skartojë lopët mbi tetëpjellëshe që s'japin qumësht.

— Do të shohësh diçka, aty po shkojmë, — tha ai.

Në kodrën nga e djathhta shkëlqen në diell fshati Guri i Bardhë, ish-fshati «Qelbësirë». Mund t'i thérresësh «qelbësirë» një njeriu, po qysh kanë mundur t'i thérresin ashtu një fshati të tërë?

Plaku Meçan nûhaste në erë, duke shikuar Shpiragun, dhe tha se do të binte shi, ndërsa qelli ishte krejt i pastër. Ishtë me trup të paktë e të drejtë, në kokë i ndriste takija e bardhë dhe, kur ia shihje fytyrën nga afër, të duket se kishe përparrë një fëmijë të qeshur shtatëdhjetëvjeçar. Ai na ftoi për drekë.

Kur hymë në shtëpinë e tij, plaku zuri të ngacmonte kryetarin e kooperativës, ndërsa i biri, i njohur në Berat për humorin, këmbënguljen në punë dhe ndershmërinë në llogari, rrinte pranë derës. Dhoma ishte mbuluar me shtroja të pastra, të qëndisura, në ballë zinte vend televizori dhe sipër në mur portreti i shokut Enver.

Këta ishin arixhinj bujq, ndërsa degën tjetër endacakë që quanin «kallbaxhinj». Plaku tregoi gjëra të tjera përfisnin e përfamiljen dhe tha se djalin e kishte martuar 15 vjeç.

Ne ia plasëm gazit. S'mund ta përfytyroje dhëndër 15-vjeçar, burrin trupmadh rreth të pesëdhjetave, që po sillte pjatat në tryezë.

— Hej, — tha i biri i Meçanit, — kur isha 25 vjeç, ecja 25 centimetra mbi tokë.

«Në zinë e tretë të bukës, — tha plaku Meçan, — vdiqën njerëz. Vdiq edhe xhaxhai i Seitim Hëngri, fiq të egër, u fry si daulle dhe vdiq. Atë vit gjyshi im e lidhi në thes vajzën e vëllait të vet dhe e mbyti në lumë, se që ngatërruar me një burrë prej Berati. Atë vit u gjet në rrugë me kokë të prerë edhe kallbaxhi Mevlani, që e paguanin bejlerët për të vrarë njerëz.

Ne ishim bujq të pashallarëve Vrionas dhe cdo Kasolle kishte një rrip tokë. Në lëmë nxi-

rrnim dhjetë kosha misër, tre i merrte pashai, një qeveria dhe gjashtë i mbeteshin shtëpisë. Po qehajai e donte misrin në mars, të shkoqur e të thatë e ta shpije vetë në Berat, dhe rën- dohej pjesa e pashait, se misri vihej në kandar në mars. Pa duhej të jepje një gjeldeti, një zog pule e dhjetë vezë dhe të bëje punë angari për qehajanë, se vlon te kamxhiku dhe të fluturonte kasollja. Në maj mbaronte buka dhe gratë, e vajzat tona dilnin për të lipur».

Për disa çaste plaku e humbi mendjen pas kujtimeve, zuri të murmuriste në gjuhën e vet diçka që nuk kuptohej, po i thaheshin buzët, në sy kishte një dritë të errët, fytyra si dru i pjekur ngadalë në zjarr i qe ngurtësuar. Pastaj drejtoi trupin, përzuri me dorë hijet e së kaluarës, buzëqeshi dhe tha:

«I kam harruar fare. Më duket sikur kam qenë në ëndërr, në një gropë të zezë.»

Plaku rri e pret të birin, që nganjëherë kthehet në mesnatë. I biri zë e tregon punët e ditës, duke shikuar të atin në sy. Plaku mbledh buzët kur nuk i pëlqen diçka. Atëherë i biri kthëhet e shpjegon qysh e tek, derisa të «sraqohet» plaku. Në agim Meçani pyet birin për «planin ditor» dhe e «udhëzon».

Ky plak jeton me kooperativën sa herë merr frysme. Kështu mund të jetë vëtëm ai që ka dalë nga «gropa e zezë». Ky plak nuhat në erë jo vetëm shiun; por edhe të keqen e të mirën. Tani ai i thotë kryetarit të kooperativës të dorëzojë të dhjetë delet, se turpëroi veten me to, duke ngrënë barin e kooperativës.

E pyes plakun për televizorin. Ai zë e qesh dhe thotë: «Morëm orkestër në shtëpi.» Burrat dhe gratë këndojnë në fushë, po tani vlon da-

ullja edhe brenda dhe nipi i tij dyvjeçar zë e hidhet valle vetë.

— Hë, të keqen, pi një çikë... Ti më kripe mua, — thotë plaku duke shikuar nga afër, me gjëzimin e një fëmije dhe atëherë s'mund të rrish pa qeshur.

Po të kërkosh në të kaluarën, fillon e lëviz krimi, dalin prej thellësive ngjarje rrëqethëse që kanë lidhje me tokën, me moralin e kohës. Sa më e largët bëhet ajo kohë, aq më të habitshme e të pabesuara bëhen ngjarjet. Kjo është e vërtetë sidomos për fshatin Moravë, kur jetonin arixhijtë e përbuzur.

4

Ngado që të ecësh, herë pas here do të kthehesht për të parë nëse baba Tomori është aty, në verilindje të qytetit. Është gjithnjë aty, me ballin e rrudhur kërcënues, me tehët e shkëmbinjve dy mijë metra të lartë, ndërsa faqet e gjera të lëmuara zbardhin nga dëbora dhe i japid qillit më tepër drithë. Kjo bukuria vjen e paprekur nga periudha kur sajoheshin male. Duke e soditur, shpirti humbet ndjenjën e kohës, të rritet fuqia e shikimit, të duket se kapërcen me mendje një kufi të paarritshëm, së ti vetë je pjesë e përjetësisë. Madhështia e Tomorit ndofta qëndron në vetminë, sepse ai ngrihet gjer te retë mbi një pellg me kodra dhe komunikon me Nëmërçkën në jug dhe Korabin në veri.

Nesër është festa e Republikës. Rreth luhishtes së madhe që shtrihet buzë luimit po ngrenë flamurët. Një flamur valëvitet edhe në ballin e kalasë. Po zbukurohen rrugët me ban-

derola. Berati ka një arsyé më tepér pér tē fe-stuar ditën e themelimit tē Republikës.

Në shtëpinë-muze, në lagjen «23 shtatori», gjendet dhoma e vogël ku fjeti shoku Enver. Aty është krevati prej hekuri me kuvertën e vjetër. Ky është një shtrat ushtari. Pak më tej gjendet tryeza e tij e punës. Këtu u shkruan dokumente me rëndësi, që kanë lidhje me formimin e Qeverisë Demokratike tē Shqipërisë.

Tani po shkojmë me dy inxhinierë tē rinj te nëna e dëshmorit Gaqi Karakashi. Më i madhi prej tyre thotë se nënë Eftalia është plakë e vjetër, me mendjen në kokë. Aty më parë inxhinieri e kishte pyetur nëse besonte ndopak në perëndinë. Nënë Talja ishte përgjigjur: «Besoj në atë që shoh me sy, në Partinë dhe në pushtetin popullor. Perëndinë s'e kam parë ndonjëherë, as në gëzime, as në ditët e pikëllimeve tē mëdha.»

Nënë Talja nuk ishte dhe aq plakë e vjetër. Ajo rrinte me trupin drejt, me shaminë e zezë tē nënave rreth kokës dhe ta kishte ënda t'ia shihje fytyrën.

Grua e një marangozi tē varfér, shumë herë i kishte mbledhur fëmijët në darkë me lakra tē egra përzier me një dorë miell. Po tre napolona flori i kishte ruajtur që nga paja e nusërisë, se nënët gjithnjë ruajnë diçka, dhe me ta ia bleu pushkën tē birit. «Gaqua është çiliimi, moj Eftali», kishte thënë burri që i shiti pushkën. Eftalia nxori napolonin e fundit e bleu dhe fishekët. Të birin e kishin arrestuar ndër tē parët në Berat, në vitin 1942, e do ta burgosnin prapë. Eftalia i tha: «Më mirë vdis si luan në mal, sesa tē hiqesh si qen në burgjet e Italisë.» Dhe i tha prapë tē birit:

«Atje tek tē vesh, erës t'i kthesh gjoksin e jo kurrizin.»

Nënë Eftalia e mbajti kokën lart në ato vite, kur gdhihej duke pritur ndonjë lajm nga i biri, kur fashistët pushkatonin djemtë e burrat në mesin e qytetit, kur pushkatonin te Cezma e Thatë 73 punëtorë, kur qindra të tjerrë torturoheshin në burgje. Dy ditë e lanë në shi Joti Kulen të pushkatuar, që njerëzit të shihnin se nuk është dhe aq e lehtë të vdesësh.

Nënë Eftalia qesh me veten, tek thotë se e zuri gjermanin nga rripi që tē mos hynte në rrugicë. Gjermani shau, u zmbraps dhe nxori «parabelin». Ajo do tē ishte «marrëzia» e fundit e Eftalisë, sikur tē mos kishte ndërhyrë përkthyesi, për t'i thënë gjermanit se gruaja ishte e marrë.

Dy inxhinierët e rinj shikojnë nënë Eftalinë me habi. Më i riu prej tyre është zbehur. Në letërsinë për luftën e në filmat nganjëherë «zbukurohen» personazhet. Ndërsa nënë Eftalia nuk «zbukuron», nuk shton lule. Ajo përpinqet tē «fshehë» veten, zemrën e saj tē madhe.

Sipër në kala u vra partizani Thoma Arbeni, thotë nënë Eftalia, dhjetë hapa para shtëpisë së tij, ditën e fundit të luftës. Atë ditë 23 djem e vajza si ai dhanë jetën për çlirimin e Beratit pa arritur tē kapërcejnë pragjet e shtëpive. Ç'të kenë menduar ata, vallë, kur u hodhën për herë tē fundit mbi armikun?

Nënë Eftalia drejton trupin, fshin një lot dhe thotë se i «loton syri». Dhe kthehet e më pyet mua përsë nuk martohen këta djem të rinj. Nipit i ka vënë emrin e Gaqit dhe do ta shohë nusen në shtëpi.

Tani mbarojnë shkollën 23 vjeç, i them unë, dhe pastaj merren më punë.

*More trëndafil me vesë,
Sakën se kërkon martesë,
Pa vajtur njëzet e pesë...*

Nënë Eftalia thotë se djemtë do të kenë më pak punë, sikur të jetë nusja në shtëpi. Ajo jetoi mjift, po do të rrojë sa të bëjë edhe Gaqi i ri një djalë.

— Pastaj, nënë Eftalia, do kërkosh sa të të sjellë një kafe djali i Gaqit, e kështu me radhë, — i them unë. Ajo zë e qesh sepse në të vërtetë ia ka ëndë të jetojë gjatë.

Plaku i kësaj shtëpie ishte marangoz kur doli në pension dhe pas një jave filloi të punonte si murator. Shtronte me kalldrëm rrugët e lagjes, për fëmijët dhe shokët e të birit, derisa vdiq. Njeriu shkon për vizitë në një shtëpi të tillë me nderim e me një ndjenjë të përzishme dhe del prej andej i gëzuar, me dëshirën që të kthehet prapë.

5

Në fillim të janarit u mblodh në Otlakë «shkolla e grurit». Presidiumi u detyrua të shtrëngohet e të lironë vend. Salla nuk i nxinte 350 njerëzit e ardhur nga fshatrat më të largëta.

«Bujku i mirë duhet të marrë 55 kv grurë për ha në mot të mirë dhe jo më pak se 55 kv në mot të keq.»

Ky mendim shkakton të qeshura. Një mendim i tillë do të dukej marrëzi në vitin 1951,

kur ndonjë gazetë shkruante se Lushnja mori 11 kv grurë për ha. Por në vitin 1979 vetëm kooperativa «J. Stalin» e Poshnjës dhe «E. Hoxha» e Perondisë prodhuan aq grurë sa Berati, Fieri, Lushnja, Mallakastër e Skrapari së toku në vitin 1938.

Dhe prandaj hapet ky «universitet i grurit» në Olltakë dhe diskutohet dy ditë radhazi «që të mbillet grurë, në tokat e misrit». Kjo do të thotë të mbillet misër për bukë pas korrjes së grurit, e jo foragjer, do të thotë të merren dy kultura të plota nga e njëjtë tokë. Lojën e fjalëve mezi e kuption një i jashtëm. Shkolla do ta rrahë punën nga përgatitja e tokës në vjetjen e prodhimit. Pastaj do të caktohen detyrat dhe do të zbatohen në fushë.

Shkolla e misrit, e pambukut, e lulëdiellit, e duhanit, e frutikulturës, e bazës ushqimore për bagëtinë. Nga një shkollë për çdo kulturë dhe pranë ekonomive të rendimenteve të larta. Këtu vijnë e jepin mësim mjeshtër të njojur, brigadierë. Një profesor nuk do të gëzonte më tepër respekt se këta brigadierë të prodhimit.

Këto shkolla kryqëzojnë urtësinë e bujkut me dijen e librit. Koha po u jep atyre dinjitetin e qendrave ku shkëmbhet përvoja dhe flitet për shkencë. Janë të mira, prandaj zënë e përhapen edhe në industri e në sektorë të tjërë.

* * *

Një burrë erdhi nga Rrësheni dhe u lut t'i vinin syrin artificial në spitalin e Beratit. Kur mbaruan punë më të, ai e pa veten në pasqyrë

me habi. Pastaj iku për në Rrëshen i lumtur, duke kthyer kokën prapa.

Mbi tryezën e laboratorit qëndron fotografia e një gruaje të pashme. Duket se ajo po përvetëson diçka të re, të fuqishme, me një gëzim të përmbytjor. Në fotografi nuk dallohet se cili nga sytë e kësaj gruaje është i vërtetë.

Okulisti dhe mjeku stomatolog punuan 14 muaj për të prodhuar syrin artificial. Lexuan libra për mekanikën, për metalet, për galvanizimin. Punuan edhe vetë si axhustatorë e frezatorë, prodhuan dhjetëra detale të imita, forma e stampa, e gjithë kjo punë jashtë orarit. Dhe kur u mblodh komisionin në ministri, një specialist tha se nuk duhet ngutur, se këta «sy» kanë ende disa defekte dhe kapi nga grumbulli mbi tryezë një «sy», për të treguar se ku qëndronin defektet. Rastësisht aty ishte ngatëruar një «sy» i importuar, pikërisht ai për të cilin fliste specialisti.

Në këtë laboratori të sajuar u prodhuan «lentet e kontaktit», «dhëmbët seri», «këllëfët metalikë». Këtu i japid syrit artificial ngjyrat, nuancat natyrore, i pikturojnë me durim arteriet e venat, sipas syrit tjeter të vërtetë. Syri lëviz, komandohet nga e njëjtë muskulaturë. Ai vetëm nuk sheh. E megjithatë ky sy u zbut hidhërimin njerëzve të aksidentuar. Ndonjërit i kthen edhe gëzimin.

* * *

E mira tërheq të mirën. Për sa i njoh hotelit unë, «Tomori» është nga më të mirat. Dhomat e fjetjes ndritin nga pastërtia, kuzhi-

an gatuan me shije, shërbimi është i përzemërt.

Po pimë kafe me profesorin e bujqësisë në barin e hotelit. Nga tavani prej xhami vjen një dritë e blertë e butë. Dielli ngroh verandën. Shiu që ra natën ka larë qiellin. Qyteti i bardhë e mikpritës po nxjerr në rrugë njerëzit për shëtitjen e së dielës. Lumi është turbulluar në thellësi. Një peshkatar me një pezvol të madh në krah, që duket si balonat e fëmijëve, lëviz me këmbëngulje gjatë bregut.

Profesori i buzëqesh diçkaje. Zë e thotë se rrëthi i Beratit ka suksese. Ky ishte ndër rrethet e para që plotësoi planin e grurit në vitin 1980, që ishte një vit i vështirë. Profesori fërkon grushtet e mëdha mbi tryezë, në fytyrën e rrahus nga dielli e era i hipën një valë gjaku. Ai ka shëtitur këto ditë fushat e kodrat. Berati e mbolli krejt sipërfaqen. Në disa parcela ai s'kishte parë gjurmë traktori e makine. Njerëzit mbollën me dorë, se traktoret nuk hynin në baltë.

Profesori sapo është kthyer nga një udhëtim në vende të huaja. Ka parë në ato vende vepra të bukura të ndërtuara nga dora e njeriut. Ka parë toka, të sistemuara e teknikë moderne. Por jeta zhvillohej si në dritën e hënës, pa perspektivë. Ndërsa madhështia e shpirtit që pa te njerëzit kur brodhi tokat me ekipin i shkaktoi atij emocione të forta.

Profesori më habit. Ai flet bukur, duke buzëqeshur, me gjakun të mbledhur në fytyrë, me një dridhje të lehtë të zërit. Ai është një kuadër i regjur i bujqësisë. Por, sado i regjur

të jetë njeriu, prapë do të shohë në Shqipëri gjëra që të sjellin emocione.

Pasdite nisemi me një shok të shohim brezaret e fshatit Tomor. Është ngricë, perëndimi ndërron ngjyrë nga e verdha në vjollcë. Në të majtë të luginës shtrihen për disa kilometra kodrat me fiq. Drurët e hirtë i kthehen qiellit me degët e përthyera, duke pritur pranverën. Në të djathtë, në anën e tejme të lumit, tërë kodrat janë veshur me ullinj. Duke rrëshqitur me makinën në asfalt, të duket se këtë peizazh të habitshëm e ke parë diku, ndofta në ëndrrat e fëmijërisë.

Për shkak të akullit nuk arritëm në fshatin Tomor. U gjetëm të papërgatitur për t'i u afruar malit të lartë. Kthehemë te një dyqan buke. Shitësi, me një krah të prerë, ishte nga Tomori. Ai më tregoi për brezaret, që nganjëherë arrijnë në katër metra lartësi. Muret janë të ndërtuara më mirë se ato të shtëpive, gjysh pas gjyshi. Dhe tani i lyejnë me gëlqere. E tërë tokat e fshatit, dyqind hektarë, qëndron mbi këto brezare. Disa kooperativistë blejnë bukë, duke këmbyer ndonjë fjalë me shitësin. Buka sikur hahet më mirë kur e merr nga një burrë që, ndonëse me një krah, nuk pranon të quhet invalid. Në qytet u kthyem natën. Unë përpiqesha të përfytyroja fshatin Tomor dhe brezaret e tij me famë që nuk arrita t'i shihja. Ne s'kemi pasur nevojë të shkojmë në asnjë vend të botës për të parë se qysht nxirret buka nga shkëmbi dhe si bëhet mali brezare.

«Mirëmëngjesi, o punë!... Ti je e fortë, po këtu jam edhe unë. Kështu t'i thërritni punës.» Këto i tha naftëtar Naimi në mbledhjen e kolektivit ditën që festohej dalja e tij në pension.

Njeriu që zhvillon një monolog të tillë me punën dhe që e përfytyron atë si një forcë përtuimposhtur, duhet të ketë një karakter inatçiu.

Ai me të vërtetë ka pamjen e një njeriu të inatosur. Shikon herë drejtorin, herë mua, me kokën, mbi gjoks. Zërin e ka bubullues. Pensionisti tjetër pi duhan në heshtje, duke më shikuar me dyshim dhe shpresë. Ç'të, ketë ai me mua?

Drejtori i ndërmarrjes së prodhimit të naftës në Qytetin Stalin thotë se vitin e kaluar plani u plotësua dhe do të rritet më tepër në vitin 1981. Do të zgjerohen konturet në vendburimet e njoitura, do të përdoren metoda «të dyta» për ta rritur koeficientin me anë të injektimit me djegie nëntokësore... Ndërmarrjes po i hapen perspektiva. Drejtori buzëqesh dhe shikon Naimin. Ky rri me duart mbi gjunjë, me trupin përpara, me gojën gjysmë të hapur. — Ashtu është, mirë punon kolektivi. Por ka punë e punë, — thotë ai.

«Në vitin 1945 u mblodh brigada në Koza-rë. Të dalin veç ata që janë nga këto anë, se ata dinë për naftën, na thanë. Ne dolëm veç, të shumtët fshatarë. Ku dinim ne për naftën. Por ishte urdhri i Partisë. Erdhëm këtu. Ishte shkretëtirë. Duhej t'u rrinim mbi kokë inxhierëve italianë, por edhe të mësonim prej tyre si nxirrej nafta. Hajde mëso nga ai që du-

het ta ruash se mos të saboton. Kishim vetëm bukën dhe fjetjen. Po furra mbetej pa bukë dhe dilnim fshatrave, disa nga ne, për të mbledhur bukë. Rrogë thua? Kujt i vente mendja për rrogë! Rrogat filluan më pas. Dilnim fshatrave edhe për të mbledhur punëtorë. Kur vinte koha e grurit, shkonim për të korrur me traktorët e pastrimit. S'kish punë të ndarë si sot. Gjashtëmbëdhjetë orë punë. Pa duhej të ngriheshe natën; me skuadra, për të ndjekur diversantët. Ja, kësaj i them punë.»

Ky punëtor komunist dhe ish-partizan punoi me ndër derisa doli në pension dhe prapë nuk i ndahet ndërmarrjes. Po zemra i kthehet shpesh në kohën e luftës e në vitin 1945 dhe atëherë bëhet i ashpër. Por kjo kohë s'mund të përsëritet. Specialistët janë tanët, 41 për qind të punëtorëve janë me arsim të mesëm, djemtë punojnë mirë e mësojnë. Nuk del nevoja ta korrim grurin me traktorët e pastrimit. Shoku Naim, asnjeri nuk jeton dot dy herë të njëjtën kohë.

Pensionisti tjetër, që fërkon duart ngadalë, që vijon të më shohë me dyshim e me shpresë, paska hallë të botojë një artikull. Ai thotë se në vitin 1936 u këput teleferiku dhe ra në lumë një djalë i vetëm nga Peshtani i Fierit. Gjashtë vjet e kërkoi e ëma poshtë e lart lumi; po duket se kufoma e tij kishte vajtur në det. U bë zhurmë për këtë djalë dhe shoqëria italiane u detyrua t'i paguante së emës një dëmshpérblim në lireta. Ajo ishte e varfër, pa njeri dhe me ato para zuri të ngrinte shkollën në Peshtan. Vente agai i Peshtanit me kalë dhe i thërriste: «Ç'e do shkollën, moj shtrigë! Ja tek është xhamia që të mësojnë fëmijët.» I thoshte plaka: «Ti, aga, djemtë i ke shpurë

në Itali të mësojnë. Do ta bëj shkollën që të mësojnë djemtë e fshatit dhe të të hanë kokën ty. Ha ha ha, do ta bëj shkollën!» Mirépo nuk mjaftuan paratë dhe ndihmuani ca punëtorë të naftës. Çuan aty edhe tuba, që i vunë të dera si shtylla. Aty janë edhe sot, në pjesën e vjetër të shkollës. Këtë histori e bëra artikull pas Clirimt, po gazeta ma ktheu se s'ishte shkruar mirë.

Një nënë e varfër, që kërkon të birin gjashë vjet anës lumit dhe që ngre me duart e veta një shkollë! Kush vallë e ktheu një artikull të tillë, se s'ishte shkruar mirë?!

7

Në të majtë puset «pleq» të rinuar çukitin në thellësi të tokës me ritëm metalik. Në të djathtë janë fushat që po shkrifën pas shiut. Nën tokë po çelin filizat e grurit.

Si lëvizjeta përpara!

Që nga fusha, Lagjja e Bardhë, sipër në kala, i ngjan një pikture të largët me kornizë tokën dhe qiellin. Gjatë 2400 vjetve të historisë së tij (të historisë që njihet), Berati u rrënuar dhjetëra herë, i goditur nga valët e pushtimeve të huaja, u shkatërrua nga zjarret e tërmetet, po, ndryshe nga Butrinti e Apollonia, ky qytet dhe kështjella e tij i qëndruan kohës, si Durrësi, si Shkodra, si Vlora.

E părë që nga hotel «Tomori», ish-lagja Mangalem shndrit në diell, me një bardhësi që të merr sytë, si një ngrehinë e vetme me «një mbi një dritare».

Kjo kulturë, që lulëzoi në kohën e vet, po kridhej në humbje, kur iu vu dorë, u ngrit dhe

çeli në kushte të tjera. Në shtëpitë e dy-tre shekujve të shkuar banojnë njerëz të rinj. Brenda atyre shtëpive është fresk në verë, ftohtë në dimër. Tani oxhakët kanë mbetur si zbulurime, zjarrin e ndezin në soba, pajisje të tjera hyjnë përherë e më shumë në shtëpitë, ndriçimi elektrik është i fortë. Ka ndryshuar çdo gjë në mënyrën e jetesës, në veshjen, në sjelljet, të menduarit, deri te të ecurit në kalldrëmet. Këto kalldrëme të habitin me logjikën urbanistike. Duken të ngushta, po në to ecte qerrja lirisht, qarkullimi nuk pengohej në asnijë anë.

Ka ndyshuar çdo gjë me themel. Banorët e kanë pajtuar lehtë e mirë jetën e tyre të re me banesat e vjetra të ribëra. Lidhjet me të shkuaren i sheh vetëm në sytë e tyre, si një ndriçim i dytë, kur hapet fjala rrëth qytetit. Ky ndriçim i dytë të bën të zgjatësh qafën, që të shohësh e të kuptosh më mirë.

Atëherë vëren të folurit e butë të beratasve me diçka gurgulluese, sidomos te gratë e te vajzat. Ato hapin sytë për një çast, sa për të kapur atë që duan të dinë. Dhe kështu, nëpërmjet gjuhës dhe syve, e disi edhe nëpërmjet lëvizjeve të trupit, të vjen një dritë e gëzueshme, e paktë, po këmbëngulëse, bëhet një lidhje e tërthortë me atë që ka qenë, me banorin e vjetër.

Që të ndërrohet gjeneza e njeriut, u dashkan 150 mijë vjet. Ky zbulim i shkencës i bën mendjes mirë. Beratasi do të jetë beratas, gjata 6 mijë brezave të ardhshëm. Cilatdo qofshin ndryshimet që do të ngjasin, ajo drita e butë e mirë e syve të tyre do të shfaqet.

NË KUFIRIN E MINERALIT

Kur ulet dielli formacionet krommbajtëse marrin ngjyrën e flakës. Këtu do të nxjerrin krom me dhjetëra breza dhe prapë malet do të mbeten. Jeta e minierës s'ka të sosur. Edhe pak dhe ngjyrat e fundit të mbrëmjes zënë e shuhën. Malet shkëmbore përballë ngjajnë tanë me stalaktite blu, të sajuara nga fillimi i kohëve, që ngrënë drejt qielilit majat e tyre të mprehta. Në qytezën e vogël të Krastës ndizën dritat.

Një gjeolog i ri, më fytyrën e mirë rrumbullake, ulet në një tryezë të kinoklubit dhe pi një ponç përtokalli. Vijnë dy gjeologë të tjerrë, ulen pranë tij dhe porositin kafe. Ia dinë hallin shokut, rëspektojnë heshtjen e tij.

Ky gjeolog ka matur «trekëndëshin», ka dhënë «pikën» për hapjen e një galerie të re

në sektorin e Theknës. Duket sikur ai rri pezull, me duart në tëmtha. I ngjan një komandananti që ka hedhur batalionin në sulm dhe pret të shohë ç'do të bëhet. Për «pikën» është i sigurt, se punoi gjatë me grupin e shokëve dhe tubi ra në krom. Po mbrapa «pikës» mund të hapet «dritarja tektonike», domethënë të jetë thyer e zhvendosur shtresa e kromit prej lëvizjeve të tokës dhe atëherë duhet të korrigohet drejtimi i sulmit. Kohë dhe mund i humbur, shpenzime. Kjo ngjan një herë në tri-dhjetë herë. E megjithatë mund të ngjasë. Ky është problemi i rëndë i gjeologut.

Ai pi ponçin ngadalë, në heshtje. Sapo është kthyer prej Theknës, se kâ mbledhjen e Partisë. Askush nuk do ta qortojë po të hapet ajo «dritarja tektonike», po një dredhi e tillë e tokës, e sajuar ndofta njëqirid mijë vjet më parë, s'ka pér t'i dalë nga mendja edhe në gjumë. Tani ai rri e pret. Do të shkojë në mbledhje, do të nisë një studim të ri. Ngado që të shkojë, çfarëdo që të bëjë, gjithnjë do të rrijë duke pritur, një javë, një muaj, me pamjen e qetë, me mendjen e nieriut që ecën në një udhëz të ngushtë, në fundin e së cilës duhet të shpërthejë gëzimi i të gjithëve.

Ky djalosh, me fytyrën e mirë rrumbullake, lëviz pesha të mëdha. Në rrugën e tij mund të takojë edhe ndonjë të njojur, pér të cilin një gjë e vogël merr një rëndësi të tmerrshme, si, fjala vjen, turni i punës, së çupës. Një gjë e tillë do ta linte të hutuar djaloshin, pastaj do të thoshte me zemrën e tij të çelur: «e po kanë edhe halle njerëzit».

Më 11 mars në Thekën binte një dëborë e lehtë e me dritë. Në pishat e larta ciceronin zogjtë. Kënga e zogjve në dëborë. Dimri s'ka fuqit.

Në sektor nuk shihen njerëz. Banorët e malit janë zhdukur brenda grykave të hapura në shumë anë. Në hyrje të galerisë së parë një minator i ri nă jep kaskat, llambat e karbitit, do të dijë nëse kemi shkrepëse. Në galeri është ngrohtë dhe qetë, një galeri e përkohshme. Më pas mund të zgjerohet, të vendoset drita elektrike, pajisjet e tjera. Ecim në thellësi. Këtu dëgjon, vetëm jehonën e hapave të tu, vërvshëllimën e lehtë të ajrit në tubacionin anësor. Sikur të mbash vesh, dëgjon edhe tinguj të papërcaktuar, që mund të kenë lidhje me mineralin e fshehur diku, në kufirin midis shkëmbit dhe kromit. Më tutje fillon të dëgjohet një oshëtimë e thellë, që zë e rritet si gjëmim, dridhet toka, sikur do të ndodhë diçka në zemrën e malit. E gjithë kjo rrapiçellimë shkaktohet prej një vagoni të vogël, me një dritë si pikë e bardhë, që vjen duke lodruar.

Inxhinieri buzëqesh. Thotë se zhurmën e përcjellin shinat. Ndriçojnë sytë e tij nën dritën e llambës së karbitit. Edhe ky duket tërë kohën si në pritje, si gjeologu i klubit. Pret daljen të «pika», si edhe diçka tjetër. Ka bërë kërkesën pér të hyrë në Parti.

Në kulmin e galerisë, në çdo njëqind metra, varet një pe i bardhë, «pikë makshederike». Tekniku ka caktuar drejtimin me busull, drejt kromit, drejt «pikës». Një njeri i pamësuar nuk vëren asgjë në galeri përveç shkëmbit dhe armaturës. Në katërqind metra thellësi mbaron

udhëtimi. Këtu klima është e njëllojtë rrrotull vitit. Ky mendim të ngjall një ndjenjë rehatie. Të mos kesh ftohtë në dimër dhe vapë në vërë. Por ama njeriu është mësuar me ndërrimin e stinëve si me qarkullimin e gjakut. S'mund të durojë përjetë një klimë të vakët, të njëllojtë. Të shkojnë sytë padashur te tubacioni i madh, që vërshëllen ngadalë dhe që trazon frymën e shkëmbit të thellë me ajrin e maleve të Martaneshit.

Këtu punojnë dy djem të rinj; ngarkojnë vagonin, thonë diçka dhe qeshin. Qeshja e tyre të térheq me jehonën, me tingujt që përhap, të bën të vësh buzën në gaz. Njëri nga djemtë quhet Sherif, tjetri Bujar. Ky i dyti është mjaft i pashëm, do të dukej si çupë e veshur minatore, po të mos ia dëgjoje zërin e trashë. Në dy galeri më tej punon i ati. E ëma punon në impiantin e seleksionimit.

Të dy djemtë kanë zbuluar krom në tavannin e galerisë. Një prerje guri ngjyrëkafë e shndritshme, «një gjurmë», «një mbeturinë tektonike». Prapë ajo fjala me tingull metalik. Bujari kërcen më tej, i bie shkëmbit me çekiçin e vogël te gjurma tjetër. Në shpirtin e tij ka depërtuar sinjali i largët. Djali, ngre llambën të ndriçojë gjurmën e re. Inxhinieri prek kromin me dorë, e fërkon ngadalë. Duhet edhe disa metra për të arritur «pikën». Këto gjurmë, janë të vërteta?

Masivi i hirtë shkëmbor nuk pytet me çekiç, se tingujt i kthen të njëllojtë, ngado që ta godasësh. Po «gjurmët» bëhen më të shpeshta, të duket sikur nëpër shkëmb ka ecur njeriu prehistorik me hapin të çrregullit, me putrën të rëndë. Deri ku shkojnë këto gjurmë? Përmasat e masivit shkëmbor nuk arrin t'i pë-

rfytyrosh. Kjo është madhështia e natyrës nga brenda, që mundesh vetëm ta ndiesh, që të bën të mbash frymën.

Të dy djemtë dhe inxhinieri rrinë heshtur, ndjekin me mendje gjurmët, si njerëz që e njohin shtegun. Nën dritën e llambave të karbitit fytyrat e tyre të bardha rrezatojnë ankthin e përbajtur, gëzimin e minatorit në kufirin e mineralit. Lëvizin me shqetësim hijet e tyre dhe fiksohen prapë në përgjim, si në një tablo të Rembrandit, si diçka që mund ta shohësh vetëm te këta njerëz, në ekstremin e galerisë:

* * *

Horizonti i sektorit Krastë, i quajtur «Lugu i Thellë», galeria nr. 6. Galeria është e gjerë; aq sa të mendosh se mund të hyje aty me makinë. Në thiellësi të saj shkëlqejnë dritat elektriqe dhe shinat pasqyrojnë këtë dritë, që bie edhe mbi tubacionet, kabllot, pajisjet. Pak më tej, përballë nesh vjen me vrull të rritur elektrovozi, që tërheq një sërë vagonetash të ngarkuar rëndë. Bie me gëzim një bori, si në një lojë të çunave të rinj. Ky është balli i minierës, i téri i mekanizuar dhe këtë s'mund ta quash një lojë të çunave. Këtu derdhet dherësa e minatorit, vihen në provë muskujt, dijet dhe vullneti i tij. Pak më tej ngjitet «kati», nëpër disa shkallë, pastaj prapë shkallë pér në katin tjetër. Lëvizin njerëz me kaska, me kominoshe blu. Dalin minatorët dhe hyjnë zjarrmtarët. Pér të arritur te Bajrami, në «nivelin e tretë», duhen ngjitur edhe disa shkallë. Ky është brigadieri që e rriti shpimin në 100 ml me lopatat vëtëngarkuese dhe elektrovozat në

transport. Dy «nivele» më lart, domethënë dy kate më sipër, Hyseni arriti ndërkohë ta çojë shpimin në 130 ml. Kjo ishte një befasi që jehoi në të pesë nivelet. Tani duhet të ndërrojnë ritmet në të gjitha nivelet e Krastës, në të gjitha «horizontet» e minierës, në çdo galeri.

Ky është fakti i ditës, i saktë si metri, rimi, që duhet të drejtojë hapjen e galerive edhe në vitin e ardhshëm. Veçse ky ndërrim i rimit nuk ndodh me të thënë e me të bërë. Do të bëjnë llogari grupet dhe mbledhje inxhinierët në zyra.

Në sheshin para sektorit sillen kamionët e rendë. Në ndërtesën përballë gjëmojnë motokompresorët e fuqishëm. Këtu punojnë vajzat e reja, gratë. Kanë hyrë këtu një muaj më parë, në vend të burrave. Ende nuk u ka kaluar druajtja. I mbajnë makinat pastër e në regjim të rregullt. Por në sytë e tyre të qeshur duket bindja, një krenari e fshehtë. Qëndrojnë të lidhura së bashku, sikur thonë «kot nă keni vonuar kaq kohë». Gratë e vajzat punojnë edhe në impiantin e seleksionimit, një ngrehinë më shtrirje të pjerrët.

Miniera është fronti i burrave. Po do të qëndrojnë ata këtu të vetëm? Duket se pyetja ka marrë një zgjidhje të urtë në Batë. Gratë e vajzat punojnë në zyra, në tregti, në komunitale. Po tani dolën edhe në sektorët e jashëtëm të minierës, në sallat e makinerive, që u japin ajër e u bëjnë dritë galerive, duke u lidhur edhe gjatë turnit me baballarët, burrat dhe vëllezërit.

Në mbrëmje hapen dyert e teknikumit dhe vërshojnë në shesh nxënësit, minatorët e ardhshëm. Në këtë orë të mbrëmjes disa nga punëtorët kthehen në klub, sidomos beqarët. Tryezat janë mbushur plot. Nuk shoh gjékundi ndonjë nga ata minatorët herkulianë që duken në disa tablo të piktorëve. Këta janë pothuaj të gjithë ish-kooperativistë ose bij të tyre, të dalë nga shkollat, me pamje të zakontë, që përvetësojnë ngadalë shprehitë e profesionit.

Por a ka një fisionomi të veçantë minatori?

Buzëqeshja e tij i ngjan buzëqeshjes së bujikut. Kur minatori sheh se kërkon miqësinë e tij, është i gatshëm të të përgjigjet, t'u dalë përparrë ndjenjave të tua, me takt e bujari. Nga kjo anë minatori i ngjan peshkatarit. Po në rast se hap me të një bisedë pune, atëherë ai përgjigjet thjesht e qartë. Kjo duket si një veti prej mekaniku.

Po pi kafe me Rustemin prej Lishanit të Dibrës. Punon në krom prej 32 vjetësh, zjarrmëtar, armator. Në Batër është më i vjetri punëtor miniere, në mos pastë ndonjë më të vjetër në Bulqizë. Ka shtatë fëmijë dhe pret të tatin. Djalin e parë e ka elekrovozist. Nëna e këtyre fëmijëve, Dija, punon seleksionuese prej 18 vjetësh, e dekoruar.

Një minator më tipik se Rustemi s'mund të bëhet. Por ai s'ka asgjë tipike, përveç syve të gjallë e të qeshur. Tregon duart e gjata, kreñohet me to si një pianist. Thotë se s'i ka vrarë duart kurri. Rri me trupin drejt, jo si një njeri që do të tregojë përveten, po si një dëgjues i vëmendshëm e kureshtar. I puqen ve-

tullat me dhembje kur sillet fjala rrëth lajmeve nga Kosova. Ky burrë do në çdo gjë të vërtetën dhe, po të belbëzosh, zë e të ndihmon për të arritur në mendimin e qartë.

Festimi, përgjegjësi i sektorit, është i gjatë, i pashëm. Thotë se, kur erdhi në minierë, njëmbëdhjetë vjet të shkuar, pyeti veten «si do të jetoj unë këtu?». Tani që banon me gruan dhe çunin në apartament, tani që miniera ecën dhe perspektiva është dritë, ky komunist pyet veten nëse mund të ndihej gjetiu më mirë se në kolektivin ku hodhi shtat dhe me të cilin lidhi jetën. Ai nxjerr nga shamia një copë mineral, të shndritshëm e me pika të bardha. Është produkt i fabrikës së ferro-kromit, së cilës këtu i gëzohen si një krijese të tyre.

Rrëth tryezave minatorët pinë kafe ose konjak, bisedojnë, si në një klub fshati. Megjithatë këta nuk janë më fshatarë. «Bujqësia» e tyre tani zhvillohet nën tokë.

Në qytezë bie dëborë e lehtë. Flokët e dëborës sillen brenda rrëthit të dritave elektrike në shtylla, si një mendim rrëth fundit të dimrit. Kalojnë qytetarë me jakat ngritur, ndalen dhe shikojnë dëborën që bie dhe zhdukët. Ndonjëri prej tyre nesër do të hyjë në galerinë që gjendet në 1500 metra lartësi mbi nivelin e detit. Pika më e lartë shkon në 1800 metra. Këta nuk e mendojnë shumë se po bëjnë një punë të nderuar, të vështirë. Këta ecin me bindjen se bëjnë punën dhe jetojnë jetën e tyre të vërtetë.

Që noga laftësitë e Batrës nuk shihet fabrika e ferro-kromit, që shkëlqen në Burrel. Polidhja është e forte. Në asnjë kolektiv tjetër s'kam pârë të tregojnë aq kujdes e dashuri për një ndërmarrje fqinje, siç bëjnë në Bâtëri për ferro-kromin. Arsyjeja është e thjeshtë. Kjo e ka liruar ndërgjegjen e minatorit prej një ankimi të vjetër. Shkonte dëm një pjese e kromit.

Formacionet krommbajtëse, që rrinë lart, kthejnë drejt diellit të mëngjesit faket e tyre me dheun e kuq dhe shkëmbinjtë e hirtë, duke thithur mendimin e kalimtarit, duke tjerhequr zëmrën e tij. Këto male i shtojnë fuqinë Shqipërisë, vendit, të tretë në botë në nxjerrjen e kromit.

prill 1981

UJËRAT E BRENDSHME

Mbi gjolin e kaltër e mbi godullat e Karavastasë sundon qetësia. Fryr maistër, era e lehtë e verilindjes, që u pëlqen detarëve, peshqve dhe bimëve. Për shkak të lëvizjes së ajrit, avullit të lehtë dhe hapësirës që shtrihet pa pengesë, zë e mashtrohet syri. Tej, në rripin e «tokës së vdekur», tufa e pelikanëve, që ka bërë aty foletë, i ngjan një ngrehine prej dëbore. Disa vela të vogla duket sikur ecin varg mbi sipërfaqe të tokës. Janë barkat e peshkimt që kthehen nëpër kanalin e gjerë, të fshehur prej gjeshtrës dhe dëllinjës.

Nga ana e detit vijnë piskamat e shpendëve të ujit, ndërsa në pyllin e pishave prapa thérresin bretkosat. Nganjëherë britma e tyre është kaq e madhe, sa të bën të qeshësh. Duket sikur do të nisen drejt detit, por buzë pyllit

fillon uji i kripur, ku s'mund tē jetojë bret-kosa.

Peshkatarët e parë po ecin në rerë drejt mensës, një ndërtesë katrore me tulla, me zyrën dhe disa fjetore. Magazinier Mylahimi po shkon në zyrën e përgjegjësit me hapin e njeriut që bart gjëra me rëndësi. Nga tē dhënët

e brigadave del se plani i tremujorit nuk do tē mbyllët. Tani, në këtë datë e në këtë orë, asnjë përpjekje s'mund tē bëhet më për planin, sado t'i shtrëngojë trutë përgjegjësi. Veç kësaj, ka ardhur edhe një telegram i gjatë nga qeveria për kursimet, që duhet t'u bëhet i ditur grupeve mënjëherë. Përgjegjësi vijon tē rrrijë i përkulur mbi tryezë, i hutuar e pa gojë. Darka e peshkatarëve në mensë ka për tē qenë e heshtur. Në heshtje do tē dëgjojnë lajmet në televizor dhe do tē shohin film. Pastaj tē gjithë do tē mbajnë fryshtë kur meteorologu, me zërin e dridhur, sikur kërkon ndjesë, tē iapë proghozën dhjetëditore. Do tē ketë shi, ndërsa pritet tē iryjë "Juga e Zezë".

Kishte mjegull tē hirtë në gjol, kur lindi dielli ngjyrë portokalli, i madh e i afërt, duke lëshuar impulse drite si urapa perdeve. Djalloshi po e shikonte me ngulim. Edhe pak e do tē arrinte tē shihtë në brendinë e lëmshit të madh tē dritës, edhe një përpjekje më shumë e dëmtë arrinte një zbulim që nuk e kishte arritur kush më parë! Atij po i rrithë zemra, më tē qetë e me gëzim.

«Pse nuk nisesh, ë Buiar!» thirri që nga dajlani një zë i ulët që u dëgjuat larg,

Djaloshi u përmend, shtyu barkën me palluq. Frynte jugë dhe më tej ai ngriti velën e vogël. Barka filloi të rrëshqiste më shpejt në «rrugën e grepave». Djaloshi e drejtonte pak në të majtë të diellit. Ishte e vëtmja pikë orientimi. Çdo gjë në të majtë të diellit. Ishte e vëtmja pikë orientimi. Çdo gjë tjetër që zhdukur prej «tymit».

Filluan të ngriheshin shpendë të hirtë, si të dalë nga uji, që shkonin në drejtime të paritura, me britma të mprehta. Rosat e egra ecnin në këmbë mbi ujë, me krahët hapur. Ndonjë pelikan fluturonte lart, mospërfillës, i rëndë e i qetë. Po ngado që të shkojë, kjo shpezëri synon t'i dalë diellit përpërpara, për atë janë britmat. Kjo ështëjeta, një himn që të nxit qarkullimin e gjakut. Gjoli i Karavastasë, me sipërfaqe prej katër mijë hektarësh, bën këtë jetë të tij të veçantë, si një ishull në tokë, me brigjet e fshehta. Djaloshi mban velën, kthehet e shikon, buzëqesh si një pronar.

Kur u duk kallami i parë, aty afër kérceu qefulli, si predhë e shtyrë me forcë. Djaloshi uli velën, iu afrua kallamit me trupin pezull. Tapën e bardhë e kishte zhytur ngjala, që zuri të dredhonte me forcë nën ujë. Bujari murmuriti fjalë, tërhoqi e lëshoi fillin me kujdes dhe, kur e solli ngjalën buzë barkës, e ngriti dhe e përplasi brenda me një lëvizje të krahut. Ishte niëkileshe, e zezë dhe e gjelbër. me trupin e shndritur madhështor dhe filloi të përpëlitez me egërsi. Bujari e vuri nën këmbë. i tha të mos lodhte veten. Me dy goditje të thikës ia preu zverkun dhe ngjala u shtri e bindur. «Ja, kaq që puna», i tha Bujari, duke marrë frymë i kënaqr.

Tre grepa radhazi dhanë ngjalë. Ky krah i

«rrugës», që hapej si hark i madh, jepte vëtëm ngjalë. Kur rruga ktheu në lindje, dy grëpa dhancë levrekë ngjyrë argjendi. Dhjetë grëpa të tjerë bosh.

— Eshtë pakësuar gjuetia, — tha Bujari me shqetësim. Aty më parë i kishte ndjekur lëvizjet mbi gjol dhe kërcimet e peshkut me buzëqeshjen e fshehtë të njeriut që është di si venë punët. Kurse tanë rrinte i hutuar, kërkon me mend shkakun e mungesës së gjahut. Mbi gjol që shtuar drita. Shpendët ishin bërë të padukshëm, britmat e tyre vinin të mbytura, nga larg, si prej qiellit.

— Kërkohet plani... Dhe Skënderit nuk do t'i pëlqejë kjo punë, — tha prapë Bujari, duke folur me vete.

Ai zuri t'i mëshonte palluqit më fort, duke e shfyrë barkën drejt parancave¹⁾ më mendien në pritje. Eshtë 23 vjeç, me trup atleti, me ftyrën e pashme të pjequr nga dielli dhe era. Kur pas gjysmë orë arriti te paranca e parë, filloi të sillej me bärkën rrëth hunive me kujdes, sikur të kishte gropë nën ujë. Ai tërroqi lart vallkuar²⁾, e lau dhe e shkundi. Aty brenda nerpëltishin gjallesa të turbullta. Kur Bujari hapi grvkën, u derdhën në fundin e barkës ngjala të holla, gaforre, ateringa dhe bûrdullakë. Ishin armiq të egër-në ujë, po atv, në fundin e barkës para njeriut filluan të rrëshqitnin mbi njëri-tjetrin, si një familje e vetme e nërqafuar. Bujari mbeti i kënaqur. «Mbushin plan», — tha. Pëstaj për tri orë kontrolloi parancat

1) Pritë me drurë e me rrjeta në mes të gjolit

2) Rrjetë në trajtë koni, në skaj, të parancës, ku hym peshku e s'mund të dalë.

e tjetra, duke lëvizur me barkën nga të gjitha anët, sikur të shkruante hieroglife të mëdha mbi ujë.

* * *

Pasdite u ngrit era e perëndimit, së cilës i tremben dëtarët. Dallgë të vogla, të shpejta, filluan të përplaseshin pas barkës. Djëlbishi i mëshonte palluqit, me flokët në erë, me sytë në ngjyrën e ujit, peshkatar i sigurt. Kur flet, duket sikur këndon. Po kthehet në dajlan me 30 kg peshk, pjësën e tij dhe të "Skënderit," që ka shkuar në një mbledhje me rënë dësi. Sikur edhe bárka tjetër të ketë zënë po aq peshk, skuadra e «mbush planin».

Nën ujë, në një metër e gjysmë thellësi, lëvizin bimët e gjelbra të gjolit. Mund t'i prekësh me dore. Po kjo është një cektinë mashtruese. Sikur të biesh aty, balta e butë zë e të tërheq poshtë. Gjoli s'të lëshon. Sa më lart ta hedhësh trupin, aq më poshtë të t'rheq. Duhet t'ia dish gjolit, të rrish i qetë në barkën e mbytur, të presësh ndihmën. Kjo gjithnjë kështuka qenë në gjol. Por ai gjuetari prej Lushnjenuk e dinte. U mërzit ose u tremb. Deshi të dilte në këmbë dhe u mbyt, vite më parë. Kurse pleqtë tregojnë për mbytje të llahtarshme të fshatarëve, familjeve, në kohën kur gjoli ishte sipërmarrje.

Në të majtë, nëpër mjegullën e lehtë, doli si që nga poshtë ujit një barkë. Më tej një barkë tjetër përpiqet të ngrejtë velën, që sillet si shpejti i xhindosur. Fërshëllen erë e ftohtë. Ky krahas i gjolit u popullua edhe me sarka të tjera, me peshkatarë që gohen, mbledhin vëlat,

i mëshojnë palluqit, ose rrinë drejt në këmbë. Këta e mbajnë drejpeshimin me lehtësi, me lëvizje të natyrshme, në një gjol të trazuar që i spërkat me dallgët. Uji ku kalojnë një pjesë të jetës është elementi i tyre. Kurse në tokë ecin si me druajtje, si udhëtarë që do të shpërndulen në çastin tjetër. Nga barka e afërt lëshoi një thirrje të gëzuar inxhinier Fadili, pyeti për diçka. Ky është shoku dhe miku i peshkatarëve.

Bujari ndjek cektinat me sytë hapët. Aty afër dajlanit sillen tryma uji, barka mund të ngecë në leqe të padukshme. Po djaloshi i kançulitur shtigjet në mendje, sipas disa shenjave që ka mësuar prej kohe dhe çan përpara me shkathësi. Tej në bankinë filluan të lëvizin ca figura të errëta. Janë peshkatarët e detit me veshjet prej gome. Ngjajnë si krijesa amfibe të porsadala nga uji. Peshkatarët e gjolit lidhin barkat, grumbullohen rreth atyre të detit. Kanë zënë peshkaqenë dhe peshk të tjerë si plakë. Dhe aty më poshtë kanë lëshuar një breshkë 80-kilëshe. Magazinieri rri galic, tund kokën dhe qesh me «zullapët» e ujit, siç bën përditë në këtë orë, duke ferkuar në xhep çelësin e magazinës.

2

Në mbrëmje zuri të gjëmonte deti, paprerë, sikur larg, në gjirin e tij të thellë, të vlonë një kazan i madh. Retë e zeza përparuan në krejt hapësirën dhe pushtuan qiellin. Era përkundte pishat dhe fijet e barit të gjatë. Bashkë me errësirën erdhën pikat e mëdha të shi-

ut. Një anije peshkimi po afrohej në «tokën e vdekur». Nuk dukej t'i kishte punët mirë.

«Garbi», tha Uani, përgjegjësi i sektorit, duke ndenjur përmbyshëmbi tryezë, me njoftimet e grupeve të peshkimit në duar. Kjo ishte era e jugperëndimit, që e njojin gjithë detarët e Mess-dheut, që nuk e pëlqejnë as bimët, as peshqit, as njerëzit. «Asgjëje nuk i bën mirë kjo murtajë», tha prapë Uani.

Era ulërinte sikur do të shkulte pyllin, u zhduk çdo gjurmë tjetër, nuk ndiheshin as insektet, as shpendët e natës. Vetëm erë, dallgë pas dallge. Uji kaloi gardhin. Ndihej fërkimi i tij pas rrërës.

Mëngjesi u gdhi i errët. Peshkatarët sille-shin rreth mensës, dhe fjetoreve të mërzitur, si ca njerëz të hedhur aty prej dallgëve që arrinin deri rrëzë murit. Brenda në mensë disa pinin çaj. Të tjerë ishin ulur në tryezat e gjata, në heshtje. Banakieri rrinte prapa xhamit me fytyrën e rrumbullakët. Ai liroi avullin e ekspresit, duke dashur të përmendte klientët.

Ajo anija e peshkimit të Durrësit, që ishte afruar në mbrëmje, kishte zënë tokën, që anuar. Gjashtë peshkatarët kishin dalë në breg me pajisjen speciale të shpëtimit. Tani ata ishin te posta e ushtrisë. Aty kishte mbërritur natën autoambulanca.

Në mensë hyri Lluka, i lagur e i hutuar, sikur aty jashtë të kishte prekur zjarrin, qëndroi pranë banakut dhe tha:

— Nuk pranon gjë prej gjëje.

Peshkatarët e shikuan pa folur.

— Grepat i ka zhdukur, — tha prapë Lluka, duke qeshur me nervozizëm.

Nga jashtë vinte gjëmimi i detit, si një sulm

në front të gjerë kundër tokës. Ky det nuk pranonte asgjë. A ishte si një qenie e gjallë, e butë dhe bujare, me të cilën merren disa njërez, peshkatarët. Po nganjëherë zemërohej paritë dhe nuk pranonte asgjë.

— I ka torturuar keq, tha Aliu, peshkatar i prej Çerme.

Ata të gjithë zunë të mendonin në heshtje për gjashtë shokët nga Durrësi, të «torturuar keq», që pushonin te posta e ushtrisë, si edhe për anijen te «toka e vdekur», që ia rrihte brinjët dallga.

Një makinë kaloi me vrull para mensës, drejt postës së ushtrisë. Pak më pas kaluan dy makina të tjera.

Hyri në mensë Ndriçimi, peshkatar i ri me trup të bukur, buzëqeshi dhe tha:

— Erdhi te posta zevendësministri. Edhe kryetari i komitetit ka ardhur.

Një barkë më motor rrëshqiti te poshtë kanalit, si duke kaluar brigjet në revistë të shpejtë, kaloi godullën me të njëjtën shpjetësi dhe doli në detin që shkumëzonte nga dallgët. Këta duhej të ishin njërez të krisur. Po shkonin tek anija e ngecur.

Uani më futi në dorë një si tabletë çokollatë. Ishte nga ato ushqimet speciale të mjetit të shpëtimit. Më tha nën zë se një tabletë e tillë zëvendëson ushqimin e 24 orëve. Ishte pak e athët. E hëngra dhe e prita efektin. Erdhi një makinë e peshkimit të Durrësit me katër veta. Dy prej tyre hipën në tarracën e mensës dhe filluan të flasin me radio të mëdha dore, me fytyrat nga ana e detit. Dy të tjerët hynë në mensë dhe morën nga një tas çaj.

Pas tri orëve u kthyen ata «të krisurit» që shkuan me barkë. Njëri ishte drejtori qendor.

U kullonte ende ujë nga mushamatë e zeza. Drejtori hoqi kapuçin dhe i ndritit koka e vogël e shogët. U foli peshkatarëve duke buzëqeshur. Tha se anjen do ta nxirrin sa të shtrat hej deti.

Në dritaret e mensës vërvhellente era dhe pishat e mëdha përkundeshin ngadalë, si në një kuvend plakash të hidhëruara. Rripi i gjatë i «tokës së vdekur» dukej si një brez i errët, përtej të cilat vinin valët e detit, të bardha të gëzueshme, duke përhapur një oshëtimë të butë, të njëllotë e të largët. Po kjo lëvizje e detit e shtynte gjithnjë më thellë në rërë anjen e mbetur. Dallgët përplaseshin në brinjët e saj si në një shkëmb që mënjanohet ngadalë. Rreth mensës po bënte rrugë pyetja nëse vepruan drejt ata shokët e «torturuar» që braktisën anjen. I kishin çuar që në mëngjes me autoambulancë në Durrës.

— Do ta nxjerrini se s'bën, — tha prapë ai drejtori i gjatë e i shogët.

3

Të fesërmen deti u qetësua, sikur t'i kishte kaluar papritur zemërimi i thellë. Shkëlqenin në diell gjoli blu dhe godullat. Frynte përsëri maistër, filladi i begatë.

Që në mëngjes ndaloj te mensa një mikrobus me 11 hidrologë, që shkarkuan pajisjet dhe instrumentat. Pas një ore u shpérndanë. Disa u nisen me barkën prej gome që e frynë me pompë. Të tjerët shkuan përtokë buzë godullës. Figurat e tyre shquhen në largësi të pamatë. Kur ndaluan në brigje, filluan të bënin me krahë lëvizje të rregullta, atthua se flisnin me vete.

Dy kuzhinierët kishin dalë te dera me kapuçat e bardhë në kokë dhe ndiqnin me vëmendje punën e hidrologëve. Në këtë kohë mbërriti aty një makinë tjetër me ekipin prej tre vetash nga ministria. Këta zunë vend në fjetore se do të qëndronin gjatë. Do të bënin gjatë një viti një studim për ujërat e brendshme të Shqipërisë. Pastaj erdhi një ekip nga ndërmarrja e peshkimit Durrës, që do të merrej me anijen. Kuzhinierët u panë ndër sy të hutuar. Duhej dyfishuar ushqimi.

Ajo ishte dita e vërvshimit të njerëzve. Në mbrëmje erdhi drejtori i ndërmarrjes nga Lushnja, burrë me trup mesatar, i thinjur e serioz. Pasi shkoi në zyrën e Uanit, ai doli te mensa dhe zuri të fliste me peshkatarët, sikur të ishin ndarë dy orë të shkuara. U dinte dhëmbë e dhëmballë. Ndonjëri përgjigjej me shpatullat mbërthyer në karrige.

Drejtori nuk e vinte në gojë as peshkun, as ngjalën. Piu një tas me çaj. Si mbaruan lajmet në televizor dhe filloi sporti, unë dhe drejtori luajtëm domino. Foli në konfidencë. Tha se kishte një javë pa dalë në sektor. Katër ditë kishin bërë mbledhje për të njëjtin problem.

Hera-herës drejtori ngrë kokën, shikon rrötull mensës, buzëqesh, i flet dikujt. Po kjo është një buzëqeshje e dyshimtë, një paralajmërim për atë që do të bëhet më pas, koha kur ai do të thotë se ka buzëqeshur mjaft.

* * *

Mbledhja e përgjithshme e sektorit filloi në mensë, në orën 5 pasdite.

Drejtori i ndërmarrjes tha se sektori nuk e

mbylli planin e tremujorit për 14 kv peshk. Kjo sasi ishte tepër e vogël, por drejtorit nuk i vinte aspak për të qeshur kur jepte llogari për këtë nga njëra mbledhje në tjetren. Ai tha se si drejtori përgjigjej për punën e dobët të çdo barke. Le të mendonin për vete, por edhe për atë si drejtor, që ishte shok dhe përfaqësues i tyre në të gjitha mbledhjet.

Uani, përgjegjësi, tundte kokën duke miratuar çdo fjalë, duke ndihmuar drejtorin. Fadili, inxhinieri me sytë e gjatë, fërkonte grushtet ngadalë. Pesëdhjetë peshkatarët dëgjonin me vëmendje të ndehur, me fytyrat e zeshkëta të rrähura prej diellit dhe erës.

Kaluan dy minuta, gjatë të cilave drejtori priti me mjekrën mbi gjoks, si para një dige. Uani u bënte shenja peshkatarëve të flisnin. Po këta rrinin si blok i errët. Bluanin punën me mendje, duke parë hera-herës drejtorin, duke lexuar parullat e reja në mure. Plani ishte i vështirë dhe mbledhja mund të anonte nga fjalët, të kalonte si mbledhje e bëq. Po drejtori nuk do ta lejonte këtë.

— Hë pra, — tha ai, — këtu jemi tanët, skemi të huaj.

Tre të parët folën si me përtim, folën për deficitin, duke u sjellë rrëth tij, «për ta zbutur», «për ta ulur», «për ta zbritur», sikur ky të ishte një ka i egër që askush nuk guxonte ta kapte për brirësh. Por i katërti tha se duheshin vënë në jetë pa ngurim vendimet e organizatës- bazë të partisë, në këtë vit të madh jubilar, sado i vështirë të ishte plani. Përse heshtnin shokët?

U duk sikur salsa u përkund pas e përpara dhe më në fund qëndroi. Erdhi si pakuptuar çasti kur secili duhej të jepte atë që mundej,

kjo tashmë s'kishte si të shtyhej më gjatë. Si dhei pse terdhi ky çast, asnjeri nuk dinte ta thoshte, por ai kishte ardhur. U çua brigadier Skënderi, me fytyrën rrumbullake, dhe tha se do të jepnin si brigadë 8 kv peshk mbi planin, se do ta shtynin tre muaj afatin e riparimit të barkave.

Dukej se drejtori tërë kohën komunikonte me peshkatarët nëpër ca lidhje të nëndheshme, me një gjuhë të dyfisë që e dinin vetëm ata, ndërsa flisnin për zotimet. Si qenë këto lidhje, ku i kishin rrënjet? Kjo gjë po ma ngrinte kureshtjen. Kisha ardhur në këtë mbledhje me dy mendje, i porsakthyer nga një gjueti dhjetorëshe në kënetë. Toka nuk po zinte vend në sytë e mi dhe bënte nxehjtë. Po lodiha më kaloi krejt dhe sendet u fiksuan për bukuri. Po habitesha me ndryshimin e thellë në fizionominë e atyre që flisnin e dëgjonin. Ishin seriozë, kuptionin shpejt e flisnin thjesht. Gjithnjë mund të habitesh më ndryshimin e pareshtur të fizionomisë së fjerëzve, po kjo më ardhhi disi e papritur me fytyrat e zeshkëta dhe zakonisht të heshtura të peshkatarëve. — Ke edhe më, diçka ke mbajtur rezervë, — i thoshte drejtori ndonjërit.

Tani drejtori më dukej këmbëngulës, disi i pamëshirë, ndofshta pák dinak. Dhe ajo gjuhë e tyre e dyte nuk ishte ndonjë mister. Njohja e gjatë dhe zanati i pérbashkët. Gjithsesi mbledhja shkonte pérpara, merreshin zotime. Pastaj u hap befas një hendek. Ishte më këmbë brigadier Sotiri, që e plotëson planin 50 për qind. Kthente trupin andej-këndeji, duke thënë se do të luftonin për 6-mujorin dhe ishte si një qefull i zënë në grep.

— A keni disiplinë në brigadë?

— Jo, disiplinë s'kemi.

— Po harmoni a keni?

— Jo, s'kemi as harmoni!

Ky Sotiri, sikur fërkohet pas mendimit se fajin e kanë pikërisht këto dy gjëra: mungesa e disiplinës dhe e harmonisë, dhe se këto s'kanë të bëjnë me personinje tij. Kjo ishte një ide e çuditshme, në sallë bëhet heshtje e thellë, peshkatarët rrinë të ngurosur, turpërohen për shokun. Ama edhe kështu s'mund të vejë. Si do të bëjnë këta pa disiplinë, pa harmoni? «Njëri thotë nisemi në orën 5 dhe tjetri në 6, njëri e kthen barkën nga bashi, tjetri e do nga kigi.

4

Kanali krejt i kaltër, gati blu, shkon drejt gjollit si një lumë i fuqishëm me prurje të plotë. Kjo është „burë“, batica e madhe, që fyrn godullat dhe gjolin, e që, do të vazhdojë për gjashtë orë. Pashkë hëna e padukshme do të shtojë tërheqjen dhe në kanal ka për të filluar lëvizja e kundërt. Deti do të thithë mbrapsht krejt sasinë e ujtit që dha, po në ngjyrë të gjelbër. Pas gjashtë orëve të tjera loja e madhe që të bën për të qeshur, fillon nga e para.

Baticën, dhe zbaticën mund t'i vëresh kudo në bregdet, po në Karavasta i sheh nën sytë e tu, ndien se si marrin frymë këto ujëra të brendshme, si mushkëri që hapen e myallen me një ekilibër madhështor, me orar të përpiktë dhe në masën e caktuar.

Inxhinieri rri më duart prapa, buzë kanalit. Shikon kanalin krejt i thithur prej tij, sikur ta shihet përmes përenjherë. Kurse ai është rritur nga këto anë. Tej, në mbarim të kanalit, lëviz prapa dhe gjëmon ekskavatori i xha Mefit. Prej

25 vjetësh ky burrë ndodhet në luftë të parerë me detin. Përkulet mbi levat dhe çukit me kovën në kanal, do të mbajë të hapëta rrugët e ujit, ndryshtë i pengohet fryma Karavastasë.

Inxhinieri kthet ngadalë në dhomë. Ai dhe dy shokët e tij duhet t'i paraqitin kolegjumit në ministri, dhe ministria qeverisë, një studim të plotë për ndërtimin e Karavastasë.

Me baticën dhe zbaticën, me fuqinë mekanike të natyrës, lëviz e qarkullon vetëm një e dhjeta e sasisë së ujit në gjolin e madh, tamam si te truri i njeriut. Pjesa tjeterë është ujë i ndenjur. Dikur kjo mund të ishte në rregull, në pajtim me kohën e me vendin. Po tani kanë ndryshuar kërkesat. Vec kësaj gjoli ka zënë të degradohet, për shkak të prurjeve të dheut, të bonifikimeve përreth. Dhe rripi i gjatë i «tokës së vdekur» i krijuar prej detit, rrezikon mbushjen e kanaleve, çka sjell avullimin e tepërt, rritjen e kripës, mungesën e oksigjenit. Të gjitha shkojnë zinxhir dhe gjoli i madh jep 50-60 kg peshk për hektar, sasi tepër e vogël për vendin që zë dhe kur në tokat rreth e qark merrin edhe 70 kv grurë për ha, ose 700 kv domate.

Prej këndej ka lindur edhe pyetja nëse duhet të jetojnë gjoli dhe godullat. Grupi i studimit punon me kartat hidrologjike, shfleton «materialet». Duhet të bëhet sistemimi i përgjithshëm nëpërmjet argjilimit, zgjerimi e thellimi i kanaleve komunikuese det-kënetë, ndërtimi i portave për të komanduar baticën e zbaticën, ndërtimi i dajlaneve me teknologji të re, futja në gjol e ujit të embël. Atëherë gjoli do të marrë fryshtë lirisht, duke u kthyer në një

fushë uji të pastër, ku të gjelqjnë peshku e ngjala. Do të trefishohet prodhimi. Por edhe kjo nuk mjafton. Përgatitet një plan për ta ngritur prodhimin e peshkut në ujërat e brendshme në dhjetëra mijëra tonë. Duhet të rritet katër herë rendimenti i Karavastasë. Peshku është ushqim i domosdoshëm për njeriun. Peshku zëvendëson mishin. Kurse mishi nuk e zë dot vendin e peshkut, për shkak të jodit, fosforit...

Tre inxhinierët punojnë natën në zyrë, nën renë e vogël të tymit të cigareve. Duhet të ndërtohen edhe rezervuarët për dimërimin e peshqve të vegjël; të kthehen në ekonomi të rritjes së peshkut tokat joproektive rrëth gjollit. Atëherë Karavastaja do të bëhet një hapësirë uji me rendiment të lartë, e integruar e tëra në ndërtimin e socializmit.

Këtë gjë grapi duhet të dijë tambrojët në kolegjum dhe në qeveri. Llogaritë janë të qarta. Po deti dhe uji kanë ligjet e veta. Si do të jetë deti pas dhjetë vjetësh në raport me ndërtimet në Karavasta? Se këtu ndodh si me enët komunikuese, do të mjaftonte një disnivel çfarëdo për të prishur ekuilibrin, prandaj çdo llogari duhet bërë edhe një herë.

Këfa tre inxhinierë, që po punojnë deri në mesnatë, janë duke bërë një studim që i përket së tashmes dhe së ardhmes. Si ndihet njeriu kur vë firmën në një dokument të tillë?

5

Në mëngjes herët po niseshimi me foribord me drejtorin dhe Uanin, për të parë grupet e peshkimit.

Në këtë orë të mëngjesit qetësia rrëth kana-
dil prishet vëtëm nga gumi-ëzhitja e sharrës elek-
triike në barakën e dy marangozëve të urtë e
të spalodhur. Barkat janë nisur me kohë, një
-pjesë drejt gjolit dhe pjesa tjetër drejt dë-
tit. Ata që nuk do të plotësojnë normën e re dito-
re, kanë për ta vijuar gjuetinë edhe natën. Ky
është zotimi.

Frymëmaistër, era e mbarë, që u pëlqen bi-
mëve, peshqve dhe njerëzve! Tëk anija që ka
zënë tokë, janë afruar draga 100-tonëshe dhe
dy anije rrujmëse. Po shkojmë te grupi i pesh-
kimit në «postën verore», në jug, dhe pastaj
te godulla përtëj kampit, në veri. Duke ecur
fillon ta njoftohet gjografinë e Karavastasë, zë
e kuption lëvizjet e ujit, që nuk shkon sipas
rastit, por drejtohet nga disa ligje të brend-
shme të këtij rezervati të madh të peshkut, kri-
juar nga natyra. Barka rrëshqet mbi valët e
lehta të detit ngjyrë qelli. Përmes ajrit të larë
nga shiu shkëlqen bregu me pishat e gjata rru-
mbullake, ndërtesar e bardha, të kampit dhe
vargut i kabinave. Kampi është i myllur, por
at y lëvizin njerëz. Janë një grup i kinostudios
që xhirojnë një film. Njëra nga aktoret e gru-
pit, djepyeste peshkatarët se ç'është qefulli me
qumësh. Meqë peshkatarët e parë nuk iu përgjigjën,
ajo ngulte këmbë t'i pyeste me radhë.
Tej, në bregun që zgjatet drejt «tokës së vde-
kur», shquhen figurat e katër vetave që ecin
në radhë. Duken të mëdhenj, të fuqishëm, si
të dalë nga legjenda. Edhe këta janë aktorë.
Këtu, për shkak të hapësirës, të dritës e të ujit,
syri gjithnjë i bën lojëra mendjes.

Tani barka dredhon përmes rripave ranorë.
Në këto çektina, në shkurt, femra e qefullit
férkon barkun pas rërës, që të lëshojë vezët,

kurse mashkulli noton sipër dhe lëshon qu-mështin pér t'i mbuluar. Uani shuan motorin dhe e'lë barkëm të rrëshqasë ngadalë përmes këtyre ranishteve të ngrohta, ku zënë e bëjnë lëvizjet e para një mori krijesash të paduksh-me, duke synuar detin. Nga gëmushat e afërtë çohet bëfas ndonjë rösë që s'ka mundur të niset në rrugën e emigrimit drejt Danubit. Uani lëpihet. «Nuk ë more çiften», i thotë si me përgjërim drejtorit. «S'është kohë çifteje», i përgjigjet ky nëpër dhëmbë. Shikon rrrotull dhe thotë: «Plani në peshkim është i pabesë.»

Ja më në fund edhe «toka e vdekur», ky rrip i gjerë ranor si kurriz peshku, i krijuar tanit vonë prej detit dhe që rrezikon jetën në ujërat e Karavastasë, si edhe ajrin. Por gryka e kanalit që e ndan godullën nga deti vazhdon të punojë. Baticë e zbaticë. Në këtë rrip toke rrinë si një ngrehinë e lartë e bardhë pelikanët. Kur u afruam, ata zunë të çoheshin në fluturim, erdhën rrrotull duke bërë hije, të rendë e madhështorë dhe pastaj u ulën në det, me sqepat e mëdhenj nga ana jonë. Në foletë e tyre, të bëra shkel e shko, kishte vezë të ngrohta, më të mëdhali se vezët e patës. Ky shpend, që arrin deri në 30 kg, jeton në pak vende të botës dhe te ne mbrohet me ligj. Prandaj rrinë gaty në det, fare afër, të qetë e mos-përfillës, këta punëtorë të rendë të ujit. Secili prej tyre ha derip në tetë kg peshk në ditë. Në shtator, para sëritë fillojë ngjala atë shteg-timin saj të quditshëm, pelikanët ngulen në radhë të ngjeshurat buzë kanalit. Asgjë nuk kalon nën sqepat e tyre të gjatë pa u ngopur ata. Ky është edhe sinjal i alarmit pér peshkatarët. «Pelikanët! po del ngjala, u nis ngjala!» Ato janë javët e begatisë, koha kur gjue-

tia arrin edhe 100 kv ngjala në ditë, stina kur mezi merr frysë peshkatari. Po ku vallë shkon ngjala? Nisët për ciklin e riprodhimit, në një pikë të thellë të Atlantikut. Asgjë s'mund ta ndalë, nuk këtë rrugë. Hollohet e nxihet në trup e mund të ecë si gjarpër edhe në tokën me bar, nëpër vesë, me një puhatje të çuditshme të lagështirës, derisa të dalë në det. Pastaj kalon Gjibraltarim, si një lëmsh i madh prej dhjetëra mijë tonësh, dhe vazhdon. Në gjol mbetet ngjala e «butë», të cilën e pjekin në hell peshkatarët. Po, përsë duhet të riprodhohet vetëm në atë, pikën e thellë të Atlantikut, kjo ngjale e «egër» e detit? Në njohjen e jetës së botës, nenujore, njerëzimi ndodhet ende në gjysmën e rrugës.

Peshkatarët janë imbledhur në mensë për televizorin. Në lajmet e imbrëmjes, nga vendi e ngat bota, spikeri mund të flasë edhe për kollektivin e vogël në Karavastë, që plotësoi planin katërmujor më 16 prill. Nga nesër e mbrapa dikush mund të shkojë me leje dy ditë, tri ditë.

Netët në prill, janë të buta e të ngrohta në Karavastë. Toka, uji dhe qelli sundohen prej një qetësie të thellë. Kur qelli është pa hënë, pishat e mëdha, si sfera rrumbullake, hedhin deri mbi ujë, hijet e tyre, të padepertueshme. Aty trazohet drita e yjeve të largëta, një pamje që ndjelli perfytyrimin e tropikut. Atéherë fillon e të rrethozemra lehtë, hija e asaj që ka kaluar mbi faqen e dheut prej fillimit të kohëve vjen këtu e dendur dhesë gjallë, të duket se

thith po atë ajër dhe se sheh me sytë e tu të harlisen drurët në tokën e liruar prej ujit. Kjo ndjesi vjen e prishet nga ndezja e një drite në fjetore, nga gjëmimi i mbytur i një makine në rrugën buzë plazhit, po hijet e rënda e të buta të Divjakës prapë mbeten.

Mbi sipërfaqen e palëvizur të ujit kërcen befas qefulli. Turret me egërsi e me zhurmë le-vreku. Nëse e ka zënë gjahun, dhe po të kesh veshë peshkatari, mund të dëgjosh se si i kërcet dhëmbët nën ujë ky peshk grabitqar. Nga foleja me dy vrima niset për gjuetinë e natës ngjala, ecën në drejtime të papritura gaforrja. Gjoli i madh dhe godullat japid bujarisht peshk për njerëzit dhe ushqim për pulat, në pritte të ndërtimeve, të kohës kur do të ndryshojnë ligjet e përjetshme të lëvizjes, duke gjallëruar nëntë të dhjetat e masës së ujit, që vazhdon të mbetet inerte.

prill 1981

qëndrën e fshatit Maricaj. Një rrugë që kalon fshehur rrëzë malit të nxjerr papritur në qendrën e fshatit Maricaj. Kryetari i kooperativës del nga zyra me kokën e futur në supe. Tani gjendet në fushatën e korrjes dhe, sado të flasë e të lëvizë, nuk arrin të fshijë nga fytyra netët pa gjumë. Kombajnat janë ngjitur në maja ku s'ta merr mendja dhe po «thithin» grurin me shpejtësi. Ndofta për 40-50 kg në hektar, nuk do të arrihet plani i grurit, që gati u dyfishua në tre vjet. Kjo gjë e bën kryetarin të ndihet si në pozicion të pjerrët, siç është e tërë kooperativa, në male e në rrëpire, deri 1400 metra lartësi, pa një copë arë të rrafshët. Kryetari bën humor për disa punë të vetat. Humori me vetveten është më i shëndetshëm. Po, ndërsa flet, mendjen e ka te kombajnat. Mbësë këto makina do të shijnë pa firo, duke e ulur

ERA E MBARË E TEPELENËS

Një rrugë që kalon fshehur rrëzë malit të nxjerr papritur në qendrën e fshatit Maricaj. Kryetari i kooperativës del nga zyra me kokën e futur në supe. Tani gjendet në fushatën e korrjes dhe, sado të flasë e të lëvizë, nuk arrin të fshijë nga fytyra netët pa gjumë. Kombajnat janë ngjitur në maja ku s'ta merr mendja dhe po «thithin» grurin me shpejtësi. Ndofta për 40-50 kg në hektar, nuk do të arrihet plani i grurit, që gati u dyfishua në tre vjet. Kjo gjë e bën kryetarin të ndihet si në pozicion të pjerrët, siç është e tërë kooperativa, në male e në rrëpire, deri 1400 metra lartësi, pa një copë arë të rrafshët. Kryetari bën humor për disa punë të vetat. Humori me vetveten është më i shëndetshëm. Po, ndërsa flet, mendjen e ka te kombajnat. Mbësë këto makina do të shijnë pa firo, duke e ulur

Një rrugë që kalon fshehur rrëzë malit të nxjerr papritur në qendrën e fshatit Maricaj.

Kryetari i kooperativës del nga zyra me kokën e futur në supe. Tani gjendet në fushatën e korrjes dhe, sado të flasë e të lëvizë, nuk arrin të fshijë nga fytyra netët pa gjumë. Kombajnat janë ngjitur në maja ku s'ta merr mendja dhe po «thithin» grurin me shpejtësi. Ndofta për 40-50 kg në hektar, nuk do të arrihet plani i grurit, që gati u dyfishua në tre vjet. Kjo gjë e bën kryetarin të ndihet si në pozicion të pjerrët, siç është e tërë kooperativa, në male e në rrëpire, deri 1400 metra lartësi, pa një copë arë të rrafshët. Kryetari bën humor për disa punë të vetat. Humori me vetveten është më i shëndetshëm. Po, ndërsa flet, mendjen e ka te kombajnat. Mbësë këto makina do të shijnë pa firo, duke e ulur

atë deficitin e vogël për hektar, mbështetje deficit mund të zhduket krejt kur të vihen ka-lamajtë të mbledhin çdo kallëz i gruri në Kara.

Gjithsesi të ardhurat prapë do të shtohen. Vjet ndanë nga 10 lekë për ditë punë, se kishin edhe borxhët e fundit. Sivjet do të ndajnë mbi 12 lekë. Burrat janë të gjithë në minierë e në blegtori. Bujqësinë e mbajnë përgatitë dhe e mbajnë mirë, dhe rritja nga viti në vit nuk do të ndalet, se është zënë puna edhe nga një anë tjetër, që nuk duket në sipërfaqe.

Bariu Bajram është i lumtur ta urojë mikun me një gotë raki për Partinë dhe t'ia marrë një këngë për shokun Enver. E shoqja i bëri punët pës u ndier. Në shtëpinë e tyre, lart në malin e Trebeshinës, të vete buka në bark dhe gjumi bëhet si lehtë. Një dritë e paftërtisë sikur vjen nga çdo anë e kësaj shtëpie dherë e kthén kokën rrrotulli.

Gruaja ka gatuar bujari shqiptar, qyn e del, nuk i ndahet buzëqeshja. Një mikun imi në Tiranë i thotë së shoqes: «Po deshe, mos i gatuaj mikut asgjë, am i buzëqeshi, vetëm buzëqeshi!» Bajrami të hedh meze në pjatë, të dëgjon buzagaz, sikur çdo ifjalë e merr shënimin në mendje, hera hërës miraton me kokë, tregoni dëçka me zërin e qetë e të mirë si prej djaloshi, ndërkohë që është baba i katër fëmijëve, çdo gjë në kohë e në masë e duhur, mendashuri e thjeshtësi. Si janë këta njerëz kështu?

Ky Bajrami ëme të shoqen e mi fëmijët jetojnë jetën e plotë. Urtësia ëshfë të thjeshtosh teprimet, nga të cilat vijnë një varg me nga-

tërresa, të jetosh me gjëzimin e punës e të kri-jimit. Këtë gjë e ndien me forcë në shtëpinë e Bajramit, dhe mbetesh disi i hutuar, sepse është diçka që nuk e ndesh përditë, dhe kur e ndesh, vështirë se mund ta shohësh kaq të kthjellët e të plotë. Atëherë doemos zë të pyesësh, që të kuptosh më mirë, duke kërkuar shkaqet.

Kur i thirrën emrin në Kongresin IX të Bashkimeve Profesionale për ta dekoruar hero të punës socialiste, Bajrami u zbardh krejt në fytyrë. «Pse!» i tha ai shokut në krah:

Bajrami ishte marrë dyqind litra qumësht nga gdo dhi, po këtë e kishin bërë edhe në vise të tjera të Shqipërisë. Gjëja e re që solli Bajrami ishte që qumështi i tufës së tij kuq-tonte lirë: nga 1,8 lekë për kilogram, zbriti në 0,7 lekë. Kjo u bë një rrugë të thjeshtë, sic bëhen gjërat e mira të vërteta: duke «punuar» dhitë, që të kullotnin pa pushim. Bajrami i prin tufës natë e ditë, duke e nxjerrë ushqimin të gjithë prej malit, pa tjetër shpenzim, veç rrögës së bariut. Dhe kështu, kjo tufë jep aq të ardhura, sa të blejë veten brenda vitit.

Kur u kthye në Maricaj, ai ishte ende i turbulluar nga ato që pa e dëgjoi në Kongres dhe sidomos nga ajo që i ngjau atij vetë. Por shumë shpejt filloi të kuptonte se qe hapur shtegu i përtë nisur në malësinë e Tepelenës një lëvizje që i përkiste tërë rrëthit dhe që do të sillte ndryshime me rëndësi në jetën e kooperativave. Ai e kishte ditur këtë gjë qysh nga di-ta kur Partia e ngarkoi atë, komunistin, bë-

ri prej 19 vjetësh, të zgjidhët kecat prej nënës e prej babës, të krijonte prej tyre tufën, ta mbante mirë, të provonte «kapacitetin biologjik». Po nuk ia merrte mendja se kjo gjë do të arrinte përmasa të tilla.

Në mëngjes herët ndriçon në pllajë tufa e dhive. Kjo është dhia «capore» e jugut, e bardhë dhe e hirtë. Mbase është rritur pak në trup, ngjyrat i ka më të qarta dhe është më e pastër. Ndryshimi i vërtetë i saj ka ngjarë nga brenda. Kjo tufë është e racës së përmirësuar, që jep dy-tri herë më tepër qumësht. Po ky nuk është kufiri ku do të qëndrojë dhia, sepse, nga njëri brez në tjetrin, do të veprojë ligji i seleksionimit, duke e bërë këtë dhi përherë më produktive.

Bajrami përshtendetet me ne dhe del në krye të tufës. Zë e u thërret, u vërvellen, sikur po nis më to një bashkëfjalim të lënë përgjysmë mbrëmjen e shkuar. Kooperativa ka tanë tri tufa të tilla të zgjedhura dhe brenda pesëvjeçarit do ta kthejë të tërë kopenë në racë të përmirësuar. Dhe tej, në brigjet buzë Vjosës, po krijojnë tufa të tilla 21 kooperativa të tjera. Po kryhet kjo lëvizje në tërë rrëthin dhe barinjtë shpesh përmendin Bajramin, që nisi në emër të tyre këtë punë prej heroi, për të çuar në vend një porosi të Partisë, një kërkesë që e solli koha.

Ai po i ngjitet pllajës në krye të tufës, duke zgjedhur vendet ku dhia ta nxjerrë ushqimin vetëm prej malit. Ai ka dhënë djersën e tij për të krijuar diçka që do të vijë duke u rritur. Këtë gjësim do ta ketë gjithnjë brenda vetes. Në dimër mund ta ketë prapë vështirë, se fryn thëllimi e bie herët dëborë në shpatet e Trebeшинës. Po kjo racë dhie e njeh dhe e do malin e ashpër, ashtu si e do malin dhe jetën Bajrami.

Kurveleshit "Sipërin", qatia e Labërisë, mble-dhur në kooperativën e Progonatit. Kësaj kooperative mund t'i kishin vënë emrin e ndonjërit prej heronjve të shquar vendas, po lebërit, që nderojnë mikun, pëlqyen më tepër emrin e Xheladin Be-qirit, «Karadakut», Heroit të popullit prej Gjakovë, komandant i çetës së parë të Kurveleshit.

Nga kjo anë e maleve të Tepelenës njerëzit ecin më rëndë dhe në të parë nuk duken aq të çelur sa banorët e krahut të djathëtë të Vjosës. Labika pasë qëndruar më vete, kudo që të ishte. Të shikonte si nga lart, sikur të vinte në peshë. Po kjo mënyrë të shikuari e labit është zbutur prej kohe, qysh se jeta përreth pushoi se qeni armiqësore përfshirë, qysh kur e pa veten krejt të lirë dhe ndjeu se mund të gëzonte frytet e punës së tij, të ndryshonte jetën. Ky ndryshim i pamjes së kurveleshasit nuk erdhi menjëherë dhe as është kryer plotësisht. Vilon të bëhet me ritëm, vëndosmërisht, duke vërvshuar këtu jeta socialiste nga të gjitha anët.

Gjithsesi kjo anë e natyrës së tij, që ka pasur arsyetë jetë, përfshakatë urisë, vëtmisë e dëborës, nuk e pengon sot kurveleshasin ta bëjë bukën në një tokë që s'ë njihte grurin dhe të marrë kooperativa 13 lëkë përfshirë ditë pune.

Përpjetë përroit të Lekdushit ngrihen humnera shkëmbore të hirta, të prera thikë, me damarë ngjyrë bakri. Në përendim të diellit, duket sikur prej tyre do të rrjedhë gjak, në thellësitetë ku ende s'ka shkelur këmba e njeriut. «U bë

Gjolekë!». Burri që bëhej «Gjolekë», se i kishte dhënë «erë pallës», duke prerë kokat turqish, në këto rrëpira të frikshme gjente strehën e fundit, kur ia bëhte që nga Janina hordhia aimike dhe mbi çdo gur bënte rojë një zaptije. Pamja madhështore e grykës dhe maleve, e sigurisht edhe ngjarjet e përjetësuara, në köngët, nxitën zhvillimin që mori këtu alpinizmi vitet e fundit.

Se kurveleshasi e ka të lehtë të përvetësojë një ide, duke nisur nga më të mëdhatë: këtë e provon historia. Po mendjes së tij të shpejtë nuk i kalojnë edhe gjérat e dorës, së dytë. Të shohësh stadiumin e Progonatit, me tribunë çimentoje, mbetesh disi i habitur, njëloji sikur të shihje një shkëmb në mes, të një qyteti. Është rritur këtu një pasion, i vërtetë për futbollin. Ngā të gjitha sportet, vetëm ky mori yrull të madh populor, ndofta sepse këtu asnjeri s'i kishte rënë topit me këmbë. Sidoqoftë, këtë mund ta shpjegojë ndonjë psikolog. Krutja e Lushnjës mori famë me skuadrën e vajzave të volejbollit.

Në njërin krah të stadiumit është ndërtesa, e re trikatëshe e gjimnazit. Në krähun tjeter, si për në breg, është klubi nën «rrapin» e Progonatit. Në hijen e tij kanë qenë mbledhur kurveleshasit, për të ngritur çetat dhe shoqëritet e arsimit e të kulturës. Kaloh, erë dhë duket sikur kërcet trunguri rrapi, drurit, më madhështor, të denjë, për të mbajtur nën hijen, e vet kuvendet. «Bilbilenjtë trembëdhjetë»... Nën këtë rrapi kishin ndenjur edhe ata, që e kthyen vdekjen e tyre, në legjendë tek ai rrapit, tjeter në Janinë.

Malet rreth Progonatit vijnë e zbuten, të veshura me një lëkurë prrallesh, kullotë e mirë. Në pllajën e lartë me brigje guri e fusha të vogla, të pjerrëta, ngrihen pesë fshatrat me

shtëpitë e bardha rrrethuar me gjelbërim, më e vjetra shtëpi 35-vjeçare, se këtu s'mbeti gur pà djequr, dy herë, tri herë. Këtu tèrhiqeshin batalionet e brigadat kur dyndej në operacione armiku. Nënët, që jetonin me fëmijët në shpellë e gûva, u ndanin luftëtarëve kafshatën e fëmijëve. Kjo është përmendur shpesh në letërsi, por edhe shumë lakra janë ngrënë, në vitin 1942, 43, 44, se, veç zjarrit e hekurit, armiku i kishte ngritur Kurveleshit rrrethimin e urisë.

Ky është një vend plot me befasi, që të habit me gjérat që sheh, si edhe me gjérat që mungojnë. Këtu do të kërkosh më kot gjurmët e një kiske a xhamije. S'ka pasur të tillë në Kurvelesh. E shumta mund të gjenden gurët e themelit të ndonjë mëkami nga koha e turkut. Banori i këtyre anëve njihet për zot vetëm shpirtin e vet. Zogu nxori një urdhëresë që cdo fshat të kishte klerikun e vet, sipas besimit. Kurveleshasit qeshën. I dërguan fjalë priftit të Pilurit: «në të ka hesap, uratë, hajde bëhu hoxhë më na».

Këtu, ende mund të shohësh nënët e vjetra me citjane, me shamitë e zeza shtrënguar rreth kokës, tek ecin me trupin drejt, duke u lëkundur, sic do të ketë ecur një grua e re qëmoti. Pak më tej shikon një bari që kthehet nga stanime radion e dorës te veshi dhë disa çupa që vijnë nga puna më veshjen e vajzave të fu-shës së Devollit, me fytyrat e skuqura nën kashforet e mëdha. Po bie mbrëmja dhe më pas familja do të mblidhet rreth televizorit.

Kurveleshasi nuk është konservator, as për punën e deles, siç thuhej deri aty më parë. Vërtet përmirësimin racor e kanë ende të ulët, po tani veprojnë shpejt, me një ritëm që s'ta merr mendja, llogaritin që në mbarim të pesëvjeçarit të arrijnë 100 për qind, duke ecur delja në Tepelenë krahas me dhinë.

Kooperativa e Kurveleshit të Sipërm do të marrë së shpejti drejtim blegtoral. Kjo është një e ardhme e afërt, që vjen e takohet me të kaluarën. Kurveleshasi gjithnjë është marrë me delen, vetëm me delen. Po tani puna ndryshon me themel. Duhen ndërtuar më tepër stalla, duhet ushqimi i koncentruar. Aty në zyrat e kooperativës janë në tension. Në tre vjet e sipër do të bëhen punë të dhjetë vjetve. Çdo gjë është me grafik e grafik do të thotë saktësi, disiplinë.

Po në të niëjtën kohë do të bëhet edhe buka. Duhet të rritet rendimenti i grurit, në një tokë që s'e ka pasë njohur këtë bimë.

E kush mund ta çmojë grurin më shumë se ai që ka pasë mbetur pa bukë në dëborë?

Tani në verë shtëpitë e bucura të bëra me plan qarkohen nga një lule vjerrëse e kuqe, që është mjaft e përhapur. Në disa oborre dikutë zë syri edhe lule në ngjyrë të kaltër e të bardhë. Lule në Kurvelesh!

Në të majtë të rrugës që të çon në Gusmar shikon bllokun e parë të madh të mollëve. Japin kokrra të mëdha, të kuqe, të forta, me aromë, me

një shije që nuk e ka asnijë lloj molle tjetër. Kur-veleshi furnizon me mollë edhe Tepelenën.

Këtu bëhet mirë edhe arra e gështenja. Këtu merret prej tokës së ashpër çdo gjë që mund të japse. Aty ku bëmë rritet në gur, njerezit janë të fortë si stralli?

Po mblidhen retë në majat e Këndrevicës. Një shqiponjë sillet ultas në grykën e gjatë të Vërmikut. Në klubin e Progonaçit burrat hijerëndë pinë kafen e mbrëmjes; ndonjë gotë raki. Tre djem të vegjël ia kanë marrë valles në një bahçë:

Këndrevica mal me borë,

Bibili me palle në dorë

Gremisi katër taborë...

Ai më i vogli, që heq vallen, pret ajrin me dorën si jatagan, kërcen lart duke u sjellë rrëthvetes, tund fustanellën që s'e ka, vë të dyja duart në mës, te koburet e sermit që i mungojnë. «Mbamëni, se fluturova», i thërret të dy shokëve ky burrë i vogël. Kjo është një mrékulli. «Mbamëni, se fluturova», i thirri çetës Bilbil Shakoja, kur u ngrit në vallë ditën e dasmës së tij.

3

Udhëtarë që kalonte në krahun e djathë të Vjosës në vitin 1943, shihte me habi trasenë e një xhadeje të vjetër, ose më mirë skeletin e saj, sepse ajo mund të ishte përdorur në kohën e qerreve, dhe pastaj që lënë. Kjo xhade e cte

buzë lumit, po diku u afrohej edhe kodrave të murrme. Rrëzë një kodre shihje një tunel të errët si një gropë e thellësisë. Në hyrje të tunelit, në terr, ndritnin eshtra të bardha, me atë bardhësi që ka vetëm vdekja. Mund të ishin të njerëzve a të kafshëve. Udhëtarit nuk i bënte zemra të kërkonte më tej. Pastaj, në kodrën tjetër, prapë një tunel po aq i errët.

Kjo ishte deri në vitin 1945 miniera e Memaliajt. Historinë e saj e gjen të mbledhur në ca shkrime të ruajtura me kujdes në një dosje të drejtorit.

Këtu e nuhatën qymyrin në Luftën e Parë Botërore austro-hungarezët, francezët dhe italiannët. Në shkrimet përmendet sidomos emri i njëfarë Novaku, çek. Më 1914 Italia zuri të nxirrte qymyr përflooten, në baltë e në ujë, si njeriu i lashtë, dhe qohej qymyri me kuaj në Rrepët e Dervenit. Pastaj heshtje. Pastaj prapë Italia në vitet 1940-1941, por e pati të shkurtër, se rrëth minierës filloi të kërciste pushka. Të asaj kohe janë eshrat e bardha, të kafshëve a të njerëzve. Pastaj historia jonë, e nisur në vitin 1947, me njëzet punëtorë në çadra, aty ku ngrihet sot qyteti Memaliaj me 5 000 banorë dhe më të ardhmen e një pune që do të ecë në breza.

A është kjo e tërë historia?

Arkeologët, ose paleontologët, mund të zbulojnë më pas gjurmë më të vjetra rrëth minierës, se qymyri ka qenë njojur edhe më lashtë dhe fshatarët dinin përf «gurin që digjej». Sa përf atë skeletin e xhadesë, dihej se ajo ka qenë e kohës së turkut dhe e cte buzë lumit, duke synuar Vlorën. Po mbapse edhe ajo mund të ketë një nënshtresë tjetër, të kohës së Bizantit, të romakëve, të ilirëve. Kjo luginë, që zbut me të

butë, në det, gjithnjë ka tërhequr njërit, të pakrën
tën që nga koha kur adhurohej ajo perëndia e
fuqishme dhe e vegjërëse Vjosës.

• * * *
• * * *
• * * *

• Për katër vjet miniera në Memaliaj e plotë-
sonte planin rrëth 80 përqind.

«Që bëhet kështu në Memaliaj?» Ndërmarrja e
madhe kishte ngecur, si një kamion që i vërti-
ten rrrotat në baltë e nuk del, sado të shtojë
zhurmëri e motorit. Prapambetja në punimet mi-
nerare kishte arritur 7 km në vit, qymyri dilte
me cilësi të dobët, gati gjysma e punëtorëve
nuk plotësonin normat. Dukej sikur një shpirti
përtac e një mendje e ngathët endej në zonën
e qymyrit. Kjo shkaktonte mërzitë njerëzit dhë
një ankth te drejtuesit e rrëthit, ndërsa nga mi-
nistria vitin pareshtur ekipeti Partia s'mund të
të durojë lëvizje gjendje të njëjse, që megjullt, në çdo pikë
të vendit që të shfaqet,

Drejtori rri perkultur mbi tryezë, kokulur. Flet
me pak zë, me sytë blu të fiksuar, athua se për
çdo mendim kërkon pëkqimin e atyre dy mijë
vetave që ndërrohen me turne në galeritë. Ndërsa
flet, llogarit djika me një makinë të vogël, xhepi.

Punimet minerare në vitin e kaluar u ngri-
tën 48 përqind, u vendosën pasaportat e ci-
lësisë me efekte mbi pagën, u krijuar brigada
për të riparuar në vendhavaritë, nisi prodhimi
në oficinë i teleferikëve, shkarkuesve, terikona-
ve...

Por asnjë nga këto punë, as të gjitha bashkë,
nuk do ta nxirrin qerrën e rëndë nga balta.

Këtë e bëri organizata-bazë e Partisë, si një zemër që çon gjakun në çdo qelizë. Këtë drejtori e sheh, e prek dhe beson në të me shpirt, se Partia nguli këmbë në studimet, në hartimin e planeve nga vetë minatorët, në disiplinën. Dhe mungesat në punë u ulën 1,7 për qind kundrejt 9 ditëve vjetore që ishin më parë, punëtorët e prodhimit plotësojnë normat 100 për qind, u zhdukën ankesat për cilësinë, kthesa e misur në vitin 1981 ecën përpara, në 6 muajt e këtij viti miniera dha 6000 tonë prodhim mbi planin dhe i ka të hapura rrugët e qymyrit.

* * *

Në katin e tretë të pusit gjendemi nën nivelin e detit. Ta dish se deti qëndron më lart, kjo të jep një shqetësim. Po të mos e ndalnin malet, dallga e madhe e kaltër do të përplasej këtu, duke fshirë gjithçka.

Në «oborrin» e pusit sillen vagonët të tërhequr prej elektrovozave. Në njërin krah kalojnë vagonët bosh, në krahun tjeter vjen qymiri. Është fresk. Këtu temperatura qëndron në të njëjtën vijë rrëth vitit, si në çdo minierë. Motopompat e fuqishme e çojnë ujin 300 metra lart, tubacione të tjera sjellin ajrin e pastër, duke përcjellë tingujt. Vështirësia fillon dy km më tej, te «llavat».

Qymiri ecën ndërmjet shkëmbit të murmë, si një vijë e shtrembër mellani, në pjerrësinë 45° dhe me një trashësi që nganjëherë nuk i kallon 70 cm. Këtu duhet të nxjerrë qymyr minatori, të lakojë trupin e të ndejë muskujt. E megjithatë, tani të rinjve që mbarojnë shkollën e mesme ua ka ënda të hyjnë më tepër në mi-

nierë, se këtu kalitet burri, shpërblimi është më i mirë dhe shoqëria e minatorëve njihet për solidaritetin.

Miniera shkon përpara. Që të bindesh për këtë, s'ka nevojë të shohësh evidencat lart në zyra. E tregojnë fytyrat e qeshura të minatorëve, thirrjet që jehojnë, në galeritë, shakatë, dhe sjeillja, e mirë qytetare, në ashensorët. Atëherë ndaleshi dhe i bën vetes këtë pyetje: si ndodhi që të njëjtat fytyra ishin të «mërzitura» katër vjet me rradhë?

«E po, bindja, organizimi, drejtimi i mirë.»

Ngado që ta vërtitësh mendimin, më në fund këtu arrin, te «bindja», «organizimi», «drejtimi». Sepse njerëzit janë prej mishi e prej gjaku dhe kanë një prirje të fortë për t'u drejtuar nga e mira.

Kjo është ndërmarrja më e madhe e rrëthit dhe, a mund, të lejohet pakësimi i nxjerrjes së qomyrit, kur botën po e shtrëngon kriza e rëndë e energjiitikës?

Kryetari i kooperativës së Krahosit është me trup mesatar, me fytyrën me rrûdhët e një burri, të moshuar, po me pamjen e një të riu, mba se për shkak të syve.

Kryetari mban në dorë një letër që ia ka dërguar njëri prej Patosi. Ky i kërkon një vërtetim për një mjek italian që paska shërbyer në spitalin e Krahosit në dimrin e vitit 1943-44. Vërtetimi i duhet për t'a dërguar mjekut në Itali.

Kryetari shikon i menduar bregun e lartë, ku ka pasë qenë ai spital i dëgjuar partizan,

që në kohë të vet i shërbeu jo vetëm zonës së Tepelenës. S'ka mbetur gjurmë prej tij dhe as plakë përkujtimore s'është vënë. Kjo s'është e drejtë. Duhet të përkujtohet vendi ku ka rënë një trim, por edhe vendi ku kanë shëruar plagët me dhjetëra veta, me ilaqë të pakta, ose edhe pa ilaqe, thjesht me qumështin e ngrohtë të fshatarit, dhe ku janë bërë operacione që mezi i pranon si faktë kirurgjia e sotme.

Ama, edhe sikur të dihej ky spital, kush mund të lëshonte vërtetim pér mjekun italian? Sidoqoftë kjo punë është pér komitetin e veteranëve. Kryetari fut letrën në xhep dhe lëviz kasketën. Tani ai ndodhet në përfundimin e fushatës së grurit dhe s'u ka ngenë punëve të tilla.

Megjithatë, përse i duhet vërtetimi atij italjanit? Mbase pér efekt pensioni, mbase është nga ato gjërat që lidhen me ndërgjegjen dhe që bëhen përherë më të rënda aty nga fundi i jetës. Kryetari shikon edhe një herë letrën.

— Dua të takoj traktorist Seferin, Heroin e Punës Socialiste, — them unë.

— Ja tek e ke, — thotë kryetari, duke treguar një traktor që vërtitet tej në pllajë.

* * *

Traktori i sillet pllajës duke shtuar ngjyrën kafe rrëth vetes. Së largu duket sikur ai kryen një punë të lehtë e të gjëzueshme. Po, si të ulesh në traktor pranë Seferit dhe t'i biesh nja tri herë rrötull parcelës në brinjë, në sytë e tu trazohet ngjyra e verdhë e zjarrtë e kash-tës me ngjyrën e errët të dheut, ndërsa vallë-

zognë kodrat, edhe kur të ketë ndaluar traktori.

Seferi duket i pandjeshëm ndaj troshitjes e zhurmës dhe ndjek me mendje brazdën. Diku plugu ndesh në shtressë të fortë, atëherë ai shton lehtas gazin, që fuqia e traktorit të jetë gjithnjë e barabartë me punën, duke ia kur-syer në çdo pikë energjitet. Kujdesi e durimi i tij të thithin krejt dhe të duket vetja një barrë e tepërt në kabinë. Ai është 41 vjeç, me trupin mesatar të fuqishëm, me fytyrën të kuqe, me flokët të prerë shkurt. Flet shtruar e ngadalë, si bujk që ka folur férë jetën me tokën. Kur ngre sytë, i ngjan një djaloshi të dashur 30 vjeç.

I bëj një pyetje krejt të rëndomtë:

— Si e ndjeve veten tre vjet më parë kur u shpallo Hero i Punës Socialiste?

— Ajo s'qe gjë. Puna ishte kur më përqafoi shoku Enver në tribunën e Kongresit IX të Bashkimeve Profesionale. Më tërroqi nga vetja, u gëzua që më pa me shëndet. Ku ka si Partia jonë në botë!

— Seferi s'ka hyrë në Parti, se i mungon shkolla. Bën klasën e shtatë. Plotëson çdo vit planin 170 për qind. Punon për vitin 1993. Duhet ta kuptoj këtë punë. Si arrin ai ta bëjë planin 170 për qind?

Ai nuk bën tjetër veç të parandiejë defektet e traktorit, si njeriu në trupin e vet dhe t'i ndreqë këto në kohë shiu, prej nëntë vjetësh, me të njëjtin traktor. Po në ballin e tij të gjerrë, në sytë e qeshur, lexohet një mendim i dytë: «punoje tokën më thellë se yt atë, jeto sipas mësimeve të Partisë».

Njeriu i mirë bëhet strumbullar. Sipas tij ecën brigada dhe zë e përhapet shembulli.

Pyeti njerëzit për të në luginën e Krahasit e në Tepelenë dhe do të tundin kokën duke thënë: «Ehë, ai është burrë.» Dhe me këtë duan të thonë se ky njeri ka për të qenë tërë jetën strumbullar.

5

Në mbrëmje Tepelena, gjysmë kala, gjysmë qytet, zë e përfaket dhe hijet e gjata të maleve shtrihen mbi lumë.

Në këtë orë të mbrëmjes katër djem këndojnë nën zë, tek agjencia rrëzë sheshit:

Ra një ves'e mbuloi dhenë,

Ra Tafili n'Tepelenë...

Në këto anë këndojnë kur janë të ngeshëm. Dhe zënë e diskutojnë për këngën. Njëri nga djemtë shfaq dyshimin nëse atë ditë kishte rënë vesë vërtet, apo ushtria kryengritëse e Tafilit mbuloi dhenë si vesa. Tjetri thotë se me këtë këngë duhet të punojë më mirë grupi i Bënçës.

Në këtë orë të mbrëmjes kthehet nga peshkimi Velikoja duke mbartur vjersha. Kur zhvishet Velikoja buzë lumit, në trupin e tij dalin në shesh gropat dhe shtrembërimet e gjashtë plagëve. Ka shkruar 170 vjersha për heronjtë e shkuar e të sotëm, po gjen vështirësi me botimet. S'di të «krehë», të «redaktojë». Sonte një kujtim i vjetër kthehet në mendjen e tij dhe zë e murmurit me vete:

Një zhurm' e pyllit më zgjoi,

Ti po kriheshe te kroi...

Në këtë orë të mbrëmjes, Shyqyriu e Zagolli ecin në rrugën e gjërë të qytetit duke biseduar. Janë të thinjur dhe pak të kërrusur në supet. Mbajnë këmbët para busteve. Tre heronjtë e shquar të Tepelenës kanë marrë ngjyrën e zjarrit nga njëra anë e bronxit, kurse nga ana tjetër bëjnë një hije ngjyrë plumbi.

— Kur ishte Abazi i burgosur në Tiranë, — thotë Shyqyriu, — i shkroi e shoqja nga spitali, i thoshte se gjendej në shtratin e vdekjes e nuk do të shiheshin më. Abazi u hoq i sëmu-rë në burg, kaloi çdo pengesë, vate tek e shoqja në spital, e përmendi, i mori fytyrën në duar dhe i tha: «E sheh që u poqëm prapë! Ti do shërohesh e do jemi bashkë.» E shpëtoi nusen që i qe dorëzuar vdekjes. Ja, këto anë të jetës së heronjve nuk janë shkruar gjëkundi.

— Gjolekës i erdhi një letër dhe një fotografi e një ushtari të Asimit, — thotë Zagolli. — U paskej thënë ushtarëve Asimi: «Kjo është fotografia e fundit, po edhe fotografia e historisë së re.»

Në këtë orë të mbrëmjes ndizen dritat e bardha lart në kodër, në varrezat e 290 dëshmorëve të rrethit. Cila dritë është e Nimete Progonatit, heroinës 14-vjeçare, që u nis me brigadën prej Luzatit në prill dhe u vra në korrrik në Dibër, duke kaluar si një yll në qie-llin e Shqipërisë?

* * *

Fryu erë tërë vitin në Tepelenë, erë e mbarë. Tepelena po bën grurë edhe në malësi, po kryhet një ndryshim i thellë në «kapacitetet

biologjike» të gjësë së gjallë, shkon përpara prodhimi industrial.

Një ekip i Televizionit sillet përgjatë Vjosës. Bëjnë një film për rubrikën «shkolla dhejeta».

Në muze qëndron shtrirë hyjnia e lumit, me trupin e fuqishëm, me fytyrën e vjetër të ashpër. Lumi rrëshqet si me fshehtësi në zallin e bardhë dhe pëshpërit në kthesa duke shkumëzuar emrin e vet të lashtë: Aoos, Aoos, Aoos..., a thua se tregon më nge legjendat e shumta, prej fisit ilir të Kaonëve deri në ditët tona.

Mund të ngjajë që të ngrihet lijeni i madh rreth kalasë. Këtë nuk do ta kapte imagjina-ta e fuqishme e Ali Pashës, por në kohën e vet ai do të jepte çdo gjë për të pasur një det të tillë rreth kalasë. Mund të fitojnë variante të tjera, ose të gjitha bashkë, duke e kthyer Vjosën në një det të vazduar ndërmjet maleve, si Drini në Veri, duke i ndërruar Tepelenës jo vetëm fizionominë, por edhe drejtimin e erë-rave.

korrik 1982

shqipërisë së cilët është qëndruar kryesisht në përgjithësi
dhe qëndruar kryesisht në përgjithësi. Në
përgjithësi, qëndruar kryesisht në përgjithësi.

KOHA E BARIUT

Në kullotat e Vajurës, në majat e Malit të Gjerë, në qershori pllajat janë të blerta, kundërmojnë lulet. Kurse tanë, në mbarim të gushtit, dridhet bari i hollë i verdhë dhe afër mbrëmjes duhet të mbështillesh me shark, duke ndier një kënaqësi që të hyn në trup.

Në pllajat lëvizin ngadalë tufat e dhënve. Një bari hedh kripë mbi gurët e lëmuar. Sot dhentë kanë ditën e kripës. Sa më larg nga deti, aq më pak kripë përmban bari. Hijet e mbrëmjes zgjaten me shpejtësi këtu në male, drita pakësohet befas, vendi shkon poshtë drejt gjirit të natës. Në qetësinë e thellë zë e dëgjohet ndonjë këmborë, vërvhellima e një bariu. Nga stanet lëshohen qentë, breshin, lehin, grinden, që të arrijnë tufat, t'i përcjellin gjatë kullotës deri në mesnatë, se nata është e ujkut, prapa të cilit ecën çakalli.

Nuk dihet përse dhe në cilën anë mund të shpërthejë shpirti i njeriut, nga një bisedë e rëndomtë, nga një kujtim. Po kur ngjet kjo gjë, duhet të rrish gati.

Një bari i porsaardhur po tregonte ngjarje nga fshati e nga ferma. Tha me të qeshur se rinia do të ujiste me kova rrapi e madh që i qenë zverdhur fletët. Një grua ishte sëmurë, me dy mjekë te koka.

Thimjoja rregulloi drutë e zjarrit dhe i ngri-
ti fitilin fenerit varur në mes të kasolles. Ish-
partizani, 58 vjeç, me trupin si një lis i fu-
qishëm, zinte gjysmën e vendit, fytyra e kuqe
i ndriste. Statistikat thonë se nga gjithë pro-
fessionet bariu ka jetën më të shëndetshme e
më të gjatë.

Thimjoja tha diçka për bujarinë e lashtë
të stanit, që mbetet kurdoherë i hapët për
udhëtarin, në kohën kur radioja nisi lajmet.
Zëri i spikerit ishte i afërt e i dashur, u kri-
juar lidhja me jetën përtej maleve. Barinjtë,
të etur për lajme si detarët, mbajtën vesh. Kur
nisi muzika, foli me mllef Qiriakoja:

«Babait tim nuk i thoshin mirëmëngjesi.
Ngjitej e zbriste rrugëve të fshatit si një trung
e jo si njeri. Kush të fliste kur s'kishte bu-
kë në shtëpi e opinga në këmbë? Qava fshe-
hurazi nga gjëzimi kur kali ynë bëri zarar, se
atë ditë u dëgjua emri i babait në fshat. Po
tani? Dy radio kam në shtëpi. Edhe televizor.
Më prishet mendja kur hyj brenda.» Në këtë
pikë ai ngre zërin lart, në fytyrën e zeshkët i
vërshon gjaku: «Mos fol me gojë për këtë që
bëri Partia, po me shpirt, që as plumbi mos të
të shpojë.» Trupi i tij i thatë është ndehur si

hark sipér zjarrit, sytë e skuqur i nxjerrin čika, duket sikur nē kêtë čast me tē vërtetë nuk do ta shponte thika, as plumbi.

Tē tjerét mbajtén vesh nē heshtje kêtë ligjératé tē befasishme tē Qiriakos, duke menduar shkakun, Mund tē ishin lajmet e radios, ose ato qē tha bariu i ri nga fshati. Ose shpirti i Qiriakos shpértheu pa ndonjë shkak. Sido qē tē ishte, Qiriakoja tha fjalë tē vërteta, ata e kishin bashkëfshatar, ia dinin jetén si jetén e tyre, por ama s'kishin ditur hidhërimin e tij pér tē atin, qē s'e përfillte kush, ishte e para herë qē e dëgjonin kêtë prej tij. Kjo ia pas-kësh helmuar jetén nē djaléri Qiriakos më fort se skamja e uria. Mohimi, mospërfillja, këto janë pér njeriuun një dënim qē nuk mbartet. Më nē fund, shumékush nga brezi i vjetër e ka provuar kêtë gjë. Po ç'iu shkrep kështu Qiriakos?

Barinjtë ndenjén dissa časte duke e parë Qiriakon pjerrtas, duke i dhënë tē drejtë. Pastaj lëvizën, përgatitën darkën, sallatë me domate e tranguj dhe përshest me qumësht. Në mbarim tē gushtit qumështi i deles ka mbi 8 pér qind yndyrë dhe duhet tē përdoret me masë.

Pas darke ata biseduan nëse njeriu lind apo bëhet bari. Disa djem nga fshati po hynin nē zanat. Veçse këta tē rintjtë i silleshin zana-tit rrrotull si një mëz qē s'do tē shtrohet nē lëmë. E duan ndryshe blegtotorinë. Kurse nē fshatin Nivicë kanë shkuar natë ditë pas deles, nga babai tek i biri.

«Kullotat po pakësohen, se hapen toka bu-ke,» tha si me drujtje bariu i ri qē erdhì nga fshati. «Do tē përdoret edhe ushqim i koncentruar.»

«Bëni si të doni», tha Qirjakoja, dhe u shtri, u mbulua me shark.

«Se mos do ta bëj unë. Këtë e kërkon ko-ha», tha bariu i ri.

Qiriakoja ngriti kokën nga sharku, ndenji në bërryl, fytyra iu duk e errët, e përzhitur, i ndritnin sytë.

«Ushqimi i koncentruar... e ku ma gjen!» tha.

Thimjoja shoi fenerin dhe barinjtë ranë të flinin në velenxat, u mbuluan me sharqet, duke menduar për të rinjtë, për ushqimin e koncentruar.

Që nga dera e kasolles dukej një rrip qie-lli. Po pakësoheshin yjet, po merrete anë agimi.

«Delja të do mbrapa», tha Thimjoja. «Ti qan për të, s'ngopesh me kullotë kurrë. Po u ngope, vate delja. Dhe kështu ti lidhesh me të shkretën dele përjetë... Mbase ngaqë vuani bashkë me të.»

Do të ishte çudi të shihje duke qarë një burrë si Thimjoja, me trupin e fytyrën e një kreshniku. Po, kur e vëren nga afër dhe i dëgjon zërin, bindesh se ai mund të qajë e të thërrasë për delen.

«Që kur mësuam gojën, i kemi folur në-nës, pastaj deles», tha brigadier Vasili.

«Vjet në Çajup, — tha Qirjakoja, — u bë dëbora det, u fry si brumë i ardhur. Minellë, humbëm me gjithë dhen, thashë unë. Do të vdesim, tha Minella. Ama ndriste hëna. Vumë cjeptë e shkretë përpara të hapnin dëborën.

Doli ujku dhe preu një dele. Minella sokëlliu, qëlloi me dyfek. Kur u praps ujku dhe cjeptë po çanin më tej, humbën mushkat. Qenë kthyer në kasolle nga e keqja. Çudi e madhe, kishin hyrë brenda duke ulur kurrizin si njeriu. Ja, këto heq kur bredh pas deles.»

Ky, Qirjakoja është 65 vjeç, po s'do të dälë në pension. Dy të tjerët e shikojnë në hesh-tje. Ç'i ka hipur Qirjakos të tregojë historira!

«Pa duhet të mbash qëngjin në gji, — tha prapë ai, «kur pjell delja në të ftohtë. Duhet të kesh mendjen nga rrëketë e shkrepat, se, po u hodh njëra dele, i venë shoqet imbrapa. Ç'heq kur të zë papritur dëbora në male. Bariu, shokë, bariu, kur gjëmon e frys veriu.»

Qirjakoja po fliste si me vete, si njeriu që lë amanetet. Thimjoja u bë merak për të, trazoi urët, hodhi një dorë shkarpa në zjarr, që tia shihte fytyrën e zeshkët. Jo, s'ishte sëmurë. Po nganjëherë Qirjakoja bëhej tuhaf. Rrinte dy ditë pa folur, pastaj fliste njëherësh.

* * *

Barinjtë dolën nga kasollja. Sa kishte filluar të merrte anë qielli, hijet në stan ishin ende të turbullta. U lëshuan tufat nga vathët, u nisën për në kullotë. Nuk i shquante syri, po drejtimi që morën kuptohej nga rrahja e tokës prej thundrave të tyre. Në ajër u përhap era e mirë e deles, trazuar me erën e barit me vesë dhe, po të nuhatje më thellë, shquhej era e trëndelinës. Zunë të lëviznim shpendët e padukshëm të malit, të kalonte fshehtas thëllëza me ngjyrën e hirtë të gurit.

Paska ardhur natën veterineri. Ka fjetur në

kasollen tjetër. Meqë do të ikë shpejt, zë e bisodon me Vasilin dhe Thimjon. Tri brigadat e kanë arritur 75 për qind përmirësimin racor. Duhet bërë grafik i ri për stacionin e ndërzimit.

Pra, këto tufa të dhenve që po shkojnë në kullotë mbartin me vete përmirësimin racor. Brenda tyre ecën një gjak nën kontrollin e shkencës. Qirjakoja po rregullon diçka te gar-dhi para kasolles. Afrohem dhe e pyes se ç'do të bëhet kur të arrihet 100 për qind përmirësimi racor.

— Do t'u kthehem nga e para.

Retë e pakta mbi Nëmërçkë kanë marrë një ngjyrë të lehtë vjollcë. Në majat e Vajurës ka më tepër dritë. Zënë e shquhen tufat e dhenve. Njeriu i pangopur me gjumë e ka vështirë të merret me kuptimin e jetës në këtë orë të agimit. Po ato dy fjalë të Qiriakos ta nxjerrin gjumin krejt. Këta e zgjidhkan fare thjesht ligjin e ndryshimit dhe seleksionimit, për të cilin janë shkruar e do të shkruhen dhjetëra vëllime, e nxitin këtë ndryshim me duart e tyre, duke synuar më të mirën, delen që do të japë më tepër lesh, qumësht e mish dhe kjo punë s'do të ketë mbërim. Si do të jetë rendimenti dhe vetë delja pas njëqind vjetësh?

Mbi malet në horizont u ngrit përgjysmë dielli flakë. Kullotat morën më tepër dritë. Në majat tej Vajurës zunë të sajoheshin figurat e disa topave. Pastaj vezulloi çeliku i tyre. Në brinjë lëvizën kamionë, duke përhapur gumë-zhitjen e motorëve të fuqishëm. Këta janë një nënrepart me kooperativistë që bëjnë stërvitje ushatarake dhe që dolën aty gjatë natës. Ende nuk shquhen njerëzit. Ka ditë kur jeta e ushtarit ngjan me atë të bariut.

* * *

Veterineri, brigadieri dhe Thimjoja, po ecin në shpat me lehtësi. Ndalojnë në breg dhe shikojnë poshtë kufirin e kullotës. Për këtë kufi Saranda kishte një grindje me Gjirokastrën. Ekziston e drejta sipas kadastrës, por edhe e drejta e bariut. Më në fund grindja u zgjidh në Kryeministri. Tani brigada duhet të bëjë kujdes me kufirin. Ata të tre flasin me zë të ulët. Bariu e merr këtë zakon të të folurit ultas përtë mos trazuar qetësinë e kullotës, po zëri përhapet lehtë në male. Thimjoja ngre krahun, tregon një luginë të vogël aty poshtë, në mes të dy kufijve. Veterineri tund kokën, nuk pranon. Thimjoja ikën më tej i zemëruar, rri me trupin e madh mbi shkëmb. Zemërimi i tij është i pafuqishëm. A mund të inatoset njeriu me kufirin e kullotës?

Një orë më pas kishte rënë qetësi në statnet. Tufat e bardha të dhenevë lëviznin ngadalë në pllajat. Kjo ishte një ditë si çdo ditë e deles, koha kur mbështetet rrëzë prallit dhe ndofta dremit bariu. Sepse ky nuk e ka të ndarë kohën. Jeta e tij rregullohet pas deles dhe stinëve të motit, në vetë gjirin e natyrës.

Në brigadën e parë pesë barinj janë ulur te gorrifica dhe dëgjojnë një leksion të teknikut për përdorimin e kullotës. Kullota nuk u pastroka vetëm me zjarr. Mendja e bariut zë e ngacmohet, tek shikon të zbulohen dukuri të cilave u ka kaluar pranë tërë jetën dhe s'i ka vënë re. Paska edhe arsyetë tjera që «bari të hahet me shkop». Jo çdo gjë e dinë barinjtë e vjetër. Librat dinë ca më shumë. Dhe sidomos kjo delja e përmirësuar, që jep dy herë më tepër se delja e vjetër, kjo e dashka ndryshe në

disa pika. Të ngjitesh në mal në verë dhe të zgresësh në dimër në vende të ngrohta, të ruhesh nga gëlbaza e bari me helm, të kujdesesh që çdo qengj të pijë nënën e vet, këto nuk mjaftojnë.

Pastaj tekniku nxori një bllok tjetër dhe filloi «rakordimin» me brigadën. Po të e cte brigada me të njëtin ritëm, në fund të vitit secili do të kishte arritur mbi 520 ditë pune. Kjo ishte një gjë e mirë fort, që i bëri nja dy barinj të çoheshin në gjunjë, ta shihnin nga afër bllokun e teknikut dhe të bënin krahasime me defterët e tyre.

Çfarë ka mbetur ngajeta e dikurshme e bariut, nga «bukuria e stanit»?

Ka mbetur çdo gjë, siç ishte, përveç urisë, morrit, paditurisë, mizerjes, që s'janë më. Të duash të zbulosh romantikën te barinjtë e vjetër, është si të shohësh jetën e kaubojve të «Perrëndimit të Largët» sipas përcudnimit të filmave amerikanë.

Jeta e bariut po ndërron edhe më tej, duke ndërruar ai me duart e veta edhe delen. Këta jetojnë brenda kohës së tyre, bëjnë një punë si gjithë njerëzit, atë punë që duan të bëjnë, sëmuren rrallë e jetojnë gjatë. Naimi e Cajupi qanë përfatin e bariut, po, me gjithë fuqinë tejpamëse, nuk mundën të shihnin se si do të ujdiste jeta e bariut me kohën e me shoqërinë në të ardhmen.

shtator 1982

KRIPA E TOKËS

1

Nëpër rrugën automobilistike ndërmarrjes buj-qësore të Lukovës i shikon vetëm «bishtat». Po të hysh brenda në të, humbet në gjelbërim, sheh aq sa mund të shohësh në pyll. As prej soditjes lart nga malet nuk mbetesh i kënaqur, për shkak të valëzimit të kodrave e grykave të thella. Atëherë zë e kërkon pika të tjera prej nga mund ta vrojtosh më mirë këtë ndërmarrje me pamje befasuese, 42 km të gjatë.

Njëra nga pikat, që ka të bëjë edhe me vetë lindjen e historikun e shkurtër të fermës, është kodra e lapidarit, ku u ndal shoku Enver Hoxha në vitin 1966 dhe porositi të shpylli-zoheshin faqet e maleve me bimësi të dendur, të egër, dhe të kthehej i tërë bregu në një plantacion madhështor të agrumeve e ullinjve.

Kjo kodër është si një ballkon mbi det. Nga e majta shikon Kepin e Qefalit dhe, nga e djath-ta, malet e Himarës, shikon Jonin blu të qetë, në sipërfaqe të të cilat lëvizin ca rrryma ngjyrë qumështi, si vizatimet e një fëmije; shikon masivin nr. 1 të ndërmarrjes, që mbulon kodrat me agrume e ullinj, prej detit deri në lartësinë 402 metra.

Në këtë kodër kanë ndalur pesë vizitorë nga vise të ndryshme të Shqipërisë. Njëri prej tyre, një burrë i moshuar nga Lushnja, kthehet rreth vetes, shikon si në të paktën, duke murmuruar: «Sa bukuri! Sa bukuri!»

— A do të qëndroje këtu përjetë? — i them. Burri i vjetër mendohet, duke pasur ende dritën në sy, një valë gjaku i vërvshon në ftyrë. Thotë:

— Secili qëndron në sektorin e vet. Kooperativa ime është buzë Shkumbinit.

Masivin nr. 1 Përparim-Borsh mund ta shohësh mirë edhe nga deti. Kur kundron në largësi, të duket se një dallgë e gjelbër është ngjitur deri lart në mal, aty ku mbaron bimësia dhe fillon faqja e veshur me gurë të bardhë. Kur lundron më afër, fillon të lexosh, dallon punën e njeriut, brezaret, rrështat e pemëve, kanalet ujitime pingul e tërthor dhe përkul trupin të shohësh më thellë, sepse aty është jeta, një gjallërim i pashembullt i tokës, diçka që ndërgjegjja jote e ka kërkuar, por që nuk ke arritur ta shohësh më parë as me lirinë e përfytyrimit. Do të doja të ishte këtu në anijen e vogël ai burri nga Lushnja.

Kurse masivin nr. 2, ku është përqendruar tanë forca kryesore e ndërmarrjes, mund ta shohësh të gjithin nga rrapi i fshatit Nivicë. Prej Qafës së Gjashtës, nën rrugën e asfal-

tit, që ndrit në diell si një vijë metalike, deri poshtë në pellgun e kodrave, po krijohet gjelbërimi i ri. Këta janë 900 hektarë të vënë nën ujë dhe të duket sikur aty po rritet bimësia nën sytë e tu, duke shlyer përjetë pamjen e tokës së thatë shterpë. Pas tre vjetësh gjelbërimi do të jetë këtu po aq i fortë, sa edhe në mësivin nr.1, me këtë ndryshim: nuk do të ketë pjerrësinë e thepisur të Lukovës dhe, në vend të detit, përpara janë fusha e butë e Vurgut dhe malet e larta.

Pra, ka një «vështirësi» në këtë ndërmarrje bujqësore, nuk arrin ta shohësh të gjithën. Atëherë lind dëshira të hysh edhe një herë nga brenda, me mendimin se duhet të zbulosh patjetër ligjet që rregullojnë jetën e bimësise së madhe, e cila sikur mbahej ndrydhur në thellësitë e një toke tepër kryenece dhe doli prej andej ngadhnjyese, me lirimë dhe vullnetin e njeriut.

2

Drejtori i ndërmarrjes është 46 vjeç, me trup të imët, me pamjen të qetë, gati të përgjumur. Kjo përshtypje bëhet edhe më e fortë kur i dëgjon zërin e ulët. Por duhet të shohësh në sytë e tij ngjyrëkafe dhe të ndjekësh më tej bisëdën për të parë se kjo pamje e qetë, e lëmuar, mbulon një intensitet të brendshëm të shkallës së lartë. Këtë mund ta vëresh shpesh te njerëzit e vërtetë të punës.

Kurse sekretari i byrosë së Partisë në ndërmarrje është me trup të bëshëm, flokëverdhë e sykaltër, me zërin e thellë. Ndryshimi në fizionomi e në sjellje nuk i pengon drejtorin dhe

sekretarin të ecin bashkë, të kenë dëshirën për të qenë sa më tepër bashkë.

— Ngado të shkosh, tek unë do të vish, — i thotë sekretari.

— Sigurisht. Po nuk do lejojmë të abuzosh në autoritetin që të jep detyra, — përgjigjet drejtori.

Kjo frysme e dashurisë, kujdesit e humorit, përhapet në korridorin e gjatë, në zyrat ku hyjnë e dalin njerëz, duke ndjellë gëzim, se punët ecin mirë. Po sikur të ndalesh më gjatë me njerrëzit, ke pér të parë se shqetësimi tek ata është shtresa e dytë më e thellë. Pa janë edhe çështjet e praktikës së përditshme, të prodhimit e të shkencës. Mund të bjerë zjarr në ndonjë anë, mund të shfaqet diku sëmundja e ullirit. Janë mbledhjet e brigadave, të organizatave-bazë të partisë, të këshillit teknik. Këtu fillojnë e dalin një varg me gjëra që s'janë bërë si duhet, diku është ulur vigjilanca, ritmi i punës, diku është dëmtuar diçka. Atëherë nis diskutimi. Drejtori flet i menduar, nën zë: «Edhe eshtërat në varr do të na tunden, pér një rrënje ulliri, pér një brezare që s'qëndron mirë.»

Këtu bëhet luftë pér të mirën, pér të arritur përsosmérinë. Por a mund të arrijë njeriu një pikë të tillë? Ditën që do të besojë se e ka arri-
tur, atë ditë ka filluar rënia e tij.

* * *

Në lagjen e re të Lukovës, me apartamentet ngjyrë trëndafili, po bie mbrëmja. Në fushën sportive që po hapet në mes të lagjes ende lozin disa fëmijë. Vullnetarët po shkojnë në men-

së. Edhe pak dhe lagjja do të tërhiqet në qetësinë e natës.

Po bisedoj me drejtorin në dhomë. Poshtë, në zyrën e Partisë, ndizet drita. Isufi ka thirrur sekretarët e organizatave-bazë, për format arsimore. Më duket sikur e shoh tek ngre sytë e kaltër, me atë pyetjen e përhershme se deri ku e ka kuptuar bashkëfolësi atë që kërkon Partia. Ne me drejtorin po i sillemi me fjalë njëri-tjetrit. Drejtori bën rojë nga çdo anë, që të mos thotë asgjë për veten, i ruhet kësaj si delja gërvshëres. Po s'është e mundur të tregosh tërë kohën në vetë të tretë, kur ke qenë një pjesëmarrës tepër aktiv në ngjarjen.

Ai erdhi këtu në majin e vitit 1969. Mbledhja u bë nën bajamet. Zunë dy dhoma në fshat dhe kështu u krijua ndërmarrja. Pesëmbëdhjetë ditë më pas, më 1 qershor, u shtjellua në gjëreshi fuqia e shoqërisë dhe shtetit socialist. Erdhën të rinxjtë, një mijë vullnetarët e parë, që do të ndërrroheshin çdo muaj. Për katër vjet kjo forcë vërshoi e pandryshuar. Njëherësh me të pati ardhur teknika. Në brigjet e thepisura, të veshura me një lëkurë të ashpër prrallesh e shkurresh, ku nuk depërtonte as egërsira, u hapën 100 hektarët e parë, u bënë prezaret.

Këtu fillon për drejtorin njëfarë drame që e jetoi muaj e vite. Se ishte përpunuar teoria e masivit, po praktika mungonte. Do të qëndronin prezaret, apo shirat do t'i çonin në det, duke larë faqet e hapura të malit, duke fshirë mundin e mijëra të rinjve të ardhur nga çdo rrëth i Shqipërisë?

Pesëdhjetë milimetra shi, pastaj shtatëdhjetë. Drejtori çohej natën me shokët, shkonte te prezaret, duke kthyer fenerët nga të gjitha anët, ndërsa mbi kurrizim mbuluar me mushama ndi-

ente kërcitjen e shiut të rrëmbyer. Njëqind e njëzet milimetra shi brenda një nate. Ujërat zënë e rrjedhin nga anë të papritura, me atë gurgullimën e butë të fshehtë. Blokohen kanalet. Ndonjë brezare shtrembërohet, diku ikën toka, duke hapur plagë të zeza, dhe nga kjo pamje të thernin kockat. Ata që kishin thënë se brezaret me pjerrësi 40 gradë do të shkonin në det, tundnin kokat me hidhërim. Po Partia, vullneti që vërshon prej saj, kërkon të ecet përpara. Atëherë bëhen prova të tjera në tri variante, me brezare si tryesa tre metra gjatësi, pesë metra, dhe gjatë dy dimrave do të shihej si qëndronte skarpati, nga shkonte uji, a kishte çarje të sheshit, prishje të tokës rrënjës, gjithnjë duke ruajtur parimin e brezares, mbush sa gërmont.

Ndërkohë hapen më tej faqet e maleve. Por nga do të kalojnë rrugët? Si do të bëhet ujitja? Spërkatja? Se pa rrugë të brendshme, pa mekanizim të spërkatjes, pa një regjim të hekurt ujites, ky masiv me një milion rrënjë pemë do të kthehej në një përbindësh që nuk i shtrohet njeriut.

•Një ditë Vasili e kishte shpirtin plot dhe mendjen të turbullt. I tha një funksionari të ardhur nga Tirana:

— S'jam akademik, Literaturë nuk gjendet. Në detin Mesdhe, në asnjë vend s'janë provuar brezare të tillë. — Në zërin e tij ndihej ankthi.

— Akademik edhe mund të bëhesh. Tani nuk do të merremi me këtë. Tani do të shohim si bëhet më mirë ajo që ka vendosur Partia,

— tha tjetri.

Vjen një kohë kur njeriut i jepet mundësia ta ndryshojë nga themeli jetën e tij. Atëherë ai i përvishet punës, sheh fryshtet e saj dhe nxitet të punojë më tepër. Fillon procesi i ndryshimit të natyrës dhe vetë njeriut, që s'ka të ndërprerë.

Ndërsa rritheshin brezaret nga buza e detit në lartësinë 400 metra, duke kaluar vitet, kthehej në një bindje të patundur mendimi i mijëra njerëzve se brezaret do të qëndronin përgjegjës.

Vasili mund ta mbante i qetë pjesën e tij, atë që i takonte si drejtor, nga pesha e masivit të madh që vërvitej lart në mesin e malit. Ai nuk çohej më natën e të rrinte këmbëkryq në shtrat për orë me radhë. Ky lehtësim erdhë pas tre vjetve.

Ai ishte një djali i imët nga Vurgu i Delvinës kur hyri në shkollën e mesme me bursë shteti. Ishte i lumtur kur merrte një tresh në vitin e parë, se e pengonte gjuha, filloren e kishte bërë greqisht. Pastaj eci përpara.

Tani, në burreri, i takoi prova e dytë dhe më e rëndë. Po kësaj here nuk ishte vetëm. Kolektivi i madh i ndërmarrjes, mijëra aksioniste, ua morën dorën brezareve. Atëherë hyjnë me guxim në pjerrësi të mëdha, duke nxjerrë nga kjo përfitime, duke arritur rekorde. Në pjerrësinë 20 gradë 200 rrënje për ha, në pjerrësinë 60 gradë 480 rrënje për ha. Si shtëpitë e Gjirokastrës. Pastaj në 70 gradë 550 rrënje për ha, 150 rrënje më tepër se në tokë të rrafshët. Dhe për rrugët, ujiten, spërkatjen, zgjidhjet erdhën njëra pas tjetrës, sipas «originalit» të Lukovës. «Problemin e keni zgjigj-

dhur për 25 vjet», tha një specialist i huaj. «Pse për 25 vjet», pyeti i zemëruar drejtori. «Se nuk dihet ç'do të bëjë shkenca më tej», tha i huaji. Drejtori buzëqeshi.

3

Në fillim të Grykës Gjashnjár është një kodër e vogël e lëmuar, e mbjellë me ullinj 13 vjeçarë. Në njérën anë të kodrës këta ullinj, që shndritin në diell si argjend, formojnë fjalën «Parti», në faqen e tjetër formojnë fjalën «Enver» dhe janë të mbushur me kokrra. Këto fjalë të shkruara me drurët e ullirit do të qëndrojnë të paktën pësqind vjet. Pastaj do të përtërihen, sepse këto dy fjalë qëndrojnë në ndërmarrjen bujqësore në Lukovë si firma në tablonë e një piktori të madh.

Gryka Gjashnjar është një çarje e madhe e tokës, e thellë, me faqet e gjera hapur në diell. Në faqen nga e majta, lart në mal, duken rrënojat e fshatit Hundécovë. Poshtë, pranë detit, në kodrën e sheshtë, janë rrënojat e një kalaje të Ali Pashës, që të befason.

Kryeagronomi thotë se Gryka Gjashnjar ka qenë një vend i egër, i padepertueshmë. Këtë ai e di mirë, se është prej Hundécovës, të braktisur që në kohën e luftës. Fshati i vogël shkonte tri orë larg përfshirë punuar si argat dhe linte «rehen» (peng) ullintë e paktë buzë grykës.

Ashtu ka qenë vërtet kjo grykë, po tani është veshur në agrume e ullinj si peshku në pare. Sa më poshtë të ecësh, aq më tepër kridhesh në to. Kur arrin në fund dhe kthen kokën të shohësh rrugën që ke bërë, ke mbi vëte

një mal me gjelbërimin rrathë-rrathë dhe kjo punë e njeriut për disa çaste sikur të merr frymën.

* * *

Portokallet e reja kanë lëshuar rreth majës lastarët si lule me ngjyrë të verdhë të çelët. Ky është vegjetacioni i tretë që përkundet prej flladir. Portokallet janë katërvjeçare dhe do të japid 5 kg për rrënje. Një prodhim të tillë duhej ta jepnin në vitin e shtafë, po janë nxitur nga të gjitha anët, me punime rreth rrënjeve, me krasitje, plehërim, ujitje, spërkatje dhe prandaj harlisen e tunden lastarët, duke zbuluar kokrrat.

Këtu mund të mbash vesh zhurmën që prodhon qetësi, domethënë kalimin e flladir në pemët dhe asgjë tjetër. Një njeriu të pamësuar kjo i sjell një si buçitje të lehtë në veshë, dhe e pushton ndjenja e prehjes. Aty poshtë, te limonat, po pushon Donika, fshin dersën dhe bën me mendje disa llogari, duke shikuar rrrotull. Është e vëmte dhe hapat tanë e gjejnë në befasi. Kur çohet në këmbë, sheh se ajo është një grua me frup të gjatë, tridhjetë vjeçe, me sytë e zinj të qeshur.

Sot ajo ka punë në këtë ngastër të freskët të limonave, që ndriçohet si nga brenda prej dritës së kaltër të detit të afërt, ndërsa lart shkëlqen dielli. Ku gjetkë mund të gjendet më mirë njeriu?

Rreth ngastrës po grumbullohet plehu. Në familjen e agrumeve limoni është më i ndjeshmi. Edhe dy muaj, në tetor, limoni fillon të përgatitet për dimër, bie në qetësi, limfa lë-

viz më pak, gjethja rri e fjetur. Atëherë është çasti të ndihmohet me pleh organik, t'i krijohet ngrohtësi dhe limoni do të dalë nga përgjumja dimërore në mars e në prill.

Këtë jetë të brendshme të limonit të brishtë, që ngjet me natyrën e disa kafshëve të pyllit, Donika e njeh, e nderon dhe sillet ndaj saj me kujdes, siç bëhet me fëmijën që e zë rrufa e lehtë. Ajo është punëtore me kategorinë e mesme dhe nënë e tre fëmijëve.

— A sëmuren fëmijët, Donikë?

Vetullat e saj ngrihen hark, sikur aty afër të kishte vërvhellyer një gjarpër. Vetëm për një çast, pastaj fytyra e saj e mirëndrit prej gëzimit.

— E pse të sëmuren! Kanotiera, diell dhe ushqim.

Këtu në brigadën e gjashtë plani i frutave plotësohet. Disa thoshin se frutat e shpérndara s'mund të plotësonin plan. Donika qesh, ngul gishtin në tokë, si për të fiksuar fjalët, me një lëvizje plot hijeshi të krahut. Thotë se gratë punojnë më mirë, por edhe burrat punojnë.

Suksesi i brigadës i jep krenari Donikës, si për një sukses personal. Po brigada ka tanë një problem tjeter, që del prej kufirit të saj, duke përfshirë tërë ndërmarrjen. Shoku Enver Hoxha ka porositur të zgjatet stina e agrumeve rrëth vitit. Ferma punon me ngulm për këtë porosi. Janë mbjellë 21 lloje agrumesh. Së shpejti do të hyjnë në prodhim agrumet e vona. Do të kemi portokalle edhe në maj. Po çfarë duhet bërë më tej me limonin dhe portokallin? Si duhet të ndihmohen specialistët?

Mendja e Donikës është e zënë me këtë punë, si diçka që i përket drejtpërsëdrejt asaj dhe kjo gjë të lë të habitur. Sepse, më në fund,

një punëtore e thjeshtë dhe e ndërgjegjshme mund të mendojë për normën e saj ditore, si edhe për skuadrën. Por që të impenjohet kaq fort kjo punëtore për një problem që i përket ligjithë ndërmarrjes duket dikça e pazakontë.

E qmiegjithatë është pikërisht kështu.

Më poshtë, në breg të detit, ku shkëlqen një plazhi vogël, hapen mbi agrumet disa pemë me gjethë të mëdha, ndofta banane, duke e bërë më të ngjeshur bimësinë. Dielli i fundit të gushtit ia ka ndryshuar pamjen vendit, duke i dhënë një bukuritë nxeh të sipër së cilës lëkundët qetësia, një mpiksje e aromës së portokalleve me vapën, me erën e detit. Puna krijoj këtë vend që i bën lojëra syrit dhe preh shpirtin. Puna u rrit Donikën komunisten që jeton me tërë qenien e saj të tashmen dhe të ardhmen.

• Duke u sjellë disa ditë në rrugët e brendshme të ndërmarrjes që vërtiten rrëth brigjeve në një gjatësi prej 55 km, të duket sikur gjelbërimi të hyn në trup, të duket sikur janë ngjyer në të gjelbër edhe sytë e njérëzve që ndesh në rrugë.

Poshtë, afër plazhit të bukurit të Bunecit, zbardh në mes të pemëve stalla e lopëve. Janë ngritur pesë stalla në pesë brigada. Brenda vitit 1984 do të ngrihen 35 stalla të tillë, për të siguruar krejt plehun organik që i duhet ndërmarrjes. Prapë luftë kundër mendimit konservervator se nuk mbahen lopët në plantacionet e agrumeve, se kostojat qumështit do të vejë në qiel. Prej një viti është provuar së mbahen mirë, me barin e brezareve dhe duke mbjellë

ndonjë rrip tokë me lakër. Dhe plani i qumështit plotësohet, lopa del me fitim. Ashtu si edhe bagëtia e imët që verojnë në male. Një e treta e të ardhurave të ndërmarrjes vjen tani nga blegtoria...

Në mbrëmje, duke u ngjitur në fshat, ndërsa mbi det kishte rënë një fashë e madhe drite, provoja një ndjenjë mirëqenieje e kënaqësie, sikur të kisha qenë për vizitë në një shtëpi që mbahet me nikoqirillëk dhe ndrit prej pastërtisë.

4

Familjarë e grupe vullnetarësh të rinj zbresin ngadalë në mbrëmje poshtë rrugës së asfaltuar. Venë në lapidar. Kjo shëtitje po bëhet zakon i një pjese të banorëve të Lukovës. Sa më tepër të kalojët koha, aq më shumë do të përhapet zakoni.

Ka çaste që imbrëmjet në Lukovë të habitin vërtet. Kjo ngjan kur mbi hapësirën e kodrave e mbi detin zënë ndërrohen ngjyrat. Po s'ka rënë shi prej kohe që të lajë qiellin, mbi det enden ca avuj të lehtë dhe drita e diellit merr këto ditë ngjyrë të verdhë. Pastaj bie muzgu dhe ndihet frymëmarrja e detit, si e një krijese të gjallë, si një dëshmitar i gjithësisë i ndalur te bregu. Edhe pak dhe nga i njëjti horizont ngrihet hëna me dritën e bardhë, nën të cilën të duket se sheh gjithçka e s'sheh asgjë. Te lapidari këndojnë ose rrinë heshtur.

Aty erdhi e qëndroi shoku Enver në vizitën e tij të dytë, më 28 mars 1978. U kënaq e u preh, deshi të rrinte sa më gjatë; u kthyte dhe

pa tunelin e ujit lart në malin Lovan dhe tha se ngjante si një shqiponjë në ngritje krahëha-pët.

Tani këto fjalë janë në gojën e gjithkujt, se dalja e betonuar e tunelit, me të dy kanalet anash, i ngjan një shqiponje të bardhë gati në fluturim.

* * *

Kjo është vapa e shëndetshme e bregdetit, po prapë vapë. Askush nga pleqtë s'mban mend një thatësirë kaq të zgjatur dhe as ka dëgjuar nga babai e gjyshi të ketë ndodhur ndonjëherë.

Në orën tetë të mëngjesit dielli të djeg zverkun dhe gjinkallat këndoijnë edhe lart në mal. Po te gryka e tunelit një rrymë ajri e ftohtë, që vjen me ujin nga thellësitë e malit, përhap freskinë rrreth e qark.

Ky tunel ecën brenda malit Lovan, për 2300 metra, duke e sjellë ujin e ftohtë akull nga Tatzati. Tre metra kub ujë në sekondë, sido që të bëjë moti. Pastaj uji ecën në kanalin nga e majta deri mbi Sarandë, si të ketë kaluar në tunelin e fshatit Përparim, 700 metra të gjatë, kurse në të djathtë do të arrijë brenda nëntorit fshatin Piqeras. Shqiponja ka hapur krahët e saj mbi 3000 hektarë tokë të bregut, që pak vjet më parë digjej prej thatësirës.

Uji është jetë. Uji ecën në kanalin kryesor për 45 km dhe zbret në kanalet e dyta e të treta, duke u hapur në brigjet, duke lëvizur në të gjitha nivelet. Ky është problemi i vësh-tirë i ujit, që u zgjidh sipas «modelit të Lukovës», sepse është një punë tepër e ngatërruar ta ndalosh vrullin e ujit në një pjerrësi që arrin 75 gradë, ta bësh të vejë në rrënjen e çdo

peme, në një milion rrënë pemë të gjitha në skarpat, të ecë sipas dëshirës sate, të ujitet aq sa duhet e të mos dëmtojë asgjë. Kjo ia ngatërroi mendjen edhe atij profesorit të dëgjuar frëng që erdhi këtu vitin e shkuar. «S'ka mundësi të ujitet ajo kodër», tha profesori. «Vemi në vend», tha drejtori. Profesori, autoritet në lëmin e bujqësisë, zbriti gjatë kodrës, me bindjen se e gjitha kjo ishte një inskenim, ndofta një marrëzi. Aty pa si qëndronte puna. Ai hoqi kapelën, me nderim, si një kalorës frëng. Kjo nuk e pengoi të shrembëronte të vërtetën në shkrimet e tij, kur u kthyte në Paris. Po të dojë, njeriu mund edhe të ndjekë shembullin e bufit, që mbylli sytë dhe tha «dielli nuk ekziston, me që nuk e shoh unë». Më pas erdhën këtu pesë funksionarë e specialistë të FAO-s, treguan habi, shfaqën admirim, kërkuan literaturë, që përvoja e Lukovës të njihet në vendet rreth mesdheut e gjetkë. Cilido komb ka të drejtë të japoë ndihmesën e vet, sado modeste qoftë, në shkencën që i duhet njerëzimit. Më pas erdhi një personalitet, u ul te lapidari dhe ndenji heshtur, me mjekrën në gjoks, duke shikuar ngadalë nga njëri breg te tjetri. Ishte trupmadh dhe fliste pak. Aq gjatë ndenji heshtur, sa ata që e shoqëronin besuan se po vuante nga ndonjë dhembje e fortë e kokës. Ai u çua dhe tha: «Jeni njérëzit më të lumtur të botës dhe që jetoni në vendin më të bëkur.» «E kemi bërë me duart tonë», iu përgjigj Vasili.

Që këtej, nga lartësia e tunelit, ndien zbrjen e ujit të ftohtë që kërkon rrënjet e pemëve të masivit me gjelbërim të fortë, të errët. Gjethet shkëlqejnë në diell me një ndriçim që të merr sytë, në krejt hapësirën. Sasia e ujit të këtij tuneli nuk ndryshonasnijëherë,

ashtu si nuk ndryshon gjelbërimi i masivit rrëth motit. E megjithatë, në Lukovë prapë mendjen e kanë tek uji. Kursejnë 700 m³ ujë për ha. Përse të lëshojnë ujë më tepër nga sa duhet? Veç kësaj, aty do të ndërtohet edhe hidrocentrali.

5

Në fund të fshatit Piqeras gjendet «ulliri i lotëve». Nja dyqind metra poshtë bregut, nën shpatin e pjerrët, është deti blu i thellë dhe plazhi i vogël e i qeshur prej nga niseshin barbat. Gratë dhe fëmijët i përcillnin deri tek ulliri burrat për udhëtimin e dyshimtë.

S'kam parë kurrë një trung ulliri të tillë, që të mbështillet rrëth vetes. Erërat e kanë sje llë ullirin e vjetër nga e djathta në të majtë dhe ai u ka bërë ballë, duke përdredhur trungan ngadalë, duke u lidhur fort. Në rrathët e sajuar prej këtij shtrëngimi të duket sikur ende vërvshëllejnë erërat e lashta gjuhëprera.

C'tregon ky defter i shkretë,/ shkruar me kalem tē zi,/ gjithë hallet e fukarasë/ mbledhurë në luturvi.

Fshati Piqeras, me dyqind shtëpi, ka pasur nëntëdhjetë barka. Shkonin në grykat e Vjosës, Shkumbinit e Bunës. Çonin vaj, lesh e bulmet dhe merrnin misër. Shkonin deri në Spanjë, kanë vajtur edhe në Indi. Nuk i ushqente toka e thatë. Nganjëherë barkat e lehta i tërhiqte deti në thellësi dhe gratë e reja lagrin me lot truallin e ullirit, prej gjetheve të të cilit pikonte hidhërimi. Tani këtu kalon kënnali ujitës dhe mund të bëhet një tietër «ballkon» për të soditur bregun, detin blu, si edhe

lëvizjet në portin e vogël të ardhshëm që po piketohet aty poshtë, në plazhin e bardhë të Bunecit.

* * *

Aristoteli dhe Straboni, për të cituar vetëm këto personalitete të lashtësisë, e kanë quajtur Ilirinë një vend të madh frytdhënës plot me ullishta e vreshta. Në varret tremijëvjeçare, në Konispol e gjetkë, janë gjetur kandila me vaj ulliri. Por ulliri në Shqipëri është edhe më i vjetër. «Ulli». Fjalë autoktone e familjes indoeuropiane, e përdorur edhe nga fqinjët e Ilirisë. Po një varg fjalësh, që kanë të bëjnë me punët e ullirit e të vajit, janë thjesht të shqipes. Këto i ka mbledhur me durim e kujdes edhe një mësues nga Lukova.

Këtu ka qenë zakon që të shkohej për Vit të Ri te miku duke mbajtur në dorë një degë ulliri, për t'i uruar prodhim të mbarë. Pastaj të rintjtë loznin rreth zjarrit duke djegur gjethë ulliri. Druri i ullirit, në bregdet dhe në vise të tjera të Shqipërisë e deri në Kosovë, i ka rrënjet në jetën e popullit prej mijëra vjetësh. Se ulliri është «bulkë», «gjellë» e «ilaç». Këto i tregon specialisti i vjetër i krasitjes, Areteoja. Thotë prapë: «E kemi provuar në kohën e lutfës.»

Ai është një burrë i thinjur e sykaltër, me ftyrë të kuqe. Është nga ata njerëz që të duket se i ke njojur edhe më parë, në kohë të pacaktuar, po sidoqoftë, i ke njojur herët dhe prej një kohe të gjatë. Kjo ndjesi të bën të afrohesh edhe më tepër, ta shohësh e dëgjosh me vëmendje. Ai paskësh qenë nga ata që mendonin se, po ta kra-

sitësh rëndë ullirin, humbet prodhimi i disa vitezave. Prandaj ulliri duhej lënë në punën e vet, një dru shekullor me tekat e një plaku kryeneç. Një vit jep, pastaj i mbyll dëgët për dy vjet. Dhe jep atë që do.

Areteoja e ka bërë autokritikën prej kohe. Ulli ri jep çdo vit, sikur t'i flasësh me gjuhën e vet. Një provë që po zgjatet prej nëntë vjetësh bindi këdo se ndryshimi ndërmjet viteve prodhimitare e joprodhimitare nuk është 1:20, po 1:1,5, me kusht që të ndërhyjë njeriu.

Frym fillad detar në luginën e ullinjve sheku llorë. Më duket po dëgjoj murmuritje, fjalë të vjetra të urta, që trazohen me gjuhën e re. Një ulli treqindvjeçar kthehet me anë të gérshërés, sharrës e thikës, në moshën njëzetvjeçare. Por ai që hyn brenda ullirit me këto mjete në duar duhet ta njohë anatominë e këtij druri. Duhet të krijojë një raport të drejtë rrënje-dru-kurorë, të ndriçojë ullirin nga brenda, t'i kthejë gjethet diellit, që të bëhet e plotë fotosinteza. Duhet ta ulë kurorën e këtij ulliri të vjetër që ka shkuar 15 metra lart dhe të krijojë nën të kurorën e re, të ulët, të fuqishme, prodhimitare. Kjo mund të kërkojë punën e tre vjetve radhë.

Në prill-maj ulliri shekullor zë e rrit sythat që nuk shihen. Atëherë i hidhet dora e dytë e plehut azotik dhe ai harlis më tepër, me një dashuri të re për jetën, si një djalosh njëzetvjeçar, duke ruajtur me kujdes ekuilibrin e vet ndërmjet drurit dhe gjethes. Këtë fuqi çudibërëse të ripërtëritjes ulliri fisnik e mori në dhjetë vjetët e fundit. Këtë veti ndofta e ka vetëm ai, nga gjithë drurët në faqe të dheut. Vetëm ai mund të komunikojë te njeriu një optimizëm kaq të gjallë e në të njëjtën kohë të jetë aq i dobishëm. Por, që ta ndiesh këtë, duhet ta njohësh ullirin.

* * * * *

Shoku Enver ka thënë se duhet ta bëjmë vajin në vend. Fjalët e tij këtu sikuri vibrojnë në ajër, sepse mund t'i dëgjosh nga goja e qdo punëtori. Është si në një marrëveshje në përmasa të mëdha për një gjë të përbashkët, ndërtimjet udhëheqësit dhe popullit të zonës. Ai tregoi në emër të Partisë se c'duhej bërë, e dhjetëra mijëra vullnetarë, të rinj e punëtorë bënë. Këtë gjë ata e ruajnë në zemër, dhe thonë se s'ka tjetër vepër në Shqipëri që të jetë kaq e lidhur me porositë e tij të drejtëpërdrejtë, si ndërmarrja e tyre në Lukovë, dhe Ksamil, skopshtë, në lulëzim të plotë.

Por vaji, për aq sa i takon ullirit, nuk do të bëhet duke përtëritë ullinjtë shekullorë. Drurët e vjetër zënë e humbasin peshë, në blloqet e ullinjve të rinj. Vetëm në masivin nr. 2 janë mbjellë e po mbillen 240 mijë rrënje.

Ulliri i ri, më ngjyrën e çelët të ngjethes, me drurin e njomë, sikur nën lëkurën e tij të qarkullonte qumësh, ka trajtë të rrumbullakët, si ca drurë të parqeve që rriten nëndorën e kopshtarit. Dhe masën e ka të paktuar, nuk do të shkojë më larg se tre metra e gjysmë. Por do ta shtojë prodhimin nga viti i në vit. Tani ullinjtë 8-10-vjeçarë janë plot koktrat, japid atë prodhim që do ta jepnin më vitin e pesëmbëdhjetë. Kjo pamje e ullirit të rrjedh të sjell harenë. Është diçka si qengji i njomë kundrejt dashit të vjetër. Është edhe më shumë. Që nga koha e Aristotelit e më parë, ulliri qëndroi i pandryshuar. Tani ndryshoi njëherësh, duke fituar një rini të gjatë. Por as kjo nuk është fjalë e fundit. Në ngastrën eksperimentale të fidanëve mbjellin njëherësh 50 lloje ullinj, me shembim

e klimë të njëllojtë. Njëri jep kokrra, tjetri ca më shumë, tjetri nuk jep asgjë dhe skartohet. Vepron vetë ligji i seleksionimit. Veç kësaj, kam përshtypjen se diçka e veçantë po zien fshehur. Mund të jetë puna për një ulli që jep kokrra në vitin e dytë dhe që po eksperimentohet diku. Drejtori s'do të flasë për këtë, këmben bisedë me mirësjellje. Në daltë vërtet ulliri dyvjeçar, atëherë kemi të bëjmë me një ulli krejt të ri, nxjerrë nga lëkura e ullirit të vjetër, që jepte kokrrat e para pas 15-20 vjetësh. Nuk ishte çudi që në kohët e lashta e vinin si detyrim mbjelljen e ullirit, e nganjëherë edhe duke e shpërblyer atë që e mbillte.

Lart në stanet verore merren me përmirësimin e vazduhar të deles. Në sektorin «Qazim Pali» në Borsh ndjekin në fidanishtë ecjen e agrumes. Këtu në kodrat e Vanës, të masivit nr. 2, në shtatë hektarë tokë, punohet për ndryshimin e mëtejshëm të ullirit, duke zgjedhur rasatin më prodhimtar për vaj e kripose.

Diku i kemi lexuar këto fjalë: Njerëzimi, si një armatë kalorësie, shkon përpara duke push-tuar përherë majë, më të larta dhe ka për të ardhur dita që të sulmojë edhe vetë vdekjen.

Në Lukovë kanë mposhtur thatësirën dhe shirat. Dhe bëjnë shkencë, me metodë e pa bujë, në përputhje me direktivat e Kongresit të 8 të Partisë. Kur sheh atë që bëhet këtu për zgjedhjen e përtëritjen, fillon të mendosh për jetën që s'ka të sosur.

7

Pak më poshtë lapidarit po ndërtohet një plattformë betoni. Këtu do të ngjitet teleferiku, që do të lëvizë 450 metra në pjerrësi, deri buzë detit. Kjo ka për të qenë prova e parë dhe

do të bëhet në nëntor. Po që se do të ecë mirë, teleferiku me vagonët me kapacitet njëtonësh do të përhapet në vitet e ardhme, do të këndoje kodër më kodër e do të përfshijë krejt masivin nr. 1, duke i çuar prodhimet në portin e vogël të Bunecit.

Në oficinë po saldohen shtyllat metalike të teleferikut. Kjo punë rëndon mbi supet e inxhinierit të ri mekanik, me stazh trevjeçar. Është e para herë që merret me një teleferik. Në fillim të krijohet përshtypja se ky djalosh i urtë e i sjellshëm nuk kuption dhe aq mirë përgjegjësinë e vet. Ç'do të ndodhë ditën e provës, kur vagoni me peshë të përgjithshme dytonësh do të ngjitet lart e do të lëshohet poshtë?

Inxhinieri ka qenë në Pukë për të parë teleferikun e atjeshmë. Por në Lukovë duhet ndryshe, me largësi të vogël, me stacione në kodrat. Këto ai përpinqet që t'i zgjidhë me punë ditën dhe me një libër të huaj mbi teleferikët që studion natën.

Ky teleferik ka për të ecur mirë që në provën e parë, duke çliruar ndërmarrjen nga transporti me krahë e automjete. Ndonjë nepromës në ministri mund të ketë ende dyshimet e veta, që nuk i thottë, po sikur ta shikosh disa ditë nga afër inxhinierin, bindja në suksesin kalon edhe te ti. Ky është nga ai brez djemsh të mençur e të zjarrtë që po rriten në ditët tona e nuk dinë të prapsen kurrë.

Ka edhe diçka tjeter. Në oficinë e vogël të ndërmarrjes, inxhinieri me teknikun dhe tornitorin e vjetër prodhuan në fillim pjesët e ndërrimit për qindra pompa të spërkatjes, pastaj pompën të tërë, tri lloje pompash njëren pas tjetrës dhe së fundi pompën «35-vjetori». Këto i bënë nga «halli i terrenit», që të punojnë me

motokultivatorë, të hyjnë kudo. U provua gjatë një vitin se kjo poimpë është më e mirë nga ato të importit, me rreze e parametra më të lartë. Pastaj prodhuar mekanizmat për ujitjen në formë shiu, pa energji, duke shfrytëzuar pjerrësinë, që u vu në provë në kodrën sipër oficinës. Kjo mund ta ndryshojë një pjesë të sistemin të ujitjes që tanë. Ja, prandaj kanë besimt se çdo punë oficina e ka nxjerrë në krye. Inxhinier, a nuk të duket se po merrni përsipër ca punë të mëdha për oficinën tuaj të vogël?

Për një qast ai të shikoh me sytë seriozë tē menduar, zë e fërkon grushtet dhe thotë më tē qetë...

Kerkohet edhe më tepër...

8

Gryka e Kakomesë gjendet ndërmjet masivit nr.1 dhe masivit nr.2. Nga ana e majtë e grykës ngrihet një mal me bimësi të dendur, si në trópik. Në të djathtë është mali i zhveshur i hirtë, si i djeguri. Rrezë këtij mali gjendet manastiri. Përparrë është gjiri i detit me plazhin e gjirë, me gurë rrumbullakë të një bardhësie që të merr sytë, me rërën e trashë, të pastër, të nxehjtë. Në tërë bregun e Jonit blu, të kthjellët, mund të gjenden vëtëm një dy pika të tjera ku uji të jetë aq i tejpashëm.

Manastiri është i vitiit 1670. Kisha e vogël, e rëndë, e stilit «kryqi më kúpolë», është mbuluar në murët e bréndshme me afresket e «Mihalit nga Zerrma» (ndofta Jermi). Afresket janë dëmtuar, po si pjesët e páprekura dalmi të gjalla ftyrat e shénjtoreve, sikur Mihali të kishte mbaruar punë me ta aty më parë dhe

të kishët e ikur duke lënë derën hapur dhe ata e presin të kthehet, më shpresë së dō t'u heqë nga sytë atë vuajtjen e përjetshme që i këlliste të ftohtë në trup bësimtarit. Ndërsa kupa e lartë vertikale, që synon qellin, ruan edhe sot fuqinë e saj shtypëse dhe s'do t'i dijë nga koha.

Ky ka qenë dëri në shekullin e kaluar një manastir i fuqishëm, me bibliotekë, më njëte lundrimi e i mbrojtur. E dëshmojnë pjesërisht banesat e murgjve që ngrihen mbi kishën, si edhe kulla me urën ajrore. Ç'bënini murgjit në këtë grykë të fshëhtë të vëtmuat? Mbësë mëreshin edhe me kontrabandë e më intrigë politike. Këtu vinte nganjëherë Ali Pasha, për ato takimet sekrete me të huajt, larg syve të botës. Një monument kulture që duhet mbrojtur më mirë.

Kur e xdhì në Sarandë në marsin e vitit 1978, shoku Enver, pyeti se ç'bëhet më grykën e Kakomesë. Ai tha se aty mund të rriten fitqë mirë.

Janë bërë matjet. Në grykën e ngrohtë, të vecuar, të Kakomesë, mund të vihen nën kulturnë nja 70 hektarë. Janë bërë rilevimet, e planimetritë edhe në grykën e thellë sipër Borshit, deri lart në Fterrë e Corraj, deri në Drasën e Kucit. Këtu janë 1600 hektarë tokë malore e kodrino-re e degraduar, që do të mbillen pemë frutore, e ullinj dhe ky do të jetë masivi, nr.3. Ky është kufiri i ndërmarrjes bujqësore të Lukovës.

Një i huaj pyeti drejtorin se kú i mërrnin paratë për investime të tillë më afat të gjata. — Cfarë?

- Fondet, kapitalet, — shpjegoi i huaji.
- Nga «Kapitali» i Marksit, — tha drejtori.
- Është i vetmi ku merr kredi Shqipëria.
- Marksi të jep kredi bujarisht dhe pa fajde, me kusht që të përdoren për qëllime fisnike e me nikoqirillëk.

Në Lukovë i kanë përdorur mirë investimet shtetërore. Për masivin nr. 1 u kursye 15 për qind e fondit. Do të kursethet edhe më tej me anë të rritjes së prodhimit, me sigurimin e plehut brenda ndërmarrjes, me kursimin e ujit, me heqjen e fidanëve nga importi, me shtimin e rendimentit të punës. Ai që do të kursejë lekun, ka për t'i gjetur edhe rrugët.

9

Më 26 gusht, afér mbrëmjes, dyqind vullnetarët e ndërrsesës u mblohdhën te lapidari. Zuri vend juria dhe nisen konkurrimet e grupeve artistike të brigadave. Disa skuqen sikur do të marrin flakë, detersijnë, murmurisin. Të tierë «artistë» sillen lirshëm, sikur këndoinë në shtëpitë e tyre. Por që të gjithë kanë një dëshirë të vetme, të nxjerrin grupin e rrethit të tyre në ballë.

Të rinxjtë do të nisen pas katër ditëve. Flaminjin e punës në aksion do ta marrë Lindita, komisare e brigadës së Krujës dhe do ta çojë në qytetin e vet. Më 1 shtator kanë për të ardhur dyqind vullnetarë nga rrethe të tjera. Dhe kështu çdo muaj. Me një punë plot ngulm mësojnë këtu teknikën e brezareve, ujiten në malësi dhe u rritet dashuria për pemët.

Prej dhjetë ditësh ndiej praninë e këtyre të rinxve, që banojnë në apartamentet fqinje. Duket sikur nxitojnë gjithandej. Bëhet Kongresi

i 8-të i BRPSH më 4 tetor. Mundohem të kuptoj këtë nxitim, duke folur me ta, por s'është aq e lehtë të bjerë barriera e moshave. Po mund të mësosh disa gjëra duke folur me komandanit e aksionit. Ky këtë punë e bën prej vitesh, komandant aksioni. Flet me një gjallëri e bujari që është krejt e rinisë dhe ka kujtime të shumta.

Kur erdhi Drandja këtu, trembëdhjetë vjet më parë, ishte korrik. Detin e kishte parë vetëm në filma. Kur e pa «të gjallë», iu duk i gjerë sa bota, u praps, iu duk sikur deti po ngjitej lart. Të rintjtë duhej të laheshin pas punës, po Drandja s'kishte rrroba banje. Atëherë komanda e aksionit bleu rrroba banje për ato që s'kishin, gjeti mënyrat t'i shpërndante pa u fyer Drandja dhe shoqet. Drandja pranoi të hynte në det, veç tha të mos e merrnin në fotografi.

Që nga ajo kohë, këtej kanë kaluar shtatëdhjetë mijë të rinj. Çdonjëri prej tyre ka mbjellë disa rrënje ullinj, që do të qëndrojnë pesë shekuj dhe disa rrënje agrume, që do të japid fruta për shtatëdhjetë vjet. Secili prej tyre ndien sipas mënyrës së vet se ka lënë në Lukovë diçka të patundur, që do të gëzojë edhe brezat e ardhshëm; njëlloj si në Ksamil të Sarandës dhe në Jónufér të Vlorës. Prandaj disa kthehen këtu në aksion për të dytën e të tretën herë. Disa mbeten përgjithnjë. Nga familjet e reja të vendosura në Lukovë, 86 janë çifte vullnetarësh.

10

Pas dhjetë ditësh, u ndodhëm pak a shumë në të njëjtën vështirësi të fillimit. Nuk arrij të formoj me këto fletë një pamje të plotë të

yeprës.. Më duket se vazhdimisht diçka me rëndësi mbetet pa thënë.

Kur qëndroi këtu, për të dytën herë, në mars të vitit 1978, shoku Enver Hoxha tha ndër të tjera:

„duhet të kesh kulturë, që të krijosh vepër të tillë të mrekullueshme, siç janë këto plantacione madhështore që shikojmë nga kjo kodër e që zgresin nga malet deri buzë detit. Gjithashtu, për të realizuar një vepër të tillë duhet të kesh shpirt të guximshëm, mendje të zhvilluar, dashuri të madhe për tokën dhe për pemët.“

Mbase duhej të kisha ndenjur më shumë me njerezit dhe më pak në natyrën e me shënimet, për të kapur atë gjënë e vëshitirë, shpirtin dhe mendjen, e atyre që po plotësojnë veprën, gjallërimin e pashembullt të dheut. Po bregu ynë i Jonit sigurisht do të tërheqë më tepër poetë, si edhe muzikantë e piktorë, që zoterojnë tingujt e ngjyrat, duke na e dhënë më të plotë pamjen.

shtator 1982

PROFILI I MALËSISË SË ULËT.

1

Përtëj pyllit më bërdha të Bunovës shtëpi hét një malësi që ngjan e ulët, por që arrin kuotatë lafta. Gërryerjet e bëjnë këtë vënd të duket si i djegur nga një zjarr i lashtë. Po ja tek hapen në brinja arat me grurë. Jëta fiton edhe mbi këto rrëpira, që shkojnë deri në Vjosë nga njëra anë dhë zbfësin në Osum nga ana tjetër. Këtu janë kufijtë e Përmëtit me Skraparin, Körçën e Kolonjën. Kjo gjë u jep njëritëzve këtë një ndjénje të përhershme gëzimi, si të njoburve që fakohen në një krÿqëzim, që janë takuar aty prej kohësh të lashta e që do të rrinë bashkë përjetë.

Makina kërkon rrugën e ngushtë me turirin krejt të ulur dhe në kthesat duket sikur do të fluturojë në hapësirë. Befas, u ndodhëm para një pamjeje, që mund ta shohësh, vetëm në ndonjë tablo dhe që të fut pranverën në zemër: një fshat i mbledhur, me shtëpitë prej guri i mbuluar nga lulet e bardha të pemëve, sikur aty të kishte rënë dëbora. Ishte Kreshova.

* * *

Në këtë fshat lulet e bardha janë kalimtare, kurse dëbora e vërtetë qëndron gjatë, si edhe balta në vjeshtë. Megjithatë jeta këtu ka një ecuri që të habit. Mosha mesatare e banorëve është 67 vjeç, mesatajra tjetër është tetë fëmijë për shtëpi dhe në çdo dy shtëpi një televizor. Prej nga ky shpërthim i jetës në këtë fshat të largët të Dangëllisë?

Sekretar i organizatës së Partisë të kooperativës është një djalë i ri, me pamjen e një mësuesi modest. Nga mënyra si flet, nga rregulli që sundon në dhomën e tij gjysmëzyrë, duket se ky djalosh ka një jetë shpirtërore të pasur. Lëmon bllokun e shënimave. Të ardhurat për ditë pune janë 12 lekë. Në ato rrëpirat deri në 1200 metra lartësi do të marrin sivjet 30 kv grurë për ha. S'kanë gjékundi tokë të sheshitë, mezi hapën një fushë sporti, po toka jep po t'i bëhet puna e të mbrohet. Fshati ka unitet. Një vonesë dhjetë minutëshe në punë përbën një ngjarje. Kur vjen korrja, të gjithë ngrenë shtëpinë lart në pllaja. Tridhjetë komunistë janë që të gjithë në vijën e parë... Rinia ka marrë përsipër të japë në gjysmën e sipërfaqes së grurit 5 kv më tepër për ha. Çdo i ri mbledh $1m^3$ pleh organik. Vetë e bëjnë spërkatjen, kullimin, ruajtjen nga erozioni, me tabela, harta teknologjike. Fshati shtohet, ka kërkesa të shumta për shtëpi të reja. Në këto ndërtime e sipër ndihet një përpjekje për simetrinë, për rrugët. Do të sillet edhe uji në çdo derë, presin vetëm tubat dy poliq.

Më duket në këtë qëndron shpërthimi i jetës në këtë fshat krejt të pjerrët: te rinia, te mosha mesatare, tek uniteti. Si edhe te diçka që ndesha rastësisht më poshtë.

* * *

Jemi mësuar të marrim shpesh si portrete pleqtë e vjetër me fjalë të urta, dhe të përfytyrojmë se po na flet vetë një shkëmb i gdhendur prej diellit e stuhisë. Kjo është mirë, se dituri pa përvojë s'mund të ketë. Po ç'mund të bëjë dituria e përvoja pa shpirtin e zjarrtë të rinisë?

E megjithatë, prapë do të kthehesh te pleqtë, kur do të kuqtoш më mirë një aspekt të së sotmes, një dukuri të pazakontë.

Në çerdhen dhe kopshtin e Kreshovës janë 45 fëmijë, të shëndetshëm e të pastër, mund t'i marrësh në fotografi për çdo ekspozitë. Një plakë rri sipër gardhit, në mes të fëmijëve, duke i parë me sytë si të përlotur, me një dritë në fytyrën e rrudhur. Quhet Ervehe Liço, mendjen e ka të kthjellët, veç është vështirë të kthesh në fjalë atë që ndodh në shpirtin e saj.

Ajo ka parë lakuriqësinë e plotë të jetës. Erdhi nuse me rrobat hua, i hoqi në darkë dhe u mbështoll me një batanije, që e preu të nesërmen për fustan. Kur ia morrën burrin ushtar, ruante arën me misër përtej malit, në Odriçan. Natën u binte teneqeve të përzinte derrat, pór edhe që të mposhtete llahtarit e vet. Kur kthehej në shtëpi, i gjente fëmijët e lidhur në djep duke thithur grushtet, të bù-

havitur prej urisë. Pastaj i vdiq fëmija për dy dollarë. E solli nga Çorovoda në duar, tetë orë rrugë, dhe e varrosi drejt në baltë, pa rroba, pa një copë dérrasë. Natën duhej të mbyste klithmat e veta, se nuk i hiqeshin nga sytë gëjymtyrët e fëmijës në baltë. Po ashtu varrosi të shoqin

Po nëntë fëmijët e tjerë i rriti, duke u pjetur lakra tri herë në ditë me të njëjtën petë. Tani ajo ka aty pranë shtëpitë e mira të bijve e nipaye. Shumë gra e burra të vjetër mund të tregojnë ngjarje të habitshme në këtë fshat. Këta diçka u kanë treguar bijve, dhe kjo nxit edhe më tepër, dëshirën e tyre për t'i kthyer rrëpirat, ngjyrë hiri në një tokë ku të jetohet si në çdo vend tjetër në Shqipëri. Kështu ka ndodhur në Kreshovë, ngritje e plotë e njëriut në të njëjtën tokë prej së cilës është munduar. Kjo është gjëja më e madhe dhe më e parë që duhet arritur me rrugën e të qenit njeri i lirë.

Këtu ka ardhur një vajzë nga Borshi i Sarandës. Iku nga shtëpia me djalin që donte, punëtor në fermën e Lukovës. I ati i vajzës nuk e pranoi këtë martesë.

Rinia e përmetit lufton prishjen e marte-save, zakonin e pajave të mëdha, paragjykimet në lidhjet e martesave. Prandaj rinia e Kreshovës po e ndjek ngjarjen e vajzës nga Borshi me vëmëndje, ashtu si edhe gjithë fshati.

Shkuam për vizitë te babai i djalit. Na gostoni, nusja. Kur ngriti sytë, në dhomë u hap

një valë e kaltër, e ardhur prej detit të Bor-snit.

— Këtu toka është e ashpër, po njerëzit janë të mirë, — i them nuses.

Ajo buzëqesh me falënderim e me druajtje. Sot pritet të vijë i ati, krushku. Nuk dihet se ç do të thotë ai tanë. Për të po gatuhet darka.

I ati i djalit, ndihmësmjek, mbulonte 16 fshatra në vitet e para të Çlirimtë. Tani i ka imbetur vetëm Kreshova. Por edhe këtu nuk është i vetmi autoritet mjekësor. Në krah të të tij rri mjek Ylli, me gjyzlykët e bardhë e fytyrën e mirë. S'ka vdekje të fëmijëve, s'ka aborte. Këta mjekë të malësive gjithandej i gjen të zënë po me këtë ide të fiksuar, të bëjnë në fshat atë që bëhet për nënën e fëmijën në qytete. Mjetet dhe kushtet nuk janë dhe aq në favor të fshatit malor, po janë gratë më të fortta. Dhe, kur duhet quar në Përmjet një grua e sëmurë dhe nuk punon makina për shkak të dëborës, fshati e con barellën në krah deri përt tej qafës, me një lehtësi e shpejtësi që e lë mjekun, të habitur.

Pasdite po vinte krushku nga Borshi. Nga larg dukej i errët e kërcënues. I vikishtë zbritur kamionit të qafa dhe e cte ngadalë, më këmbë. Mbëpara tij vinte një polici dhe tek si shihje, të mbahej ifryma. Po krushku nuk ishte i ngrysur, as i zemëruar. Dhe polici që vinte më të ishte, më duket, vëllai i djalit, me shërbim në Përmjet, dhe e mbante krushkun më muhabet, i ndizte cigare. Krushku paskej kaluar dikur si partizan nga këto amë, dhen prandaj ndalej i hera-herës të shihë rrëpirat, luginat e thella, me tsytë atë mallengjyer.

«Në ka një gjë, për të cilënë shqipëtarëtë duhetë të kujdesenë më tepër, ajo pa ndryshim është DITURIJA», thotë Sami Frashëri në kapitullin «Çdo të bëhetë Shqipëria?».

Përballë muzeut gjendet shkolla e mesme bujqësore që mban emrin e tij. Është pasdite, djemtë lozin futboll me rroba sportive, vajzat mësojnë e hekuosin lart në dhoma.

Kur u ngrit ky muze i Frashërit, njerëzit imblodhën gurët, çdo gur që ishte i shtëpisë. «Me kujdes, o shokë!». Dhe u bë muzeu, me kujdes, sikur do të ktheheshin për të banuar aty tre vëllezërit, njëri më i madh se tjetri, dhe duhej ta gjenin shtëpinë në rregull.

«Çdo shqiptar do të jetë ushtar... në kohët të lüftësë të dalën gjer më 500.000 burra.»

Këto fjalë të Samiut i përsërit si me vete një oficer progonatas, që ka ardhur me disa shokë nga Erseka. Po hyjnë në muze. Oficeri nga Progonati buzëqesh, i zbehtë. Të druajtur janë edhe shokët e tij, kopsiten, heqin kapelet, ndreqin flokët. Cilit shqiptar do t'i bënte zemra të hynte aty pa hequr kapelen?

Tej, në pllajë është një shkëmb i vogël, që i thonë: «Guri i Naimit». Mbase aty ka pasë murmuritur vjershat e para djaloshi tuberkuloz. Ai nuk qau për veten, po për atdheun. Nxiti njerëzit, u dha drithë e shpresë me ato vargjet, që don't i murmuritnin pas tij ndanë vatrave edhe plakat tetëdhjetëvjeçare. Sa janë njerëzit, që mësuan shkrimin shqip të nxitur nga dëshira për të kopjuar vjershat e tij? Sa janë komitet që bridhnin maleve duke i mbajtur këto vjersha në gjë? Duhet të hidhesh mbrapa në kohë, të thithësh të njëtin ajër e të

hash po atë bukë, për të zgjidhur këto dhe pyetje të tjera, që kanë të bëjnë me shpirtin e epokës.

Ai oficeri ka dalë prej muzeut. Nga fytyra duket sikur aty brenda t'i ketë ngjarë diçka e bukur, që i sjell turbullim të thellë. Vjen e rri pranë meje me kapelen në dorë, shikon «Gurin e Naimit» e thotë:

— S'ke si të mos e duash me shpirt Naimin.

Kjo është fjala që mund të thuhet për Naimin. Se ai ishte poet e mësues, aq sa ishte njeri e luftëtar, në kohën kur vendi ja kishte më tepër nevojën, prandaj ai të bën ta duash me mallëngjim, përjetë.

— Samiu ka shkruar një dramë për Progonatin, dramën «Besa», — i them oficerit.

Ai kaloi dorën në flokët, buzëqesh, kërkon me mendje lidhjet e Samiut me Progonatin,

* * *

Samiu na thotë se Frashëri ka qenë një «fshat-qytezë». Ashtu ka qenë në kohën e lulëzimit të vet kjo qendër e Dangëllisë, po luftërat dhe robëria e gjatë e rrënuan dhe në çlirim në Frashër kishte mbetur pothuaj vetëm kujtimi i asaj që kishte qenë. Sot ka 130 familje. Nga viti 1975 e këtej popullsia është rritur 38 për qind, janë ndërtuar një varg me lokale të shërbimit, ka 18 kuadro me arsim të lartë, 30 me arsim të mesëm. Tendenca është për rritje të mëtejshme, po ka diçka tjetër në Frashër që të bën të mendohesh.

Në këtë kooperativë punon kau e mushka. Punon me vështirësi edhe traktori, po peshën e mbajnë këto kafshë, që shkelin kudo që ka

një copë tókë pér të shkélur. Megjithatë grurin është pródhojnë më gjysmën e shpenzimeve të disa kooperativave në fushë dhe të ardhurat pér krah pune lu friten brenda një viti 24 pér qind e do të friten më tej. Këto më anë të mekanizimit, siç është do vindi, duke tërhequr me kafshë makinat e mbjelljes e të spërkatjes. Dhe, megjë s'kisht burra të mjaftë pér pârmehdat, bënë përparrë vajzat. Kështu koopérativa e Frashërit, me tokën në britja e hë shpatet me gurë, ku filloj dëbora herët dhe ka limeret thëllëza; u bë vindi i seminareve së si të qeverisë më mirë njëri, të harxhojë më pak e të marrë më shumë.

Fadili, kryetar kooperative prej 22 vjetesh, deputet në Kuvendin Popullor dhe Hero i Punes Socialiste, përkul trupin e madh dhe sheh mikun brenda në sy, duke pyetur veten se çfarë të bëjë tjetër pér ta kënaqur më mirë. Kë ndezur zjarr, i ka dhënë mikut ndërresa të pastra dhe çaj mali më erë të mirë. Matarë gatuhet darka.

Kjo sjellje është tij shtrihet edhe te njerëzit e shtëpisë dhe te shtëngohet zemra, të duket se në çastin tjetër ky burrë do të ulet para mikut në gjunjë, ndërsa qëndron fort në këmbë dhe mbush dhomën më trupin e tij. Kjo s'është thjesht mikpritje bujare dhe është, po një fismikëri që lidhet më dikë të lashtë, me ndërimin pér njeriun.

Kur ndertohej muzeu, Fadili filloi të mbledhë gurë vëtë, në krye të Ishatareje, i zgjidhte, i fshinte gurët. Dhe në dimërt kur u desh të nxifrej patatja në dëbore, ai e mori thesin i pa-

ri. Një herë tjeter, kur duhej bërë një kanal dhë disa fshatarë rigurronin, Fadili e bëri vetë kanalin për gjithë natën, qeshi dhë tha: ja, u bë kanali. Dhe një herë tjeter... Ky njeri punon me gjithë mend, jo sa «për të dhënë shembull.»

Më mbetet edhe një orë e gjysmë shqeti me Fadilin, aq sa zgjat rruga nga Zavalani në Frashër. Më duhet njëfarë kohe që të mbledh përshtypjet e natës që kalovalë në shtëpinë e Fadilit në Zavalan. Bisedova gjatë me një bufrë të sjellshëm, që përgjigjej shkurt e pyeste aty-këtu, megjithatë e mbante bisedën gjallë, urtësia e tij për të kuptuar të tjerët është e thelle e si pa gojë, por ajo shtohet me kohën; ndodhesha para njeriut, fjalë e të cilit ujdiste më jetën e tij dhe me të vërtetën në mënyrë të plotë. Këto mund të them përf Fadilin. Ky është kryetar Hero, aq sa është njeri dhe komunist. Ky është bashkëfshatar i Naimit. Vegse, po ta sjellësh fjalën rreth tre vëllezërve të mëdhenj, Fadili rri heshtur, ul kokën, duke thënë me këtë se ata, vëllezërit, janë përtej fjalëve, për ta vetëm duhet menduar. Kjo çiltërsi e bukuri e karakterit të Fadilit bën hije edhe në shtëpi. Njerëzit e tij më puthën në mëngjes, kur undamë, më dhanë ushqime përrugës, sic bëhet me vëllanë, dhe kjo m'u duk krejt e natyrshme. Bëhesh vëlla i një familjeje të tillë brenda një nate.

Tani po ecim rrëzë malit të Qelqëzës, nën bresin e gjatë shkëmbor, që sundon mbi luginën e madhe, të thelle. Pllaja e malit, me ngjyrën e barit të çelët, është e mbuluar nga një prush me gurë të hirtë. Therrmohet shkëmbi, prej shumë kohe, pa krisma, pa u ndier. Në natyrë mund të vëresh gjurmë se si zë e sajohet një shkëmb, po që të shkoqet një bërë i tillë ma-

dhështor, si nga një siklet i bërendshëm, është dëcka që të habit. Po mund të duhen dhjetëra mijëra vjet që të shkoqet i téri.

Mushkat ecin fare buzë rrugës, duke zgjedhur tokën e thatë. Kjo është kafsha që bën për këto anë. Fadili ecën përpëra duke u menduar. Hera-herës shikon rrrotull. Kjo është një shprehi profesioni, një zakon prej kryetari, që do të mbajë nën vëzhgim atë që ndodh rreth tij. Fadili e bën këtë me një shikim prej babe. Nëpër dritën e mëngjesit ende shquhet Zavalani me pllajat e bukura jeshile. Në këtë fshat të lartë marrin 31 kv grurë për ha.

— A ka prishje martese, — e pyes Fadilin.

Ai ndalon mushkën, shikon rrrotull, thotë se që nga krijimi i kooperativës s'kanë pasur.

Jeta nga këto anë paska veçoritë e veta. A thua këtu njerëzit grinden më pak dhe çiftet ujdisin gjithnjë në karakteret? Duhet ndenjur më gjatë për të këptuar më tepër.

— Po vjedhje? — e pyes prapë.

Fadili i ka zbritur mushkës, që të çlodhet kafsha. Sytë e tij në ngjyrën e gurit të Qelqëzës vetëtijnë. Edhe sot ndonjëri diku e merr një kalli misri të njomë, po vjedhje penale kanë pasur vetëm një, për 700 lekë, 22 vjet të shkuar, para formimit të kooperativës.

Që nga formimi i kooperativës... Ky burrë e ndan kohën më dysh. Lidhjet me jetën janë të vjetra e të gjalla, po jeta e vërtetë fillon me kooperativën. Janë të lidhura me kujtime që lënë gjurmë... Se njëherë, në vitin e dytë, e ndali njëri në rrugë, shau kooperativën, pushtetin dhe kryetarin. Ishin vetëm dhe Fadili humbi mendjen, e kapi fshatarin nga gjoksi, e shtriu përtokë dhe ngriti grushtin e madh ta dërrmonte

gojën e urryer. Žemërimi i njeriut të urtë e të drejtë është i rrezikshëm. Po Fadili pa frikën dhe habinë në sytë e fshatarit dhe u çua i turpëruar. Këtë e ka bërë në fshehtësi Fadili, që s'ka ngritur dorë në jetën e tij. Dhe fshatari ishte i varfër, i prapë e kokëfortë. Pesë vjet më pas ky i tha: «Fitoi kooperativa, o Fadil, kishe të drejtë.» Fadili iku tutje duke iu marrë këmbët prej gjëzimit. E kishte pritur pesë vjet pajtimin.

Kam ndonjë pyetje tjetër, po të vjen turp, ndien keqardhje ta trazosh këtë burrë me pyetje të vështira, aq më tepër se e ka mendjen të zënë me punë të tjera.

Shkruan Samiu në kapitullin «Ç'është Shqipëria»:

«... eja, ti, shqiptar i varfërë, të paguanç pesë grosh pér një dhi, nga e cila s'nxjerr dot as gjysmën e këtyre pareve në mot.»

Sot dhia ka ndërruar lëkurë e zakone. Në Frashër marrin 100 litra qumëshët pér kokë.

Kjo është ende pak. Ai bariu mbi Këlcyrë merr 300 litra dhe një më tej 350 litra. Fadilit i mungojnë krahët e punës pér të zvogëluar tufat, pér ushqimin. I vërshon gjaku tek sjell ndër mend atë kohën para kooperativës, kur iknin një pjesë e fshatarëve dhe ai nuk u përpoq sa duhej pér t'i mbajtur. Pa duhet çuar më tej drenazhimi i tokës me mjete rrëthanore, duhen zbutur pjerrësitë, duhet të shtohet mekanizimi në malësi, që të kushtojë edhe më lirë prodhim... Edhe pér këto duhen krahë pune.

Pak më tej disa çuna të shkollës, që venë në aksion, kalojnë nëpër një arë me grurë. Fadili nuk tha gjë, i priti çunat tek ura, u përshtëndet, i pyeti pér mësuesin duke folur me tasi një moshatar. Më në fund njëri nga çunat tha se kishin ecur nëpër arën me grurë.

— Edhe unë u çudita, — tha Fadili. —
Pyeta veten si e kanë hallin këta.

Çunat përshëndetën «xha Fadilin» dhe u nisën varg buzë pérroit, të heshtur, duke shpejtuar, sikur aty më parë të kishin shkelur në thëngjij.

S'ka vjedhje penale, s'ka grindje të rënda. Ka sjellje të mirë e bujari. Kodi moral i shqerisë sonë ndriçon në këto male. Po të vëresh më me kujdes në sytë e njerëzve, mund të thuash se këtu kanë ndikimin e vet edhe «vëllezërit e mëdhenj» me kriteret e tyre mbi të mirën e të keqen.

Po të pyesësh për këto fshatra tō Dangëllisë në luginën e Përmetit, buzëqeshin. Thonë se shtëpitë e tyre ndritin nga mikpritja e pastërtia. Kjo malësi vete mirë, në jetë e në punë, njerëzit janë të prirë në cdo anë nga e mbarë, më mbarë nga sa mund të ëndërronin Abdyli, Naimi e Samiu.

nëntor 1982

DRITA E GURIT TË KRUJËS

Para se të ndërtohej muzeu, Kalaja e Krujës i ngjante një eshtre të madhe të malit shkëmbor, mbi të cilën koha bënte të yetën. Tani doli prej tokës ky muze solemn duke mbartur më vete lashtësinë dhe, kur e vështron nga larg, të bëhet sikur janë gjallëruar edhe muret, sikur aty prapa enden banorët e hershëm, duke u marrë me ca punë që s'kanë, të ngjarë me ato, që bënин dikur, Eshtë kohë lirie dhe pritet që në portën e madhe të hyjnë stërnipat, për të sjellë nderimin e thellë.

Bukuria e jashtme e këtij muzeu qëndron në unitejin me kalanë. Në mund të bëhej një krasim, do të thosha se muzeu hyri në kala si predha në folënë e një topi me qitje të largët. Të lind dëshira t'u shtrëngosh fort të dyja duart arkitektëve, inxhinierëve, gurskalitësve, sepse e ngritën këtë muze në vendin dhe mënyrën e

duhur, një sintezë më e plotë midis arkitekturës dhe artit s'kishte si bëhej, në të s'ka një vijë të tepërt dhe asgjë mangët.

Befastia shtohet kur shkel në pragun e derës. Aty shfaqet grupi skulpturor, jo statik, po në lëvizje. Skënderbeu në krye të popullit, një rrëmet i zbritur prej shkëmbit, që nuk do të ndalet as para vdekjes pa arritur lirinë. Ndjenja e parë është të sprapsesh, t'i hapësh rrugë këtij populli që ecën drejt përjetësisë. Pastaj fillon të shohësh fytyrat e mira bujare, t'u lexosh në ballë e, në armët e rënda qëllimin fisnik.

· Në këtë muze të tërheq rruga nga një periudhë në tjetrën. Si njihesh me grupin skulpturor, si një parathënie e përgjithshme e brendisë, bie në tokë më të qetë, në sallën e periudhës ilire, të hijeshuar prej busteve të Teutës e të Pirros, me në sfond tablonë murale të një beteje iliro-romake. Mbretëresha krenare nuk iu nënshtrua fuqisë së re që vinte nga përtejdetit. Por kjo fuqi rritej si ciklon, pas vdekjes së Teutës mbretëria e Ilirisë do të binte. Zemra e Skënderbeut do të anonte më fort nga ai tjetri, «burri», mbret i Epirit, që përmëndet në letërsinë botërore si një ndër tre kapitenët më të mëdhenj të lashtësisë, sepse ky, Pirroja, ishte strategu i parë i kampeve ushtarake dhe i mësymjes me kombinimin e të gjitha armëve. Dhe ishte hedhur në Itali për të ndihmuar mikun. «Në mos gabofshin kronikat tonë, ne jemi epirotë. Ne kemi qenë atje edhe më parë dhe nuk jemi ndarë keq. Ai Pirroja im ka qenë pikërisht në Tarant...»

* * *

Një albanolog i huaj ka thënë: «mos kërkonit asgjë të shkruar në Shqipëri, veç atyre që janë gdhendur në shkëmbinj, se të gjitha dokumentet u zhdukën gjatë sundimit osman».

Ata që kanë ndër mend të shkruajnë për Skënderbeun dhe epokën e tij nuk duhet t'i lërë kuraja. Dokumente po gjenden e do të zbulohen ca më shumë në të ardhmen. Në Gëziq të Mirditës u gjetën dy fragmente guri që dëshmojnë marrëveshjen e Dhimitrit të Arbërisë me Raguzën. Këta gurë janë prapa xhamit në muze. Ja tek është edhe faks-simile e letrës që papa Inocenti III i dërgoi më 28 shkurt të vitit 1208 të njëjtit Dhimitër, sundintari i Arbërisë. Jo vetëm në gur, por edhe në pergamen mund të lexojmë në muze të dhëna rrëth historisë së principatës së Arbërisë, duke filluar nga viti 1208. A mund të arrihen data më të hershme? Këtë do ta tregojë koha.

Duke ecur, ndiejmë se po i afrohemë qendrës së shpërthimit, çastit kur do të bien këmbanat e Krujës dhe gjithë Shqipërisë për të lajmëruar kthimin e Gjergj Kastriotit, si në korin e gëzimit në Simfoninë e Nëntë të Beethovenit.. Po më parë duhet kaluar nga këndi i qëndresës dhe njëkohësisht i hutimit, kur zotërit shqiptarë grindeshin, kur fshatarësia, e vënë nën zgjedhën e këtyre zotërinjve, përpiquej të mbronte gjënë dhe lirinë. Të ruante edhe kulturën. Ja, ndërmjet të tjerave, një imitim i kodikut të Beratit, që të bën të kthehesh ta shohësh prapë, sepse i ngjan tërësisht origjinalit. Teknika për të vjetruar një objekt mbështetur po aq e vështirë dhe e bukur sa ajo e përtëritjes. Pastaj zbret një shkallare më poshtë, në një katrot, ku

ndriçon vitrazhi me ngjyra i pushtuesit osman që hedh mbi skeletin e kontinentit flakën e verdhë, si frysë të vdekjes. Të kalon një rrëqetësje përsëri prangave; hekur i rëndë për të mbërrthyer në mur edhe trupin e një kolosi, që përkulët pëska për t'u thyer. Prapa është portë metalike, me purtekat majëmprehta. Një shpirt i errët cinik ka llogaritur të mbyllë në katror një popull të tërë, një gadishull, një kontinent. Po frugë të tërheq si nëpër një tunel nën kubët e heshtave dhe këmbanavë, për të dëshmuar se s'ka katror të mbyllur pa një dalje për popullin që kërkon lirinë. Përtëj kubesë hapet salla e madhe e bëashkim-përballimit. Këtu zotëron fryma e të dhë ajri i kaltër. Çdo gjë fillon të vihet në lëvizje për ndeshjen e afërt, krejtësisht të babarabartë. Mërr flakë kushtimi në mozaikun nga e mëjta, që zë krejt faqen e murit. Në çastin vendimtar ka ardhur Skënderbeu, siç dallin përpëra njerëzit e mëdhenj në udhëkryqet e historisë, si vullnet i koncentruar i popujve të tyre, të aftë të shpejtojnë ecjen e njerëzimit. Lëzha, beteja, rrëthimet e mëdha, armët. Këtu vizitorët ndien se trashëgon diçka nga lavdia e etervë. Në sfond qëndron piktura murale e Bakkallit, nga përmasat ndofta më e madhja në vendin tonë, me një mozaik patnjesh që, si ide kompozimi, të kujton atë vepren e Mikelanxhelos në Kapelën Sistinë. E pë gjithkush e ngjyjen penën në dëthi e klasikëve.

* * *

Lart, në një dhomë si kullë, është kanceleria e Skënderbeut, me tryezën e punës dhësëndukët anash. Këtu kthehej ai pas betejave e

rrrethimeve të mëdha, të festonte me popullin fitoret, t'i përgatitej rrrethimit tjetër. Piste ambasadorët e huaj dhe shkruante letra të gjata, me zemrën të rënduar prej tradhtive të brendshme dhe pabesive të mbretërve evropianë.

Por ai nuk hiqte dorë. Donte që Evropa të kuptonte se sulltanët rrini portat e saj të vjetra me dhunë e mashtrim dhe vinin në rrezik jo vetëm vlerat kulturore e materiale të Evropës Jugore e Qendrore, por edhe ekzistençën e popujve të kësaj zone të gjerë, që kërcënohej me shkombëtarizim e robëri të rëndë. Por Evropa e çoroditur, që vinte arsyen në gjumë, ndërsa i digjej jorgani nga këmbët, ishte një rrotë tepër e madhe për t'u vërvituri drejt luftës së përbashkët prej një burri të vetëm, sado tej pamës e strateg i shquar të ishte ky burrë. Ja edhe përgjigjet e shumta. Gjatë qëndresës së tij 25-vjeçare ai mori letra nga disa papë, të ftohta si qelqë me ngjyra, letra të mbretërve, të fryra me fjalë, që premtionin të dilnin në luftë, tërë kohën duke bërë gatitje të bujshme marshimi e nuk dilnin kurrë. Por ama, që të gjithë janë detyruar t'i njojin meritën, ta quajnë mur të lartë të Evropës, shpëtimtar, kapi-ten, vëlla, të përulen me nderim e habi para popullit shqiptar e Skënderbeut dhe prapë të vi-jojnë dinakëritë.

Përpjekjet e tij për frontin e përbashkët dhe për t'i ruajtur lirinë Shqipërisë dëshmojnë ngulimin e një burri shteti me mendjen e një diplomati. Traktati me Venetikun, Raguzen, Napolin, armëpushimi i shkurtër me sulltanin, kur i duhej t'i bënte një kërcënim Evropës. Por duket se, nga fundi i jetës, ai arriti ta bindte yeten që, duke kërkuar bashkimin e Evropës, ishte endur

për një çerek shekulli si në një pyll me mje-gull. Atëherë murmuriti fjalë të një krenarie të paepur, si të shkruara me gjakun e zemrës së tij dhe tha se shpëtimi i popullit ishin vetë armët e tij, kështjellat dhe malet e larta ku duhej të mbështetnin krahët. Kur thoshte këto, më kë-shillin e luftës mungonin shumë prej kapitenëve të vjetër, po trashëgimi që linte pas do të ishte një vazhdim i denjë i veprës, ura që do ta conte Krujën dhe Shqipërinë drejt përjetësisë.

* * *

Nga njëra sallë në tjetrën, për të arritur kancelerinë, ke ngjitur një piramidë të historisë, e cila nuk e humbet madhështinë në zbritje. Tani ndodhemi në sallën e bashkëluftëtarëve, një varg bustesh, prej Aranitit e deri tek ushtari që vrau Ballaban Baderën. Ndofta këtu mungojnë disa: Aidini, që ra në Torvioll dhe që kreu një punë të rëndë në betejën e parë të madhe, ku shqiptari mësoi të luftonte i bashkuar. Prej kësaj beteje rrodhën të tjerat. Mungon Moisiu, me shpirtin përherë në stuhi, nipat e Skënderbeut nga Balshajt, që i ndenjën besnikë deri në fund, ushtari anonim që i shpëtoi jetën me gjoksin e vet në Bulqizë. Po nuk do të mjaftonte as i gjithë territori i kalasë për të ngritur bustet e kapitenëve dhe të ushtarëve të shquar që i ndenjën prijësit në krah gjatë 25 betejave të përgjakshme dhe rrëthimeve më të mëdha të kohëve.

Në sallën e rezistencës pas Skënderbeut, të pushton një ndjenjë dhembjeje e respekti. Një gravurë venedikase paraqit Mehmetin II, shkurtabiq, me turbanin e madh, me një hanxhar të rëndë ngritur mbi Kështjellën e Krujës, që lartëso-

het si pirg graniti. Ky Mehmeti i ngjan një kri-jese të ferrit, me shpirtin te tehu i armës që mban në duar, ndërsa nën xhybe e përpjijnë ethet e pasionit dhe hakmarrjes për krenarinë e tij të hedhur tri herë në baltë. Këtu janë tablotë e mërgimit, kryengritjet që pasuan nën emrin e birit dhe nipit të Skënderbeut. Por kohët kishin ndryshuar dhe as ata s'kishin shtatin e prindit të tyre të madh.

Më poshtë, salla e pinakotekës me vepra arti të vendit dhe të huaja, tablo e gravura nga kohë e vende të ndryshme, anonime dhe të njohura. Është e habitshme se qysh e kanë përfytyruar Skënderbun këta autorë, që nuk njihnin veprat e njëri-tjetrit. Këtu duket kryekomandanti që përfshin me syrin e vet fushën e betejës, aty burri i shtetit, më tej një dijetar me ballin e Sokratit, më tej një plak që mbart me stoicizëm dhembjen dhe mjerimin e popullit. Por të gjithë këta ruajnë për habi profilin e shqiponjës, siç e ka përshkruar Noli në poezitë dhe prozën e vet. Në sallat e tjera janë këndet e kështjellave në miniaturre, punuar në alabastër, këndi i monedhave, i filatelistë, që u emetua në kujtim të heroit, veprat që u shkruan. Kur arrin në dalje, ke përshtypjen e thellë se çdo gjë që i përket heroit është vënë me kujdes e dashuri në vendin e vet të nderit.

* * *

«Bukur», po thoshte një plak tropojas. Me trupin e gjatë e të thatë, me mustaqet e bardha dhe veshjen e lashtë, dukej sikur të kishte zbritur nga tabloja murale, pa armë, për të soditur kohën e vet. Sytë e gjelbër tregonin gëzimin

dhe habinë e thellë. Po kërkonte diçka: «Bukur fort, po ku është i zoti i shtëpisë?» pyeti ai. Kur e kuptuan se çfarë kërkonte, e çuan lart, te një sallë çlodhjeje. Në mur ishte portreti i shokut Enver. «Ja, kështu po», tha plaku, ngjatjetoi me dorën në zemër, pastaj u kujtua dhe nderoi me grusht.

Një arsimtar i vjetër thotë se para Çlirimt mit në Krujë jetonin vetëm rrënojat e kalasë dhe kujtimi i madhi i Skënderbeut. Në histori nuk humbet asgjë. Kjo është një e vërtetë objektive. Veçse, kur historia qëndron e mbuluar për një periudhë të gjatë, ndikon në çorditjen e shpirtrave, meqë ajo është për popujt si Ylli Polar për detarët. Dhe pastaj duhet mund i madh për ta përtërirë. Këtë mendonte ai plaku kur pyeti për të zotin e shtëpisë.

Sepse, që prej krijimit të saj, Partia dhe shoku Enver, me thirrjet e zjarrrta për luftë dhe në çdo rast, kanë evokuar Skënderbeun, duke përtëritur imazhin e tij në shpirtin e popullit. Jo vetëm për ne, por edhe për popujt e tjerë, të ngritur në luftën çlirimtare, emri i Skënderbeut ka shërbyer si kushtrim. Pas Çlirimt mit Partia e vuri heroin në piedestalin e lartë. «Populli ynë, me Skënderbeun në krye e bënë Shqipërinë dhe Krujën të famshme në historinë e njerëzimit», thotë shoku Enver në dorëshkrimin e tij në Krujë, më 23 mars 1967. Ky muze vjen si një kurorë plot dritë e asaj që ka bërë në 40 vjet Partia për të nderuar kujtimin e epokës së madhe të së kaluarës dhe për të kultivuar traditën.

Këtë muze, që i dhuroi popullit Partia, duhet ta shohësh me sy, që të bindesh se ai teikaloni çdo përfytyrim. Shkrimet, filmimet e rastit dhe mjetet e tjera, sado të mira qofshin, të japin

vetëm një ide të vakët. Aty çdo gur, dru, hekur, qelq, është punuar në çdo centimetër, me durim, talent e shpirt. Çdo sallë a kënd është një befasi dhe të gjitha bëshkë krijojnë një përmendore unike. Aty është kryqëzuar për mrekulli e dobishmja me të bukurën, informacioni ma ndjenjën e lartë të estetikës. Kjo u bë me bashkimin e qindra njerëzve, si një provë e gjallë e zhvillimit të fuqishëm të kulturës dhe të artit në Shqipëri, me një shtrirje që përfshin çdo fshat e çdo qendër pune e banimi. Këtë e thonë edhe të huajt që vizitojnë muzeun e që kanë parë shumë muze të botës — duke shfatur admirim e respekt.

Por Partia na thotë se ngulmi ynë për të arritur gjithnjë majën më të lartë s'duhet të njobë të ndalur. Kjo është dialektika dhe botëkuptimi ynë. Muzeu duhet të punojë. Ende nuk e njobhim operën për Skënderbeun të Antonio Vivaldit, kompozitorit të shquar italian të shekullit XVII, që themeloi gjininë e koncertit. Një muzikolog gjerman po thoshte një ditë se ka dëgjuar një fugë të Bahut për Skënderbeun. Kjo gjithashtu është me shumë interes. Flitet për dhjetëra vepra arti që autorë evropianë i kanë kushtuar heroit shqiptar. Mbase nuk janë të gjitha vepra të dorës së parë, por ato provojnë jehonën e madhe të qëndresës së Skënderbeut, në një kohë kur përhapja e zërit nuk njihte mjete të tjera veç hapit të udhëtarit. Këto vepra në një mënyrë a në një tjetër duhet t'i gjurmojë, muzeu. Një studiues shqiptar i shkruan muzeut duke pyetur se çfarë vendi u është bërë vëllezërve Gazuli nga Mirdita, që të tre radhazi ambasadorë të Skënderbeut në Raguzë. Më i madhi prej tyre paska qenë matematikan dhe astronom i njobur në Evropë, Ja, një fakt i

tillë nuk njihet. I njëjti studiues përmend disa vepra letrare-artistike-historike, që gjithashtu nuk përfshihen në muze. Duket se autori i letrës e njeh punën e vet. Po do të jenë të shumta sugjerimet e ndihmat drejtuar muzeut, se me ekspozimin e tij të shkëlqyer ai nxit fantazinë dhe dëshirën e gjithkujt për ta bërë sa më të përsosur.

nëntor 1982

DREJT SË BUKURËS E SË DOBISHMES

1

Prej emrit të vjetër «Ergjëri», për shkak të ngjyrave të bardha e të hirta, të dritës që pasqyron, qyteti të sjell ndër mend argjendin dhe të bëhet sa dëgjon edhe tingullin e këtij metali, nën rrahjen e butë të çekanëve të largët. Atëherë ndalesh për të soditur, me mendimin se kështu do të arrish ta kuptosh më mirë këtë qytet. Po gjithnjë të duket se në krahët mbetet diçka e pakapshme, që rrëshqet mbrapa. Kjo ka lidhje me formën monumentale, me lakimet e ndërtimit, me lartësitë, rrafshet, luginëzat, kreshtat, që shfaqen e fshihen, duke të bërë të mbash frymën se mos po rrëzohet një kodër me ndërtesa, mos po thyhet diçka, dhe në të njëjtën kohë ndien sigurinë se çdo gjë do të qëndrojë

përjetë ashtu siç është. Ky plasticitet të nxit të ecësh më tej, të «lexosh» fisionominë e rrugëve e lagjeve. Me këtë formë të qytetit, pra, ka lidhje përshtypja e parë se gjithnjë të rrëshqet diçka, por edhe me dinamizmin e jetës, me gjallërinë dhe lëvizjen e banorëve. Të dyja bashkë të jatin lëndë për të menduar, duke i thënë vetes se ndodhesh në një qytet që mund të jetë i tillë i vetmi në botë. Kjo bindje të forcohet edhe më tepër kur zë t'i «hysh më brenda» Gjirokastrës.

* * *

Këtu çdo lagje qëndron më vete, me ndërtesat dhe terrenin e saj. As në sheshin e Çercizit, as në Qafën e Pazarit, as në Pazarin e Vjetër, as te gjimnazi, nuk thua dot se je në qendër. Dhe të gjitha lagjet bashkë krijojnë unitetin, konceptimin e plotë të një kryeqendre, që s'mund të jetë më e madhe, as më e vogël, po pikërisht aq sa është. Kjo harmoni, yërehet edhe brenda lagjes. S'ke për të gjetur në Gjirokastër dy ndërtesa identike, dhe çdonjëra qëndron në pozicion të tillë, që të ketë hapësirën dhe lirinë e vet e të mos pengojë lirinë e fqinjët, që e ka poshtë tij çatinë, të mës ia shohë oborrit dhe aq më pak jetën intime brenda shtëpisë. Këtu jetojnë ngushtë dhe nuk ndihen ngushtë aspak. Dhë as ke për të parë në tjetër vend një «pazar» si ai që ngre kurrizin lart në qafë, me ato dyqanet e vogla që duket sikur jatin e marrin nëpër dyert ngjitur, që nxënë, për habi, aq te-për mall në aq pak vend dhe duke qenë i terti ky mall nën sytë e tu.

Këtu s'ka rrugë pa krye. Ka një qarkullim të

lirë e me vazhdimësi, nëpërmjet kalldrëmeve, «qilima me dritë të gjirokastritëve», me gurin e zi me fërkim të butë dhe me atë pjerrësinë e lehtë anësore, aq sa kalldrëmi të mbetet i thatë dhe ta hedhësh hapin të sigurt, të duash të ecësh e të arrish pa mundim.

Si dhe kush e ka «organizuar» kaq hollë ndërtimin e lagjeve dhe të mbarë qytetit?

Ndjenjat dhe prirjet e vetë gjirokastritëve, kushtet dhe koha, që janë në çdo rast rrëgulluesi i vetëm i të gjithave dhe që u materializuan me mendjet e qarta të «bylykëve» muratorë prej Dangëllisë e Oparit, me krahët e punëtorëve të gurit, me djersën e qiraxhinjve, që e sillnin bredhin e kuq, gështenjën e lisin nga Zagoria e Kardhiqi, gurin nga «mademet» e Matlit të Gjerë dhe rërën nga lumi Drino.

Po, ngado që të silleh, syri qëndron te Kala-ja, jo vetëm si kreshtë e madhe sunduese, por edhe si boshti i formulimit urbanistik të qytetit. Robert Uellshi e ka quajtur një nga kalatë mallore më të fuqishme e më madhështore të Evropës. Para se të ngjitesh aty, duhet të përgatitetë zemrën, se ajo të merr frymën me historinë dhe me dramat njerëzore, që vijuan deri në ditën e çlirimt:

* * *

Një hoxhë i zi doli nga hotel-turizmi dhe tnis përpjetë kalldrëmit. Me vete mbartte hijen e vet të errët, si një dordolec i habitshëm, që doli papritur nga ndonjë plasaritje e dheut. U rikthyen një fuqi e vjetër, e harruar, në mes të ditës e nën shkëlqimin e diellit, duke synuar Qafën e Pazarit. Sa më tëpër ngjitej, aq më shumë i përngjante një krimbi të zi që kërkon

palcën e lisit të shëndetshëm, duke i lënë një-njëzit pa frysë. Ky nuk ishte një vegim. Hoxha po ngjitej vërtet. Këtu xhirohet një film për Avni Rustemin. Njerëzit kalonin më tej, tundnin kokat, ndërsa fëmijët përcillnin hoxhën duke mbushur rrugën me zhurmë.

Në një skenë masive të këtij filmi, katër qind burra e gra ia morën këngës: «Mos pandeh se u harrove/Lule, o Avni Rustemi». Kjo ishte jashë skenarit, spontane, po njerëzit kënduan deri në fund dhe disa i kishin sytë të përlotur. Po u vinte Avni edhe një herë, në personin e aktorit. Ky ishte një nga ato çastet e rralla, të lumtura; kur regjisori mund të hedhë në erë tekstin dhe kapelën dhe të xhirojë atë që i shohin sytë. Po le të kthehem te hoxha. Në Qafën e Pazarit ky s'mundi të duronte më gjatë frysë e përgjimit dhe të ilaritetit që po mblidhej rrëth tij, hoqi 'xhyben dhe çallmën dhe u kthyte të shihët njerëzit, të bindej edhe vetë dhe t'u tregonte të tjerëve se kjo ishte vetëm një punë filmi.

Ky ka qenë një «popull pagan», «myslimanët më pak myslimanë në tërë perandorinë». Në Gjirokastër duhet të përkulesh për të parë një ish-xhami. Kjo për shkak të terrenit të «aksidentuar», por që ujdiste edhe me prirjet e qytetarëve, për t'i parë kishat e xhamitë si diçka e ardhur nga jashtë dhe që s'kishin punë me shpirtin e shqiptarit. Prandaj ato kanë qenë bërë si nga ca argatë me mendjen gjatkë, me përmasa të vogla, shpesh pa hajate të jashtme, asnjëherë s'kanë ngritur krye të sundojnë, të vendosura në qoshet ku njeriu mund të kalonte pa i parë, duke i lënë të banojnë në atë botën e tyre në vetmi, nën hijen e ndërtesave me arkitekturë madhështore.

Në marsin e vitit 1978, shoku Enver Hoxha u dha disa këshilla bashkëqytetarëve për ruajtjen, restaurimin, ndërtimin, gjelbërimin, ndriçimin e Gjirokastrës, të shpallur vite më parë qytet-muze. Ai përmendi me radhë lagjet, rrugët, shtëpitë, me emrat, tiparet, vlerat e tyre. Ato që tha shoku Enver i kërkonin vetë sokakët e Gjirokastrës. Qyteti do të përtérihej, duke u bërë përherë më i bukur, me sa më pak shpenzime, me punën e përbashkët të qytetarëve e të shtetit.

Tani lagjet ruajnë e forcoinë pamjen e larmishme e të zhdërvillët që kanë pasur, përgje të larta me ndërtesa, që ndiekin njëra-tjetrën, si një ngrehinë e vetme, që shkon drejt malit. Prej tokës dalin objekte të vjetra. Te «shtatë çezmat» të ndërtura nga «shtatë vëllezërit» u gjinden e po ribëhen tri vjetë tvre. Po kërkohen të tjerat. Këto janë në një sipërfaqe prej pesëdhjetë metrash dhe këtu dikur merrte ujë pothuaj tërë Gjirokastra. Ndërsa ngrihen me mjeshtëri objekte të reja, kompleksi i bukur sportiv sipër pazarit, pika turistike lart në Kërcullë, në faqen e së cilës janë «lukuramat e Zekate», rrafshet me pllaka ku rrëshqitnin djemuria e Palortosë, duke grisur rrobat, për gjëmën e aneve. Diskutohen projektet e klubit të veteranëve dhe lokaleve të tjera në ndërtesa historike, që këto të jenë sa më të dobishme. Por veprat më e madhe do të jetë kompleksi kulturor në qendër, aty ku sot gjendet një kinema e stilit të bizantit rus, një nga ato gabimet që u bënë tek-tuk në vitet e para dhe që do t'i fshijë koha. Thuhet në projektprogram: «Ky ansambël duhet të jetë një kulm ideor dhe artistik i

ndërtimeve në Gjirokastër... duhet të përmbledhë në vete gjithë madhështinë, fryshten heroike dhe krenarinë tonë për veprën e popullit dhe të Partisë». Do të fillojë vitin që vjen, dhe do të bëhet nga arkitektë që i provuan talentet e tyre në muzeun e Krujës. Në të njëjtën kohë bëhet fjalë për zgjerimin e Sheshit të Çerçizit. Vetë këtij burri, Çerçizit, nuk i mjafton sheshi, po nuk, u mjafton më as gjirokastritëve. Ideja tjetër plot guxim është që sheshi të lidhet me rrugë me kompleksin kulturor. Si do të duket qendra monumentale e qytetit pas disa vitesh? Dhe si do të ishte sakatuar qyteti, po të bëheshin ndërtime «allafranga»?

* * *

Fati i këtij qyteti është i vetëm. Në formë duhet të kthehet në kohën e lulëzimit të vet arkitektonik, duke bredhur mbrapa në shekuj, duke ruajtur të pacënuara vlerat kulturore, si një trashëgim të madh që s'mund të ribëhet për shkak të përmasave e të shpirtit. Në përbajtje duhet të jetojë intensivisht të sotmen dhe të shohë qartë të ardhmen. Kjo përputhje nuk është e lehtë. Këtu s'kemi të bëjmë me monumente të pjesshme, siç mund të ndodhë gjetiu, po me një qytet të tërë muze, ku jetojnë njëzet mijë njerëz.

Shefi i zyrës urbanistike ka këtë problem; të përshtatë ndërtimet e reja me fizionominë e përgjithshme të qytetit, të futë në masë të caktuar përdorimin e gurit, të ruajë ngjyrat e hirta e të bardha, të rregullojë ndriçimin. Po mund të shkohet edhe më tej, si me blokun e tregtoreve të reja në Palorto, që nuk dallohet fare nga banesat përreth. Dhe kështu, me kuj-

des, dashuri e talent, objektet e reja, me destinacion shërbimi, nuk do të prishin asgjë në qytetin e vjetër.

Kurse dega e Institutit të Monumenteve ka më tepër ndërlikime, për shkak të volumit të punës, por edhe të kërkesave të reja ndaj së vjetrës. Diku lind kërkesa për të përshtatur një kuzhini, për të hapur një dritare. Çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet? Ekziston rregullorja, po s'ka rregullore, që të hyjë në jetë pa urtësinë, fantazinë dhe shpirtin e atij që e zbaton, dhe sidomos pa bashkëpunimin e atyre mbi të cilën zbatohet. Mbarë gjirokastritët bashkëpunojnë me zell të shtuar.

3

Ata që kanë pasë punuar në «mademet» e gurit, qiraxhinitë e xhadeve të largëta, zanatçinjtë, tani janë pleq dhe dalin më rrallë në Qafën e Pazarit. Por bijtë e tyre, 12000 punëtorë, zgresin çdo ditë, në uzinat, duke e pasur gjithnjë më vështirë të kuptojnë tregimet e pleqve, grevat, «shoqëritë», «lidhjet» e viteve njëzet e më pas, që u luhatën aq kohë si zogu në vezë.

Nimet Kasëmi ngrihet natën dhe i thotë vetes «më hengre shpirtin, mor zanat». E shoqja kuption se plaku s'ka prehje, vazhdon të «punojë atje» dhe punë s'bën, djersitet e lodhet shtrirë në dyshek, s'e zë gjumi pa çekan.

Ky është biri i «Qato Evgjirit», farkëtarit të madh, që ka pasë punuar hekurin rrëzë kalasë, zanat i trashëguar prej të atit, gjyshit, stërgjyshit, deri në kohët e largëta, ku humbet kujtesa e njeriut.

«Hekurin e njeh në ujë dhe pastaj e mëson me sy», thotë plaku.

Këta e kanë të zhvilluar ndjeshmërinë ndaj hekurit në një shkallë të habitshme. E si të bënini ndryshe pér të dalluar llojin e metalit që donte plori, sëpata, kazma, pótroi, pirustia? Dhe as saldimi nuk ishte, prandaj e bënин ngijtjen e hekurit me «zierje» në zjarr, duke e «ëmbëlsuar» me baltë. Vec, duhet të njohësh zjarrin, pikën e luhatjes dhe këtë e fiton me punë të gjatë ustai.

Dhe kështu, duke përqendruar fuqinë e shpirtit dhe përvojen tek uji e zjarri, këta breza farkëtarësh kanë zotëruar hekurin dhe kanë nxjerrë prej tij gjithë veglat bujqësore e orënditë shtëpiake që i duheshin Kurveleshit, Zagorisë, fushës së Dropullit dhe vetë qytetit të Gjirokastrës, gjithsej pesë biruca farkëtarësh.

Por vjen një kohë që disa trashëgime ndalin rrjedhën. Sot uzina metaliqe prodhon në dy muaj atë që jepte krejt industria e Gjirokastrës para Luftës. Megjithatë, disa punë të dorës do të përtérihen, në përputhje me nevojat që i shtrohen sot qytetit. Se do të vihen në vend portat, kangjellat, zbukurimet, aty ku janë zhdukur, aty ku mund të jenë edhe të dobishme. Dhe sipër në pazar, në dyqanet me kolona, pilastro e korniza me gurë të latuar, ku sundon vija e drejtë, por edhe harku, ku vijon në të dy krahët një trajtim arkitektonik i njëlljojtë dhe prapë ta mban syrim gjallë, në këtë pazar, pra, që s'ke pér t'i gjetur shoqin, ka ende punë, pér të hequr materialet plastike dhe shtojcat e huaja e pér t'i bërë në çdo anë si kanë qenë, që dyqanet, zyrat, rrugët, të jenë «Gjirokastër» dhe këto s'mund t'i bëjë asnje fabrikë.

Artisti Koço, që ka punuar me ustallarët e

njohur, që kënkon me ngulim shkrimet, qëndizmat, monedhat e vjetra, për të parë me anë të tyre se si ka qenë një orendi e mirëfilltë, po nxjerr nga atelieja e tij punime që i jasin dritë lisit, arrës dhe panjës. E po, kur ka dalë ndonjë herë një gjë me bukuri të vërtetë që të mos ketë kërkuar djerßen dhe vetë shpirtin e autorit?

Ky Koçua shkon çift me piktor Bashkimin dhe po krijojnë rrëth tyre ato nuklet e punëtorëve të gurit, hekurit dhe drurit, tre elementëve që kanë sajuar qytetin. Dhjetëra mjeshtër kanë në trup e në shpirt gjëra, të tjera për të thënë, që Gjirokastra të shquhet gjithnjë më qartë si një monument i vetëm i artit populor dhe i kulturës.

4

Gjirokastrën mund ta shohësh pothuaj të gjithë nga Sheshi i Kalasë. Po që nga pika turistike e Kërcullës ke nën sy edhe vetë kalanë, që i ngjan një kryqëzori të ndalur rrëzë malit, i cili vetë hapet si një dallgë e madhe e stërgjatë nga ana e detit. Sikur të buçitnin njëherësh topat e vjetër të kalasë dhe sidomos artilleria trofé e Luftës Nacionallirimitare, Gjirokastra do të dridhej si në një shtrat prej dërrase dhe kjo dridhje është do t'i kalonte luginës dhe maleve.

Por rrëth e qark është qetësi. Nga ana e zonës industriale dëgjohen goditje të lehta që përhapen mbi qytetin e argjendtë, i téri në diell. Për një çast duket sikur nëpër lagjet e tij futurojnë lejlekët e bardhë. Po lejlekët nuk do të kthehen më, se moçalet janë tharë.

Qyteti jeton të tashmen, me shikimin nga

e ardhmja. Këto ditë u përfundua vepra hidriku në Virua. Sivjet mbaron edhe vepra në lumë e Kardhiqit. Dhe kështu në Pogon, Suhë, në Kakavie, në Fushëbardhë, duke atakuar zonat malore, duke shfrytëzuar çdo burim në sipërfaqe dhe në guvat nëntokësore. Në fund të vitit aftësia ujitëse do të mbulojë 73 përqind të sipërfaqes.

Kjo bëhet në Gjirokastrën e sterave, ku njëriut i thahej pështyma për një pikë ujë. Potaani deli ujë me të tepër, uji që ka qenë posmund të arrihej, si në atë shpellën e habitshme të Skotinisë, 130 metra të gjatë. Dhe përdorimi i ujit në bujqësi do të bashkërenditet me energetikën. Aty poshtë, në zyra, diskutojnë për një varg me hidrocentrale, që mund të jepin një energji vjetore dhjetë herë më të madhe nga ajo që konsumon sot Gjirokastra. Këtu të gjithë janë të zënë në punë. Në fabrikat e reja prodhohen orënditë e kuzhinës, furnelat, çadrat e të tjerë artikuj të njohur në gjithë vendin. Kërkohen krahë pune në mjaft objekte, se duhet të zgjerohen uzinat e të bëhen të reja, të ndërrohen frigoriferi, ujësjellësi i ri, të zgjerohet qyteti në kodrat sipër spitalit, të rrëthohet Gjirokastra me kurorën e gjelbër.

5

Kalaja, kjo kreshtë e qytetit, flakërin për disa çaste nën dritën e perëndimit. Këtu mund të ndeshësh në çdo hap në vlera njohëse, nëpër të cilat duhet ecur si mbi gurë të çmuar, për të kapërcyer një hapësirë kohe prej 1400 vjetesh, gjë që të nxit fort fantazinë. Sepse ende nuk janë zbuluar gjithë të fshehtat e saj. Mbeten

për t'u hapur sidomos lidhjet e hershmë që ka pasur me qytetin. Ndonjë plak flet me bindje për një kanal të nëndheshëm të Kohës së Ali Pashës, që lidhet kalanë me shtëpinë e Zekatëve në Palorto, ndërtesa më e vjetër, me harqe madhështore. E parë që nga kalaja, kjo anë e qytetit duket si një përrua fantastik, me shtëpi të bardha e çati të hirta. Vetëm një mendje si ajo e Aliut mund të ketë shpikur një kanal të nëndheshëm në një thellësi e në një hapësirë të tillë. Po kush mund të thotë se ç'do, të na zbulojë në të ardhmen eksplorimi i mëtejshëm i kalasë? Për perspektivën mund të fliste komisioni i restaurimit, i cili ndodhet në Tiranë.

Nënë kullën e sahatit pë hapet një sallë arkeologjike. Aty rreth gjenden hyrje e tunele të fshehta që s'dihet ku të nxjerrin. Këto ditë nuk merret njëri me to, se nënsheshin e kalasë bëhen gatitjet për festivalin Poja tek vjen një çast kur duket sikur sahati i kullës ndalet, përgatitjet pëzullohen, askush s'mund të thotë se ç'do të bëhet me njëfarë kaqerme të ndërtuar vonë. Dikush thotë se punët do të shkonin ndryshe, po të vendosej këtu ai komisioni që ndodhet në Tiranë.

Sonte në Dacaj këndojnë një këngë vjetër:

*Djalé, c'té ormisi nëna,
Se c'té dha armë të renda*

Pastaj këndoijnë një avaz tjetër:

*Cüpa kishte hyr' në magje,
Binte era manushaqe.*

Këndoijnë gjashtë vellezërit dhe dy nga nuset, me vetullat ulur, me zë të shtruar, duke kërkuar më të qetë e durim rrënijët e këngës. Ende s'janë të sigurt nëse kënga është passtruar nga shtresat që i ka vënë koha dhe ata përpiken, synojnë më thellë, duke kërkuar brenda vetes. Hera-herës mbajnë vesh nga dhoma pranë, se mos po thotë ndonjë gjë plaku, që është mbërthyer në shtrat. Kur erdhi në Gjirokastër shoku Enver në marsin e vitit 1978, plaku zbriti në Sheshin e Çerçizit duke kënduar me djemtë, nuset e nipat.

Po plaku s'hotë gjë. Dëgjon në heshtje, e di se kënga do punë. Djemtë marrin zemër dhe nisin një këngë tjetër:

*Qyqeja në lis të thatë,
Qaj, nëno, qaj, moj nëne,
Vajton ditë, e vajton natë.*

Një lis i thatë, një nëne kërcu dhe nuset e mbetura qyqe, se kanë shkuar djemtë nizamë. Dacajt i theksojnë fjalët, se labi në këngë kérkon tregimin. Dhe melodia e shtruar, e butë, duket si me prirje gazmore, po brenda saj vërtitet një notë trishtimi, një qarje që mezi ndihet. Gjithsesi, kësaj këngë nuk po i gjendet ana mirë. Nga brenda kollitet plaku. Dacajt do ta këndoijnë nesër mbrëma prapë. Njëri nga vellezërit thotë se kësaj këngë ia paskan gjetur më mirë Biçakajt, që përgatiten çdo natë për festivalin.

Ethet e festivalit kanë hyrë në çdo shtëpi gjirokastrite dhe deri në fshatrat më të largëta. Duket se tani më fort se kurrë do të zënë të dalin në arenë këngët dhe vallet e pastratë popullit, si një burim që vjen e zgjerohet, duke na çuditur me atë që e kemi pasur fare pranë dhe nuk e kemi ditur. Ditën që njeriu do të pushojë së kërkuar më të bukurën, atë ditë ka filluar rënia e tij. Po kjo me artin e popullit s'do të ngjasë.

* * *

Tani, në mbrëmje, zënë e mbushen dy lokalet e bukura te parku i Viroit, ku bëhet çdo vit festa e 1 Majit. Çiftet sillen buzë liqenit me shelgje dhe nën ujin blu të pastër përkundet një bar i gjatë, si nga një erë e brendshme e kanalit. Në verë mund të hapet edhe plazhi buzë lumenit. Po një pjesë e qytetarëve mund të pëlqejnë të ngjiten këtu në Kërcullë, ose lart në kala, ose edhe të pinë një birrë me kukurec «ndën kubé». Gjithnjë më pak njerëz rrinë së koti më këmbë aty te Qafa e Pazarit dhe anetë i mbledhin më pak buzët kur çupat vonohen edhe ca në shëtitje, ndërsa nuset me burrat mund edhe të kthehen pasdarke.

Gjirokastra është një grackë e madhe, që të zë shpirtin, që ke për ta kujtar gjithnjë dhe për të cilën ti vetë do të doje të bëje diçka, të flasësh, të shkruash, që ajo të mbetet siç është, që të ndryshojë vetëm për mirë. Dhe të hyn gëzimi në trup kur sheh se çdo ditë bëhet diçka, që afrimi e përputhja e qytetit të vjetër me jetën e re të jetë sa më i plotë, me dëshirën, vullnetin dhe gëzimin e vetë gjig-

rokastritëve, duke ndier ata se vepra e tyre, që rritet nën kujdesin e Partisë, u jep një krenari mallëngjyese shqiptarëve kudo që janë dhe kultivon në brezin e ri shijet estetike, respektin ndaj punës dhe atdhedashurinë e flaktë.

maj 1983

LËVIZJA E DHEUT

Në fushën e gjerë lakohen rrreshtat e plipave, duke sajuar ca vizatime që nuk kuptohen nga larg, po që sigurisht kanë të bëjnë me një bonifikim të mirë. Dielli shkëlqen e të djeg zverkun, po s'ka më atë dritën e bardhë të korrikut. Ka më tepër një nuancë në të verdhë. Hijet zgjaten papritur, ndërrojnë ngjyrat, bën kruashqi dimri me vjeshtën. Në rrugët e fushës lëvizin qerre, kamionë të ngarkuar. Aty-këtu duken pirljet me panxhar të shkulur.

Kam ardhur të shoh kooperativën e tipit të lartë të Plasës, të kuptoj si ngjet që në një pikë të caktuar të shpërthejë papritur një energji njerëzore e madhe. Pse pikërisht këtu dhe jo në një kooperativë tjetër?

Kur ndonjë kolektiv arrin digka të madhe, rëndom të thonë: «E po ja, njerëzit... u punuan këto e ato vendime... u bë kthesa». Këto përm-

gjigje sjellin një varg me pyetje të tjera, si fjala vjen: «A ishin njerëzit po ata, a nuk nji-heshin vendimet edhe më parë? Dhe ç'gjë e kishte penguar kthesën?» Përgjigjet mund të jenë të mira, po prapë të duket se në fund mbetet diçka e pashpjeguar.

Shumëkujt Plasa i është kthyer në mendje hera-herës, prej gazetave e televizorit, duke ngjallur kureshtje. Pesë vjet më parë kjo ishte një kooperativë e aq. Po zuri të merrte befas fuqi, të rritet me grurin, panxharin, patatet, blegtorinë, perimet, frutat, të përhapë «habbi» e të shkëlqejë nga çdo anë, a thua se prej pesë vjetësh dielli ngroh më tepër në Plasë!

Kjo imja s'është vetëm një kureshtje prej shkrimitari. Ndiej nevojën ta shoh e ta kup-toj Plasën si njeri, si qytetar. Kjo është rritur brenda meje pa u ndier, por është rritur dhe këtë e shoh më qartë tani, tek ngjitem në shkallët që të çojnë te zyra e kryetarit dhe më rrëh zemrëa lehtë. A do të mund ta zbuloj Plasën për veten time? Pastaj edhe mund ta shkruaj.

1

Kryetari i kooperativës ndodhet në një mbledhje në Tiranë. Zyra e sekretarit të byrosë së partisë është plot me njerëz, ulur në karrigjet rrëzë mureve. Në pamje këta nuk ndryshojnë nga njerëzit e fushës. Në të vërtetë qenkan arsimtarë e përgjegjëse të kopshteve e çerdheve. Bëhet fushatë. Fytyrat e tyre janë të ndehura e si në pritje. Të tilla ishin edhe fytyrat e njerëzve në rrugë dhe të atyre që ktheheshin në klub për një kafe. Ç't'u ketë ngjarë?

Sekretari i byrosë e ka zërin të thellë. Buzëqesh me sytë e kaltër dhe, hera-herës, ngre pjerrtas kokën rrumbullake, si për të kërkuar një mendim. Trupin e ka të fortë e të shëndetshëm dhe ia arrin ta mbulojë shqetësimin. Nuk kuptoja se ç'donin me fushatën e madhe, sidomos kopshtet e çerdhet. Po kjo u qartësuat menjëherë. Njerëzit do të punonin me lindjen dhe perëndimin e diellit dhe më të njëjtin orar do të punonin kopshtet e çerdhet. Ky ishte një mendim i thjeshtë, por që të bënte të vije buzën në gaz. Po «hynin» në fushatë edhe vocërrakët.

Kjo fushatë e vjeshtës i shtrinte rrënjet në anët më të papritura, në shtëpitë e kulturës, në magazinat, në dyqanet, në sendet e njëjës. Plasa kishte vështirësi me plugimet, me vjeljen dhe tërheqjen e prodhimit të madh. Po Plasa s'mund ta durojë diçka të tillë. Dhe fillon të ndiesh se odo gjë po ndehet, në të nëntë fshatrat dhe 3156 hektarët, një lloj kresh-përimi i tërë kooperativës si para rrezikut.

Jashtë ajri është i qetë, po duket sikur dridhen lehtas edhe gjethet e pemëve. Më duket se zë të kuptoj diçka, po fusha mund të thotë më tepër.

* * *

Më 1978 Kosta ishte përgjegjës sektori. U shkarkua për punë të patates. Hodhiën 30 kv farë dhe morën 40 kv prodhim. Ky ishte një shpërdorim i tokës.

Prej pesë vjetësh ai punon si brigadier. Është 37 vjeç, serioz e i sjellë. Prej pesë vjetësh merr mbi 500 kv panxhar për ha dhe i thonë «bri-

gadier i panxharit». Po mund t'i thonë edhe brigadier i grurit. Sivjet mori 68,2 kv grurë për ha në krejt sipërfaqen. Mund t'i thonë edhe brigadier i patates, sepse ka marrë mbi 270 kv dhë synon të arrijë 300 kv.

Brigada po shkul pataten. Një rrjetë e madhe drite me re ka mbështjellë Malin e Thatë dhe malin e Ivanit, duke i sjellë pranë. Pastaj pamja do të ndryshojë. Malet me drithë e hije do të largohen. Kjo lojë e hijes dhe e dritës duket sikur bëhet edhe në shpirtin e brigadierit. Diku' gropat japid patate të mëdha, vezake, krejt të lëmuara, me lëkurë të hollë, nëpërmjet së cilës duket lëngu. Ngjajnë si fruta që mund të hahen. Gropa më tej nuk jep të njëjtin prodhim. Dheu i shkrifët, në ngjyrën e hekurit, ka ende të fshehtat e veta, që e bëjnë brigaderin të mendohet.

Me rendimentet shembullore ky Kosta duhet të ketë ushqyer edhe një ndjenjë të vogël «hak-marrjeje» kundrejt shkarkimit nga detyra e përgjegjësit pesë vjet më parë. Ia them këtë në njëfarë mënyre, duke pritur, duke e hetuar me kujdes.

Në fytyrën e tij të kuqë, të pjekur, vërvhon gjaku lehtas. Pastaj ai thotë se, është mirë me brigadën. Kjo përgjigje vjen prej shpirtit, s'ka shtresë tjetër as në mendim, as në zemrën e tij.

Çunat u ndodhën në vështirësi të ngutshme dhe pyetën të hutuar ustanë: «Si ta ngremë këtë çati?» «Me anë të zjarrit», u përgjigj ustai. Çunat kuptuán dhe i hynë punës me zjarr, duke vënë shpirtin.

Puna e madhe, e vërtetë, si kjo që bëhet në Plasë, vepron brenda njeriut si një zjarr i pastër, i ngadaltë, duke e qiruar prej ambicjes, egoizmit dhe një tok ndjesive të kota që 'ia

mbajnë energjitetë të zëna. Sa më shumë ta shohësh brigadën e Kostës, aq më mirë bindesh përkëtë gjë dhe kjo arrin vlera që g'mund të maten me çfarëdo prodhimi të japë toka.

Këta janë shoqëri e mirë dhe ka arsyetë të jenë sepse puna e tyre është e qartë. Në parçelat e gjera të prodhimit të madhi bujqësor çdo individ ka detyrën e vjet, normën ditore, pa ka të caktuar edhë tokën, numrin e bimëve që duhet të rritë. S'mund t'i shmanget përgjegjësisë, sepse vetë bimët tregojnë si i ka bërë punët, mbjelljen, plehërimin, prashitjen, ujitjen. Dhe nga puna e individit sajohet parcela e skuadrës. S'ka akraballëk. Ka bindje se e drejta është rruga më e shkurtër drejt mirëgenies. Ka bindje në shkencë. Shërbimet, plehu, ujitja, të gjitha me shkencë. Tashmë u bind gjithkush se shkenca jep trefishin e prodhimit.

Zhuljeta është skuadërkomandante në këtë brigadë, 23 vjeçë, me trup të imët. Një, kapelë e madhe kashtore ia mbulon kokën deri në supet. Zëri i saj mezi dëgjohet nën kapele. Nuk arrin t'ia shohësh sytë, tek përgjigjet në ecje e sipër me një ose dy fjalë. Duket aq e druar, sa edhe e imët. Atëherë kthehem e pyes një burrë të vjetër, punëtor i skuadrës, se qysh i bindet ai një çupëza të tillë. Burrit i qeshin sytë. «E, jo... e kemi zgjedhur vëtë. Punëtore e palodhur, e drejtë, e mirë.» Dhe kështu është kjo çupëza që ndan e kontrollon punën, që nuk fal gabime, se nuk fal as veten. «Dhe çfarë bën ajo në kohën e lirë?» Oh, tani mbetet fare pak kohë. «Megjithatë, çfarë bën?» «Pak lexim, qëndisje, punë shtëpie, nganjëherë në kinema.»

A pshëretin aty tej gardhit ndonjë «Romeo» përkëtë Zhulietën? Këtë e di ajo. Nën strëhën e madhe të kapeles vetëtijë befash sytë e kaltër

si prej fëmije. Një gjë është e sigurt: ajo ka për të luftuar fort për një jetë të pastër.

Në skuadrën tjetër punon e ëma e Zhulietës dhe një skuadër më tej motra. Njerëz të gëzuar e të qeshur. Sado me vëmendje të kërkosh, po atë gjë do të shohësh, gëzim të qartë. Dhe ngutje. Është kohë fushate. E duke ndejnjur me ta fillon të ndiesh edhe ti vetë një ndryshim në mënyrën e të menduarit e në sjeilljen tënde. Arsyeton më qetë e më intensivisht në të njëjtën kohë dhe ke një tok me gjëra pér të gjykuar.

2

Në blerimin e fushës, në fletët e panxharit e në pemët, ka depërtuar hija e dimrit, që s'mund të shihet, por që ndihet. Gjëja më e ngutshme tanë është të hiqet panxhari, të lirohet toka pér grurin.

Është kthyer nga Tirana kryetari i kooperativës. Është me trup mesatar, pak i shogët, me flokët të zbardhur, 49 vjeç, të bën përshtypjen e një burri me autoritet, që flet thjesht e me kursim, duke synuar qartësinë.

Ideja pér një ekonomi model, pér një «provê», erdhi nga lart, nga Komiteti Qendror i Partisë. Kjo ide gjeti në Plasë tokën e duhur. Kryetari deshi të dinte në fillim nëse kjo «provê» ishte nisur njëkohësisht edhe në vende të tjera. Jo. Kjo do të bëhej pér herë të parë në Plasë. Kërkohej kthesë rrënjosore në bujqësi.

Në vitin 1971 u bënë në Plasë studimet agrokimike, pedologjike, hartat e kadastrës, atlatset: «Të përcaktohet toka, të zgjidhet fara, të

përqendrohet prodhimi duke i dhënë çdo bri-gade dy ose tri kultura, të bëhet qarkullimi bujqësor, të mbillet jónxhë aty ku ka qenë gru-rë, duke i kthyer tokës fuqinë që i merret, duke e pasuruar më shumë.»

E gjitha kjo duket tepër e thjeshtë. Po në të vërtetë kjo do të thotë të rrëzosh diçka të ndërtuar prej kohe, pas së cilës je kapur përjetë dhe të ndërtosh një mënyrë pune krejt të re. Se ishin mësuar të punonin në të njëjtën tokë, të mbillnin një mozaiq bimësh, në mos u bëftë njëra, bëhet tjetra, ishin mësuar të mendonin po njëloj, kurse tani...

Dheu zë e vërtitet, fryhet fusha, të merren mendtë, dhe ti rri me sytë hapur, si njeriu para një hendeku, që nuk di se në ç'tokë do të bjerë në bregun tjetër. Kështu ishte vite më parë, kur nisi përqendrimi e specializimi, kur çdo brigadë do të lëvizte pas tokës, duke ndjekur qarkullimin e kulturave të veta. S'ka më një sektor të patundur të brigadës, por një prodhim të madh bujqësor, që i përket tërë kooperativës. Për këtë duhet të mendojë individi, sku-adra, brigada. Por, ama, këtë do ta mendojë duke kryer punën e vet, duke lëvizur pas stinëve.

Po si do të lëvizin kafshët, mjetet, si do të rregullohen marrëdhëni me sektorin? Këto dhe një varg pyetjesh duhej të shpjegoeshin me durim, sepse njeriu hynte në marrëdhënie të reja me vetë tokën, gjë me rëndësi jetike për bujkun.

Dhe nuk është vetëm kooperativisti që ngu-rron. Ndonjë seksion aty në rrëth i pranon rendimentet që do të sjellë ky ndryshim, po nuk pranon ndryshimin vetë.

* * *

Kryetar Mihallaqi, nxënës në shkollën e mesme bujqësore, në kohën e lirë e cte pas traktorit duke menduar. Babai kishtë qenë bari lopësh, hyzimeqar në Polenë. Po në vitin 1947 u dhanë tokë në Rrëmbec dhe babai filloi të punonte për veten e vet, të ushqente tetë fëmijët. Mihallaqin e morën me zor në shkollë. «Merreni, hallall», — tha më në fund plaku — kam djem të tjerë.» Plaku nuk dëgjonte nga veshët dhe vinte ndonjëherë në shkollë të shihte nëse i jepnin djalit për të ngrënë. Ikte duke tundur veshin me gisht. Djali ishte i veshur e i ushqyer.

Mihallaqi e cte pas traktorit dhe mendonte se duhej të bënte diçka për atë që i kishte ndodhur, të tregonte mirënjojhen. Më pas, në Institutin e Lartë Bujqësor, kjo ndjenjë e mundonte edhe më fort. Në libra mund të lexoje me sytë hapur se në botë kishte vende që merrnin 40-50 kv grurë për ha, bujqësia duhej të bëhej ndryshe. Librat thoshin një gjë dhe ajo që bëhej në Rrëmbec ishte një gjë tjetër. Mihallaqi nuk po shihte qartë. Ky lloj mjegullimi vazhdoi deri në ditën kur erdhi i deleguari i KQ dhe atëherë Mihallaqi, tashmë kryetar kooperative, e pa shtegun që kërkonte, filloi t'i rrihte zemra. «Mos u ngut, — thoshte i deleguari, — kjo është me shumë përgjegjësi.»

Nga viti 1975 deri më 1979 u përvetësua përgjendrimi dhe specializimi i kulturave, si edhe shkalla e dytë, përqendrimi e specializimi i brigadave. Tashmë ishin krijuar për herë të parë në një kooperativë sektorët e veçantë të blegtorisë, perimeve, frutave, transportit. Plasa po jepte rendimente më të mëdha se të tjerët. Në vitin 1980 rezultatet e arritura nga Plasa s'mund

të mos merreshin parasysh. Kryetari i kooperativës u duartrokit në mbledhjen e plenumit. Ky është një burrë i pjekur, energjik, me një kulturë bujqësore të formuar. Gjatë tërës bisedës, nuk ka pranuar të flasë për veten. I shtrëngohet mjekra e i errësohet fytyra. Edhe për ata që kanë penguar nuk do të flasë. Thotë se idetë e rëja, veprat e mira asnijëherë nuk e gjejnë rrugën të shtruar. Jeta është luftë. Rëndësi ka vetëm një gjë: nga viti 1979 e pas Plasa ka ecur gjithnjë në rritje.

* * *

Në gusht të vitit 1981 kooperativa e tipit të lartë të Plasës i shkruante shokut Enver Hoxha se arriti të merrte 50 kv grurë dhe 400 kv panxhar për ha në krejt sipërfaqen dhe për suksesë të tjera në front të gjerë. Specializimi e përqendrimi dolën të drejta! Atëherë zënë e hartojnë teknologjitet e përparuara të prodhimit më qartë e më me guxim. Një vit më pas, prapë në gusht, kooperativa i shkruan shokut Enver se mori 65 kv grurë për ha. Do ta çojnë përpara revolucionin tekniko-shkeicor. Me këtë revolucion Plasa arrin brenda katër vjetve ta rritë rendimentin e grurit 16.7 kv për ha dhe të panxharit 120 kv.

Tani, duke sjellë ndërmend ato mbledhjet e para të nxehta, fjalët që u thanë, dyshimet, «grindjet», njeriu zë e qesh me vete, pyet se ku e kishte pasur mendjen. Dhe shikon më tej. A janë këta kufijtë që mund të arrijë Plasa?

Tej, nga bregu i lumit Devoll, mbuluar prej gjelbërimit, vjen një gumiëzhitje e paprerë traktori. Duket sikur metali po gjerryen rrëzen e malit Ivan. Çdo gjë lëviz në Plasë.

Poshtë, te stallat e vjetra të Rrëmbecit, ndodhet qendra eksperimentale e grurit. Kurse në Tërovë është qendra eksperimentale e panxhahit dhe në Plasë e patates.

Në «laboratorin» e Rrëmbecit punojnë dy mbëdhjetë gra. Secila ka peshoren e vogël, qeskat dhe defterin. Marrin «familjen», numërojnë «vëllezërit», u matin kallinjve të grurit peshën e gjatësinë, duke bërë shënimet. Punën e drejton Dhimitri. Ky duket se tërë kohën shikon diçka tej supeve të vizitorit. Ai do të marrë dyqind kokrra gruri prej qeseve të përgatitura në «laborator» dhe do t'i mbjellë në 10 metra gjatësi. Pastaj do të vrojtojë mbirjen, ngritjen, lulëzimin, kallëzimin, sémundjet... Pastaj kjo farë e zgjedhur do të shumëzohet, me atë progresion që tregohet në përrallëzën përløjën e shahut dhe do të mbillen ngastrat e mëdha në fushë.

Dhimitri, njeriu që duket se tërë kohën përgjon diçka, dhe ato gratë e «laboratorit», zënë e marrin një fuqi të madhe, që s'mund ta marrë asnje brigadë, asnje mekanizëm. Me kokrrat që kalojnë nëpër duar, me qeskat, bëjnë të buçasë në fusha një grurë i ri i bollshëm. Kjo është shkenca, një shkencë që bëhet thjesht, po të vësh në të shpirtin dhe durimin. Dhe pasi u krijua kjo farë elite, «laboratori» punon përtë marrë superelitën dhe super-superelitën, që të japë prodhim sa më të lartë e t'i qëndrojë motit; dhe puna përtë arritur kufijtë e grurit më të mirë s'paska të sosur, si jeta.

Kur qendra e zërit thërret se në 10 hektarë u arritën 85-90 kv grurë, Dhimitrit i rreh ze-

mra me forcë, fusha merr më tepër dritë, si përpara një mrekullie.

Ky është vetëm një përfytyrim. Këtu s'ka asnjë mrekulli. Ka shkencë. Një tjetër do ta bënte këtë shkencë të fuqishme të farës po aq mirë sa ky. Ishte koha që kjo shkencë të hynte në Plasë nga porta e madhe, në marrëveshje me individin dhe tërë kooperativën. Tani Plasa bën farën e vetë i tepron për shitje, dhe punon mbi katër varietetë farërash të reja. Megjithatë, përsë nuk u bë kjo më parë?

* * *

Një burrë me shëndet të tepërt, 62 vjeç, por që jeton në harmoni të plotë me punën e me kohën, me sy të gjelbër depërtues, që flet ngadalë dhe thotë gjëra të vërteta, ky është Spiroja, përgjegjës i sektorit të frutores.

Nga bahçja e mollëve në Tërovë dalin qerrët e ngarkuara. Frutat sivjet janë mjafët të pastra dhe do të merret dyfishi i planit. Këtu në fushë janë disa ngastra me pemë frutore, në prodhim të plotë, po s'kanë të ardhmë. E ardhmja e frutores është lart, në kodrat e Dumbravës, në grykën e Cangonjit, 180 hektarë fruta e vreshtha.

Spiroja është i ngathët në lëvizje. Si bën ai përtë mbajtur nën kontroll ngastrat e frutave e perimeve të shpërndara në tërë kooperativën?

Kjo pyetje, e ardhur prej pesë vjetëve më parë, e mbetur rrugës, i shkakton Spiros një turbullim. Paska ende njerëz që pyesin rrëth përqendrimit. Ai përgjigjet ngadalë, thotë se s'ka asnjë vështirësi, hap dorën lart si për të

përzënë një të keqe, me të cilën Plasa ka mbaruar punë.

Më fort se çdo gjë te ky njeri të bën përshtypje bindja në atë që thotë dhe këmbëngulja. Nuk do të shkojë dëm asnjë kokërr domate, zë e merr frymë me vështirësi kur ai i tregtisë i bën fjalë. Pastaj qetësohet, thotë se frutat dhanë mirë edhe vitin që shkoi ë do të japidnë qëdo vit. Tërë puna është te kujdesi i njeriut, te futja e shkencës. Kjo gjë të kujton rrugën e ullirit të Lukovës, dëgjon të njëjtën gjuhë, sheh të njëjtin përfundim.

Ja, pra, tani edhe frutat japidnë dyfishin. Çdo gjë në Plasë jep më tepër, falë punës së njeriut dhe depërtimit të shkencës. E pyes Spiron pse nuk u bënë disa nga këto gjëra më parë, pse pikërisht pesë vjet e këtej, si është e mundur të shpërthejë ndryshimi njëherësh e nga çdo anë?

Mendohet dhe thotë se ndofta, për të kuptuar më mirë atë që bëhet sot në Plasë, duhet njuhur e kaluara.

4

Fshati Rrëmbec ka planimetrinë e një qytete të vogël. Një rrugë e drejtë e asfaltuar kallon përgjatë fshatit me blerim të fortë. Në të dhjathët është shtëpia e kulturës, me kabinetet, muzeun, bibliotekën, kinemanë. Nga kjo anë edhe dyqanet dhe ndërtesat e tjera publike, të bukura e me një lulishte përpara. Nga krahu tjetër shtrihet fshati, me udhëza të drejta që dalin të gjitha në «bullevard». Kjo shtrirje e banesave, më shumë nga njëri krah, nuk ia prish bukurinë «qytezës».

Në rrugën e tretë e ka shtëpinë Vasili. Thonë se te ky Vasili mund të mësosh qdo gjë që lidhet me të djeshmen e kooperativës së Plasës, e quajnë si njëfarë libri të gjallë.

Ai është 73 vjeç, i thatë, më trupin të drejtë, gjithnjë me kasketën në kokë dhe lëviz e mban vesh me gjallëri. Duket sikur vite më parë t'i ketë ngjarë diçka, një përvëlim që e mban nën probat dhe ai rri në rojë nga qdo anë, se mos po afrohen fshëhtas hijet që kanë të bëjnë me atë ngjarje. Po kur zë e flet, dukë të parë në sy, kuption se nuk është puna të ndonjë ngjarje e vegantë, po te e tërë jeta e tij, e mbushur me mundim e me dritë.

Pema do diellin e verës që të piqet. Kështu edhe kujtimet, duhet të bëjnë kohën. Kujtimet e Vasilit nuk ndryshojnë po ndryshon koha, duke ua rritur vlerën kujtimeve. Ai ishte 28 vjeç kur u bë kryetar kooperative, më 16 tetor 1948. Tani rri në pension, por aq sa mund të rrijë një burrë si ai. Nganjehërë u flet të rinjve, Këta e dëgjojnë me njëfarë habie e humor, pastaj mendohen, shohin se ata të parët, themeluesit, kanë jetuar kohë të vështira që as mund të merren me mend.

Më 16 tetor 1948 hynë në kooperativë 54 familje. S'kishin, mjete pune, vegla e farë. Kishin vetëm tokën dhe shpirtin. Mjetet mund të gjendeshin, po 54 familjet duhej t'i bënin ballë «trethimit» të tetëdhjetë familjeve «private». Sepse ata mbidhën natën prodhimet e kooperativës së vogël, i bënin padi në gjyq kryetarit. Dhe njëri ngriti kosën. Vasilit i ndriti në sy tehu i bardhë me atë shkëlqimin e çelikut dhe mënjanoi kokën. Ishte fshikur në zverk. Për gjakun në pëllëmbën e dorës dhe u ul nda në gardhit i hutuar. «Ti nuk deshë të më pri-

sje kökën, apo jo?» pyeti Vasili. «Më mirë të kisha vdekur vetë, po se si më erdhi kur më shikele në arë», tha privati, dhe zuri të dridhej, i tmerruar prej asaj që kishte ngjarë, si-kur Vasili të mos mënjanonte kokën.

Kjo ishte lufta me fshatin, me veglat, me farën. Por ishte edhe lufta brenda, se kooperativisti punonte vetëm 110 ditë në vit. Gjithë ditët e vitit ishin të zëna me nga një emër shenjtori, po 255 ishin shenjtorët më të fortë, që kérkonin heshtje, lutje, pushim të plotë. Dhe kur erdhi traktori i parë, kooperativistët bridh-nin, rrinin përtej gardheve, a thua se do të ngjante ndonjë shpérthim. «Lesimi prish gru-rin», «ujitja plevitos tokën». Pas ujitjes rrinin me zemër të ngrirë, se po ftohej toka, plevitosej jeta. Po prapë rrinin të bashkuar ish-bujqërit e bejlerëve. Mungon ushqimi për qetë, secili të japë kashtën e dyshekut. Duhet ngritur sektori i pularisë, çdo shtëpi të japë një pulë dhe ngrihet sektori me 54 pula. Kështu edhe për lopët. Veçse asnje grua nuk dilte për mjetjen e lopëve.

Kishte ditë kur Vasilit i dukej se kooperativa tretej, po ndalej jeta, fryma nuk arrinte në mushkëritë e anëtarëve, bimët nuk rriteshin në ara, në trungjet e pemëve nuk qarkullonte limfa. Kurse armiku ia fërkonte brinjët me zjarr kooperativës, nganjëherë edhe me duart e «privatëve» dhe me anë të gjuhëve «private» përhapte gazin e vet prej nepërke. «Në Krutje të Myzeqesë rrojnë në kazermë. Shtatë gra veshin një fustan. Marrin fëmijët nga gjiri i nënës. Kjo është kooperativa.»

Në mëngjes mblidhej kallaballëk para kryesisë, tek ish konakët e beut. «Më mirë të pri-shet kooperativa.»

Atëherë kryetari merr detyrë të re. Të mos hipë asnijëherë në kalë, të bëjë edhe shtatëvjeçaren natën, që të jetë me shkollë. Asnjë nga komunistët të mos flejë. Çdo natë mbledhjë dhe, pas mbledhjes, rojë në çdo anë. Dhe ja tek vijnë prapë shokë nga komiteti i partisë, jepet ndihmë në farë e vegla. Kooperativa mbahet. Vitin e parë merr 13.6 kv grurë për ha, një rendiment i mirë ky, që i bën «privatët» të mendohen. Po puna duhet forcuar. Natën e dasmës së tij Vasili vete në shtëpi afër mëngjesit, se kanë ardhur në Korçë shokë nga Tirana. S'ka gjumë për komunistët.

Ato që kanë hequr komunistët dhe shumë njerëz pa parti, s'kanë të treguar. Por edhe gjëzimet nuk tregohen. Gruri arrin 16 kv për ha. Kooperativës i jepet flamuri i Këshillit të Ministrave. Zënë e vijnë delegacione në kooperativë dhe kryetari shkon nëpër rrethe të japë përvojë. Zënë e afrohen «privatët», bëjnë lutje.

Vjen edhe vetë shoku Enver Hoxha, në gushtin e vitit 1954. Vjen pa lajmërim, sheh çdo punë të kooperativës, cdo lëmë, çdo stallë, sic janë. Rri me njerëzit, flet për blektorinë e për ndërtimet, thotë ndërtoni sic e keni nisur, më pas i bëjmë më të mira. Shkon vizitë te familja e dëshmorit Pali Xhelo. Kur sheh plakën, shoku Enver mban këmbët. Kjo është një plakë e fortë. S'e ka qarë të birin. «T'u vra djali», i thotë shoku Enver. «Na u vranë shumë djem. Hajde brenda», i thotë nëna. Shoku Enver kthen kokën mënjanë, hedh sytë lart nga Morava. Plaka i sheh turbullimin, kërkon sytë e tij; asaj i dridhet buza lehtas, i vë dorën në supin e lartë dhe i thotë prapë: «Hajde brenda!»

Fshatarët ndenjën heshtur, duke pirë duhan

rrëzë gardheve, sa kohë që shoku Enver ndenji brenda me pleqtë e Palit. Po kur doli prapë, u ngrit edhe më e madhe hareja, krisi kënga e vallja. Po s'kishte muzikë. Kishin një djallo djalë ters me violinë që nuk i binte po të mos i mbushej koka. Atë ditë i ra me duf të madh dhe u hodh valle e këndoi gjithë fshati. E hoqi vallen vetë shoku Enver. Të nesërmen Rrëmbecit iu dërgua fizarmonika dhe u themelua «orkestra».

5

Ju keni treguar se jeni njerëz punëtorë e me vullnet, u shkruante ndër të tjera shoku Enver kooperativistëve të Plasës më 11 gusht 1981.

Ky vullnet i Plasës, që përhapet në çdo skaj, na heq udhën përpjete grykës së Cangonjit. Rrëzë Zëmblakut janë bahçet me perime e fruta dhe më lart stallat e lopëve të tufëzimit. Ky duket një kënd i qetë e me pamje të lirë, ku bagëtia mund të hajë ushqimin me shije e të dimërojë ngrohtë, vëçuar prej fshatit dhe prapë pjesë e tij. Prej kohë kooperativistët e marrin qumësht, vezë, perime e fruta sipas nevojës.

Lopët e tufëzimit janë në kullotë, veç dy-tri kërëvë me regjimi stalle. Kartelat e viçave tre-gojnë se shtimi i peshës 400 gr në ditë écën në rregull, si edhe qumështi i lopëve. Beni, zooteknik i lartë, ndalet para kártelave. Duket se puñen, e ka në vijë. Po hera-herës i shtrëngohet mjekra. Ka diçka që do ta arrijë së shpejti dhe mendja e tij është kapur fort pas kësaj gjëje. Lopët e kooperativës janin 900 litra qumësht më tepër se këto lopë të tufëzimit. Veç

kësaj kryesia synon të arrijë doemos në 4000 litra për kokë. «Na duhet edhe plehu, — ngulmon me forcë kryetari, — vetëm me përdorim kimik toka atrofizohet. Ne s'jemi për të ikur këtej pas dhjetë vjetësh.»

Beni do të arrijë së pari me lopët e tufëzimit, atë që kanë arritur lopët e kooperativës. Do të thotë të dyfishohet prodhimi i sotëm. Kjo është një rrotë tepër e madhe për t'u vërtitur. Po tre vjetët e fundit tregojnë se, nga lopa që sheh sot, pas tre vjetësh del një lopë tjetër. Asgjë nuk është e paarritshme. Ai ndjek remontin me ngulm, me kujdes. Kartelat tregojnë si ecën çdo lopë. Ecën sipas stallierës që e ka në ngarkim. Po të japsed lopa aq qumësht sa duhet jë japë, stallierja e ka dhënë ushqimin në kohën e në dozën e caktuar, e ka bërë mirë mjeshtjen, pastrimin. Ndryshtë ajo, stallierja, duhet të flasë, të tregojë si është puna.

Bima rritet pas ligjeve të thjeshta të natyrës, kurse njeriu ka luftën e brendshme, gjaku i tij lëviz si rrëke në stuhi të vazhduar. Ky Beni, 27 vjeç, me ftyrën e këndshme, me zërin e butë, nga pamja e jashtme të kujton bimën që hedh shtat pas kushteve të tokës e të motit. Kurse nën këtë pamje të qetë e të lëmuar vërshon pasioni i tij. Ai duhet të çoje përpara kafshët dhe shpendët. Problemi këtu është më i ndërlikuar se me grurin në fushë. Ai e di këtë me themel dhe buzëqesh. Di edhe se ndodhet nën vëzhgimin e të gjithëve dhe prapë mbahet i qetë. Tani rri të dera i menduar, me diellin pas zverkut. Ka gjetur përkrahje që të shtohet sipërfaqja e foragjereve dhe të mbillen lloje të duhura, për të arritur recetën më të mirë të ushqimit. Atje e kë mendjen, te fusha, andej varet suksesi. Bën llogari edhe

natën, që këto llogari të jenë të qarta e bindëse për të gjithë. Kur të dalim në rrugë, ka për të pyetur si me zor diçka për letërsinë. Gëzohet në heshtje, jo vetëm për punët e mira të njerëzve, në sektor, por edhe për punën e gjithkujt.

Rreth stallave sillen njerëz, duke lëvizur si brenda disa vijave të hequra me mendje. Një shkelje do të binte në sy menjëherë. Këtu mund të ketë veç rregull, marrëveshje të plotë ndërmjet njerëzve. Por edhe luftë, pa të cilën s'mund të ketë marrëveshje. Në këtë luftë e në këtë përpjekje vendin e parë si individ në sektor e zë Beni, duke u rritur personaliteti i tij në heshtje. Si ta kesh njohur një herë, s'mund të mos e kujtosh pa u gëzuar. Ja, i tillë është djali.

Përtej lumit, në pyllin me plepa, është pularia. Këtu gratë dhe vajzat kanë të ndara secila «ngastrën» e vet. Nga çdo kotec duhet të merren 107 kokrra vezë për pulë. Brenda dy vjetëve mesatarja duhet të arrijë 115 kokrra për pulë dhe duhet të shtohet në një të tretën mishi i shpendëve. Gratë dhe vajzat duhet të shpejtojnë më tepër, me sytë te grafikët.

Poshtë, në fushë, çdo njeri e çdo skuadër ka të caktuar punën e vet, njëloj si këtu në sektorin e blegtorisë e të pularisë. Prej këndej e nxjerr Plasa një pjesë të mirë të fuqisë, brei «organizimit të vogël». Çdonjëri synon ta bëjë sa më mirë punën e vet dhe të gjithë bashkë synojnë ta ngrenë sa më lart emrin e Plasës, jetën e tyre të begatë.

Anës rrugës ndalon një taksi me nusen. Burri që rri pranë shoferit zbret dhe thotë diçka. Duket se nuses i merren mendtë. Dhëndri vështron fushën nga xhami, i skuqur, fshin djer-sën dhe kthehet e shikon nusen me merak. Vajza që rri në krahun tjetër, i rregullon nuses kurorën, i fshin supin lehtas. «Hajde, nuse, se do të kesh kohë që të të merren mendtë», i thotë burri që ka zbritur dhe qesh fort. Shoferi tund krahun si në valle. Taksia niset me një kërcitje të gëzuar të motorrit, del nga rruga e asfaltit dhe zbret poshtë fushës e mbështjellë me pluhurin e vet.

Kjo nuse del nga një shtëpi e mirë, për të shkuar në një tjetër shtëpi të mirë në fshatin pranë. «Si jetojnë këtu?» pyes një arsimtar. «Hyr ku të duash dhe ke për të parë», përgjigjet ai.

Këto të kooperativës së Plasës janë nëntë fshatra, rrëzë Moravës, të mbledhura e të ndërtuara mirë, me lule e pjergulla në oborre dhe në ndryshim të vazhduar. Mesatarja e ndërtimeve, gjashtëdhjetë shtëpi të reja në vit. Në tre vjet të ardhura përfrymë u irritën 20 për qind. Në çdo tri shtëpi, dy televizorë. Dhe është një popullsi që shtohet 2 për qind. Këto i thotë kryetari i këshillit popullor të bashkuar. Një mjek me gjyslyke që i vezullojnë në hijen e zyrës, thotë se në Pendavinj prej 7 vjetësh s'kanë vdekje të fëmijëve nga 0-4 vjeç. Në Rov s'kanë prej 14 vjetësh. Kanë çerdhe, kopshte, ambulancë, maternitet në çdo fshat. Mjeku bashkon duart mbi tryezë, duket pak kryeneç nga mënyra e të folurit, ndofta sepse mendja e tij

është kapur pas ideve që synojnë larg. Ndonfta mendon të mos ketë fare vdekje fëmijësh nga 0-4 vjeç në nëntë fshatrat e Plasës. Këtij i thonë pediater, luftëtar.

Hijet e mbrëmjes zënë e zgjaten në fushë. Dielli i madh, i qartë, ngjyrë portokalli, ndriçon butë bllokun e mollëve, duke i ndezur drurët nga brenda. Aty po ecën me hap të gjatë një burrë me çifte dhe me qenin. Nuk dihet nëse do t'i arrijë turtujt e majmë në fushë para se të marrin fluturimin e natës.

Tani në mbrëmje fshati Rrëmbec, që gjer aty më parë rrinte si i mbyllur, zë e popullohet shpejt. Një grua në shtëpinë përballë ushqen lepujt, një djalë lëshon qenin të shëtitë në oborr, që zë të hidhet e t'u lehë fort kundërshtarëve të paqenë. Gra të tjera shkojnë nga dyqanet, ose të marrim fëmijët në kopshte e çerdhe. Në këto punë të tyre të duket sikur ka një qortim të buttë, pa zë, për burrat, që zënë të sillen si me përtim te lulishtja. Tek qëndrojnë aty, në rrëthin e dritave që do të ndizen pas pak, këta burra ndi ejnë ende nën këmbë dheun e fushës, ia kuptojnë gjuhën e re, ia dinë nevojat dhe më së pari përkëtë do të kuvëndojnë.

Në këtë orë të mbarimit të ditës merr rëndësi personi i drejtorit të shtëpisë së kulturës, i cili ka vënë altoparlantin për të hapur tigujt e një këngë që tretet ngadalë në muzgun e qetë të ngrrohtë. Kinemaja ka hapur sportelin. Njeriu që rri aty, me llambën elektrike mbi kokë, numëron diçka, ngjan sikur thotë me shpejtësi një mësim. Sheshi është në pritje, kushedi pse po vonohet rinia. Drejtori i kulturës del në dritaren e zyrës dhe këmbej një shikim me atë të kinemasë, që ka zgjatur kokën jashtë sportelit.

Diku prapa është «stadiumi» i Rrëmbecit, me dhoma, pista e fusha. I njëjtë «stadium» po ndërtohet në Plasë. Nga ky «stadium» i Rrëmbecit po kthehen vajzat e skuadrës së voléjbollit duke fitor nën zë. Tek i sheh, të kujtohet një fotografi e grupit teatral të viteve tridhjetë, që është në muzeun e Rrëmbecit, se ky fshat e ka dashur kulturën që herët. Në këtë fotografi janë ca gra të çuditshme, pëthuaj komike, me sy tepër guximtarë, me një dëshirë të brendshme për tu dukur sa më tepër gra. Në të vërtetë janë burra, gjyshërit e këtyre vajzave, që ecin gati duke rendur dhe nuk dihet se pse zënë e qeshin njëherësh. Pastaj qeshja e tyre prishet nga kuja e një fëmije të rrëzuuar në mesin e «bulevardit». Vajzat mblidhen rreth fëmijës që thërritet sikur t'ikishin prerë kokën. Që nga shtëpia pranë turjet e llahtarisor e ëma, pastaj, kur del në «bulevard», ajo rregullon shaminë: rreth qafës dhe mban shapin.

Ky Rrëmbeci është dyfishuar në tridhjetë vjet, nga 130 shtëpi, arriti në 270. Ashtu si edhe fshatrat fqinje, Rrëmbeci ka një prirje e një dëshirë të përbajtur për ti ngjarë sa më shumë një qyteze të vogël, me rrugët e asfaltuara, me sheshin, «bulevardin», ndërtesarat pëplike, «stadiumin». Ka jetë të shëndetshme fshati, nuk rrënohet, nuk braktiset, si në vise të tjera të botës. Ky mendim të ngroh zemrën. Dhe shifrat në bllokun e kryetarit, të këhillit popullor të Plasës janë mirë: Prodhimi i madh socialist do të sillte doemos edhe pasurimin e jetës. Varet nga njerëzit nëse të dyja këto do të ecin me të njëjtin hap, por ato kurrsesi s'mund të vecohen. Këtu, në Plasë, kanë bërë kujdes për jetën shoqërore, dhe, po të prehesh pak, aty te sheshi i fshatit, në këtë orë të mbrëmjes, fillon të ndiesh gjithnjë e më tepër bukurinë dhe dinjitetin e saj.

Sekretari i byrosë sheh se fushata po ecën mirë, si një mekanizëm i vajosur nga të gjitha anët. Kjo u raportua edhe mbrëmë. Sekretari di se jo çdo gjë ecën siç raportohet në mbledhjet. Disa bëhen, disa mbeten pa bërë, ose bëhen përgjysmë. Por ai i ka parë punët edhe gjatë tri ditëve, duke shkuar në sektorët.

Ai buzëqesh, bën shaka. Nga lëvizjet e pre-ra që bën, duket se ish-mekaniku ende s'e ka harruar tornon. Ajo i ka hyrë në gjak që në djalëri dha aty do t'i mbetet, ndërsa i duhet të përvetësojë në çdo anë ndjesitë dhe sjelljet e bujkut.

«Se nuk ndryshon vetëm mënyra e prodhimit, ndryshon çdo gjë. Dhe më parë duhet të ndryshojë puna e Partisë, të bëhet shkencë, informacioni e kontrolli të vihen në rrugë të reja. Të shihen prirjet, aftësitë, përvoja e secilit komunist, si mund të japë më tepër dhe ku. Dhe ata të janë në ballë, të tejkalojnë normën doemos, të marrin arsim të lartë, 37 përqind të janë në organizmat shkencore. Ashtu si dikur, nuk është e lehtë të jesh komunist në Plasë, kanë ndryshuar vetëm kushtet dhe format...»

Sekretari flet shkurt, qartë e me urtësi, si një mekanik që e di zanatin, dhe ti zë e ndien se po hyn më brenda Plasës, po ecën drejt qendrës prej nga e merr Plasa fuqinë. Po ato që thotë sekretari janë më tepër kujtime të së kaluarës. Kurse ai është më fort i interesuar për të tashmen e të ardhmen. A janë këta kufijtë ku duhet të mbahet Plasa? Mundësitë që hapen përpëra janë pa kufi dhe kjo ka të bëjë me botën e shkencës e me njerëzit.

Ai po rri me kokën mënjanë. Drejtimi ësh-

të nga artet e shkencat më të vjetra, por ajo që kërkohet prej tij dhe byrosë është një drejtim i llojit të ri, që synon vetë ndërgjegjen e njeriut. Nganjëherë nuk kuptohet se ç'ndodh në ndërgjegjen e njeriut dhe ti kërkon më kot si në një mur pa portë. Këtu ka lëndë të mjaftë për tu menduar, për mjetet, për format...

Ka apo s'ka akraballëk në sektorët?

Përpara kësaj pyetjeje sekretari ngre sytë në boshllëk, pak i hutuar, sikur dikush të kishte hedhur lart një send të njojur dhe ky send të mbetej varur në ajër. Mendohet, buzëqesh dhe thotë se ky nuk është më një problem. Pastaj ashtu me kryet lart, me rrudhât në ballë, i mbërthen sytë në xhamin e tryezës, sikur aty të lëvizte diçka e padukshme, e dyshimtë.

«Papritur mund të ndeshesh në një akraballëk!... se ky i ka rrënjet si bari i keq. Atëherë duhet punë pa u lëkundur, të shpjegosh me durim, të qortosh. Po këto bëhen përherë më të rralla...

Po, rrënjet e akraballëkut në fshat janë të vjetra. Dhe aty tek jeton ende, akraballëku ecën si ujërat e nëndheshme, pa zhurmë, pa ngjyrë, pa erë. Mund t'i kalosh pranë e të mos e vësh re, deri në çastin kur ngre krye dhe ta bën të keqen, me atë fytyrën e tij primitive.

Aty te skuadra e Zhulietës, dhe më tej te skuadra e Ramies, që punon buzë lumit, thonë se s'ka akraballëk. E kush e thotë me gojën e tij dhe të ngrejë gishtin akuzues mbi veten?

Por nga mënyra si e thonë këta kooperativistë, me buzëqeshie të hapët, duke të parë ndër sy, si njerëz të liruar aty më parë prej një gripi, nga mënyra si e arsyetojnë këtë mungesë, duhet të krijosh doemos bindjen se ashtu

është, si thonë ata. Thonë se, duke ndarë drejt punën dhe shpërblimin, është më mirë për të gjithë.

Kjo gjë e vjetër dhe e ndërlikuar, akraballëku, vjen e thjeshtohet në këto fjalë për çudi dhe fillon e emocionohesh, si para një zbulimi. Njeriu jep e merr nga çdo anë, përpëlitet, përveten e përfamiljen, përfisin, dhe befas ndalon, i goditur prej një mendimi të njobur prej kohë, por që bëhet i gjallë dhe merr forcë vetëm tani — drejtësia për të gjithë është rruga më e shkurtër për mirëqenien e secilit.

Më duket se në skuadrat s'ka favorizime të asnje lloji, njerëzit ecin drejt, i them sekretatit.

Fytyra e tij rrumbullake merr dritë. Gëzohet që këtë gjë e sheh edhe një i jashtëm. Thotë se njeriu mund ta arrijë këtë duke iu qepur punës. Thotë se kjo arrihet më lehtë kur puna ecën, jep mire. Është gjë e madhe që njerëzit të punojnë vëtë, pa i nxitur, dhe të jenë të drejtë deri në fund. Kjo është fitore e vërtetë, më e madhe se gruri në fushë...

Në Plasë njeriu e ndien veten si mbi një breg prej nga sheh më tepër hapësirë, dikçka që nxit imagjinatën dhe i hap shtigje të tjera mendimit. Ky nuk është një fluturim poetik. Është realiteti i Plasës.

Në rrugën automobilistike Korçë-Bilisht mund edhe të pyesësh veten, ku është pra, kjo Plasa? Vetëm ndonjë tabelë mund të tregojë se je duke kaluar nëpër të. Në pamje të jashtme ajo nuk dallohet prej kooperativave fqinje. Ndryshtimi është brenda, kur hyn aty dhe rri disa ditë.

Aty shehi se Plasa është bërë një shëmbull i madh, me vullnetin dhe fuqinë e saj. Atëherë fillojnë të zgjohen ca anë të shpirtit që nuk i ke njohur më parë, fillon të shohësh ndryshe tokën, njërejt dhe veten tënde! Të bëhet të mendosh se, në kohën që këta njërež pënonin fort për të ndryshuar çdo gjë, ti në njëfarë mënyre paske dremitur dhe habitesh më të drejtë me veten tënde. Dhe për sa i takon asaj pyetjes së fillimit, shkakut të të gjitha pjetjeve, se përsë nuk i bë ndryshimi i madh më parë dhe përsë pikërisht në Plasë, kjo pyetje tani duket naivë, humbet rëndësinë.

Nga viti 1956, kur kjo kooperativë mori flamurin e Këshillit të Ministrave, se arriti një rendiment prej 16 kv grurë për ha, dëri në vitet 80, kur e katërfishoi këtë rendiment dhe shkoi përpara në front, duke marrë titullin e lartë Heroine e Punes Socialiste. Që nga afj. kohë, pra, është bërë luftë në Plasë. Sado të nxitet, bima do kohën e vët të piqet. Po të mos e ndjekësh në çdo hap historinë, zë e bën pyetje që nuk i qëndrojnë arsyes. Koha e Plasës dhe e ekonomive të ngjashme me të është tani. Kjo kohë erdhi si një shëndoshje e vetë tokës në gjithë vendin.

Në bisedën me disa kuadro të rretheve Korçë e Pogradec, në Drilon, më 8 gusht të vitit

1982, shoku Enver Hoxha tha: «Unë personalisht dhe shoku Hysni kemi pasur si qëllim që përvoja e Plasës të zbatohet në të gjithë vendin...»

Në kooperativat c'afërtat dhe larg punojnë përfarërat, përspecializimin e përqendrimin. Plasa nuk është e vetmja ekonomi e rendimenteve të larta. Ajo është një shembull. Në Plasë nuk kursehen të jatin përvojën. E jatin me bujari e gjëzim. Po ndërsa kapen fort pas punës dhe gjëzohen, në sytë e tyre lëviz si shtresë e dytë shqetësimi. A do të mund të qëndrojnë në këtë pozicion në vitet që vijnë? Ç'gjëra të reja do të japë Plasa? Më 1 tetor kooperativa e tipit të lartë të Plasës u bë fermë shtetërore. Kjo ia rrit fuqinë, i jep më tepër siguri. Aty nuk po ndërrohen vetëm tabelat. Po bën rrugë mendimi se tani Plasa është prona e të gjithëve.

Gjethet e plepave dridhen lehta. Fusha bie disa çaste në qetësi të thellë. Të duket se në këtë qetësi mund të dëgjosh edhe lëvizjen e plisit të dheut në arën e punuar. Edhe pak dhe mollët do të lëshojnë fletët. Në degëzat qarkullon mengadalë limfa, në tokën që pret dëborën tërhiqen më thellë insektet. Po nis ai ndryshim që do të bëjë rrugë të nëndheshme e do të shpërthejë në pranverë. Rrotullimi i stinëve do të përhapë gjithnjë më tej përvojën e mirë, që po nxirret nga këto fusha të Plasës, si një vullnet i njerëzve dhe diktat i kohës.

tetor 1983

VËRSHIMI I JETËS

Kur vinin vurgarët në Delvinë ditën e tregut, shpërndaheshin gjithandej, a thua se mbulonin vendin. Ngjanin si njerëz të dalë nga një tunel i errët, krijesa që jetojnë gjysmë në tokë gjysmë në ujë, që vrojtonin me kureshtje tokën e thatë. Rrinin mbi thasët e tyre me ato fytyrat e kyçura, si nga një fyerje e vjetër, që niste nga një pikë e pacaktuar në mesin e ballit e nuk do të shlyhej kurrë. Ajo që shitnin kalonte fshehur, pak oriz ose fasule. Pastaj i shihje të silleshin rrëth dyqaneve, të nguleshin para vitrinave, sikur të mbaheshin më këmbë vetëm nga prania e gjërave të mira në raftet përtej xhamave. Më mirë të mos tra-zoheshe me ta, se ishin mjaft të duruar e të druajtur, por edhe mund të shpërthenin befas, kur u bije më qafë, të zinin të thërritnin fort e të bënин përparrë me sytë e ndezur. Pasdite,

ndërsa qyteti llogariste fitimet dhe humbjet, filloente tërheqja e vurgarëve, nëpër rrugët prej nga kishin ardhur, duke lënë mbrapa të njëjtën pyetje rrëqethëse: si jetonin vallë në atë luginën e tyre të ujit, baltës, lagështirës së përjetshme?

Po i buzëqeshja vetes me këtë kujtim të fëmijërisë, ndërsa kalonim me makinë përmes Finiqit, qendër e kooperativës së bashkuar të tipit të lartë, që përbledh 17 fshatra të Vurgut. Pesëdhjetë kasolle me baltë të Finiqit të vjetër janë zhdukur, si të fshira, prej një stuhie të mirë dhë tanit hapën 'në faqe të kodrës treqind e pesëdhjetë shtëpi të ndërtuara bukur, me kopshte të gjelbëra, me antenat e televizorëve në çati. Më tej ngrihen disa apartamente pesëkatëshe dhe zgjerohet si shëtitore rruga e asfaltuar, me dyqanet në të dyja anët. Afër mbrëmjes, në këtë «bulevard» kalojnë njërejzit, ca më shumë të rinxjtë. Finiqi të ndjell gëzimin, me atë gjallëtinë e tij të një qyteze të vogël.

Në historinë e saj të shkurtër kooperativa ka njojur ulje e ngritje. Po më në fund ajo e gjeti shtratin e vet, si Bistrica, dhe tanë ecën përparrë pa lëkundje. Në dhjetë vjet e këtej prodhimi i drithërave të bukës u rrit 47 për qind. Në dy vjetët e fundit të ardhurat përkrahë pune ërriten 13 për qind. Në 17 fshatrat e kooperativës ka 18 shkolla. Dyqind e pesëdhjetë kuadro të larta, agronomë, mjekë, ushtarakë, kanë dalë nga ish pellgut i Vurgut. Cdo vit ndërtohen 60 shtëpi të reja. Pöpullsia rritet. Lindjet kundrejt vdekjeve ecin, në raportin pesë me një.

Këto shifra i mban të regjistruar pastër kryetari i këshillit populor. Ai ngrët kokën të shohë efektin që bën mbi në ky ekspozim i fuqisë së kooperativës.

* * *

Ku është Vurgu i vjetër? Ai lloji qytetërimi është zhdukur. Të kërkosh Vurgun e vjetër në natyrën, në sendet, në njerëzit, duket po aq e vështirë sa të gjurmosh ilirët. Po diçka gjendet, në sytë e njerëzve, në mendjet e të moshuarve, prej nga mund të shohësh hera-herës; si nëpër një shteg që të çon në mjegullimin e arsyes, duke të dridhur trupin.

Thomai, i zoti i shtëpisë ku po hamë drekë, thotë se në vitet e para, kur ai ishte kryetar kooperative, nuk guxonë t'i hipte kalit, se dilte ndonjë fshatar dhe e mbërhente për freri. Vurgari i ri dridhej prej zemërimit, xhindosej krejt, tek shihte përsëri një njeri në kalë. Njerëzit në kuaj kanë pasë qenë armiku më i keq i vurgarit.

Kur hymë në atë shtëpi, Thomai nuk ishte. E thirri e bija. U duk sikur u zgjerua e u ngroh më tepër dhoma nga prania e këtij burri, me fytyrë e zemër të celur. Tani ai zë i numëron, ish-armiqjtë e vurgarit, në majë të gishterinjve: agai, në kalë, xhandari, uji, hajduti, perçarja, dhe prifti, që nuk i ndahej njeriut nga lindjaderi, tre, vjet pas vdekjes, sa të mbaronin të tretat, të shtatat, të dyzetat, gjashë muajt, viti, të viti i dytë, viti i tretë. Në mbarim të këtij afati prifti, më në fund, e lëshonte të vdekurin.

Nga dritarja e hapur mbi kopsht vjen era e protokalleve në diell. Dhe shtëpia brenda ndrit

prej pastërtisë. Televizor, lavatriçe, frigorifer, səbə e emaluar, qilima tə bukur. Hijet e ish-armiqve tə vurgarit janë si fantazma tə nəntokës.

Thomai tund kokën, thotë:

— Nuk na besojnë. Kur i flasim rinisë nə ndonjë përvjetor u duket sikur u tregojmë pérndonjë botë tjetër. Po këto kanë ngjarë këtu, nə këtë fshat, nə Vurgun tonë. Deri nə vitin 1949 kam jétuar nə një kasolle që e mbaja me hunj, se ma prishte shiu dhe era. Po hajde thuaju këtyre.

— A i beson ti, Lefteri, babait?

Vajza merr flakë, me duart mbi gjunjë, me sytë e kaltër tə qeshur.

— Babai nuk shton kurrë, po... si tə them, ja, rinia mendon: si kanë mundur ta durojnë atë jetë e tə mbeten gjallë?

* * *

Ka një pikë që i thonë «kérthiza» e Vurgut dhe kjo pikë lidhet me emrin e fshatit Pal. Ky fshat nuk éshtë më, filloi tə tretet ngadalë nə ujë dhe ata më kokëfortët u shpërngulën nə vitin 1947. Tani nə territorin e ish-fshatit Pal, ngrihet një kompleks i blegtorisë.

Prej Pali éshtë Ilia Lasku, nëntëdhjetëvjeçar. Fytyrën e ka tə re, sytë gri tə mprehtë, kujtesën tə qartë. Nusja e djalit e kreh, ia rrëgullon jakën e bardhë tə këmishës, plaku qesh bukur, me shpirt, tə bën tə qeshësh bashkë me tə. Plaku nuk di shqip, ngre supet, i duket marrëzi që nuk mësoi shqip nə kohën e vet. Por e tillë ishtejeta.

«Në atë fshat edhe nə fshatrat rrëth e qark

njenëzia jetonin në ujë, dimër verë. Veshja e njeriut ecën sipas nevojës. Në këto fshatra burrat nuk përdornin pantallona, se s'kishin kohë t'i thanin, duke hyrë e dalë nga ujet. Dhe këpucën nuk e njhnin, as opingën, asgjë në këmbë. Gratë vishnin një rrobë të zezë, që i thoshin allaxha. Secili kishte pranë kasolles koritën, një kërcu i gdhendur që shtyhej me hu. Për të arritur Sarandën udhëtohej me koritë, për shkak të thellësisë. Kurse në verilindje, për të shkuar në Delvinë e në mullinjtë e Navaricës, udhëtohej edhe në këmbë, me ujet deri në brez, nëpër «poro», shtigje me bar, që ndërronin sipas ujit, që nuk i gjeje asnëjëherë në të njëjtin drejtim dhe ishin të pabesa. Në Çauš u mbyt nëpër «poro» një nuse e bukur, ditën e dytë të martesës. Pak më tej u mbyt një djalë 26-vjeçar. Nuk shihje quellë në «poro» në asnëjë anë, për shkak të kulprës, shelgut e kashtës. Nga kjo anë e veriperëndimit janë mbytur shumë njerëz, se vërvshonte papritur edhe Bistrica e Vogël, që zbrët nga malet e Dhivrit, tri herë më e tmerrshme se Bistrica e Madhe, sidomos kur ndodheshe jashtë fshatit.»

Nuk i tregon plaku këto. S'mund ta detyroshtë flasë, sado kurthe t'i ngresh. Në shpirtin e tij është formuluar një betim: të mos flasë përtë kaluarën kurrë. Ai buzëqesh me mirësjellje, tek dëgjon të birin të trëgojë, i vërvshon gjaku, rrotullon gotën e rakisë në duart që i dridhen lehtas. Atëherë duken shtrembërimet e rëndë të gishtërinjve të tij, eshtra të ngrira që në ri-ni, kur shkulte prrallet përtë hapur tokë anës kënetës.

Në fshatin Pal plakut i kanë vdekur shtatë fëmijë. Por ai vetë ka qenë një burrë me trup çeliku. Askush nuk bridhte si ai. Nisej në dar-

kë për në Muzinë dhe kthehej në mëngjes. Aspirinën e parë në jetën e tij e piu një muaj më parë. Po s'ishtë punë aspirine, kishtë marrë një pneumoni dhe duhej shtruar në spital.

«Mirë, — tha plaku, — vemi në spitalin e Partisë.» Aty pa shtratin e butë, muret e bardha, thirri të birin dhe i tha në vesh t'i sillte një fotografi të shokut Enver Hoxha.

* * *

Për në fshatin Aliko rruga kalon sipër argjinaturës së Bistricës. Fshatrat e Vurgut janë që të gjitha të lidhura me rrugë automobilistike e me telefon. Bie prapë shi dhe prapë diku shkrep dielli. Në të djathët, majë një kodre të vogël të bleruar, ngrihet lapidar i bonifikimit të Vurgut. Aty, bëhet festa. Në pastë lapidar të ngritur në vendin e tij, ky është njëri prej tyre që, të bëhet të ndalosh t'i puthësh gurin. Më tej shtrihen kodrat e mbjella me treqind mijë rrënje portokalle e ullinj. Nuk më ndahet nga mendja biseda e mbrëmshme me plakun.

«Pemë të tilla nuk njiheshin fare, nuk njihej asnjë lloj pemë», tha plaku mbrëmë.

Ai kishte filluar të fliste befas. U bë shkak një pyetje për sasinë e misrit që merrte kooperativa, 60-70 kv për ha. Plaku e kuptoi, këtë dhe filloi të bisedonte me të birin. Në zërin e plakut ndihej qortimi. Ai dinte se ferma e Vurgut mori 80 kv, kurse Vrina 86 kv. Pse të merrte më pak kooperativa? Nga biseda e tyre e shpejtuar dukej se plaku nuk i pranonte arsyetimet e të birit.

«Sa misér merrnit ju në Pal?» e pyetë unë plakun.

«Tetë kuintalë, e shumta dhjetë. Misri mbillej në qershor dhe kalbej në vjeshtë», lu përgjigj ai.

Pas kësaj ai filloi të fliste pa e kuptuar as vetë, me gjakun në fytyrë, si i zënë nga ethet. I biri dhe nusja e shikonin me shqetësim, se mës po i hipte ethja prapë.

«Pema nuk njihej. Nuk e lejonte beu, se zihej toka e bukës. Që nga kulla e beut vërshtellente plumbi i belxhikut në pragun e kassolles, po të dilte pula, se mund të shante misrin e beut. As gruri nuk njihej fare. Kurse gruri është jetë. Në vitin 1970 vdiq plaku Jani Cili. Ky mbante një kuletë në gjoks. Kujtuan se kishte para, a ndonjë tapi. Ha ha hal Jani mbante në kuletë një dorë grurë, që e përtërinte çdo vit. E donte grurin pranë zemrës, që të bindej se fëmijët do ta kishin përfjetë. Beu nuk lejonte grurë. As shtëpi prej guri. Pale oxhak. Fshatarët ngritën përfterë natën, një ahur prej guri dhe e prishi xhandari në mëngjes. Nuk pranonte beu shtëpi guri, që të mos kishte thëmhele fshatari. As vend vatri nuk jepte beu. Në vitin 1936 fshati Çukë bëfi lutje përmend vend varri, po nuk i dhanë. Dëgjo, vor shok, sado, të flasësh, asgjë s'ke thënë. Jeta ishte turp, vdekje. Ishte xhehenem kjo tokë e bollëkut, ku erdhën gjyshërit tanë dyqind vjet më parë. Sado, të punoje, prapë vdekje ishte. Burdeni nga Çuka kish tri ditë që punonte në arën e përblytur të shpëtonë misrin dhe vdiq kur i quan ushqimin, se hëngri njëherësh.»

Ku janë vallë ato kullat si karakollë të skëterrës? As gjurmë e tyre nuk shihet në fushën e blertë të ndarë në katrorë të bukur.

Shoqëruesi thotë se kullat u zhdukën në koçën e luftës. Vurgarët panë te Páttia shpëtimin,

hynë me shumicë në çetën «Lefter Talo», në batalionin «Pandeli Boçari».

— Pse nuk i mbajtët kullat t'i bënët shkolla e spitale?

— Nuk deshi populli. I fshiu në tërbim e sipër.

* * *

Në sheshin e gjerë të fshatit Aliko, me dyqanet anash, po zbresin nxënësit e shkollës së mesme bujqësore. Kjo shkollë e re, trikatëshe, është ngritur sipër në breg. Në të djathtë është ndërtesa e bukur e spitalit dhe pak më poshtë kompleksi sportiv me tri fusha të pajisura. Nxënësit e bujqësores grumbullohen te libraria, që të blejnë kartolinat e Vtit të Ri. Këta flasin shqip. Kurse ata të fillores, që po shkojnë te kompleksi sportiv, cicërojnë greqisht. Shqip do të mësojnë më pas, në shkollat e mesme e të larta.

Vajzat e shkollës bujqësore janë të sjellshme, me jakat e bardha. Një brez me shtat të lartë, i pashëm, me sy të qeshur krenarë. Duke shikuar në këta sy, tregimet e Thomait në Finiq dhe të plakut Ilia Lasku nga fshati Pal, anulohen krejt, duken si *ëndra* të ardhura nga një botë e gjumit plot ankth. Por ajo botë ka ekzistuar jo më larg, po dyzet vjet të shkuara. Dëshmitë mund t'i gjesh më dendur nga sa kujton në fillim, po që se ngul këmbë për të gjetur anën e atrimit.

Vangjeli nga fshati Aliko ka qenë traktorist i «lordit».

Ky «lordi» duhet të ketë qenë i pari kolonizator italian në Shqipëri. Se nga mbiu në

fshatin Aliko në vitin 1916 dhe nisi menjëherë ndërtimet. Ngriti pallate, central elektrik, motopompë, solli makineri bujqësore, bëri vreshta. Sikur të kishte zbritur prej hënëzës, vurgarët nuk do të qenë habitur më tepër me të. Dhe ishte i gjatë, tuhof, nuk fliste me gojë. Pas një viti rruga për në pallatin e tij u mbyll. I vinin miq të huaj, gjuante rosa pa hesap. I merrte nga një pupël secilës dhe i groposte.

Nga ato që bënte ky «lordi», mund të thoshe se ishte i lajthitur, por ama punën e çifligut të tij e dinte. Nuk u lejonte asnje bujqësi fshatarëve. Duhej të punonin tek ai për copën e bukës. Atëherë fshatarët zunë të shkonin në Pal e gjetkë, me mëditje tek agallarët vendas. «Lordi» qeshi. E dinte se nuk do të gienin më mirë nga ai krah. Në vitin 1936 fshatarët u mblodhën dhe bënë «dhipolloqe» në vendin e quajtur Rahullë, domethënë ledh të dyfishtë për të pritur ujin dhe futën pendët e qeve. «Lordi» thirri xhandarët nga Saranda me varkat e tij, rrahu fshatarët, i dëboi, prishi ledhët, nuk donte bujqësi në asnje anë, as afër as larg. Të nesërmen zbritën gratë në Rahullë dhe rrahen për vdekje me shata italianin e «lordin». Po «lordi» ishte tuhof, qeshi me gratë, i ngacmoi, tha se i pëlqenin femrat guximtare. Megjithatë prapë solli xhandarët.

Ky «lordi» ishte **napolitani Luka Mimbeli** dhe emri i tij mbeti si i shkruar me zjarr në mendjet e fshatarëve. Kur erdhi koha, me zjarr ia zhdukën kujtimin. Asnjë gur nuk gjendet në brigjet ku ishin sarajet e tij.

— Ama, ti, si traktorist i «lordin», ke jetuar më mirë, — i them Vangjelit.

Gishterinjtë e ish-traktoristit kanë të njëjtat shtrembërimë të tmerrshme të gishterinjve

të plakut, Ilia, Vangjeli hedh trupin lart, me sytë e fiksuar të njeriut që shikon gjarprin;

— Dëgjo, shok, cilido qofsh. Këtu ka qenë tmerri. Nuk tregohet. Dilja prej ujit dhe flija në baltë, me derrin. Kandil ndizte ndonjëri sa për të ngërënë darkë. Po të shumtët bënin dritë me shkarpa. Kur hynte uji, ngjiteshim në trarë. Kur frynte, duhej ta mbaje kasollen me hunj, si varkën në mes të detit. Njëzet e pesë vjet nuk pashë një herë babanë me pantallona. Gjithnjë me brekë të gjata. Turpi dhe varfëria na kishin hyrë në mushkëri. Dëgjo, shok, më mirë e lëmë këtë bisedë. Sa për «lordin», ai ishte shpirtqen, siç mund të jetë, vetëm një i qmendur.

Rreth maleve të buta ngjyrë ulliri, që mbajnë erë kule sfake e trëndeline, sillen re të shpejta. Shiu shpërthen nga pikë të ndryshme të quillit. Diku hapet një fashë e madhe dritë që lëshohet mbi tokë si shtëllungë e lartë, ndriçohet ndonjë fshat.

Në fushën dhe kódrat e lugines ka vërvshuarjeta. Përmes reve kalimtarë ajo duket si një se rrë e hapët, e punuar në çdo anë me kujdes e dashuri, dhe shkëlqen në ngjyra. Tej, në kódrat afër Sarandës, ngrihet si një qytezë, e kuqe, Gjashta, qendra e ndërmarrjes bujqësore, që zë 1800 hektarë tokë të Vurgut, me parcelat e drithit të rendimenteve të larta, me komplekset e bardha të qingjaye, me perimoret, ullishtat. Si ka lënë vrullin e saj, në dy hidrocentralet, shket përmes fushës në fshehtësi Bistrica blu. Lart, në burimin e saj, rreth syrit ma-

gjik, është hapur një amfiteatër i madh stacioni i rritjes së peshkut, që parashihet të japë në fund të pesëvjeçarit 8000 kv troftë.

Kjo luginë e ngrohtë dhe e begatë, që i kthen faqen diellit, popullohet nga njerëz që kanë ndër sy një pasion të zjarrtë për të ndërtuar, për të ecur. Prapë i buzëqesh vetes, me ato kujtimet të fëmijërisë për vurgarët. Veçse kësaj here më duket se pashë e dëgjova diçka nga e vërteta rrëqethëse që nuk arrija atëherë ta plotësoja me përfytyrimin dhe them se, në pastë një vend që doli nga gropë e errët në dritë e nё 'ajer (të pastër, nё) këptimin e 'thelle' të fjalës, ky është Vërgu i Delvinës.

BVLV
dhjetor 1983

SHTRUQNI PËR NGRADHËN E VJEDULLIT
DHE NË KËMPSIN TË TËLJAVE SË LUGINËS
PËR VJEDULLIN, NË QËNDRËN E KËPTIMIT TË
FJALËS, NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983.
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,
DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983, NË QËNDRËN E
KËPTIMIT TË FJALËS, VJEDULLI
DHE VJEDULLIT NË DITËN TË 12 DECEMBERIT 1983,

KOHËT QË SHKOJNË, KOHËT QË VIJNE

Lumi i kaltër rrëshqet me fuqi. Tej, te shkëmbinjtë e ndritur, në hapësirën e grykës, qëndron Ura e Dragotit, si një ngrehinë e hollë, e lehtë, e sjellë aty prej erës dhe e ngecur në shkëmb.

— Në kohën e vet kjo urë ka qenë e pa-në Ballkan e një gjatësie të tillë, pa këmbë, — thotë «intendanti».

Dy të tjerët e shikojnë me interesim.

— Po më, — i thotë Kapoja duke buzë-qeshur.

— Kur i hoqën skelat e drunjta nga poshtë, — thotë prapë «intendanti», — inxhinieri shkoi e u mbyll në barakë, mbuloi kokën. Po të mos qëndronte ura, ai mund të vriste veten, ose të çmendej. Po nuk krisi asgjë. Ura qëndroi.

Atëherë inxhinieri gdhendi ato fjalët: «Kjo urë do të qëndrojë sa të jetë ky shkëmb».

Ata të tre shikojnë urën. Fjalët e gdhendura në shkëmb janë një sfidë që i bën kohës një konstruktor mëndjemadh, apo bindja e thellë e një burri në krijesën e yet?

Sidoqoftë njeriu kalon me njëfarë shqetësimi mbi të duke uruar më mendje që të fitojë inxhinieri, sepse vepra e një njeriu është disi vepra e njerëzve gjithë. Deri më sot ura qëndron mirë, e lidhur në të dyja anët, me shkëmbin dhe çeliku i harqeve të saj kthen rrëzët e diellit. Bombat e aeroplanëve dhë predhat e topave sikur kanë kaluar nëpërmjet hargeve të saj duke ia shtuar më fort qëndresën. Ajo i shpëtoi një rrëziku të vërtetë edhe në shtatorin e vitit 1944, kur Komandanti i Përgjithshëm, shoku Enver Hoxha, ndaloi hedhjen e saj në erë, urdhëroi të mbrohej ura me çdo kusht, edhe pse përfaqësuesi jugosllav Stoinici kërcente përpjetë «sikur ta kishte ngrënë grerëza».

Flitet se një nga digat e hidrocentraleve mbi Vjosë do të ndërtohet këtu. Po, të dalë e vërtetë, atëherë «shkëmbi» nuk do të jetë më, ka për të ndryshuar formë, ura do të hiqet duke u përbushur profecia e inxhinerit.

«Intendenti» shikon lumin me përqendrim, në pikën ku merr kthesën, duke vërvshuar me forcë. Pak më poshtë lumi zgjerohet, bie në qetësi, me një thellësi të dyshimtë. Fytyra e intendentit bëhet, si të thuash, e saktë, e prerë, si e skalitur në çdo vijë, në çdo qoshe. Sytë e mëdhenj në trajtë bajameje i bëhen edhe më të errët. Duket sikur kérkon dicka në lumin e thellë, një gjë të gjallë, që do të dalë befas. Po lumi nuk ndryshon, vërsion si me një forcë të njëjtë metalike, me ngjyrën e kaltër të the-

llë. Kápoja i rri në krah me trupin e madh të përkulur, thuajse mban brënda vetes një gëzim e një shaka që mund ta shkarkojë në çdo çast mbi fqinjin. Në sytë i endet ajo buzëqeshja e lehtë, që shkon e vjen nga njérat kohë në tjetër, gjithnjë duke shëtitur mendjen. I treti, Arifi, edhe ky i gjatë e me trupin të drejtë, duket se nuk mendon asgjë, shikon përpara me sytë si të ngjyer në ujin e Vjosës. Veçse pikëzat blu me të cilat u spërkat përgjithnjë fytyra e tij e pashme, prej asaj bombës gjatë sulmit në Labinot, sikur ndizen nga brendë. Është e vëmja shenjë që tregon se tanit ka emocione të forta.

— E mban mend kur ra Ismaili te trapi dhe humbi në Vjosë pa gjurmë? — thotë «intendanti». Fytyra e tij është zbardhur.

Për disa çaste rrinë të tre në heshtje.

Kapoja hap sytë. S'e kishte dëgjuar «intendantin» kurrë të fliste duke murmuritur, me atë dridhje në zë, dhe as një fytyrë të tillë s'ia kishte parë, në asnje rast.

— Aty kemi qenë, — thotë Kapoja. — Hajde të shkojmë, se tam do të zësh të tregosh sa herë je kredhur në këtë lumi.

Ata ecën në mes të «brigadës». Ndërsa po hynin në urën e qytetit, «Intendanti» ndalon hapin, sikur të provojë urën.

— Çpate? Mos të ka rënë këtu ndonjë mushkë? — e pyeti Kapoja.

Dikur kjo ishte një pasarelë, që tundej e shkundëj dhe kuajt egërsoheshin, nuk donin të kalonin. Përgjigjja e intendantit humbet në bro-

horinë që ngrihet nga të dyja anët e rrugës. Më tej, qyteti i njohur, bujar e i pastër, i Përmjetit është si i rënduar nga njerëzit, që duartrokitnin «brigadën». Mbi ta bien reflekset e flamurëve të kuq, gjëzimi rrëshqet në pllakat e rrugëve, «brigada» kalon si nëpër një tunel të hapët, të nxeh të.

Në mbrëmje, në sheshin e madh, fillojnë e rrallohen njerëzit. Një pjesë shkojnë në koncert. Të tjerët nisen nëpër shtëpi, secili me partizanin e vet, me mikun e vjetër. «Intendantë» sillët rrotull një copë herë, pastaj tërhiqet si më marifet; zhduket, siç ka bërë çdo përvjetor. Ku shkon ai ta kalojë natën?

Ai është një burrë i çiltër dhe në çdo punë do ta gjesh gjithnjë për mirë. Nuk është në natyrën e tij të rrëshqasë fshehur në rrugica. Në të vërtetë s'ka asgjë për të zbuluar në këtë «térheqje» të tij. Shkon për darkë te «ev-gjiti», te familija e një ish-hamalli që ka vdekur, që e pati ndihmuar në një rast intendentin në kohën e luftës. Dhe pastaj kujtimet për të njëjtin hamall kanë të bëjnë më një «ashik», që u hodh në Vjosë e u mbyt, si kishte pirë aty në breg një shishe konjak.

* * *

Lumi rrëshqet si në fshehtësi, por aty në kthesë pikojnë mbi të dritat e qytetit dhe më tej këto drita zgjaten në fasha lëpijnë lumin në një përpjekje për të mposhtur errësirën. Që nga salla hëpet mbi lumë e në lugine zëri i Mentor Xhémalit, që këndon në skenën e sallës së koncertit. E kush mund të këndoje sonte më mirë se ai, ish-partizani i Brigadës VI S? Du-

artrokitje të nxehtha për Mentorin. «Na nderoi, qerratai!» «Hallall bukën e brigadës!»

Zë e kumbon gërneta e Laverit, thotë fjalë, dhe aty në sallë disa zgjatin qafën, se qysh është e mundur të flasë vegla si njeri:

*Rri mendoj për Shqipërinë,
Syt' e mi me lot janë mbushur,
Në kurbet humba rininë.*

Pastaj duket se del në skenë ajo vajza, Adriana, me siguri ajo do të jetë. «Aman, o moj faqe bardha», lutet me një zë që del nga fundi i shpirtit, të rrëqeth e të pushton, sikur të hyn në trup një lëng i nxehtë.

Në anën tjetër të luginës llamburisin, fshatrat, si një qëndisje në qiellin e ulët. Bujq e blegtorë të mirë që po dalin në vendet e para ka kjo luginë. Ky popull di edhe shtigjet e fshehta të këngës dhe qysh t'ia nxjerrë forcën e madhe. Dhe gjuha e tij, e qartë, e butë, është e njëjta gjuhë e Naimit. Po të besosh në shpirrat, mund të thuash se sonte ata, tre vëlle-zërit nga Frashëri enden në shpatet e maleve që ngrihen egërsisht në qiell, si edhe buzë lumit, duke shikuar horizontet e rëja të panjohura të luginës. Mbështetje hyjnë edhe si bujtës në vatrat përmetare, për aq sa mund të jetë bujtës një hije e dashur e mirë.

* * *

Është koha të shkoj për darkë te Vitore Gjergji, njëqind e katër vjeçë. Në shtëpinë e saj në Odriçan ka ndenjur pesë muaj shoku Enver. Plaka tanë nuk sheh dhe i është rënduar dëgji-

mi. Po shqisat e tjera i ka në rregull. Rri ndenjur në kanape, me fytyrën e pastër të qetë, ngre kokën dhe pyet, «ku është partizani?». Zë e fërkon ngadalë dorën e partizanit me duart e saj të buta, e heton dorën, e shtyp lehtë me gishtërinj. «Unë të njoh të kujtoj, kujtomë edhe ti, hë, të keqen, më ndihmo mua plakën ta shoh prapë atë kohë», thoshin me të butë, me përgjërim duart e saj. A thua me të vërtetë plaka di ta dallojë me anë të duarve dorën e një ish-partizani? Thonë se, kur humbet njëra shqisë, shqisa tjetër bëhet më e fortë. Ish-partizanit i rrëqethet trupi, tek rri i kërrusur para plakës. I bëhet se po prek duart e nënës së tij që s'është më. Aq e fortë dhe e qartë bëhet kjo ndjenjë, sa ai shikon me habi duart e tij dhe të plakës, duar që kanë zënë të flasin.

Pastaj plaka kthehet në atë dremitjen e gjatë ndenjur, e tërhequr në një si botë të largët, hyrjen e se cilës më kot do ta kërkosh. Ndërmjet plakës dhe njerëzve është ngritur një mur i padukshëm, pa portë, njerëzit e ndiejnë këtë dhe buzëqeshin me keqardhje, me njëfarë hutimi. Po befas plaka gjallërohet, pyet «ku është djali?». Ky është një fëmijë motak, stërnipi më i fundit. Për një çikë plaka do të pyesë prapë pér këtë djalë, që s'e ka parë, që e njeh vetëm me të prékur. Për të pyet tërë kohën. Kjo lidhje e tretë dhe e fundit më jetën e nxit mendjen e saj më fort se çdo gjë tjetër.

Në dhomën plot drithë shkëlqejnë fytyrat e të zotëve të shtëpisë. Ata ndenjën në heshtje, sa kohë nëna e madhe mbante dorën e «partizanit», që ajo të kryente punë me zemrën e saj. Po tani erdhi koha të njihen edhe ata me mikun. Burri buzëqesh plot vëmendje, merr xhezven ta bëjë kafen vetë. Gruaja, me trupin e bëshëm,

ka harenë në fytyrë. Ndofta vuan nga tensioni, po sonte e ka harruar këtë gjë. Edhe pak e do të ngrejë gotën dhe duket sikur do të gati-të këmbët për valle. Të dyja çupat dhe nusja duken pak më të druajtura, po me premtimin se do të çelen më pas. Këtu sundon me fuqi të plotë ajri i mikpritjes, që lajmërohet me gotën e parë të rakisë dhe më ato reçëlet e shumta e të dëgjuara të Përmetit.

Po kështu e ndiejnë veten një mijë e teteqind ish-partizanët e brigadës, në këtë orë të mbrëmjes, në çdo shtëpi përmetare. Dollinë e parë për Partinë dhe shokun Enver. Ja tek hyjnë në dhomë ata të kronikës së televizionit. Më hipën dëshira të ngre gotën, t'u them vajzaye në Tiranë se kam dalë prapë partizan, sipas mundësive të moshës, me tryezën plot, sipas kushteve të reja. Vërtet, kushedi si e përfyrojnë vajzat, kushedi si e mendojnë ata djemtë e çupat që kanë ardhus në Përmet në këmbë të étérve të tyre. Mbështetje s'paskan hequr dhe aq keq baballarët në janar të vitit 1944.

Lufta rrrokuillisej në faqe të dheut me gjëmim. Dukej sikur prapa maleve, shpërtihente një vullkan, më tej hapej një humnerë, çdo gjë ishte në rrotullim e në lëvizje, koha kur njeriu mezi arrin të mendojë. Kështu duket lufta nga larg. Po, kur vjen afër, njeriut fillon t'i lëvrijë gjaku më shpejt.

«Ata ia bëhen nga Qafa e Kicokut nga njëri krah dhe nga Tri Urat në krahun tjetër. Nën helmetat e ulurë të murrme u ndriçonin sytë me një lakmi të egër të ftohtë. Me asgjë njerëzore s'mund të merreshe vesh me ta, me asnjë gjuhë,

veçse me anë të plumbit. Prej tyre mund të pritje vetëm vdekjen. Kërkonin qytetin e Përmetit, ta digjinin prapë, dhe brigadën të gjallë.»

«Atëherë batalionet u ngjitën në male, në dëborë e në acar, duke lënë të paprekur në so-fër drekën e formimit të brigdës dhe e ndalën me zjarr armikun. Yt atë atë ditë ecte zbathur, ishte i uritur e i egërsuar. Merrte frymë me mjekrën shtrembër kur arriti në bregun Karshi Kuqarit. Që atë ditë nuk e pashë më. Diku aty rrotull iu bë varrimi i parë. Ta them copë, ishin varre të bëra shpejt e shpejt, me thellësi të dyshimtë, sipas nevojave të luftës... Ranë shumë shokë si ai, por armiku u ndal, u tërhoq populli i Përmetit, erdhë që nga majat e Dhëmbelit spitali partizan, punëtoria e prapavijës, dhe kaluan aty te pasarela, duke thyer brigada rrethimin...»

* * *

Ata të tre, me Kapon në mes, shtrijnë duart ngadalë në vijat e pantallonave, ushtarët e vjetër.

Lexohet që nga tribuna përshëndetja e shokut Enver. Kapoja zgjat qafën, si për të dëgjuar vetë zërin e njojur, të ngrohtë e të thellë të Komandantit të Përgjithshëm.

Komandanti i thotë brigadës, luftën e keni bëre mirë. Keni qenë trima, nuk i jeni kursyer mundimit, ju dhe ata që ranë, më të mirët... titullin brigadë heroinë e keni merituar...

Fjalët i futen në shpirt secilit me ndjenjën e qartë se Komandanti po thotë atë që duan të gjithë, duke i bërë pjesën e vet secilit partizan, trimave që nuk e peshuan vdekjen, si dhe atyre

që u shkuan pas. «Intendanti», zbardhet, i njo-men sytë, për shokët dhe për veten. Në fytyrën e bukur të Arifit zënë e skuqen pikëzat blu. Komandanti i Përgjithshëm përmend heronjtë, komandantin lab Jaho Gjoliku, Mustafa Matohitin e zjarrtë, komisarin e shquar, shokun Haki Toska, Faton dhe Persefonin, pionierin Çelo Sianani. Fare mirë. Këta e përfaqësojnë denjësisht brigadën në sytë e popullit, të 203 të rënët. Dhe, nga këta partizanë që ndodhen sot aty rrrotull sheshit, në çdo tre veta dy e kanë provuar plumbin. Plumb të madh ka ngrënë brigada dhe tanë rri gatitu, rrëth sheshit nuk lëviz asgjë, shpirti i brigadës zë ë brendë në vise të largëta, në Alpet: kalon Majën e Hekurave, arrin malet e akullta të Suhagorës: pa veshje të mjaftueshme, pa bukë, me fishekët të numëruar, aty ku e drejton zëri i Komandantit. «Sipas fonogramit tuaj, shoku Komandant i Përgjithshëm, datë 29 nëntor 1944, për asgjësimin e armikut në tokat e Jugosllavisë...».

* * *

«Intendanti» fillon të hajë edhe një herë nga-dalë e me kursim drekën që la pa ngrënë 40 vjet më parë. Rakinë nuk e prek. E mbështjell shishen me letër dhe e fut në xhep. Në një raft të mbyllur në shtëpi mban katër «arançatat» e përvjetoreve. Aty ka edhe shallet e kuqe, shënimet, fotografitë, dokumentet, çdo gjë që lidhet me batalionin e me brigadën. Të gjitha këto një ditë do të kalojnë në pronësi të djalit, i cili ka për të ardhur si përfaqësues në përvjetorin...

Të gjithë hanë e pinë në sallë, qeshin. Gjoleka ia merr një këngë, me zërin e fortë e të

bukur, me fytyrën gjithë gaz, si qëmoti. Deri këtu çdo gjë shkon mirë. Por «intendentit» i është kthyer ai ankth i vjetër prej intendantit. I duket sikur në ndonjë anë do të derdhet papritur diçka. Ky merak, që i kthehet sa herë mblidhen njerëz për të ngrënë dhe që nuk i është ndarë kurrë, e bën të sjellë kokën rrëth sallës.

— E kanë marrë racionin të gjithë! — i thierret Kapoja te veshi, tund kokën dhe qesh fort.

— Më trullose, — i thotë «intendantit», duke rrudhur fytyrën si për të kërkuar mëshirë. Pastaj u l Kokën, vazhdon të hajë ngadalë...

Ky Kapoja, që qesh e flet me tre njerëz njëherësh, shamataxhi ka qenë gjithnjë, por i përbajtur, me mend, dhe me ato që thotë e bën, nuk fyeni kurrë. Ta lexon rradaken nga brenda duke të parë në sy. Ama, kohët e fundit është zbehur, për të mos thënë i është zbardhur lëkura. Megjithatë nuk ankohet nga ndonjë sëmundje. Kurse Arifi, në krahun tjetër, skuq prej shëndetit. Është i sjellë, i qetë, mirënjoës për çdo shërbim të vogël. Dhe tani që ha, e imban trupin drejt. Ky ka shkuar bari që dhjetë vjeç. Mezi e drejtonte tufën në male, me anë të qenit. Kur pushonte, e lidhte bejkën, me terkuzë në belin e tij, që të zgjohet po të lëviznin dhentë të qethura përgjysmë. Me gjithë jetën që ka bërë, prapë lëstar e ka trupin. Trim i patundur ka qenë. Vec të mos vërë më tepërt bark. Po pse i ndizen prapë ato pikë blu në ftyrë, ridërsa qesh me dikë?

Në sallat e mëdha të ushtrisë, ku ha drekën «brigada» ngrihet edhe më lart hareja. Qeshin e gëzojnë shokët me kokat bardhoshe. Dhe kame-

rieret me veshjet akull, janë aq tē pērzmērta e tē gatshme, sa tē mblidhet lēmshi nē grykë. Nuk ndodh kurrē tē tē shérbejnë kështu, sikur porsa je kthyer nga lufta duke bërë tym një armik tē keq, duke shpëtuar qytetin.

Kalon me nxitim një anëtar i komisionit, me dosjen nën sqetull. Tërë kohën është i shqetësuar, sikur mbi kokën dhe supet e tij tē ketë rënë qeverisja e brigadës.

— Po kv, a iu shoftë? Sikur ky e ka bërë brigadën! — thotë Arifi, si duke folur me vete. Pastaj vijon tē hajë, duke menduar se kështu ndodh kur mbidhen njerëz. Do tē dalë ndoniéri që tē hicoet sikur vetëm ai dhe disa tē tierë kanë qenë e janë. Pò ç'rëndësi ka kjo? Rëndësi ka vëtëm një gië: tē dijë njeriu se nē kohën e tij bëri atë që mundi.

«Intendenti» ndiek lëviziet e kokave tē gëzuarë bardhoshe. Dikush kollet, dikush cohet befas pér një dölli. Koha vien e shkon si batica e zbatica e detit, duke siellë ndryshimin. Po sikur ta shohësh nga afër, sikur tē përhapet kjo miegull e lehtë e mallëngjimit, dalin nē shesh ato fytyrat e para tē shokëve, si prei një guaske që i mbari tē mbyllura. Këtë përtëritie ai e do medemos, e do niëzetedyvjeçare brigadën, s'mund ta përfytyrojë ndryshe, pa ndier një dhembje nē gjoks. Endrrat e kanë tē vështirë tē vdesin, ato tē bëjnë ta jetosh tē kaluarën nē tē tashmen. Por ja, që koha s'mund tē këmbehет a tē blihet vecse me jetën. Ah, ja, prapë shkon dikush, ta tokë gotën nē presidium. I skuq fytyra flakë, i merren këmbët lehtas. Të ngrin zemra. A do tē arrijë nē rregull dhe tē thotë ato dy fjalë?

— Mos ia ki frikën, është kockë e vjetër,
— i thërret prapë Kapoja «intendentit» te v-

shi. Intendentë pret me grushtet mbledhur mbi tryezë, me eshtrat e fytyrës të dala.

Dikur këta, me një fjalë të Partisë i ngjiteshën Dhëmbelit me dy metra dëborë, hynin në Vjosën e turbullt dy herë brenda një nate dhe e zinin për gryke armikun: kur ecnin, dukej sikur as që shkelnin në tokë. Po ja, që tanë dikujt mund t'i merren këmbët edhe me një «arancatë».

Djali i Dalipit, inxhinier në ushtri, fëmëzeshkët, i fortë është i qeshur, di ta nxisë bisedën më një frazë si të thënë rastësisht: «Eshtë nga ata që të hyjnë në Zemër ngadalë dhe mbeten aty. Djali i Dalipit bën dhe humor. Imiton të atin që nuk erdhi nje festë, i thotë një shokut të tij: «E sheh atë qafën aty? E mban mend kur i zure dorën gjermanit dhe më shpëtove jetën?»

Këta janë djemi t'i pişti në gotë. Të bëhet qejfi tek i shëh të ecin të përqafuar, djali i xha Reufit me dialin e Novruzit. Deri aty më parë as që njiheshin, po kanë qenë shokë baba-llarët.

Po, të mbeten sytë dhe rri gjatë më këmbë tek sheh një brez edhe më të ri, ca djem e vajza 15-vjeçare. Këta janë më të druriat, rrotullojnë ngadalë sytë e bukur mbi njërezit përsëndet përfshirë që nuk arrinë ta kasikur të pyesnin përfshirë që nuk arrinë ta ka-pin dhe që këta të bëjnë me vetë thelbine gjërat e. Duhet kujdes më këta, nipay, që dë dë tenvijave. Duhet kujdes më këta, nipay, që dë dë tenvijave. Duhet kujdes më këta, nipay, që dë dë tenvijave. Duhet kujdes më këta, nipay, që dë dë tenvijave.

të dy atje, më duket janë nipat e xha Jahos. Kanë pasur nënën partizanë, por edhe gjyshin. Si ka qenë nëna në moshën 16-vjeçare, mund edhe ta përfytyrojmë, se e kanë pranë. Po si ka qenë gjyshi?

Atyre koha e gjyshit u duket aq e largët, sa edhe «intendentit» kohë e Tafil Buzit. Kohët zë-në e trazohen në sytë e «intendentit». Do t'u afrohet atyre nipave të pashëm, t'u thotë se gjyshi ashtu ka qenë, si Tafili, po më gjaknxehtë, me më tepër zemër. Se gjyshi i kishte të katur fëmijët partizanë dhe donte të merrte në brigadë edhe qentë e fshatit, që t'ia lëshonte armikut. Partia i vinte gjyshit dorën në sup, që të përmbahej, nuk i ndahej shoku Haki Toska, sidomos kur iu vranë të dy djemtë. Dhe gjyshi përmbahej, mësonte hapin e Partisë, drejtonte luftën. Ekte rrëth brigadës me hapin e rëndë e me armët e rënda, duke ruajtur batalionet sikur t'i kishte tufa me fëmijë. Por, kur ndodhej para armikut, i thoshte borizanit t'i binte. Dhe binte boria me alarm, sikur të merrte toka zjarr dhe kishte raste kur gjyshi i vinte gjoksin mitralozit armik, si në Dukaj, në Mavrovë, në malet e larta të Bosnjës... E megjithatë plumbi nuk e prekte gjyshin...

Edhe pak e do të nisen autobusët për rrugën e kthimit. Aty më tej Abdyl Hakiu, Hero i Populli, «skifteri», siç i thërritnin në kohë të ilegalitetit, bisëdon me gazetarin. Flet e buzëqesh si me dhembje. Paskan shkruar një artikull se në Kurvelesh një njeri nuk e pranoi në shtëpi Mustafa Matohitin. Dhe Mustafai qenka gdhirë

te streha në dëborë. Nga kjo gjë, i zoti i shtëpisë qenka prekur e bindur, dhe u bë me luftën. «Gjepura, as labi s'ka qenë i tillë, as Mustafai», thotë Abdyli. «Këto mund të kenë ndodhur gjetiu. Po s'kanë faj të rinjtë që i shkruajnë, faji është yni, që i tregojmë».

Çfarë është pjellë e fantazisë dhe çfarë është e vërtetë? Si duhet bërë që ata nipat e xha Jahos ta shohin gjyshin të gjallë, duke komanduar brigadën?

Janë mundësitë që të shkruhet vetëm e vërteta, sikundër është shkruar, me përjashtim atykëtu. Lidhja e kohëve, marrëveshja e plotë e brezave mund të arrihet edhe në art, siç ndodh në jetë, vetëm në kushtet tonë. Veç duhet shpejtuar, sa janë burimet të gjalla, dhe si art duhet ngritur gjithnjë më lart...

* * *

Në rrugë gjëmojnë autobusët me flamurë, një varg i gjatë që të jep vendjenjë e forcës. — — — Armatë ka qenë, e shkreta, — — — thotë Arifi, — — — dhe armatë mbetet prapë.

janar 1984

1000 i tash e llog përgjigjet e përgjithshme që
 ndryshe është që shtypet e njohur që
 kthehet e llogarit e përgjithshme që
 shumë e llogarit e përgjithshme që
 nuk mund të
 mëngjesit i përgjithshme që
 ndryshe që
 është që
KAPITENI
 1000 i tash e llog përgjithshme që
 nuk mund të

Në orën 6 të mëngjesit dielli ishte si një
 hënë e kuqe me ndrigim të dobët. Pastaj mjegulla u përhap. Mbi detin fare të qetë u shtua drita. Anija linte prapa një rrnymë, sikur të rridhte Valbona në një fushë të kaltër. Rreth e qark sundonte hapësira ujore. Dukej sikur zhurma e butë ritmike e motorit të fuqishëm po e
 conte anijen në gjirin e gjithësisë.

«I bukur deti?

«Ehë... mjaft i bukur!»

Prapë u ngrit mjegull. Tani dielli ishte si një reflektor i bardhë, i dalë në krahun tjetër. Nga ky krah u shfaq anija «Naum Thanasi», që rregulloi kursin dhe shpejtësinë për të ecur njëherësh me ne.

Në urën e komandës qëndron vetëm «Xhifrafa», i përkulur në timon, duke rrotulluar kokën

e vogël mbi qafën e gjatë. Ai duhet ta shohë detin në një pamje të kufizuar në dyqind metra, të shohë buçullën dhe aparatin e thellësisë. Në thellësinë 74 metra aparati filloi të jepet shenja, haje të shkëputura prej fundit të detit që ndryshojnë formë. Kalon peshku. Po «Xhirafa» s'mund të vendosë vetë. Duhet të presë kapitenin.

Erdhi kapiten Rifati, pa aparatin e thellësisë, ndezi radarin. Pastaj shkoi në kthinën tjetër dhe thirri në radio: «Thanasi! Thanasi!» «Milaqi, të dëgjoj», u përgjigj një zë i fuqishëm në radio.

Të dy kapitenët këmbyen mendime dhe ranë në ujdi për diçka që do të zhvillohej më pas. Rifati shkoi te pulti dhe pushoi helikën. Anija rrëshqiti lehtas edhe pak dhe ndali krejt. Atëherë «Thanasi» filloi të sillej në krahun tonë të djathtë si një mëz i madh që bresh i lirë në lëndina të qeta, duke bërë rrathë pérherë më të mbyllur. Më në fund u vu ngjitur me ne dhe pushoi.

Kur u hodh e gjithë rrjeta, njëren anë të saj e kapi «Thanasi» dhe ana tjetër na mbeti neve, «Demir Milaqit». Filluan ngadalë lëvizjet e hapjes, të dyja anijet u vunë në largësinë 150 metra dhe ecën përpara në të njëjtin kurs, me shpejtësinë e zbritur në 4.5 milje në orë. Ishin të lidhura nga të dyja anët e rrjetës, e cila zgjatë deri në fundin e detit. Në grykën e saj duhet të hyjë peshku, që do të udhëtojë në tunelin e rrjetës për njëqind metra dhe do të përfundojë te «thesi», prej nga do të dalë vetëm përtu zbrazur në kicin e anijes.

Kapiten Fati është 35 vjeç, me trup mesatar të lidhur, me sy ngjyrëkafë të qeshur, me ballë të lartë, me flokë të dredhur. Punon në det prej 17 vjetësh. Në ndërmarrje thonë se është kapiteni më i mirë.

Ai po shënon në defterin e madh gjërat që ka vërejtur në udhëtim, të cilin e ka bërë me qindra herë. Çfarë mund të vërejë ai në një hapësirë uji si pasqyrë drite, ku nuk ndryshon asgjë? «E po, gjëra të zanatit.»

Nga mënyra si përkulet mbi fletore për ato shënimet e shkurtra, me durim e thjeshtësi, duket se ndjek një synim të largët. Kam përshtypjen se ai po mbledh shënimë prej vitesh, në një përpjekje të madhe për të eksploruar detin në çdo pëllimbë.

— Në çfarë bazohet puna juaj? — pyes.

— Në disiplinën. Të gjendet çdo njeri në vendin e vet, në kohën e duhur. Të ndiqet pa lëshim viaj batimetrike. Në njerium.

— Në dimër ndryshon puna, — them unë.

— Në dimër ndërron krejt.

«Kur mblidhen te kici «mullarët» e bardhë dhe derdhen brenda duke të përplasur andej-këndej, peshkatarët zënë e inatosen. Atëherë heqin mushamatë e rrobat, dalin në këmishë e mbathje, trazohen me shkumën, fillon përleshja.»

Ndërsa flet duke të parë me atë shikimin horizontal të detarit, kapiteni e ka mendjen tek ajo që kalon ndërmjet dy anijeve, te gjallesat e detit, që hyjnë në «syrin» e rrjetës dhe ecin të hutuara nëpër tunelin e thurur. Dy orë më pas pamë se thesi kishte mbledhur sardele, nja shtatëdhjetë arka, dhe disa peshq të llojeve të tjera. Nuk ishte keq.

Ecim përpara, gjithnjë në det të qetë vaj, aq sa të pasqyrohen në të retë kalimtare. Deri kur? Drejt Durrësit shkojnë dy anije të huaja, të mëdha, të rënda. Kalojnë shpesh, me flamurë nga kontinentet.

* * *

Pasdite u ngrit maister i lehtë. Në të majtë, fasha e diellit ndjek anijen. Në të djathtë shkumëzon «Thanasi», duke lënë prapa një buzëqeshje të zgjatur.

Kaluan në afërsi një çift anijesh të peshkimit. «Qëllofshi! Të fala shokëve!»

Këtu jemi në ujë blu, si mellani. Prapa anijes lahen delfinët. Kërçejnë lart nga dy, me trupa të zinj të shndritshëm. si në një përqafim njerëzor. «Edhe këta na duheshin», thotë dikush. Peshkatarët as që ngrenë sytë pér t'i parë. Delfini është peshku më i zgjuar e paqësor, po dhëmbët e tij janë të rrezikshëm pér rrjetën.

Rrjeta doli e paprekur. Dha qefull, skumër, sallatorë deti, yje, si edhe një peshk helmues, me turirin e një bulldogu dhe trupin të bukur. Në kurriz ka ato halat e zezë, që të japidhëmbje të paduruara tri ditë me radhë.

Ecim në thelli. Thirri radioja nga qendra. Kjo thirrje erdhi si një litar i zgjatur, i gëzueshëm, që lidh anijen me tokën. Pas informacionit, Fati pyeti pér motin. Nata do të ishte po aq e qetë.

Deti shtrihet tejendanë me shkëlqim, me ngjyra aq të buta, sa të shëmbellejë me një qilim të madh që vjen duke u zbuluar. Duket sikur asnjeri s'ka kaluar më parë në shtigje të tillë, ku të prehet syri me pamje të panjohura.

(62) Skemi pér të parë heronj që pérleshen me elementet e natyrës. Asgjë nuk lëviz, — themi unë.

Fati búzëqesh. I ngjan një otakulli dinak.

«Sepse në det s'mund të parashohësh kurri dhe asgjë. Që të bindesh pér këtë, do kohë. Deti është një shkollë e gjatë, ku asniëherë nuk të lëshojnë dëftesë të plotë. Në një det që duket anembanë i qetë, papritur zë e lëkundet lehtas anija, pastaj më fort. Nga qëfësia deti fillon e kalon në egërsim. Por as egërsimin nuk ia sheh dy herë niellkoj. Askush s'mund të thotë se ka parë të njëjtin det dv herë, vëç në qoftë ky njéri një vrojtues i përciptë.»

Në horizont mund të shquash me dylbi anije të huaja peshkimi. Ka ngjarë që ndonjëra të bjerë ngushtë dhe atëherë dëgjon thirrje, në nevojë si të njeriut të lashtë. Po diku kalojnë edhe afër Hapin sytë mbi peshkatarët tanë, zotër të anijeve të fuqishme e moderne. E kanë vëshfisë të kuptojnë sidomos këtë gjë: pronësinë mbi anijet e mjetet e punës, ndarjen e vlerës së prodhimit.

— Tu nuk e nisi, — i përgjigjet asgjë, — op!

— Tu nuk e nisi, — i përgjigjet asgjë, — op! — usAnija, thotë: «Më truaj prej tokës, të të riuqaj prej detit».

Me këtë thënje të detarëve të vjetër në mendje kapiteni po e con anijen nëpër një zonë me shkëmbitë nëhujorë. Pa duhet të truaië edhe frijetëm që kushton shtrerijtë, brej anijeve të mbitura, prej trungjeve, bâtillave, bimëve të gjata detarët e mblidhen si bllok. Se njëherë në kohë stuhie, mbeti në det rrjeta e gjithës

dhe ekuipazhi nuk fjeti 24 orë. E mblođhi të nesërmen të paprekur.

Të dyja anijet lundrojnë pranë me kujdes, «Thanasi» del e hyn, zhduket në miegull me kreshtën ngjyrë hiri të çelët, sikur të jetë bë-rë prej ajri. Pamja kufizohet në pesëdhjetë metra. Veç radarit, u vu në punë edhe kambana në bashin e anijes. Çunat bëjnë secili një punë. Njëri lan kuvertën, një tjetër stivon arkat në heshtje. Kjo miegull e ngjeshur, që kalon rrëshqitas, ndielli në sytë e tvre shëtësimin më fort se dallgët dhe stuhia. Kjo është munge-sa e qartësisë, që ushtron një shtypje të mundi-mshme mbi njeriun.

Miri i bie kambanës me goditie të ndara, kërkon rrugë të lirë. Fytyra e qeshur, me flokët e verdhë, me mollëzat të dala, i është bë-rë edhe më e imët. Raqi stivon arkat, drejton trupin e fugishëm dhe kërkon me sy në miegull, por asgjë s'mund të shikojë dhe zë e merr frymë thellë. Ky ka qenë i prapë në tokë, po në det erdhi e u bë i druajtur si cupë, punëtor. Tani në svetë blu ka nië ankth për anijen, që kridhet më thellë në miegull. Secili nga këta cuna, oë lëvizin në heshtje dhe mbajnë vesh, ka nië të kaluar dhe të tashme krejt të vetën. Po të gjitha këto treten në miegullën e hirtë dhe në shesh mbetet vetëm ania, që can ngadalë pënpura me bashin e mprehtë, me kuidesin e nië kafshe të vyllit oë di se një çark i fshehtë mund të shkrehet papritur.

Më tei miegulla bëhet më e ngjeshur. Hapat e njerëzve në kuvertë, zhurmat e niohura, tinguit metalikë i dëgjon vetëm nië cast. Të duket se ke mbetur i vetëm në botë, se edhe trupi yt po tretet në miegull... ndërsa ndien nië shtrëngim në fyt. Pastaj sheh befas, fare pranë,

fytyrën e një peshkatari, me një qartësi të tillë, sa t'i dallosh edhe porret e lëkurës. Kjo fytyrë qesh, shtrembërohet pa arritur të fshehë shqetësimin, por ama është një fytyrë miku nga ata që nuk të lënë në baltë.

«I bukur deti?»

«Ehë... mjaft i bukur!»

Mjegulla sajon përcakohë mbi det gjithfarë figurash. Pastaj zhdukjet nëpër rrugë të fshehta, si e thithur prej qiellit. Peshkatarët shkojnë të hanë mëngjesin dhe të nisin punën me brigadier Lleshin. Ky është një burrë i fuqishëm, me trupin e qllartë, i vetmi në anijen «Demir Milaqi» me pamjen klasike të detarit.

2

Po ëndërroja në kabinë një thes me 20 kuintalë peshk të ndritur si argjend, kur dëgjova nga një zë që thërriste «Thanasi... Thanasi... Thanasi...» Në të njëjtën kohë ky zë ndillte gjumë, niste me forcë dhe mbaronte duke u shuar, si një murmurimë. Kapiteni i anijes po kërkonte në radio «Thanasin». Si duket, ai tjetri kishte myllur radion, diçka që pothuaj nuk ngjante kurrë, ose ekuipazhi kishte zbritur poshtë, duke lënë vetëm urën e komandës, diçka që gjithashtu ndodhë rrallë. «Thanasi, more... Thanasi... Thanasi!...»

Fillova të ndiej shqetësim. Përse nuk përgjigjej «Thanasi»? Befas buçiti zëri i tij: «Milaqi! Ju dëgjon Thanasi, ju dëgjon.»

Kishte ngjarë një defekt në vinçin e «Thanasit», që po riparohej. Kapitenët e biseduan punën në radio, ndërsa dy anijet ecnin me një koordinim të heshtur e të plotë të lëvizjeve, si një çift në vallëzim. Kështu vazhduan edhe një gjysmë

ore. Aparati i thellësisë nuk shënonte lëvizje mbi fundin e detit. Atëherë «Milaqi» propozoi ta «mbyllnin». «Thanasi» pranoi. Ai zuri të bënte në krahun tonë të djathtë lëvizjet e njohura, si një kalë deti, afrohej e largohej, gjithnjë më pranë, sikur na merrte erë. Më në fund lëshoi disa goditje të motorit, tamam si hingëllitje të rënda, dhe ndenji urtë e butë bri nesh, duke na hedhur «cimat».

Ne kërcyem në kicin e «Thanasit» për të parë ngritjen e rrjetës, atë që do të jepte deti. Kapiten Meti rrinte me trupin e përkulur, me fytyrën flakë, mbi dy peshkatarë të rinj, tetëmbëdhjetëvjeçarë. Për një pakujdesi të tyre kishte ngjarë një ngatërrim në kavot e rrjetës, në anën që tërhiqte «Thanasi», dhe nga kjo gjë mund të ishte mbyllur «syri», gryka e rrjetës, duke çuar dëm për dy orë mundin e anijeve. Të dy peshkatarët rrinin kokulur, të zbehtë, pa zë, ndërsa kapiteni i tyre vijonte të merrte fryshtë thellë, edhe ky pa hapur gojë. Më në fund u kthye dhe ndenji më tej, priti të shihte atë që pritej, rrjetën boshe, të cilën tetë peshkatarë, të vënë në radhë, po e tërhiqni me lehtësi, si njerëz që bëjnë lëvizje të kota me krahët. Po «thesi» kishte diçka, nja dhjetë arka me peshk, një të gjashtën e asaj që kishin dhënë rrjetat e para.

Kapiten Meti i anijes «Naum Thanasi» vazhdoi ta ndiente peshën e «gabimit» edhe në mbrëmje, duke përbajtur inatin. Është 26 vjeç, ka mbaruar shkollën e lartë të marinës «Hysni Kapo», i pashëm, me trup atleti, me lëvizjet

ë përpikta të një ushtaraku. Në kohën e pushimit i propozova të loznim shah. Pranoi përmirësjellje.

«Lepuri», njëri nga djemtë që ngatërruan kavon, kë zakonin të shfaqet papritur në pikë të ndryshme të anijes, i zhvëshur nga mesi e lart, me fytyrën e imjet, me flokët e pakrehur mbi ballë. Mendova se do të ishte struktur diku, në pritje të kohës kur qortimi i heshtur i kapitenit do të kthehej në fjalë; ndofta në mblehdhjen e 'ekuipazhit. Por ai u shfaq pas drithareve. Zuri të kërcente andej-këndeja. Lante kuvatern e bëshit me tubin e ujit. «Lepuri», «Xhirafa», «Daci». Këtyre u kanë thirrur aq shumë me nöfka, sa të harrojflë edhe emrat e tyre të vërtete. «Lepuri» vijon të kërcejë me tubin e ujit, ndalet dhe shikon pjerrtas. Kërkon ndëshkimin. Sa më parë, aq më mirë.

«Po të ketë disiplinë... po të shkijnë 'mirë dy kapitenët, shkon mirë gjuetia pelagjike...» Që kur nisi gjüetia «pelagjike», me dy anijet çift në tërheqjen e rrjetës, u tha se plani i zënies së peshkut do të dyfishohej. Të dyja anijet dalin e kthehen në port me ato lëvizjet e gëzuara. Tani në ndërmarrje rrinë në përgjim, presin, shohin shkarkimin e peshkut në mbremje. Eshtë në provë emri i të dyja anijave. Dhe nga ky shkak ekuipazhet rrinë në një shqetësim të vazhduar, sikur të ecin mbi një tel të zgjatur të padukshëm. A do të hyjnë e të dalin përsëri në port të dyja anijet si binjakë të shkathëta e krenare të detit?

— i alo, s'lik, lejohen gabime, s'ka si të lejohen! — «thotë kapiten Meti, duke shtyrë gurët e shahut

Aparati matës shënonte në qoshe, me shifrat e kuqe, që ndërroheshin parreshtur, thellësinë 78-79 metra, ndërsa në ekran ecën si një diagramë vija e zezë, që tregon fundin e detit. Sipër kësaj vije filluan të dukeshin hijet e vogla në trajta të ndryshme, si vizatimet në figurën e një mushkërie të pezmatuar. Këto figura të shkëputura prej fundit të detit ishin krijesa të gjalla, tufa peshqish. Kapiten Fati priti vizatimet e mëtejshme, me sytë të ngulitur, pastaj i thirri «Thanasit» në radio të ndryshonte kursin 5° djathtas.

Dy ditë më parë, kur më shpjeguan mekanizmin e këtij aparati, mendova se ai kishte syrin dhe trurin e njeriut. Mendova se me një aparat të tillë asnë tufë peshqish nuk do të kalonte në hapësirën ndërmjet dy anijeve pa u futur në grykën e rrjetës. Mirëpo aparat i habitshëm nuk tregonte atë që vinte. Tregonte vetëm atë që kalonte nën barkun e anijes. Kjo ishte e meta e tij. Ky aparat zbulonte diçka, po nuk do të vidente pa trurin dhe përvojën e kapitenit.

Lajmi se aparat po shënonte mirë u përhap në anije dhe ndonjë nga peshkatarët ngjitej herë pas here në urën e komandës. Nuk kuptohej si u përhap lajmi, duke ngritur te njerëzit ethet e qeta të gjuetisë. Ndofta për shkak të ndryshimit të kursit. Kapiten Fanti u përgjigjej pyetjeve pa e pasur mendjen. Shikonte kursin në busull, aparatin e thellësisë, ndezi radarin. Kjo gjendje tensioni vazhdoi disa minuta. Pastaj vija e fundit të detit u zgjat në aparat krejt e bardhë, në thellësinë 85-86 metra.

Për disa çaste mbetëm vetëm me Fatin. Tani do të bëja me të bisedën që e conte punën

në fund. Ai e ndjeu këtë, e peshoi me mendje dhe vendosi të fliste. U përgjigj se gjuetia pelagjike ishte e re dhe si e tillë nuk po jepte atë që pritej, po do ta jepte. Veçse nuk duhej besuar që me këtë metodë plani do të dyfishohej si me magji.

— Atëherë, ç'do të bësh? — e pyeta.

Shikimi i tij horizontal, prej detari, kaloi mbi syprinën e ndritur të ujit dhe tha:

— Duhen zbuluar përqendrimet e peshkut, llojet, emigrimet. Sardelja lëviz sipas planktonit, temperaturës së ujit. Janë edhe rrymat që në detin tonë shkojnë nga jugu në veri. Kurse hëna i çon nga lindja në perëndim. Dhe të gjitha këto ndryshojnë sipas stinës e motit... dhe peshku është pa mendime, shkon andej nga e drejton nevoja, i prirë të ecë kundër rrymës. Duhen njojur këto, si edhe plot të fshehta të tjera.

Në sytë e mi deti nuk ishte më një fushë e kaltër, e paanë, ku mund të bredhësh duke kërkuar fatin. Këtu, sa më tepër të ecësh, aq më e vështirë qenka të zgjedhësh vendin prej nga duhet nisur. Ky kapiten i ri, me ballin e lartë të menduar, ndodhet tërë kohën në këtë hall.

— Peshkimi nuk është më fat, po shkencë,
— thotë ai, duke lexuar mendimin tim. — Shkencën duhet ta bëjë kryesisht instituti, por ai ecën ngadalë.

Atëherë kapiteni i drejtohet përvojës së tij. Po njojuritë që ka mbledhur, pikë nga një pikë, prapë nuk i mjaftojnë. Ai duhet të shohë qartë nën sipërfaqen e detit, që në këtë orë të ditës duket krejt i palëvizshëm, si kapaku i një libri të myllur. Kapiteni përkulet edhe më fort mbi ditarët e tij, bën shënimë çdo ditë, çdo orë. Kjo është një përpjekje e madhe, e urtë, e zgja-

tur në vite. Një valë gjaku i kërcen në ftyrë tek thotë se, sikur çdo kapiten të mbante shënimë dhe pastaj këto të përpunoheshin në një zyrë...

* * *

Në thesin e rrjetës që ishte ende nën ujë lëvizte diçka e fuqishme, një delfin ose një peshkaqen. Mund të ishte edhe një breshkë dykuintalëshe, sepse për disa çaste rrinte e tulatur. Po të që breshkë, do të shkonte për ushqim kafshësh, megjithëse disa peshkatarë kanë filluar ta hanë mishin e saj në pjesët e gjoksit, që është si mish dashi.

Në kuvertë kanë dalë të gjithë: motoristi, kuzhinieri, për t'ia hyrë punës te rrjeta. Çikrikët e mëdhenj tërheqin kavot metalike, lëvizjet udhëhiqeshin me gjuhën ndërkombëtare të detit, me shenja që zbatohen shpejt dhe saktë, me një vëmendje të nderë, një rit që përsëritet në çdo kalatë, por që gjithnjë do të sjellë diçka të re. Kur më në fund vinçi ngriti thesin, lëvizjet brenda tij u përhapën nga të gjitha anët. Aty duhej të ishin jo një, po disa peshq të mëdhenj. Erdhi koha e thikës së kapiten Metit. Sa herë tërhiqeje rrjeta dhe, si mbaronte punë me manovrimet, ai gjithnjë zbriste te kici, duke tundur lehtas thikën në dorë.

Bashkë me peshqit e zakonshëm ranë në dysheme disa «gofa» njëzetkilëshe, peshk i cilësisë së parë, në trajtën e qefullit, po me ngjyrën e trëndafilit rreth shpinës. Kjo i gëzoi çunat, ndërsa kapitenët u mbajtën të qetë. Vunë anijet në rrugë.

Tani diellin e kemi në të djathë. Nuk e kup-

tøj se si u gjendëm përsëri afër Durrësit. Në këtë pikë, në janar, Fati nxori atë kalatën e madhe, më të madhen kalatë që mbahet mend në peshkim, 135 kv sardele. Dridhej vinçi, dridhej e gjithë anija, njerëzit mbetën pa gojë, u mbush kici sa të derdhej peshku në det. A mund të përsëritez befasisht një gjë e tillë?! Ngà ky mëndim filloi të më rrihte zemra. Jo, tani jemi në "maj". Duhet të kënaqesh edhe me një kalatë! — kuintalëshe.

Befas anija u shpyt përparrë, prej motorit që gjëmoi nën ujë, valët rrähën brinjët e saj dhe kicin e gjerë, duke krijuar shkumë, ndërsa prapë mbetej gjurma e madhe si një ugar i trazuar që ndante detin në dy pjesë. Një njeri i pamësuar në det gjithnjë shqetësohet nga lëvizjet e beftë. Po s'ka ngjarë asgjë. Po shtojmë shpejtësinë, po çajmë më vrull drejt jugut, në një zonë tjeter gjuetie.

Kalojmë duke gjuajtur anash një batullë, që mund të jetë disa kilometra e gjatë. Mijëra tonë barëra, që lëvizin aty poshtë sipas rrnimave, në një pështjellim pa fund.

— Si është puna? — pyet Meti që ngà «Thanasin».

— Ec përparrë! — përgjigjet Fati.

Kjo është nën përgjegjësinë e tij të plotë. Bâtulla mund të gjallërohet befas, të përfshijë rrjetat. «Ec përparrë!» Për disa çaste kapiteni më duket si një njeri që ka fuqi të shohë nën ujë.

Bri Kepit të Selitës, aty ku mbaron bregu i gjatë me dafina dhe fillon pylli i Divjakës, mbi anije nisën të silleshin fare afër pulëbardhat, duke piskatur me alarm. Shoh me habi se Fati i ndjek me sy si një cunak. Po nuk gjëzohet me to, përpinqet të kuptojë diçka, ndërron edhe

një herë kursin ^{5°} dhe një gjysmë ore më pas nxjerrim kalatën. Njëqind e tridhjetë arka. Me këto plotësohet planisja tek delonga togu i sardeles edhe një «shtizë» dhjetekilëshe; e zezë, në trajtë e një predhe. Këtu fillon të ndërrojë edhe peshku. Pulëbardhat po bëjnë festë. Lëshohen mbi sardelen e démtuar në det njëra pas tjetrës, duke ruajtur radhën e gjuetisë. Më stë rejt gabojnë në shenjë. Fati kërkon diçka në det, me atë shikimin horizontal të vëmendshëm, të shqetësuar. Po nuk thotë asgjë. Besoja se tani, buzë mbrëmjes, do ta mbyllte gjuetinë. Por u vumë menjëherë në rrugë, bri pyllit të Divjakës, që duket si rrip i prerë, i gjatë e i blerëtë. Ja edhe plazhi i bardhë, mbi të cilin zotëron me madhështi ndërtesa e kampit. Sikur të zbritje diku në tokë, ky breg do ta humbiste bukurinë magjike që i jep pamja nga deti.

4

Në jug duken Sazani e Karaburuni, në lindje malet e Tepelenës dhe në verilindje «Baba» Tomori. Janë të rënda e të lëmuara, me një ngjyrë të bukur hekuri, si të pikuar në vjollcë dhe ngjan sikur mund të arrihen me një gjysmë ore lundrim, sidomos Sazani. Kjo pamje e habitshme, që ta çon mendjen larg, drejt gjithësisë, humbi pas disa minutash. Retë nga ana e perëndimit morën të kuqen e flakës. Pastaj të kuqen e perëndimit. U zhduk dhe u ngritë hëna e veshur. U ndezën dy projektorët e anijes, duke hedhur dritën e fuqishme mbi sheshin e kicit, ku po derdhej kalata e fundit. Peshku mori një ngjyrë të fortë argjendi. Përsëri 120 arka nga kjo kalatë e fundit. Peshkatarët i ka pushtuar ethja e pu-

nës. Që nga kuzhina vjen era e supës dhe e peshkut të pjekur.

Një orë më pas, ngado që të ktheheshe, horizonti ishte i zënë me re të buta. Deti ngrihej gjer në qill, ku hapeshin rripa të gjerë me yje. Vetëtinte në thellësi.

— Të ndërtosh shtëpi në të, — thotë Isai, duke parë detin e errët, të qetë xham.

Peshkatarët po tërhiqen për punët e natës. Kjo është nata e tyre, e butë, e qetë, si një kthim në shtëpi pas punës, në shtëpinë lundruese, prej nga s'kanë dalë prej katër ditësh. Poshtë, te fumajoli, Miri po tregon mbasë për të dhjetën herë të njëjtën shaka: I tha ai vajzës: «kam shumë munizione, s'të flas dot». I tha ajo: «léri kontinentet». I thotë prapë ai, «ëndërroj të kem shumë kalamaj me ty». «Çerri» qesh kot, me zë të lartë, Isai shan «Çerrin».

Këta peshkatarët përdorin shpesh fjalë të rënda, që mund ta bënin njeriun të dukej vulgar. Po ja që mbeten të pastër, si fëmijët, sepse shahen pa të keq, pa inat. Fati u përkul mbi balustrën të zadra e shpëtimit dhe u thirri të shkojnë të flenë. Kishte në këtë zë jo vetëm një thirrje, por edhe një lutje, për të qenë të vëmendshëm, tepër të vëmendshëm. Çfarë parandiente ai? Pastaj Fati shau dikë. Edhe ky shan dhe mbetet më i pastër se të tjerët.

Kapiteni kthehet dhe flet në radio me «Thanasin». Zëri i butë mospërfillës i Fatit prapë ka një tingull shqetësimi. Si mbarojnë bisedën të dy kapitenët, papritur gjëmojnë motorët e anijes dhe ajo zë rrëshqet në errësirë si një hajdut i natës. Për ku ky udhëtim i papritur? Fati po i çon të dyja anijet për strehim te godulla e jashtme e Karavastasë. Ai tërë pas-

dreken u ka vënë veshin buletineve të lundrimit në radio, ka ecur poshtë-lart duke nuhatur, duke parë barometrin. Ndien afrimin e diçkaje të pazakontë. Tani është përkulur mbi radarin. Në xhamin e tij dritat e bardha sajognë një radioskopi në lëvizje. Të duket se sheh qytete e vende të banuara. Në të vërtetë aty pasqyrohen plazhi, qendra e peshkimit, godullat e bren-dshme, pyjet me pishë dhe më tej kodrat e ulëta. Njëzet minuta më pas të dyja anijet kishin arritur në vendet e strehuara. U lidhën në brinjë, u shuan motorët, u ndezën dritat e baterive, rreth e qark sundon errësira dhe një heshtje e shurdhët.

— S'ka si era e pishës, — tha Fati. Ai po mbushej me frysë, duke ecur ngadalë në kuvertën e bashit. Mbi det hapej era e pyjeve të Divjakës. Pastaj Fati hyri në kabinën e tij me një peshkatar të ri dhe mbylli derën.

Djaloshi e kishte fytyrën e bukur në vuajtje. Brenda vetes mban diçka të huaj, të cilën duhet ta heqë në ndonjë mënyrë. Është dënuar nga ndërmarrja me vërejtje me paralajmërim dhe është dërguar në anijen e Fatit. Tani djaloshi duhet të tregojë krejt të vërtetën, ndryshe s'ka pér të pasur përkrahjen e Fatit. Që të dy e dinë se qëndrimi i djaloshit në anije varet nga biseda që do të vijojë dhe pér një kohë rrinë të heshtur, duke u parë ndër sy.

* * *

Agimi ishte me dy ngjyra, i errët në det dhe i bardhë në qiell. Era me shije të kripur vërvshëllente në kuvertë. Kush hynte në kabinën

e timonerisë, hapte derën me forcë dhe kércente brenda duke e mbyllur shpejt, sikur të kishte kapercyer një hendek. Pak më vonë, në detin e shqetësuar, të errët, filluan të dukeshin kreshtat e bardha, si një ushtri e madhe që vjen ultas, duke i bërë tokës një rrëthim.

«I bukur deti?»

«Éhë... i bukur fort!»

Mbi tryezë tundej shishja. Një rrip i varur në mur filloj të shkonte si lavjerrësi i një ore. Kur doli dielli, drita e tij hyri nëpërmjet oblosë si disk rrumbullak dhe filloj të kércentë në kabinë nga njëra anë në tjetrën. Ky duhej të ishte një det katërballësh.

Anija jonë u vu paralel me «Thanasin» dhe u hodh rrjeta.

— Peshku s'ju ka munguar. Keni ngrënë në sasi të madhe, tërë jetën, dhe sot është ditë pune, — po i thoshte brigadier Lleshi dikujt te tamburi i vinçit.

Isai doli më gjysmën e trupit te dhoma e motorëve, shikoi detin dhe tha:

— Kanë përtë ardhur «mullarët».

— Po vijnë me shumicë, — tha Miri që si përt nga kulla e radarit. Ky gjithnjë hipën diku dherri aty mbledhur, me sytë ngjyrë hiri në të bardhë, me flokët të verdhë. I ngjan një maceje që ia ka ëndë të ferkohet. Në çastin tjetër do të zërë të bëjë dicka, të lidhë një tel, të ndreqë një bravë.

Lleshi eci duke u përkundur me trupin e madh të fuqishëm dhe qëndroi në fundin e anijes. Aty pa se kavot e rrjetës ishin në tregull dhe po kthehej, kur dallga e parë e madhe e kapi në befasi dhe e rrëzoi mbi togun e litarëve. Lleshi fshiu ujin nga mjekra dhe mallkoi. Ky të kujton njeriun e lashtë, me

trupin tepër të madh dhe fytyrën eshtake. Ishte i qetë, po nuk duhej ta trazoje në punë e sipër, se atëherë mund të përdorte edhe duart. Rrallë fort, kur grindej me Fatin, Lleshit i ulej tensioni i gjakut, djersinte, shtrihej në shtrat.

«Mullarët» filluan të vinin. Shtëllunga e mëdhe e ujit u përplas në kic, shkuma u tërhoq nga dërrasat dhe hekurat me vërvshëllimë, anija rrëshqiti përtëj si një kriesë e gjallë, duke kërkuar shtigje të buta. Lleshi dhe dy peshkatarë të tjerë u ulën te dera e depos dhe zunë të riparonin një rrjetë. Bregu ishte zhdukur në tymin e dallgëve dhe nga këto anë s'ka vende ku të mbrohesh prej jugperëndimit. Dhe kjo është nga ato anijet e vogla me të cilat deti bën si të dojë, veçse rreziku i vërtetë me to është i paktë. Ama, në këtë zonë e pësoi ajo, «Dafina», që u braktis prej ekuipazhit. Fillova të vëreja pjerrtas zadrën e shpëtimit. Kjo është si një fuçi e vidhosur, një pajisje moderne, që hapet si çadër në det, duke strehuar dymbëdhjetë veta për gjashtë ditë. Në anije ishim njëmbëdhjetë.

Po vinte një «mullar» tjetër, duke u rrötulluar me shpejtësi, në majën e tij valëvitej me kërcënim kreshta e bardhë. Ky «mullar» u ngrit rrith vetes si mur, si një kodër uji e gielbër, i shtyrë nga një shpirt i errët, dhe u përplas në kic me gjëmim. Lleshi prapë fshiu fytyrën, ngriti kokën dhe mbloodi buzët, sic bëhet me një çapkën prej të cilit mund të presësh marrëzi të tjera. Ky det i egërsuar dukej si jashtë kohës e vendit, nën një qiell të bardhë, mos-përfillës, ku vërvshëllenin erëra të largëta. Lleshi uli kokën, vijoi punën e tregoi ngadalë:

— Ajo nuk ishte grua e mirë. Qau hi hi hi,

i dolën edhe dy pika lot. Si do të ikësh ti, i tha kunatës. Pastaj tundi flokët, qeshi ha ha ha.

Peshkatari tregon diçka, bën një punë, që të mbulojë shqetësimin e vet. Dhe ajo gruaja e ve, e dikujt, që aty qan e aty qesh, i ngjan këtij deti, ku shquhen në largësi «mullarët» e mëdhenj të bardhë, si kuaj të hazdisur.

Ky ishte një det gjashtëballësh, që bënte qarkullimin e ujit, pasuronte veten.

Lart, në urën e komandës, Fati mbante timonin, ndërsa hante mëngjesin. Deti mund të ashpërsonej edhe më dhe atëherë askush nuk do të mund të hante. Timoni nuk qëndronte. Tani Fati përpinqet ta zotërojë këtë stuhi të bardhë të papritur me anë të fuqisë së motorëve e të timonit. Do të mbrohet nga dallgët e t'i kthejë shpinën erës që të arrijë të nxjerrë rrjetat. Këtë mot e ka provuar shpesh. Po natyra të bën të çuditesh, sepse asnjë stuhi nuk i ngjan tjetrës. Anija kridhet poshtë si në një gropë që synon fundin e detit, ngjitet lart në një breg me ujë, duke ta sjellë zemrën te gryka. Ky det, me fuqitë e tij mekanike, mund t'i përsërítë goditjet pa fund. Dy peshkatarë të rinj janë bërë petë në palmet. Aty është shtrirë dhe ai tekniku i ndërmarrjes që erdhi në këtë «vijazh» për të provuar diçka në aparatet e ndërlidhjes. Deri mbrëmë tregonte për udhëtimet e tij rrëth Mesdheut. Tani rënkon për ibret, thërrret «amani, hidhmëni në det». Nuk po shoh të afrohet ndokush te zadra e shpëtimit.

Gjatë pesë ditëve kam pyetur veten përse është kaq e përqendruar fuqia e një kapiteni dhe si e përdor ai këtë fuqi. Ja tek është

ky Fati, 35 vjeç, i shëndetshëm, i pashëm, me duart shtrënguar në timon. Asgjë nuk e shquan nga një peshkatar e aq. Dhe këtu në anije rri i veshur si mundet. Mban pantallona të vjetra doku, që i shkurton hera-herës dhe i ka sjellë deri te gjunjët, ecën zbathur, shan e flet njëlloj si të tjerët. Megjithatë, këtu në det fuqia është e tëra në duart e tij. Askush në anije nuk do të ngatërronte një urdhër të Fatit me një shaka. Sa e thotë ai një gjë, do të bëhet në çast. Autoriteti i tij është vendosur kohë më parë dhe përgjithnjë, ai nuk ndien nevojën ta ushqejë me forma të jashtme.

Këtë gjë nuk arrij ta kuptoj. Çdo shef a drejtor, duke qenë nën vështrimet e të gjithëve, duhet ta ushqejë autoritetin e tij çdo ditë. Ndërsa ky, Fati, nuk bën asgjë. Veç punës.

Mendja e tij është e zënë me diçka të dytë, që përbën boshtin e jetës së tij. Këtë e ndien kur flet me të. Ai tërë kohën bën diçka, çohet befas dhe shikon një aparat, i thërrret një peshkatari, ndërsa vijon bisedën me ty. S'ka prehja kurrë, asgjë çast s'mund ta gjesht të lirë. Te një tjetër kjo do të ishte fyese. Po Fati duket sikur vazhdimi shëtë kërkon ndjesë me anë të buzëqeshjes, që e ka mendjen të zënë dhe ti thua me vete se ky njeri s'mund të jetë ndryshe.

Ai do të jetë në anije gjithçka dhe në të njëjtën kohë të mos jetë. Është ai që e çon anijen aty ku duhet, që cakton përmasat e gjue-tisë. Por ai do që këto t'i bëjnë edhe të tjerët, dhe i mëson ata kurdo, në çdo gjë.

S'ka shenjë se do të ulet ky det. Fati po mban timonin prej dy orësh dhe tanë erdhi

çasti i vështirë. Duhet të nxirret rrjeta. Një dallgë mund të flakë në det një peshkatar pa përvojë dhe ta bëjë të zërë aty «not shpirti». Një dallgë tjetër mënd t'i përplasë anijet gjatë manovrës së afritimit.

«Në ballin e tij janë mbledhur rrudhat, sepse po niggjan njëfarë drame. Ai po bën gjumi i një mot kur shumëkush ia ka mbathur drejt porfit. Po të ëcë mbarë, kjo i përket tërë ekuipazhit. Po në daltë bosh, në u dëmtoftë dëckë, atëherë të tjérët vetëm sa kanë zhvilluar urdhurat e tij. Kësh e udhëhoqi këtë gjuejtë të rrezikshmë boshe? Ai, kapiteni. Dhe kështu pjesa e tij është e rendë në humbje dhe e lehte në fitime.»

Fati vendos ta shtyjë nxjerrjen e rrjetës edhe një gjysmë ore dhe qëndron te timoni, ndërsa «Xhirafa» po fshin xhamat që t'i lirojë pafnjën kapitenit. Kjo është e kotë, sepse vjen dallga tjetër dhe varen ujërat prapë, qan deti dhe «Xhirafës» i duhet të kapet fort me duar, duke bërë përtëj xhamave të mjegullt lëvizje qesharake me krahët e gjatë.

Herë tjetër Fatis i ka qëlluar të rrije në timon edhe tetë orë me radhë, duke ngrënë mës kujt e tij. Dhe pastaj, kur të kthehet në shtëpi, plaku ka për t'i thënë: «Prapë paske pirë, or bir.» Ndërsa ai s'ka vënë asgjë në gojë. Këtë e kupton edhe Lupi, qeni më madhështor që kam parë ndonjëherë. Në ditët me tallaze, pa peshk, qeni rri i tulatur, kokulur, a thua se dremit. Në të vërtetë i fergëllon qimja, mbledh gëzimin, që do të shpërthejë me lehje të shpejta, me kërcënimë të gjata ballas dhe anash, po që se Fati do të bëjë një shenjë.

«Thanasi» po thirret përsëri për rrjetën. Ky çast s'mund të shqyhet më. Anijet e kanë

vështirë t'i bëjnë ballë një deti të tillë, me rrjetën prapa. Prapë shoh rrëth vetes fytyra të zbehta, që përpinqen të buzëqeshin, ngërdheshen, që presin atë që do të thotë Fati. Tani lëvizjet e mëtejshme varen nga buzët e tij. Kjo është një tjetër nënshtresë e autoritetit të kapitenit: përvoja, kureshtja për të mësuar, trimëria. Po ndofta mbetet për të parë edhe më.

Nuk u rrëzua në det askush dhe anijet u sollën rrëth njëra-tjetrës disa herë, aty-këtu duke përpjekur lehtë brinjët e mbrojtura nga gomat. Rrjeta dha gati njëqind arka peshk, si dhe një fuçi të madhe me hekurishte dhe sende të tjera që s'ta merr mendja se gjenden në det. Që nga fundi i thesit rrëshqiti edhe një si gjarpër deti, i trullosur nga pesha e fuçisë. Ishte një peshk i gjatë laraman. «Helena morena», tha tekniku i ndërmarrjes. Kishte ardhur deri te kici me mundim, ishte dyllë në fytyrë, dukej sikur do të frëzohej në çastin tjetër. Zuri të shpjegonte se ky lloj peshku, «e bukura e detit», nuk kapet i gjallë kurrë, mbyt veten kur e zë grepi para se të dalë në sipërfaqë. Si tha këto, iku prapë si i dehur dhe pak më tej u përkul më dysh. «Çerri» e ndihu të kthehej në palmet.

Peshkatarëve u qe lagur edhe «gjuha në gojë» dhe qeshnim me egërsi. Anija filloi ta zotëronte detin më mirë me forcën e dy motorëve, me titmonin të lehtësuar. Dallgët ishin më të ulëta, po më të shpeshta, dhe drita dukej e dyshimtë. E vetmja gjë e ndërtuar nga njeriu, që mund të shihje në një det të tillë, ishte anija jonë. Edhe «Thanasi» qe zhdukur. Po rri shtrirë në kabinë, me atë erën e njobur të anijeve në hundë e në mushkëri, duke menduar për jetën e kapiten Fatit dhe forcën e tij të vërtetë.

Si edhe mbi atë «helena morenën» që mbyt veten e nuk dorëzohet. Fati the se tekniku nuk dinte gjë. Ky ishte një lloj peshku tjetër i thellësive. Morena nuk rri në det të hapët, por afër brigjeve shkëmbore.

5

Deti ngrohet në diell, si një konvaleshent, dhe buzëqesh aty-këtu në brigjet. Ngjyrat janë të thella e të gjalla. Njëzet e katër orë më parë këtu ishte një si fushë uji e rrahu nga dallgë të hirta, ku vërvshëllenin djajtë. Tani mezi besohet se ky det i butë është i njëjtë me atë që kaloi.

Sot po shkojmë drejt veriut. Kjo anije e mirë, e ndërtuar në kantierin e Durrësit, çan me bashin e mprehtë duke u lëkundur me një hijeshi që të merr zemrën. Kjo anije është një pelë deti për qejf dhe spiranca 200-kilëshe me vinçin përkatës janë freri i saj. Po mësohem ta dua këtë anije nga spiranca e bashit deri te teneshiri i kicrit. Po sidomos dua njerëzit që bart ajo.

Qëndruam vetëm një natë në Durrës. Fati nuk rri më tepër, veç kur s'ka ç'të bëjë. Aty në tokë, i veshur mirë e pastër si një shkollar, ai i ngjan një udhëtarë në një stacion, që pret nisjen me njëfarë shqetësimi. Kur iu afruam portit, deti kishte rënë, nëpër mjegull vinçat e lartë ngjanin si qukapikë të mbetur në ajër. S'kishte lëvizje. Bankinat e ndërmarrjes ishin të mbushura me anije peshkimi, një qytezë liliputësh me qindra dritare të vogla në përgjim. Kur u akostuam, pamë njerëzit që na pritni. Ishte edhe drejtori, burrë i ri flokëverdhë, me

shikimin të menduar. Në krah, i rrinte kryein-xhinieri, pak i shogët, me sytë e zinj të ndritur. Pyetën si ishim dhe si kishte vajtur gjue-tia dhe ikën në një mbledhje. Pastaj mësuam se ata kishin ndenjur tërë kohën pranë radios. Këtu njerëzit nuk i shfaqin ndjenjat, janë të kursyer në fjalë e në lëvizje.

Kurse tani jemi prapë në udhëtim të shpejtë, arrijmë mbi 20 km në orë dhe po qarkojmë Bishtin e Pallës. Më në fund po e shoh Fatin të flejë. Duket se ndien në trup dridhjen e këndshme që i jep shtratit motori i fuqishëm poshtë, dhe me këtë e zë gjumi sikur ta përkundrejtë nëna e tij. Por nuk është e thënë të flejë. Njëri nga motorët zuri të bëjë ujë.

Kalata e parë dha 23 arka peshk. E dyta 15. Për dy orë të tjera aparati nuk shënoi lëvizje peshku, deri pasdite i ramë detit poshtë e lart, «dogjëm naftë», sipas vijave të lakuara batimetrike që shënonë harta, me të njëjtin përfundim. Ishim si njerëz që bredhim përmend në një fushë të hapët uji.

Kjo dukej si një nga ditët pa peshk. Kapiteni do të ngulmonte deri në darkë, më shumë duke ecur poshtë e lart anijes, zbathur, kokullur, duke férkuar gjoksin. Përgjigjet nën zë dhe më mirë të mos i flasësh. Dhe, po nuk i fole, flet ai, pyet përmirëse radhën në timon, përlistën e shërbimit natën, megjithëse këto punë në anije ecin vetë, sikur t'i rrotullonte një dorë e fshehtë. Në mbrëmje Fati ka përmend të shënimet në regjistër. Shënimet provojnë, vite me radhë, se në këtë zonë e në këtë stinë të motit këtu ka lëvizur sardelja. Ku gjendet burimi që

e ka têrhequr? Duket sikur e têrë gjuetia është pakësuar. A tha lumenjtë tanë të shumtë, nga Vjosa në Drin, nuk sjellin më ushqim të mjaf-të? Fati ka pér ta kérkuar këtë gjë me mendje, duke ndenjur natën në shtrat me sytë mbyllur.

Në orën katër, afér Rodonit, na priu e mbara. Zumë 120 arka sardele dhe gjashtë peshq mbi, 20 kg copa. Në anije u kthyte gjallëria. Pér habinë time, Fati nuk e lëshoi rrjetën prapë. Të dyja anijet u vunë në rrugë me forë, përgjithës pushimin e natës. Po shkonim drejt gjirit të Rodonit me tufën e delfinëve prapa dhe pulëbardhat mbi krye.

* * *

Një gji deti si i bërë me dorë, krejt i qetë, me ujin në ngjyrë të gjelbër. Ky është Rodoni. Në skaj shtrihet mbi det një vijë ranore që mezi dallohet. Në mbërim të saj është një shkëmb, një platformë e gûrtë nenujore, pikë ku kâllafatonin anijet detarët e vjetër. Aty është edhe burimi i fuqishëm me ujë të ëmbël të freskët, që del nga fundi i detit. Detarët e merrnin këtë ujë me kova drejt nga anijet.

Shkojmë paralel me bregun kodrinor, me shkëmbinj argjili. Pyjet që veshin faqet e kodrave duken me majë të verdha, ndofta për shkak të lules së gjineshtrës. Ndërsa kurrizet e kodravë janë krejt të lëmuara, të mbjella me grurë dhe hapen si një valëzim i madh që mbulon kepин në têrë gjatësinë.

Ja edhe Kalaja e Skënderbeut, me muret e

rrënuara, të trasha e të hirta, Për shkak të një-farë mjegulle a tymi, të duket se ke përpara një fotografi të pazhvilluar mirë. Sa më tepër përpinqesh të depërtosh, aq më shumë mjegullohet pamja. Po ja tek ngrihet mbi muret ai vetë, Skënderbeu 60-vjeçar, me armaturën e rëndë, i mbështetur me të dyja duart mbi shpatën dhe shikon i menduar. Ai ka ndenjur tërë kohën me shpatullat në male, por i duhen këto dalje në detin ku lulëzon tregtia. Ai përkulet nga-dalë, sikur mban vesh një mendim të dytë. Prej këndej kanë ardhur nganjëherë edhe be-fasitë. Pastaj ai zbret në shesh i përcjellë nga një turmë me luftëtarë, që shtyjnë një rob me veshje të bucura, si një dordolec që nuk i zotëron gjymtyrët. Nga gjithë robërit vetëm këtë shtyjnë drejt mesit të sheshit. Nga krahу i detit afrohen me druatje dy kapitenë venedikas me shpatat e holla në ijë.

Në sheshin e vogël të blertë zotëron hesh-tja. Skënderbeu pyet robin për diçka, zgjat-kokën me kujdes të dëgjojë përgjigjen. Skënder-beu nxjerr shpatën dhe mendohet. I sillet ro-bit nga ana tjetër. Ka një dëshirë të madhe t'ia çajë nipit trupin për së gjati, ta shohë njëherë me sytë e tij si është nga brenda tradhi-tia, që ia mundoi shpirtin tërë jetën, por këtë nuk e bën dot në praninë e të huajve, dhe be-fas rrëzohet shpata me flakërimë, koka e robit shkon mënjanë, ndërsa trupi bie në krahun tjet-ter, ashtu siç bie një trup i vdekur që më këmbë, me gjakun të mpiksur nga llahtara. Skënderbeu e kalon trupin e rëndë me hapin mospërfillës, ecën ngadalë drejt mureve dhe zë e tretet në mjegull. Sa herë e kisha parë me mendje këtë skenë!

Po kurrë nuk ishte dridhur aq fort imagjina
nata ime. Ishte hera e parë që e shihja kalanë
nga deti.

Lundrojmë ngadalë brenda gjirit. Anija lëkundet lehtë, hidhet përpara si e mbajtur nga një forcë e fshehtë.

Fati rri mbështetur te balaustra, bën me mendje hartën e plotë të gjirit. Më duket se ai e njeh këtë det me pëllëmbë, sidomos nga Divjaka në Shëngjin. Në çdo pikë që ta lëshosh, qoftë edhe në errësirë, zë e nuhat ujin dhe bregun. Kjo nuk është gjë e lehtë. Në det s'është si në tokë, ku mund të zbulosh një vend dhe ta fiksosh në mendje sipas shenjave. Për të njobur detin duhet të provosh të gjitha erërat dhe prapë nuk mjafton.

Dielli preku detin dhe, kur filloi të zhytej, mori ngjyrë të butë portokalli, gati të kuqe. Kjo dritë e kuqe u përhap në tërë vijën, sikur të digjej një zjarr i madh në kufirin e gjithësisë. Brenda në gji lëviznin rryma të qeta, po deti tej zuri të «kthente», ndofta shkumëzon te lehtë. «Se ai është një masë lëvizëse pérherë në ndryshim...»

— Ky gji është i mbrojtur nga erërat prej perëndimit në lindje, — thotë Fati. — Le të shpërthejnë stuhitë nga të tria anët, këtu anijet do të gjejnë një strehë të qetë. Veç po të fryjë veriu.

Aty më parë, kur po kalonim afër kalasë, Fati ngadalësoi shpejtësinë e anijes, ndofta në shenjë nderimi. Tani shikon këtë gji të habitshëm, si një skenë boshe, ku dikur janë lu-

ajtur drama të rënda dhe lëviz buzët, thotë me vete diçka. Më duket se tani shpirti i tij do të zërë të hapet krejt, ky është një rast dhe i afrohem ta shoh më mirë. Po çasti kaloi, ai kthehet e bëhet Fati i çdo dite, shikon edhe një herë rrrotull gjirit që po errësohet dhe fillon manovrat e atrimit të anijeve për pushimin e natës.

* * *

Poshtë në mensë, brigadier Lleshi, përgjegjës i grupit të edukimit, po u bën peshkata-reve informacionin politik favor. E pashë në mëngjes tek përgatitej. Rrinte këmbëkryq pas fumajolit, me mjekrën e rëndë shtrënguar. I duhej të përplaste kokën kundër paditurisë së tij, për të shpjeguar disa ngjarje të Amerikës Latine. Po duket se më në fund mbeti i kënaqur. Futi bllokun në xhep, u mblodh në veten e tij me bërrylat mbi gjunjë, si një katana, dhe ia mori një kënge të vjetër të padëgjuar.

Të dyja anijet janë lidhur në brinjë. Cunat po ngjiten lart te televizori, për të parë një ndeshje futbolli. Unë dhe Fati po shkojmë për darkë te «Thanasi». Festohet mbyllja e planit 6-mujor një ditë para afatit. Në bordin e «Thanasit» na pret motoristi i parë. Ky është 40 vjeç, kosovar me flokët e thinjur të prerë shkurt. Në det rastis të takosh njerëz nga vise të ndryshme dhe me karaktere nga më të ndryshmet.

Njeriu kujton se ha peshk, sa kohë s'ka ngrënë peshk të gatuar prej zanatçinje në anije. Atëherë sheh se peshku qenka një gjë

tjetër, me shije që vërtiten si trëndafili i erë-rave. Sa më shumë të hash peshk, aq më tepër, mësohesh me të. Nuk të bien më ndërmend gjërat e mira që hahen në tokë. Në fillim hëngrëm një supë me sardele, pastaj fileto. mëlci e vezë peshku. I kishte gatuar Fati. Meti kapiteni i «Thanasit», buzëqeshte, krenohej edhe pér, këtë zotësi të shokut, si pér një veti që mund ta kishte vetëm ai.

Përballë rri një inxhinier i Institututit të Peshkimit. Shpesh kafshon thonjtë, kruan tëmthim. Nga trupi vjen i paktë e i thatë. Nesër ai do të provojë me të dyja anijet një rrjetë që është thurur nën drejtimin e tij. Mendjen e ka të ngulur te llogaritë dhe merr vjesë në bisedë vetëm kur flitet pér rrjetat. Nganjëherë zma-dhon sytë, si para një hendeku. Po të dalë nesër prova mirë, kjo gjueti e re e sardeles ka pér t'u përhapur në krejt ndërmarrjen e peshkimit. Ta ka ënda të shohësh një njeri të thi-thur tërësisht nga vuna, deri në hutim. Një-rëz të tillë gjithnjë do të nxjerrin diçka në krye.

Darka po shkonte përpëra me kujtime të rastit. Meti tha se profesori i navigacionit në shkollën «Hysni Kapo» nxohej fort vo të thoshe «bashis» e «kicis». Të ulte notën. Pranonte vetëm termat shqip. Mirëpo peshkatarëve u është, ngulitur ajo gjuha e detarëve ulqinas e durrësakë. Pér dişa caste fytyra e pashme prej djaloshi e Metit ndriti prej kujtimit të bukur të shkollës.

Tari gjymtyrët, dhe mendjet e kapitënëve ishin të lira, ata do të jepeshin pas tregimeve, avarive në det, ngjarjeve të rënda, pér të cilat kisha pritur një javë, të dëgjoja. Kjo ishte ana tjetër e jetës së tyre, si «ujqër» të rinj të detit. Pop ata prapë folën pér punët e ditës.

Avaritë, telashet e detit, s'duan t'i zënë në gojë.

Në cepin e pasqyrës ishte fotografia e djalit pesëvjeçar të Fatit. I bëra shenjë me gisht. Fati buzëqeshi, tha:

— Nuk e di pse do t'i bëjë të gjitha si unë. Çdo gjë.

Djali ecën, ha, flet dhe zemërohet si i ati.

— Endërron anjen. Stërvitet në tokë, —

thashë unë. Lindi ajo biseda e zakonshme për prindët që s'duan t'u japin fëmijëve profesionin e tyre. Fati dëgjoi me vëmendje, tha:

— Zanati përparon edhe më mirë kur trashëgohet.

Ai vetë ishte lidhur me ujin e më peshkun cë tetë vjet, kur shkonte pas dajës, që sillej ditë me radhë në Erzen. Shpirti i tij prej fëmije u mbush, ra rob. Uji ishte jetë. Që atëherë as i ka shkuar në mend se mund të bënte ndonjë punë tjetër. Në cilin zanat mund të përparojë njeriu pa qenë i udhëheour nga një pasion që të merr shpirtin? Djali duhet të mësohet ta dojë detin që tani.

U shuan motorët dhe u ndezën dritat me bateri. Për disa caste sundoi qetësia.

— Hëngre mirë, — i thashë Metit.

— E do puna, — u përgjigji ai. — Nuk i dihet. Nganiherë të ushqejnë të tjerët në timon si bebet.

— Deti kërkon energji.

— Tërë kohën pas e përpara, me dhëmbët shtrënguar. Duhet forcë për të mbajtur drejt-peshimin.

Sido cë të bëhej, ata nuk do të tregonin përngjarië të shkuara. Ishin të interesuar për lëtersinë.

Ylli i Mëngjesit ulet e ngrihet, ose bën një gjysmë rrathi. Një yll që të vallëzojë me gëzim mund ta shohësh vetëm nga obloja e një anijeje. Edhe pak e do të çohet Fati. Nga përkundjet e gjata të anijes duket se deti jashtë gjiritë është egërsuar prapë. A është ky një det i mbarë për provën e atij inxhinierit të institutit? Në orën 5 anijet u nisën dhe ranë në shkumën e valëve të shpeshta, duke kërkuar rrugët e gjuetisë e të shkencës.

«I bukur deti sot?» — pyet «Xhirafa».

«Ehë... i bukur!»

Jeta e peshkatarit është e rëndë dhe e bukur. Ndofta asnjë mënyrë të jetuari nuk do të ishte e denjë dhe me të vërtetë e bukur, po të mos qe në njëfarë mënyre e rëndë, e vësh-tirë, e imprehtë. Sepse gjérat e lehta sjellin monotonin, impirjen e mendjes e të shpirtit.

Jemi të dy me Fatin në kabinë. Duket se nuk është ngopur më gjumë. Ai ka qenë me mua tërë kohën i sjellshëm e plot kujdes, po në ditët e fundit ndahet hera-herës e më shikon me vëmendje.

— Qëllofsh, — i thém unë.

U shikuam thellë në sy, jo kalimthi, si më parë, po gjatë, dhe qeshëm. Besoj se po më zë ajo sëmundja që i thonë «malli i detit» dhe që mbetet përgjithnjë në fundin e shpirtit.

PËRMBAJTJA

KALËRIMI I GJATË MBI DRIN	3
QYTETI I BARDHË	34
NË KUFIRIN E MINERALIT	58
UJÉRAT E BRENDSHME	67
ERA E MBARË E TEPELENËS	86
KOHA E BARIUT	104
KRIPA E TOKËS	112
PROFILI I MALËSISE SË ULET	137
DRITA E GURIT TË KRUJËS	149
DREJT SË BUKUREŞ E SË DOBISHMES	159
LËVIZJA E DHEUT	173
VËRSHIMI I JETËS	198
KOHËT QË SHKOJNË, KOHËT QË VIJNË	210
KAPITENI	224

Titulli 4000 rređe
Titulli 35x78/10
Titulli 35x78/10
KOMBIKATI POLITOGRAFIK - SHKUP
Titulli 1988